...Nëse do të mësosh se si kanë rrjedhur ecuria dhe fuqizimi i mbështetjes për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe rrugëtimi i njerëzve drejt saj, ky libër është një vlerë dhe njëkohësisht një dritare e pazakontë. Nëpërmjet fakteve dhe dokumenteve historike, shumica të cituara dhe të botuara në libër, mund të mësosh se është kaluar nëpërmjet shpalljes së fakteve, edhe kur nuk je i besuar; nëpërmjet deklaratave, edhe kur ato janë quajtur heretike; nëpërmjet njohjeve me publicistë dhe aktivistë të të drejtave të njeriut, edhe pse fillimisht kanë qenë të paktë; nëpërmjet botimeve të ndryshme në shtypin e kohës; edhe pse gazetat bënin kujdes; nëpërmjet takimeve me shtetarë dhe diplomatë; edhe pse ata ishin të vëmendshëm që të mos trazonin Jugosllavinë e mbetur, deri tek kalimi në demonstrata dhe protesta masive... Ky përshkallëzim ka çuar pastaj deri tek njohja, përkrahja dhe mbështetja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës...

Bedri Islami

ISBN 978-9951-8503-3-9

POLITIKA NORDIKE DHE RRËFIM I NUFRI R. LEKËS PËR VEPRIMTARINË E TIJ NË KUADËR TË ORGANIZATËS LËVIZJA POPULLORE E KOSOVËS (LPK)

POLITIKA NORDIKE

dhe një rrëfim i Nufri R. Lekës për veprimtarinë e tij në kuadër të organizatës Lëvizja Populllore e Kosovës (LPK)

LPK

1982

POLITIKA NORDIKE

dhe një rrëfim i Nufri R. Lekës për veprimtarinë e tij në kuadër të organizatës Lëvizja Popullore e Kosovës (LPK)

Botues
“Epoka e re”

Copyrights
Nufri Lekaj

Redaktor gjuhësor
Mr. Sci. Berat Dakaj

Redaktor teknik
Shkembim Krasniqi

POLITIKA NORDIKE

dhe një rrëfim i Nufri R. Lekës për veprimtarinë e tij në kuadër të organizatës Lëvizja Popullore e Kosovës (LPK)

Botues
"Epoka e re"
Prishtinë, 2014

Përkujtime e nderime të gjithhershme mikes, humanistes, idealistes dhe veprimtares së vyeshme për lirinë dhe të drejtat e shqiptarëve, znj. Berit Backer.

Lavdi!

Përmbajtja

PARATHËNIE - GJERGJ KABASHI, DREJTOR I REVISTËS "DRINI"..... 9

REZYME HISTORIKO-POLITIKE E SHTETEVE NORDIKE 11

NJË RRËFIM I NUFRI R. LEKËS PËR VEPRIMTARINË E TIJ NË KUADËR TË ORGANIZATËS LËVIZJA POPULLORE E KOSOVËS (LPK)..... 59

REFERENCAT E INTERVISTËS NË ORIGJINAL DHE SHQIP 109

FOTOALBUM..... 235

PASTHËNIE / BEDRI ISLAMI, ISH-KRYETAR I LPK-së..... 261

Parathënie

Në maj të vitit 2012 revista "Drini", në kuadër të shënimit të 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, i bëri një kërkesë veprimtarit të njohur të çështjes kombëtare me banim në Oslo të Norvegjisë, z. Nufri R. Lekës, që nëpërmjet një interviste të rrëfejë për veprimtarinë e vet patriotike në diasporë.

Pasi kërkesa e revistës "Drini" ishte që intervista të bazohej në dokumente/referenca të verifikueshme, intervista e botuar doli e gjatë. Rrjedhimisht, me iniciativat dhe propozimet e ish-bashkëveprimtarëve dhe miqve të Nufri R. Lekës, revistës "Drini", lexuesve të revistës "Drini" etj., u vendos që kjo intervistë me dokumentet/referencat përkatëse të përkthyera në gjuhën shqipe të botohet në këtë libër si një rrëfim i komprimuar dhe i dokumentuar i Nufri R. Lekës për veprimtarinë e tij në kuadër të Lëvizjes Popullore të Kosovës.

Së këndejmi, lexuesit e këtij libri e kanë mundësinë të lexojnë edhe një rezyme historiko-politike të shteteve nordike, që të informohen më konkretisht dhe më thellë për politikën nordike. Kjo rezyme historiko-politike e shteteve nordike është shkruar enkas për revistën "Drini" nga Fatmir R. Lekaj, politolog, por për të parën herë botohet në këtë libër.

Gjergj Kabashi, drejtor i revistës "Drini", 2013

Rezyme historiko-politike e shteteve nordike

Hyrje

Shikuar historikisht, shtetet nordike karakterizohen nga veçantia e përbashkët në politikat e tyre të brendshme dhe nga dallueshmëria në politikat e tyre të jashtme. Duke i identifikuar disa karakteristika të përbashkëta të shteteve nordike në politikat e tyre të brendshme, mund ta përkufizojmë në një mënyrë më konkrete veçantinë e përbashkët politike të shteteve nordike por, vetëm duke i identifikuar këto karakteristika si një pako karakteristikash të shteteve nordike, e jo si karakteristika të izoluara veç e veç, sepse ndonjëra nga këto karakteristika, si karakteristikë e izoluar, mund të identifikohet në një masë edhe në politikat e shteteve të tjera evropiane. Duke marrë pikënisje në historinë politike të shteteve nordike, mund t'i identifikojmë në një mënyrë më të thellë shkaqet historiko-politike që i kanë kushtëzuar shtetet nordike të evoluojnë dallueshëm në politikat e tyre të jashtme, gjithashtu t'i diferencojmë (në bazë të rolit të tyre proaktiv) në kuadër të bashkëveprimit ndërkombëtar.

Karakteristikat që i dallojnë shtetet nordike nga shtetet e tjera evropiane

Fillimi i vitit 1930 shënon një pikënisje për formësimin e dallueshmërisë politike në mes të shteteve nordike si një grup shtetesh (Danimarkës, Suedisë, Norvegjisë, Finlandës, Islandës) dhe shteteve të tjera evropiane. Kjo periudhë e fillimviteve 1930-ta në shtetet nordike konsiderohet si "një rrugë e tretë" (në mes të fashizmit dhe komunizmit) e karakterizuar me më pak konflikt në shoqëri dhe me nivel punësimi më të lartë. Me fjalë të tjera, përderisa në këtë periudhë, pothuajse në tërë kontinentin e Evropës, sistemet demokratike u zëvendësuan nga sistemet autoritare, në shtetet nordike lulëzuan sistemet demokratike të karakterizuara nga: lëvizjet e forta korporative, nga shtetet aktive/ndërhyrëse në ekonomi, nga lëvizjet e fuqishme të punëtorëve që u centralizuan në organizata të

mëdha, në veçanti në Skandinavi (Danimarkë, Suedi, Norvegji). Kjo dallueshmëri në mes të shteteve nordike dhe shteteve të tjera evropiane ka rezultuar me kohë në disa karakteristika që, si një pako karakteristikash, i dallojnë shtetet nordike nga shtetet e tjera evropiane.

Sistemi multipartiak me aftësi të fortë të vendimmarrjes është një karakteristikë e përbashkët e shteteve nordike në kuptimin se një numër i madh i partive janë pjesë e parlamenteve nordike dhe se, pavarësisht që asnjë parti nuk e ka shumicën, ekziston aftësia për vendimmarrje. Gjithashtu, tradita konsensuale për dizajnimin e politikave është karakteristikë e shteteve nordike, që nënkupton se ekzistojnë praktikat për përpjekjet në arritjen e konsensuseve për çështjet politike: duke marrë pikënisje në pikat pajtuese në mes të palëve kundërshtuese, e jo duke marrë pikënisje në pikat kundërshtuese. Me fjalë të tjera, politikanët në shtetet nordike janë shumë të prirur të përpiqen të ndërtojnë konsensuse për çështjet politike, fillimisht duke pasur aftësinë dhe vullnetin t'i identifikojnë pikat për të cilat pajtohen, pastaj duke u përpjekur ta zgjerojnë këtë unitet rreth pikave pajtuese.

Një karakteristikë tjetër shumë e rëndësishme është korporativizmi shoqëror, që nënkupton se grupet e interesit, shoqëria civile në përgjithësi dhe ekspertët e kanë një rol shumë të rëndësishëm në dizajnimin e politikave nëpërmes "kanalit korporativ". Grupet e interesit dhe shoqëria civile në përgjithësi, duke marrë pjesë në komisione për çështjet e caktuara (nëpërmes takimeve të rregullta në komisionet negociuese me autoritetet shtetërore: burokracinë, komitetet partiake pranë parlamentit etj.) e kanë ndikimin e vet të rëndësishëm në dizajnimin e politikave. Gjithashtu, ekspertët e fushave të caktuara e kanë një pozitë të fortë dhe legjitime në dizajnimin e politikave, jo duke u bazuar në politikat ideologjike, por duke u bazuar në radhë të parë në njohuritë e tyre profesionale që kanë për fushat e caktuara.

Korporativizmi shoqëror (si zgjidhje në mes të korporativizmit shtetëror dhe lobizmit) legjitimohet në bazë të argumentimit se kanali korporativ (kanali organizativ) e plotëson (por nuk e zëvendëson) demokracinë reprezantuese (kanalin numerik, zinxhirin e udhëheqjes

parlamentare nëpërmes votës së dhënë nga qytetarët). Njëkohësisht, kanali korporativ e forcon legjitimitetin dhe efektivitetin e shtetit, sepse shteti nga njëra anë më lehtë e legjitimon ndërhyrjen e vet në implementimin e vendimeve politike, duke i bërë bashkëpërgjegjëse organizatat (palët e prekura/përfshira për çështjet e caktuara) gjatë procesit të dizajnimit të politikave të caktuara, nga ana tjetër shteti bëhet më efektiv (me zgjerimin e detyrave shtetërore) duke e deleguar autorizimin (nëpërmes kanalit korporativ) tek organizatat e caktuara për t'i implementuar politikat e caktuara.

Po nëpërmjet kanalit korporativ (duke u marrë parasysh dhe duke u negociuar interesat dhe vlerat e grupeve të ndryshme shoqërore) shmangen dhe mbahen nën kontroll konfliktet e mëdha në shoqërinë si tërësi. Megjithëkëtë, korporativizmi shoqëror gjatë disa periudhave kohore ka rezultuar me tendencën e segmentimit të interesave të caktuara (që përfaqësojnë resorët e caktuar dhe të rëndësishëm ekonomikë) duke mos marrë parasysh interesat e grupeve të tjera shoqërore dhe interesin e shoqërisë si tërësi. Këto interesa segmentohen duke u bërë aleancat në mes të grupeve të caktuara shoqërore të interesit, komiteteve përkatëse në parlament dhe drejtorive/ministrive përkatëse saqë në periudha të caktuara studiuesit kanë konstatuar se ky segmentim ka shkuar në dëm të demokracisë reprezantuese (kanalit numerik) në kuptimin se "votat po numërohen, ndërsa interesat e segmentura po vendosin më shumë". Për shembull, në vitet 1960-ta studiuesit e kanë ngritur për shqyrtim të ashtuquajturën tezën e segmentimit, e kjo ka ndikuar që politologët dhe sociologët norvegjezë të bëjnë një hulumtim të gjatë në periudhën 1972 - 1981 nëpërmes të ashtuquajturit "Raporti për pushtetin". Gjithashtu, në Suedi është bërë një hulumtim i ngjashëm në periudhën 1985-1990. Një raport të ngjashëm studiuesit norvegjezë e kanë bërë edhe në periudhën 1998-2003.

Gjatë viteve '80-ta studiuesit kanë identifikuar një transformim nga tendenca e "segmentimit korporativ" në tendencën e "përgjithësimit korporativ", që nënkupton se nga njëra anë grupet e interesit fillojnë t'i marrin parasysh interesat ndërgrupore, duke bërë aleanca ndërgrupore jashtë segmenteve të interesave të tyre që i përfaqësojnë, pa marrë parasysh forcën ekonomike që e reprezantojnë grupet e

ndryshme të interesit. Nga ana tjetër, grupet e interesit nëpërmes dialogut deliberativ ndërgjegjësohen për t'i legjitimuar interesat e tyre, duke argumentuar se interesat e tyre janë edhe interesa që i shërbejnë shoqërisë si tërësi (grupet e interesit që të mund ta legjitimojnë ekzistencën e vet, vetëdijesohen se interesat që i përfaqësojnë mund të legjitimohen vetëm derisa nuk janë të dëmshme për interesin e përgjithshëm të shoqërisë si tërësi). Me fjalë të tjera, tendenca e segmentimit korporativ karakterizohet nga veprimi strategjik dhe segmentimi i formalizuar institucionalisht në mes të shtetit dhe grupimeve shoqërore, duke ndërkomunikuar interesin e përgjithshëm të shoqërisë si tërësi. Ndërsa tendenca e përgjithësimit korporativ karakterizohet nga veprimi deliberativ (argumentimi) dhe intersegmentalizmi, duke e komunikuar edhe interesin e përgjithshëm të shoqërisë si tërësi. Rrjedhimisht, tendenca e përgjithësimit korporativ ndikon që korporativizmi shoqëror të bëhet edhe më pak i formalizuar dhe edhe më shumë pluralist, duke e përfshirë edhe veprimtarinë lobiste. Për shembull, kontaktet joformale në mes të politikanëve dhe shoqërisë civile.

Një karakteristikë tjetër që dominon në shoqëritë nordike janë marrëveshjet kolektive të punës në lidhje me pagat, kushtet e punës, orarin e punës, pushimin etj., si rezultat i negociatave në mes të organizatave të punëtorëve dhe organizatave të punëdhënësve. Kjo nuk do të thotë se nuk ka edhe përcaktime individuale të pagave, por marrëveshjet kolektive të punës (për dallim të shteteve të tjera) janë shumë dominuese në shtetet nordike.

Shtetet nordike janë të karakterizuara nga një traditë e fortë e ndërhyrjes së shtetit në rregullimin e tregut, duke bërë kështu që shteti të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në ekonomi. Me fjalë të tjera, shtetet nordike janë aktive në rregullimin e tregut, duke qenë të prirura nga ideja se rregullimi i tregut në mënyrë të caktuar i shërben shoqërisë si tërësi në kuptimin se: kur një grup shoqëror e përjeton se shteti duke qenë aktiv në caktimin e rregullave të tregut i krijon siguri ekonomike, atëherë edhe grupet e tjera shoqërore kërkojnë nga shteti një siguri të ngjashme ekonomike, e në këtë mënyrë shteti arrin t'i evitojë problemet që rrezikojnë mirëqenien e përgjithshme shoqërore (shtetin e mirëqenies). Rrjedhimisht, historia e shteteve nordike në

raport me tregun e lirë karakterizohet fillimisht nga disa rregullime të vogla të tregut dhe gradualisht nga evoluimi i sistemit si tërësi në drejtimin ku shumica e grupeve shoqërore kanë kërkuar mbrojtje ekonomike nga shteti. Kjo nuk nënkupton se ndërhyrja e shtetit mund t'i rregullojë të gjitha problemet ekonomike, por nënkupton se ndërhyrja e shtetit mund të kontribuojë shumë për një ekonomi dhe për një mirëqenie më të mirë.

Një karakteristikë tjetër e shteteve nordike është se elitat kanë relacione të personalizuara duke u njohur në mes vete (jo vetëm personalisht, por edhe në lidhje me pikëpamjet, vlerat dhe preferencat politike), e kjo kontribuon që më lehtë të vijnë tek zgjidhjet pragmatike për çështjet politike. Me fjalë të tjera, relacionet e personalizuara kanë krijuar një traditë që nënkupton se elitat në shtetet nordike (elitat politike, elitat e shoqërisë civile, elitat burokratike etj.) e kuptojnë më lehtë se çka është e rëndësishme për palën e kundërt dhe anasjelltas, duke rezultuar kështu në një kulturë negociuese, në një kulturë të përmbajtjes nga ofendimet personale ndaj njëri-tjetrit. Janë evidente kompromiset kur njëra palë heq dorë nga diçka më pak e rëndësishme, e pala tjetër heq dorë nga diçka më pak e rëndësishme, duke u takuar kështu në një pikë afër mesit. Relacionet e personalizuara në mes të elitave janë fenomene të shteteve të vogla, jo vetëm të shteteve nordike. Kjo mund të jetë negative në disa shtete ku ekziston kultura e korrupsionit, por në shtetet nordike kjo ka luajtur rol pozitiv për kompromiset në politikbërje. Megjithëkëtë, duhet potencuar se ka edhe biefekte të këtyre relacioneve të personalizuara. Për shembull, nganjëherë shfaqet fenomeni kur "shoku shokun e punëson në nivele të larta shtetërore", duke shpërfillur kështu kriteret për punësim. Por, ky fenomen, sapo të shfaqet, luftohet në mënyrë efikase nga mediet dhe ligjet përkatëse konform kritereve ligjore për punësim.

Sistemet partiake në shtetet nordike janë të karakterizuara nga modeli nordik pesëpartiak. Me fjalë të tjera, sistemet partiake në shtetet nordike mund të përkufizohen dhe analizohen duke marrë pikënisje këtë model pesëpartiak, njëkohësisht edhe duke u bazuar në devijimet nga ky model. Prapavija historike e modelit nordik pesëpartiak është, nga njëra anë e karakterizuar nga qendra e djathtë

politike deri tek e djathta politike (partitë agrare, partitë liberale dhe partitë e djathta konservative), nga ana tjetër nga qendra e majtë politike deri tek e majta politike (partitë socialdemokrate dhe partitë revolucionare komuniste). Rrjedhimisht, modeli nordik pesëpartiak (edhe pse emrat e partive simotra në shtetet nordike dallojnë pjesërisht me njëra-tjetrën) është, nga njëra anë i karakterizuar nga një parti e madhe socialdemokrate (dy ose tri herë më e madhe se partitë e tjera) dhe nga një parti e majtë socialiste si parti më e vogël (në disa raste e bazuar në partinë e mëhershme komuniste), nga ana tjetër nga një parti liberale, nga një parti agrare dhe nga një parti e djathtë konservative.

Ky model nordik pesëpartiak është i idealizuar sepse duhet pasur parasysh se në kohë dhe hapësirë ka devijime në sistemet partiake nordike që nuk korrespondojnë krejtësisht me modelin nordik pesëpartiak, sidomos Islanda dhe Finlanda, por nga pak devijojnë edhe shtetet skandinave. Megjithëkëtë, prej viteve 1920-ta deri në vitet 1970-ta sistemet partiake në skandinavi (Suedi, Norvegji dhe Danimarkë) korrespondojnë në një shkallë të lartë me modelin nordik pesëpartiak. Për shembull, në Norvegji kjo periudhë karakterizohet vetëm nga një devijim i vogël, përkatësisht nga ekzistenca e Partisë Popullore Krishtere (Kristelig Folkeparti) ngase në këtë periudhë shtetet e tjera nordike nuk kanë pasur parti popullore krishtere në parlamentet e tyre. Po ashtu, në Danimarkë në këtë periudhë ka devijime të vogla që kryesisht karakterizohen nga ekzistenca e përkohshme e disa partive në parlamentin danez, gjithashtu nga prania e reprezentuesit të minoritetit gjerman në jugun e Danimarkës që, herë pas here, e ka reprezantuar minoritetin gjerman në parlamentin danez.

Partia Liberale në Danimarkë është relevante të problematizohet në lidhje me modelin nordik pesëpartiak sepse, shikuar historikisht, mund të thuhet se ekzistojnë dy parti liberale në Danimarkë. E ashtuquajtura Partia e Majtë (Venstre), e cila e ka pasur rolin primar si Parti Agrare (e ndërlidhur me reformën agrare) dhe që ideologjikisht e ka pasur rolin e Partisë Liberale (duke i prirë procesit të demokratizmit të plotë në Danimarkë), e cilësuar edhe si Parti e Qendrës Liberale. Gjithashtu, prej vitit 1905 fenomen politik në

sistemin partiak të Danimarkës është edhe një Parti Liberale (e cilësuar edhe si Parti Social-Liberale), e ashtuquajtura Partia e Majtë Radikale (Radikale Venstre). Kështu që, në Danimarkë është një traditë e bashkëpërzierjes në mes të agrarëve dhe liberalëve që kanë qëndruar historikisht bashkë në Partinë e Majtë (Venstre) për shkak të historisë së veçantë të kësaj partie.

Gjithashtu, është e pranishme në kontiniutet edhe një parti e veçantë liberale, përkatësisht Partia e Majtë Radikale (Radikale Venstre). Devijimi më i madh (sesa në Norvegji dhe në Danimarkë) nga modeli nordik pesëpartiak gjatë kësaj periudhe ka qenë në Finlandë ku, përpos një partie domethënëse të minoritetit suedez, e ashtuquajtura Partia Popullore Suedeze (Svenska Folkpartiet) spektri i majtë politik dominohej (në vend të Partisë Socialdemokrate, e cila ishte një parti e vogël në këtë periudhë) nga një parti e madhe komuniste. E, shikuar historikisht, Partia Agrare, e cila më vonë e ndryshoi emrin në Partinë e Qendrës (Keskustapuolue), është historikisht partia më e rëndësishme e spektrit të djathtë politik në Finlandë, sepse shtresa fshatare në Finlandë (sikurse edhe në Norvegji) ka pasur një rol shumë të rëndësishëm historik.

Gjatë periudhave historike, kur qytetet e Finlandës dominoheshin nga suedezët, e kur rusët e kontrollonin politikën finlandeze, fshatarësia finlandeze u bë shtyllë e kombit finlandez. Kjo është një parti shumë interesante në kuptimin se është diçka më shumë dhe diçka më ndryshe krahasuar me partitë e tjera agrare në shtetet nordike, sepse tradicionalisht ka qenë partia kryesore antikomuniste, njëkohësisht në politikën ekonomike e orientuar afër qendrës politike, ndërsa në disa dimensione të tjera politike (kombformim, shtetformim etj.) e orientuar tërësisht tek e djathta politike, sidomos parti interesante për studiuesit e jashtëm që merren me studimin e partive politike të Evropës lindore dhe që dëshirojnë t'i kuptojnë më lehtë dimensionet e së djathtës/majtës politike të partive në Evropën lindore. Sepse, duke marrë pikënisje në historinë e (Partisë Agrare) Partisë së Qendrës në Finlandë, mund të kuptohet më lehtë se si një parti mund të orientohet afër qendrës në politikat ekonomike, ndërsa në të gjitha dimensionet e tjera politike (identitetit nacional, qëndrimit ndaj minoriteteve, antikomunizmit etj.) të orientohet krejtësisht tek e

djathta politike. Megjithëkëtë, devijuesja më e madhe nga modeli nordik pesëpartiak është Islanda, pasi partia dominuese në Islandë gjatë kësaj periudhe ka qenë partia e djathtë konservatore, e ashtuquajtura Partia e Pavarësisë (Sjálfstæðisflokkurinn). Gjithashtu, Islandës i ka munguar krejtësisht Partia Liberale, e cila është formuar shumë më vonë. Suedia në këtë periudhë ka qenë më së shumti në përputhje me modelin nordik pesëpartiak.

Një shpjegim i rëndësishëm pse shtetet nordike karakterizohen nga konsensusi në shoqëri dhe nga kompromisi në politikë ka të bëjë se politika në shtetet nordike tradicionalisht dominohet nga menaxhimi i konflikteve të interesave ekonomike, e jo sikurse në shumë shtete të tjera evropiane dhe në përgjithësi në shtetet e tjera në botë, ku politika dominohet nga menaxhimi i konflikteve gjuhësore, religjioze, territoriale etj. Rrjedhimisht është më e lehtë të arrihen kompromiset për konfliktet e bazuara në interesa sesa të arrihen kompromiset për konfliktet e bazuara në vlera. Sikur të kishte qenë politika në shtetet nordike e dominuar nga çështjet që kanë të bëjnë me gjuhën, religjionin etj., kultura e konsensusit në shoqëri dhe kultura e kompromisit në politikë nuk do të ishte siç është. Kjo nuk do të thotë se politika në shtetet nordike nuk ka qenë aspak e sfiduar nga konfliktet për çështjet e tjera. Për shembull, prania e minoritetit suedez në Finlandë dhe prania e minoritetit gjerman në Danimarkë kanë qenë çështje sfiduese, por kurrë nuk kanë arritur të bëhen çështje që dominojnë politikën daneze dhe politikën finlandeze. Kryesisht janë trajtuar dhe zgjidhur në mënyra të civilizuara. Gjithashtu, mund të thuhet se (krahasuar me shtetet e tjera evropiane dhe me shtetet e tjera në botë) mungesa e kontestimeve të mëdha territoriale në mes të shteteve nordike (gjatë historisë) ka kontribuar të zhduken traditat e zgjedhjeve të konflikteve në mënyra ekstreme.

Por disa studiues të shteteve nordike e mbivlerësojnë dallimin në mes shteteve nordike dhe shteteve të tjera. Me fjalë të tjera, disa studiues, duke paraqitur imazhe të idealizuara të stabilitetit dhe të konsensusit në shtetet nordike, e paraqesin politikën në shtetet nordike edhe më të "bukur" sesa që është në realitet. Stabiliteti dhe konsensusi janë karakteristika kryesore, mirëpo kjo nuk do të thotë se nuk ka përjashtime nga këto dy karakteristika kryesore. Për shembull,

Suedia, e cila karakterizohet më së shumti nga stabiliteti politik, nga mesi i viteve ’70-ta deri në fillimvitet ’80-ta e ka pasur një udhëheqje jostabile me qeveritë që vinin dhe shkonin si pasojë e mosmarrëveshjeve në lidhje me çështjet kyçe siç janë: prodhimi i energjisë elektrike, buxheti shtetëror dhe çështjet e tjera.

Një shembull tjetër i jostabilitetit politik në shtetet nordike është shfaqja e partive të reja politike në parlamentet e shteteve nordike në fillim të viteve ’70-ta. Atëkohë sistemet partiake në shtetet nordike kanë rezultuar me devijime të tjera nga modeli nordik pesëpartiak, në veçanti në Danimarkë, ngaqë prania e partive në parlamentin danez pothuajse u dyfishua në 10 parti. Partia Populllore Krishtere (Kristeligt Folkeparti) rezultoi në parlamentin danez si subjekt politik kundër sekularizimit (kundër ligjeve për ndalesën e mësimit fetar në shkolla) dhe kundër liberalizimit të pornografisë (në fillimvitet 1970-ta Danimarka ishte vendi i parë në shtetet nordike që i dha mbrojtje ligjore liberalizimit të pornografisë). Gjithashtu, shkak për shfaqjen e Partisë Populllore Krishtere ishte edhe çështja e abortit që në këtë kohë shihej si një çështje transnacionale. Danimarka ka traditë të ketë tatime edhe më të larta sesa shtetet e tjera nordike, por shkaku pse Partia Përparimtare (Fremskridtspartiet) rezultoi si parti e protestës kundër tatimeve të larta ishte sepse edhe koalicioni qeveritar i djathtë që ishte në pushtet për një kohë të gjatë në këtë kohë filloi t’i ngrehë tatimet në nivel të njëjtë sikurse bënin socialdemokratët më herët.

Demokratët e Qendrës (Centrumsdemokraterne) rezultuan si një çarje ideologjike nga socialdemokratët (Socialdemokraterne) sepse, sipas tyre, socialdemokratët ishin bërë më majtistë sesa që duhej. Shkaku pse edhe Partia e Majtë Socialiste (Venstre Sosialistisk Parti) u shfaq në këtë kohë në Danimarkë (edhe pse ekzistonte Partia Populllore Socialiste: Sosialistisk Folkeparti) ka të bëjë me kundërshtimet në mes të krahut të majtë pro/kundër anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe me relacionin pro/kundër politikave të NATO-s. Gjithashtu, pragu i ulët zgjedhor 2 % është një shpjegim për hyrjen e këtyre partive të reja në parlamentin danez, sepse ua bëri të lehtë dhe atraktive grupeve të caktuara politike të bëjnë çarje nga partitë e tjera dhe t’i formojnë partitë e veta. Ndërsa shkaku pse më vonë edhe një parti tjetër u shfaq dhe hyri në parlamentin danez,

përkatësisht partia popullore daneze (Dansk Folkeparti), është sepse një grup bëri çarje nga partia përparimtare (Fremskridtspartiet) në krye me znj. Pia Sjærskog, për ta bërë mobilizimin kundër politikës liberale daneze ndaj emigrantëve. Në Norvegji, në fillimvitet '70-ta kanë hyrë disa parti të reja në parlamentin norvegjez.

Partia Liberale Popullore (Det Liberale Folkepartiet) u shfaq si rezultat i një çarje nga Partia Historike Liberale Norvegjeze (Venstre) për shkak të mosunitetit në pyetjen pro/kundër anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Partia Përparimtare (Fremskrittspartiet) rezultoi si një parti e protestës kundër tatimeve të larta dhe si rezultat i diskrepancës në mes të zgjedhësve dhe partive politike, në lidhje me çështjen e anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Partia Socialiste e Majtë (Sosialistisk Venstreparti) u themelua në vitin 1972 nga disa socialdemokratë që bënë çarje nga Partia Norvegjeze Socialdemokrate, e ashtuquajtura Partia Norvegjeze e Punës (Norsk Arbeiderparti) dhe nga disa komunistë që ishin kundër anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe në NATO.

Në vitin 1989 një subjekt politik i quajtur Aksioni i Finmarkut (Aksjon i Finmark) hyri me një përfaqësues në parlamentin norvegjez. Ky subjekt politik fitoi një mandat sepse fitoi pothuajse të gjitha votat në prefekturën e Finmarkut, që është prefektura më e madhe gjeografikisht në Norvegji. Por ky subjekt politik nuk ka arritur të vazhdojë të hyjë prapë në parlamentin norvegjez. Gjithashtu, Partia Bregdetare (Kystpartiet) ka arritur në vitin 1997 të përfaqësohet nga një reprezentues i saj në dy perioda në parlamentin norvegjez. Edhe kjo parti nuk mundi të vazhdojë të jetë më pjesë e parlamentit norvegjez, përveç të tjerash, për shkak të mosunitetit të brendshëm që kishte të bënte me një bashkëpërzierje në mes të retorikës periferike dhe populizmit djathtist. Shpjegimi pse në Norvegji nuk ka rezultuar një parti stabile e gjelbër, është sepse partitë e tjera, Partia e Majtë Socialiste (Sosialistisk Venstreparti), Partia Liberale Historike Norvegjeze, e quajtur Partia e Majtë (Venstre) dhe Partia Agrare, e quajtur Partia e Qendrës (Sentrumspartiet) i kanë "grabitur" (marrë përsipër) çështjet ambientaliste.

Në Suedi hyrja e partive të reja në parlament pas vitit 1970 (krahasuar me shtetet e tjera nordike) është më e vogël dhe, sipas

studiuesve, shpjegimi për këtë është kryesisht pragu i lartë zgjedhor. Megjithëkëtë, partia demokristiane (Kristdemokraterna) ka arritur të hyjë në parlamentin suedez në vitin 1985 në krye me Alf Svensson, i cili është popullarizuar aq shumë saqë arriti të mbledhë rreth vetes disa votues nga spektri i djathtë politik.

Partia e të Gjelbërve (Miljöpartiet de Gröna) ka hyrë në parlamentin suedez në vitin 1988, në vazhdën e etablimit të partive të gjelbra si rezultat i efektit nga katastrofa atomike e Çernobilit. Në fakt, janë aktivistët e fushatës kundër centraleve bërthamore që formuan Partinë e Gjelbër Suedeze, e kjo parti pastaj mbeti fenomen politik permanent në sistemin partiak suedez. Gjithashtu, partia demokracia e re (Ny Demokrati) arriti të hyjë në parlamentin suedez në vitin 1991. Kjo parti ishte një përpjekje për të formuar një parti simotër të partive populiste në Norvegji dhe në Danimarkë kundër tatimeve të larta etj., të ashtuquajturave partive përparimtare (Fremskrittspartiet & Fremskridtspartiet) në Norvegji dhe në Danimarkë.

Partia Demokracia e Re (Ny Demokrati), duke pasur mosmarrëveshje në mes të themeluesve të vet, nuk arriti për të dytën herë të hyjë në parlamentin suedez. Problemi kryesor i kësaj partie ka qenë i karakterizuar nga mosuniteti se çfarë duhet të jetë profili i saj kryesor: parti e përqendruar kundër politikave të tatimeve të larta, apo parti e përqendruar kundër politikës liberale suedeze ndaj emigrantëve. Si pasojë e këtij mosuniteti, më vonë është forcuar edhe një parti tjetër, e ashtuquajtura Partia e Demokratëve Suedezë (Sverigedemokraterna) si një parti simotër e Partisë Nacional Konservatore Daneze (Dansk Folkeparti) e përqendruar kundër politikave liberale ndaj emigrantëve.

Po në Finlandë pas vitit 1970 kanë hyrë disa parti të reja në parlamentin finlandez, por meqë shumica prej këtyre partive kanë hyrë vetëm një herë në parlament, nuk janë parti relevante. Vetëm dy parti të reja (që kanë rezultuar pas vitit 1970) kanë mbetur relevante në sistemin parlamentar finlandez: Partia e të Gjelbërve (Vihreä Liitto, Vihr) dhe Partia Demokristiane (Kristillisdemokraatit).

Gjëja interesante me Finlandën është se (duke qenë tradicionalisht devijuese e modelit nordik pesëpartiak, krahasuar me Suedinë, Norvegjinë dhe Danimarkën) kur Suedia, Norvegjia dhe Danimarka në

fillimvitet ’70-ta filluan të devijojnë nga modeli nordik pesëpartiak, Finlanda në fundvitet ’70-ta e fillimvitet ’80-ta iu afrua modelit nordik pesëpartiak, sepse komunistët, por edhe fashistët, si formacione politike antisistemi (parti që nuk respektojnë rregullat bazore demokratike), u dobësuan në Finlandë. Gjithashtu, kjo ka të bëjë edhe me shfaqjen dhe forcimin e partive të reja politike në parlamentet e shteteve nordike në fillimvitet ’70-ta (në veçanti shfaqja e antikonsensuspartive: partive të djathta populiste) të cilat ndikuan që Danimarka, Norvegjia dhe Suedia të devijojnë nga modeli nordik pesëpartiak. Disa studiues i cilësojnë edhe partitë e djathta populiste (që u shfaqën në fillimvitet ’70-ta) si, për shembull, Partinë Përparimtare Norvegjeze (Fremskrittspartiet) si antisistem-parti në kuptimin e të qenurit parti antikonsensusi dhe antimirëqenie, ndërsa studiuesit e tjerë i cilësojnë këto parti të djathta populiste vetëm si antikonsensus, parti ose antiestablishment parti, në kuptimin se nuk ishin parti antidemokratike (antisistem-parti) sepse i respektonin rregullat parlamentare, por vetëm antikonsensus parti në kuptimin se iu kundërvunë konsensusit mbizotërues të sistemit partiak nordik të para viteve ’70-ta.

Megjithëkëtë, cilido qoftë përkufizimi më preciz për këto parti të djathta populiste (parti antikonsensusi ose edhe parti antisistemi) është më shumë kategori historike sesa përkufizim i vlefshëm në kohën tonë. Për shembull, pothuajse në 100 % të programit të partisë përparimtare norvegjeze (Fremskrittspartiet) nuk mund të gjesh sot elemente politike radikale.

Në Islandë pas vitit 1970 kanë hyrë disa parti të reja në parlamentin islandez, por shumica e tyre kanë dalë prapë nga parlamenti duke mos fituar votat e duhura gjatë zgjedhjeve të tjera. Në disa raste këto parti kanë rezultuar si çarje nga partitë e tjera, ngase Islanda ka një traditë më të fortë krahasuar me shtetet e tjera nordike, që politikanët e pakënaqur të dalin jashtë partive dhe të krijojnë listat e veta partiake.

Partia më signjifikante që u shfaq në këtë periudhë dhe që ka vazhduar të qëndrojë në parlamentin islandez është Partia e Gruas (Kvénnalístínn). Gratë në Islandë tradicionalisht nuk kanë qenë pjesëmarrëse në sistemin politik në nivel të njëjtë sikurse gratë në shtetet e tjera nordike. Rrjedhimisht partia e grave që ua mundësoi

grave në Islandë kyçjen më të lehtë në politikë ishte jo vetëm subjekt politik i nevojshëm, por edhe i mirëseardhur.

Sa i përket socialdemokracisë skandinave, mund të thuhet se Norvegjia dhe Suedia e reprezantojnë më shumë socialdemokracinë skandinave sesa Danimarka. Kjo kryesisht ka të bëjë se Danimarka nuk ka resor natyror sikurse Suedia dhe Norvegjia dhe rrjedhimisht lëvizja punëtore në Danimarkë (edhe pse daton shumë herët) nuk ka qenë një lëvizje e fuqishme në kuptimin e një zhvillimi dhe mobilizimi të hovshëm si në Suedi e në Norvegji. Kjo është edhe arsyeja pse Partia Socialdemokrate Daneze nuk ka qenë historikisht e fortë në nivel të njëjtë sikurse Partia Socialdemokrate Suedeze dhe Partia Socialdemokrate Norvegjeze. Partia Socialdemokrate Daneze vetëm në periudha të shkurtra, për shembull gjatë viteve '60-ta, e ka pasur shumicën së bashku me partitë e tjera të spektrit të majtë politik. Përndryshe, kur ka dëshiruar të qeverisë Partia Socialdemokrate Daneze, ka qenë e zakontë t'i afrohet qendrës së djathtë për të bërë koalicione si, për shembull, me Partinë Liberale (e cilësuar edhe si Parti Social-Liberale) të ashtuquajturën Partinë e Majtë Radikale (Radikale Venstre).

Partia Socialdemokrate Norvegjeze dhe Partia Socialdemokrate Suedeze kanë qenë më të forta krahasuar me partitë e tjera socialdemokrate në shtetet nordike, por Partia Socialdemokrate Suedeze, krahasuar me Partinë Socialdemokrate Norvegjeze, për shkak të strukturës konstitucionale në Suedi (parlamentit dydhomësh deri në vitin 1970) nuk ka arritur ta ketë shumicën e pastër në parlamentin suedez sikurse ka arritur ta ketë shumicën e pastër në periudha të gjata historike Partia Socialdemokrate Norvegjeze. Megjithëkëtë, Partia Socialdemokrate Suedeze e ka një traditë të gjatë të udhëheqjes qeveritare nëpërmes koalicioneve me Partinë Agrare (që tani quhet Parti e Qendrës: centerpartiet) dhe me Partinë e Majtë, e ashtuquajtura venstrepartiet (që, shikuar historikisht, është një parti komuniste).

Partia Socialdemokrate Norvegjeze nuk ka pasur nevojë për koalicione me partitë e qendrës së djathtë ngaqë, duke e pasur vetë shumicën e pastër në një periudhë të gjatë historike, ka qeverisur vetë. Madje gjatë një periudhe historike e ka udhëhequr bashkëqeverisjen

në kuadër të spektrit të majtë politik. Me fjalë të tjera, në Norvegji nuk ka traditë që Partia Socialdemokrate të bëjë koalicione qeverisëse me Partinë Agrare (që tani quhet Partia e Qendrës: senterpartiet) përpos një rasti të bashkëpunimit në vitet 1930-ta, në lidhje me një çështje ekonomike dhe në vitet 2005-2009, 2009-2013. Gjithashtu, në Norvegji nuk ka traditë të bashkëqeverisjes në mes të socialdemokratëve dhe komunistëve sepse janë të përçarë që nga koha e revolucionit proletar në Rusi. Janë përçarë prapë pas Luftës së Dytë Botërore në lidhje me politikën norvegjeze pro-NATO. Prandaj, mund të thuhet se socialdemokratët në Norvegji kanë qenë historikisht parti më dominuese në qeverisje sesa socialdemokratët në Suedi. Po ashtu, mund të thuhet se socialdemokratët në Suedi kanë qenë parti më stabile sesa socialdemokratët në Norvegji, ngaqë socialdemokratët në Suedi nuk kanë qenë të përçarë me komunistet, e kjo ka të bëjë se Suedia, duke qenë shtet neutral, ua ka bërë komunistëve më të lehtë mbijetesën politike. Komunistët vazhduan të mbijetojnë në sistemin partiak suedez vetëm duke e ndryshuar emrin, nga të quajturit Partia Komuniste Suedeze në Partinë e Majtë Komuniste, në fund e hoqën fjalën komuniste e sot quhet Partia e Majtë (venstrepartiet).

Socialdemokratët në Finlandë nuk e kanë pasur kurrë shumicën në parlamentin finlandez (as po qe se i llogaritim së bashku me komunistët), ndërsa socialdemokratët në Islandë kanë qenë historikisht më të dobëtit në nivelin nordik. Kjo ka të bëjë se sistemi partiak islandez u etablua në një periudhë historike kur gjëja më e rëndësishme për islandezët ishte shtetndërtimi. Me fjalë të tjera, çështja kryesore gjatë kësaj periudhe historike ishte pavarësimi nga Danimarka/shtetndërtimi, e jo interesat ekonomike të klasës punëtore dhe mirëqenia. Kjo është edhe arsyeja, pse historikisht partia dominuese në sistemin partiak islandez u bë e ashtuquajtura Partia e Pavarësisë (Sjálfstæðisflokkurinn).

Edhe një karakteristikë që mund të identifikohet si e përbashkët e shteteve nordike, krahasuar me shtetet e tjera, është se burokracia tradicionale (weberiane) është më imune ndaj trendëve të rinj për reformat burokratike siç është, për shembull: trendi që ka pasur ekspansion të fuqishëm nga vendet angloamerikane, i ashtuquajturi menaxhimi i ri publik (New Public Menagement). Menaxhimi i ri

publik, duke qenë i bazuar në shtyllën ideologjiko-teorike dhe doktrinën, që nënkupton përdorimin e principeve të biznesit nga tregu i lirë, në sferën e shërbimeve publike (i prirur nga ideja se konkurrenca e zhvillon dhe e efektivizon burokracinë) nuk ka pasur ndikim të madh reformues në burokracitë e shteteve nordike, sepse është implementuar shumë pak: në një mënyrë shumë të kujdesshme dhe pragmatike.

Disa ndër arsyet kryesore pse doktrina e menaxhimit të ri publik (për dallim të shteteve të tjera) nuk ka pasur ndikim të madh në shtetet nordike, ka të bëjë se burokracia në shtetet nordike është efektive dhe me ekspertizë solide. Besueshmëria ndaj sektorit publik në shtetet nordike është e madhe, duke u bazuar edhe në moralin e lartë të tatimpaguesve. Idealet e forta për barazinë në shtetet nordike kanë bërë që konkurrenca private si zgjidhje për shërbimet publike të mos jetë e popullarizuar. Gjithashtu, invadimi i sindikatave dhe i grupeve të interesit nëpërmes kanalit korporativ (në bashkëdizajnimin e politikave me autoritetet shtetërore) e ka ngadalësuar reformën e menaxhimit të ri publik.

Shkaqet e dallueshmërisë së shteteve nordike në politikat e tyre të jashtme

Islanda

Islanda, krahasuar me shtetet e tjera, është një shtet mjaft interesant si për nga demografia ashtu edhe për nga forca ushtarake, në kuptimin se ka më pak banorë sesa Oslo (kryeqyteti i Norvegjisë), njëkohësisht është shtet pa ushtri. Kështu që, shikuar nga perspektiva e Max Weberit për shtetin, Islanda mund të karakterizohet më shumë si një zonë autonome nën mbrojtjen amerikane sesa si një shtet në kuptimin e plotë të fjalës.

Për historinë e identitetit norvegjez Islanda është e rëndësishme ngase, shikuar historikisht, ka qenë pjesë e Norvegjisë (pjesë e perandorisë atlantike norvegjeze). Në vitin 1397 Norvegjia me territoret e veta (ishujt Island, Færøyene, Grønland) dhe Suedia (që

përfshinte edhe regjionet e Finlandës) u bënë pjesë e unionit nordik, që dominohej nga Danimarka. Pas luftërave të Napoleonit, me ndikimin e Fuqive të Mëdha, Norvegjia hyri në union me Suedinë, mirëpo danezët arritën në heshtje të vazhdojnë t'i mbajnë nën kontrollin e vet territoret e tjera të Norvegjisë (ishujt Island, Færøyene, Grønland). Islanda mbeti kështu koloni e Danimarkës që nga mesjeta, dhe vetëm pas Luftës së Parë Botërore arriti të fitojë një lloj autonomie nga Danimarka, por jo pavarësinë e plotë.

Lufta e Dytë Botërore ka qenë vendimtare për Islandën sepse gjatë kësaj kohe Danimarka u pushtua nga Gjermania, ndërsa Islanda nga Amerika, kurse në vitin 1944 arriti të bëhet shtet i pavarur. Përveç shkaqeve të sipërpërmendura, Islanda (si një vend me resor të kufizuar si në aspektin demografik, ushtarak dhe ekonomik) nuk ka arritur as pas Luftës së Dytë Botërore të konsolidojë një politikë të jashtme proaktive në kuadër të bashkëveprimit ndërkombëtar, sepse politikën e jashtme e ka pasur të karakterizuar edhe nga një konflikt permanent në mes të partive politike. Krahu i majtë politik në Islandë ka qenë në kontiniutet (sidomos gjatë Luftës së Ftohtë) kundër politikës islandeze pro-NATO, njëkohësisht kundër pranisë së bazës ushtarake amerikane në vend, ndërsa partitë e djathta dhe socialdemokratët në kontiniutet kanë qenë pro politikës islandeze pro-NATO dhe pro pranisë së bazës ushtarake amerikane.

Finlanda

Finlanda është një vend me një histori krejtësisht të dallueshme në disa variabla krahasuar me shtetet e tjera nordike. Me fjalë të tjera, Finlanda e ka një histori të kombformimit dhe shtetformimit të dallueshëm nga shtetet e tjera nordike, sepse nuk ka qenë e identifikuar si një bashkësi shoqërore unike as në mesjetë e as në kohën e renesancës. Finlanda ka qenë një zonë nën Suedinë e madhe deri në fillim të shekullit XVIII, përkatësisht një provincë e Suedisë ku jetonin finlandezët, suedezët dhe samët (samët janë një popullatë e lashtë me shtrirje të shkëputur gjeografike pothuajse në të gjitha shtetet nordike). Popullata suedeze në Finlandë ka qenë dominuese deri në fillim të shekullit XVIII, jo vetëm për arsyen se e kishte

pushtetin politik, por edhe për shkak se banorët që banonin në qytete të mëdha dhe në bregdetin e Finlandës flisnin kryesisht në gjuhën suedeze.

Në fillim të shekullit XVIII Finlanda u aneksua nga Suedia dhe ra nën okupimin e Rusisë. Nën okupimin e Rusisë, Finlanda e arriti një lloj autonomie, por mundësinë historike për t'u bërë e pavarur (sikurse edhe disa shtete të tjera evropiane) e arriti gjatë Luftës së Parë Botërore, përkatësisht në vitin 1917. Megjithëkëtë, pavarësia e Finlandës vazhdoi të rrezikohet nga Rusia. Rrjedhimisht procesi i kombformimit dhe i shtetndërtimit finlandez ka qenë i ndikuar nga dy linja të konfliktit, nga njëra anë nga konflikti gjuhësor në mes të finlandishtes dhe suedishtes, nga ana tjetër nga konflikti ideologjiko-politik në relacionin realpolitik pro/kundër Rusisë. Këto dy linja konflikti janë manifestuar historikisht në politikën finlandeze.

Konflikti ndërgjuhësor, gjatë periudhës në mes të dy luftërave botërore, ishte një çështje politike akute, sepse në këtë periudhë dominanca e gjuhës suedeze ka qenë shumë e fortë. Për shembull, Universiteti i Helsinkit ka qenë i dominuar nga gjuha suedeze dhe përpjekja e finlandezëve në këtë periudhë (tashmë në një Finlandë të pavarur) ishte, pos të tjerash, që edhe në universitete të ligjërohet në gjuhën finlandeze. Kjo çështje politike akute është zgjidhur gradualisht deri në një masë, duke rezultuar në vendimin që të dyja gjuhët (finlandishtja dhe suedishtja) të bëhen zyrtare në Finlandë.

Në vitet e mëvonshme, pas Luftës së Dytë Botërore, konflikti politik rreth çështjes gjuhësore u reduktua gradualisht edhe më shumë, sepse përdorimi i gjuhës suedeze u reduktua në praktikë, përveç të tjerash, edhe për shkak të shpërnguljes vullnetare të një numri të popullatës suedeze nga Finlanda në Suedi. Në ditët e sotme ky konflikt ndërgjuhësor në Finlandë pothuajse është tejkaluar krejtësisht, sepse karakterizohet më shumë si konflikt i tipit se rinia finlandeze dëshiron ta mësojë anglishten në vend të suedishtes si gjuhë obliguese në shkolla.

Konflikti ideologjiko-politik në lidhje me relacionin realpolitik pro/kundër Rusisë ka shkaktuar pasoja të mëdha për politikën finlandeze. Shkak i këtij konflikti ishte revolucioni që ndodhi në Rusi në vitin 1917, sepse ky revolucion u bë edhe një inspirim i madh për

spektrin e majtë politik në Evropën perëndimore. Lëvizjet majtiste në Evropë dëshironin ta implementonin sistemin e njëjtë politik që u implementua në Rusi, madje kishte edhe lëvizje majtiste që dëshironin, që vendet e tyre të bëhen edhe pjesë e sistemit politik rus. Në këtë kohë në Finlandë ekzistonte një lëvizje e fortë pro-bashkimit me Rusinë dhe u bë shkak i luftës qytetare në mes të komunistëve dhe antikomunistëve. Antikomunistët e fituan luftën qytetare me ndihmën e shteteve perëndimore.

Lufta qytetare në Finlandë shkaktoi pasoja konstitucionale, parlamentare, në sistemin partiak, në veçanti në politikën e jashtme. Me fjalë të tjera, lufta qytetare në mes të komunistëve dhe antikomunistëve nuk fragmentoi në mënyrë ekstreme vetëm sistemin partiak në mes të majtëve dhe të djathtëve, por e fragmentoi përbrenda edhe spektrin politik të majtë, sepse lufta qytetare, duke e përçarë lëvizjen punëtore, bëri një ndarje të thellë në mes të socialdemokratëve dhe komunistëve.

Konstelacionet partiake për formimin e qeverive në Finlandë kanë qenë tradicionalisht të prira të qeverisin me shumicën parlamentare. Një shpjegim pse qeverisja në Finlandë tradicionalisht është udhëhequr nga shumica parlamentare ka të bëjë me qëllimin e shumicës parlamentare për t'i dobësuar politikisht komunistët. Rrjedhimisht, ka qenë e lehtë që Qeveria ta ketë me vete 2/3 e parlamentit, sepse tradicionalisht Partia e Qendrës, Partia Socialdemokrate dhe Partia e Djathtë Konservatore kanë formuar qeverisjen me këto variacione qeverisëse: qeverisje në mes të Partisë së Qendrës me Partinë e Djathtë Konservatore (qeverisje në mes të qendrës së djathtë politike dhe së djathtës politike), ose qeverisje në mes të Partisë së Qendrës dhe Partisë Socialdemokrate (qeverisje në mes të gjelbërve dhe të kuqve), ose qeverisje në mes të Partisë Konservatore dhe Partisë Socialdemokrate (qeverisje e qepur) dhe plus Partia Popullore suedeze si pjesë e ndonjërit nga këto koalicione qeveritare.

Një shpjegim shtesë pse qeverisja në Finlandë është udhëhequr nga shumica parlamentare ka të bëjë se në këtë mënyrë parlamenti ka mundur ta evitojë presionin nga presidenti, në mënyrë që parlamenti të mund të marrë vendime si kundërpeshë politike ndaj presidentit.

Lufta qytetare në Finlandë pati edhe konsekuenca konstitucionale ngase Finlanda, për dallim prej shteteve të tjera nordike, rezultoi si sistem gjysmëpresidencial. Edhe Islanda mund të cilësohet formalisht shtet gjysmëpresidencial, mirëpo nuk është në praktikë shtet gjysmëpresidencial, sepse presidenti ka më shumë rol ceremonial në Islandë (edhe pse ka pushtet në letër). Në fakt, Islanda në praktikë mund të kategorizohet se bën pjesë në sistemet demokratike parlamentare sikurse, për shembull, Austria dhe Gjermania, edhe pse kanë president. Ndërsa në Finlandë sistemi gjysmëpresidencial është realitet politik edhe në praktikë sikurse, për shembull, në Francë, në kuptimin se parlamenti pothuajse nuk ka kontroll mbi presidentin. Arsyeja kryesore pse Finlanda rezultoi si sistem gjysmëpresidencial ka të bëjë me politikën e jashtme finlandeze që tradicionalisht e ka pasur një pozicion të vështirë në raport me Rusinë. Fillimisht (pas pavarësimit të Finlandës) presioni ndaj politikës së jashtme finlandeze ka qenë i karakterizuar nga rivalizimi në mes të Gjermanisë dhe Rusisë.

Sistemi gjysmëpresidencial ka qenë një strategji e mirëmenduar në kuptimin se ka qenë më e lehtë që politika e jashtme dhe diplomacia finlandeze të udhëhiqet nga një aktor (presidenti me një staf shumë të limituar) sesa sikur politika e jashtme dhe diplomacia finlandeze të ishte udhëhequr nga shumë aktorë (në bazë të koalicioneve qeverisëse), gjë që do të mund ta fragmentonte politikën e jashtme dhe diplomacinë finlandeze, e kështu të rrezikohej Finlanda nga një invazion i Bashkimit Sovjetik.

Pas Luftës së Dytë Botërore Finlanda u kushtëzua nga marrëveshja me Bashkimin Sovjetik. Pos të tjerash, nga kjo marrëveshje u detyrua ta përkrahë Bashkimin Sovjetik në Kombet e Bashkuara. Kështu, kjo marrëveshje e shpëtoi Finlandën që të mos okupohet nga Bashkimi Sovjetik.

Politika e jashtme dhe diplomacia finlandeze pas Luftës së Dytë Botërore kanë qenë shumë të kujdesshme në raport me Bashkimin Sovjetik. Prej fillmviteve 1950-ta deri në fillimvitet 1980-ta Finlanda e ka pasur vetëm një president, i cili ka qenë edhe shef i politikës së jashtme dhe i diplomacisë. Rrjedhimisht, Finlanda pas Luftës së Dytë Botërore jo vetëm se nuk ka mundur të zhvillojë një politikë të jashtme

proaktive, por politika e jashtme finlandeze ka qenë e bllokuar në një shkallë të lartë nga relacioni realpolitik ndaj Bashkimit Sovjetik. Madje në këtë mënyrë (në mënyrë të heshtur) u kushtëzua nga Bashkimi Sovjetik edhe politika e jashtme suedeze, pos të tjerash, për shkak se në Finlandë banonte një popullatë e konsiderueshme suedeze, në veçanti për shkak të influencës historiko-politike të Suedisë në Finlandë.

Suedia

Shikuar historikisht, edhe Suedia është unike në krahasim me shtetet e tjera nordike, në kuptimin se historikisht e ka pasur një aristokraci të fortë në aspektin politik. Edhe aristokracia daneze ka kontinuitet historik, mirëpo ajo çfarë e karakterizon aristokracinë suedeze është se e ka mbajtur më gjatë pushtetin politik sesa aristokracia daneze. Kjo ka të bëjë se në Danimarkë gjatë fundshekullit XVI aristokracia e humbi pushtetin politik. Pushteti politik u reduktua në një autokraci monarkiste (rojalizëm absolutist), ku vetëm mbreti e kishte pushtetin politik. Kështu që, pas fundshekullit XVI aristokracia daneze nuk karakterizohej më nga pushteti politik, por vetëm nga pushteti ekonomik dhe pushteti i prestigjit. Ndërsa e veçanta me Suedinë është se aristokracia suedeze e ka mbajtur pushtetin politik vazhdimisht (në një shkallë më të lartë dhe në një periudhë më të gjatë historike), duke e përfshirë edhe periudhën e shekujve XVII - XVIII.

Periudha e fundshekullit XVIII dhe fillimshekullit XIX edhe në Suedi, sikurse në shumë shtete të tjera, karakterizohet si periudha e industrializimit dhe urbanizimit. E veçanta me Suedinë, krahasuar me shtetet e tjera nordike, është se gjatë kësaj periudhe u shfaq një shtresë e lartë borgjeze që, në fakt, ishte një vazhdimësi e aristokracisë dhe që, shikuar historikisht, edhe në kohën tonë është në një shkallë të lartë pronare e industrisë së Suedisë. Kjo e bën historinë politike suedeze të ndryshme nga shtetet e tjera nordike sepse historikisht Suedia është më shumë e karakterizuar nga identitetet e forta të shtresave shoqërore. Mund të thuhet se Suedia është shembulli më i spikatur ku historia e tranzicionit politik përputhet me filozofinë politike të Charles Montesquieu: duke i dhënë rëndësi parësore

qeverisjes së civilizuar (ndarjes konstitucionale të pushtetit) dhe rëndësi dytësore demokratizimit të plotë të shoqërisë.

Si rezultat i ekzistencës së një qeverisje të gjatë dhe stabile konstitucionale, demokratizimi i plotë në Suedi është realizuar më së voni krahasuar me shtetet e tjera nordike. Me fjalë të tjera, parlamenti suedez ishte një kohë të gjatë i përbërë nga katër dhoma: një për fermerët, një për qytetarinë urbane, një për klerikët dhe një për aristokracinë. Parlamenti katërdhomësh u transformua në vitin 1860 në parlamentin dydhomësh, ndërsa parlamenti dydhomësh u transformua në vitin 1970 në parlamentin njëdhomësh. Kështu që, shikuar historikisht, Suedia është e karakterizuar nga një tranzicion i ngadalshëm demokratik. Vetëm fazën e pas Luftës së Parë Botërore e karakterizon një fazë e shpejtë drejt demokratizimit të plotë në Suedi: në kuptimin e drejtës së votës për të gjithë të rriturit dhe rrjedhimisht instalimit të sistemit të qeverisjes demokratike parlamentare në bazë të votës së përgjithshme të qytetarëve. Njëkohësisht, tranzicioni në demokracinë e plotë në Suedi gjatë shekullit XIX ka qenë shumë i suksesshëm dhe fascinues, sepse Suedia nga të qenurit më reaksionarja dhe më konservatorja, në krahasim me shtetet e tjera nordike, u bë shumë shpejt, së bashku me Norvegjinë, më socialdemokratja. Kjo ka të bëjë edhe se politika suedeze, duke qenë e karakterizuar tradicionalisht nga identitetet e forta të shtresave shoqërore, ndikoi që socialdemokratët të kenë mobilizim të fortë gjatë periudhës së demokratizimit të plotë, si kundërpeshë ndaj shtresave të tjera shoqërore. Njëjtë sikurse socialdemokratët në Norvegji, edhe socialdemokratët në Suedi e morën pushtetin në fillimvitet 1930-ta.

Lufta qytetare në Finlandë në vitin 1918 e sfidoi politikën e jashtme suedeze në raport me Rusinë, në kuptimin e nevojës së një balance për t'i mbrojtur disa interesa, njëkohësisht për të qenë e kujdesshme në relacionin realpolitik me Rusinë. Nga njëra anë, duke e marrë parasysh praninë e një popullate të konsiderueshme suedeze në Finlandë, gjithashtu lidhjen historike të Suedisë me Finlandën, Suedia mori qëndrim ta njohë Qeverinë antikomuniste finlandeze si qeveri legjitime të Finlandës së pavarur. Nga ana tjetër, për të qenë e kujdesshme ndaj Rusisë, Suedia (për dallim të disa shteteve të tjera perëndimore) refuzoi zyrtarisht t'ua japë ndihmën me armatim

antikomunistëve gjatë luftës qytetare në Finlandë. Gjatë kësaj periudhe Suedia përpiqej t'i marrë territoret e Finlandës, ishujt (Ålandsøyene) nën sovranitetin e vet, por kjo kërkesë e Suedisë u refuzua nga Lidhja e Popujve në vitin 1921.

Me shpërthimin e Luftës së Dytë Botërore Suedia u vetëshpall shtet neutral në raport me konfliktet në mes të Fuqive të Mëdha. Por, kur në dhjetor 1939 Bashkimi Sovjetik e sulmoi Finlandën, politika e jashtme suedeze prapë u sfidua. Megjithëkëtë, Suedia arriti fillimisht të mbajë një balancë në politikën e jashtme. Nga njëra anë i ofroi ndihmë të madhe humanitare Finlandës, nga ana tjetër e refuzoi kërkesën për t'i kaluar trupat e aleancës perëndimore nëpërmes territorit suedez, për ta ndihmuar Finlandën kundër Bashkimit Sovjetik. Por me pushtimin e Danimarkës dhe Norvegjisë nga Gjermania në vitin 1940, neutraliteti i politikës së jashtme suedeze u lëkund shumë sepse Suedia bëri një numër koncesionesh në kundërshtim me principin e neutralitetit të vet. Fillimisht e lejoi transitin e infermierëve, pajisjeve mjekësore dhe furnizimeve për trupat gjermane që luftonin në rrethinën e Narvikut, në veri të Norvegjisë, pastaj gradualisht u bë një marrëveshje suedezo-gjermane për dërgesën e materialeve luftarake dhe trupave ushtarake nëpërmes territorit suedez në veri të Norvegjisë. Në vitin 1941, kur Gjermania e sulmoi Bashkimin Sovjetik, Suedia i dha leje Hitlerit që divizioni gjerman të kalojë nga veriu i Norvegjisë nëpër territorin e Suedisë në Finlandë për ta sulmuar Bashkimin Sovjetik.

Neutraliteti i politikës së jashtme në Suedi u riformulua pas Luftës së Dytë Botërore në kuptimin që Suedia mos të bëhet pjesë e aleancave në kohë të paqes, e kështu të ketë të drejtë ta shpallë veten neutrale ndaj ndonjë konflikti eventual në mes të Fuqive të Mëdha. Neutraliteti suedez ishte i rëndësishëm si për Finlandën ashtu edhe për Suedinë, sepse kështu forcohej besueshmëria edhe në praktikë në relacion me Bashkimin Sovjetik, në kuptimin se: neutraliteti i Suedisë në mënyrë të heshtur e bënte më të besueshëm në praktikë relacionin e Finlandës ndaj Bashkimit Sovjetik. Përndryshe, një politikë e jashtme suedeze, e zhbalancuar, rrezikonte ta shkaktojë invazionin e Bashkimit Sovjetik në Finlandë, në Suedi dhe më gjerë në shtetet nordike. Kjo nuk do të thotë se Suedia pas Luftës së Dytë Botërore e ka pasur politikën e jashtme krejtësisht të kushtëzuar nga Bashkimi Sovjetik sikurse

Finlanda. Kjo nënkupton se një politikë e jashtme aktive suedeze mund të zhvillohej vetëm si e balancuar në përputhje me rritjen e besueshmërisë së neutralitetit politik. Për shembull, Suedia, në kuadër të një politike aktive të balancuar dhe në përputhje me rritjen e besueshmërisë së neutralitetit politik, ishte kritike gjatë viteve '60-ta ndaj Amerikës në luftën e Vietnamit. Ishte kritike edhe ndaj invazionit të Bashkimit Sovjetik në Çekosllovaki në vitin 1968. Lufta e Ftohtë në mes të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik e bëri gradualisht shumë të pasigurt Suedinë saqë filloi të investojë në vetëmbrojtje ushtarake duke u bazuar në prodhimin vendor të sistemeve të armatimit, gjithashtu e aktualizoi çështjen që t'i ketë edhe armët bërthamore.

Danimarka

Shikuar historikisht, Danimarka është e karakterizuar nga ekzistenca e monarkisë më të vjetër në Evropë, ndoshta edhe në botë, dhe mund t'i konkurrojë edhe monarkisë japoneze. Duke e pasur një pozicion të fortë politik dhe një kontiniutet të gjatë historik, monarkia daneze ka kontribuar jo vetëm se shtetëbërja mesjetare daneze të mbijetojë, por ka pasur rol kyç që Danimarka në periudha të caktuara historike të ketë përmasa perandorake. Përveç të tjerëve, nën dominimin danez kanë qenë edhe një numër i madh i gjermanëve (gjermanët veriorë). Gjermania në këtë periudhë nuk ishte e konsoliduar si shtet, kështu që provincat veriore gjermane ranë nën sundimin danez.

Gjatë shekujve XV dhe XVI Danimarka ka qenë shumë e fortë ushtarakisht, jo vetëm pse e kishte një traditë të fortë të marinës që e bënte shumë efektive në luftërat detare, por e kishte një aftësi organizative ushtarake saqë arrinte pa problem ta dërgonte ushtrinë e vet në misione edhe jashtë vendit. Danimarka qëndronte e fortë në këtë periudhë edhe për shkak të disa faktorëve të jashtëm: Gjermania nuk ishte ende e konsoliduar si shtet, Holanda ishte e dobët ushtarakisht, ndërsa Britaninë e Madhe dhe Francën nuk i kishte shumë afër gjeografikisht. Gjatë shekullit XVIII, kur u forcua Prusia, Danimarka e humbi pushtetin perandorak.

Forcimi i Prusisë shkoi në dëm të Danimarkës, sepse procesi i

shtetkombformimeve gjatë shekullit XVIII bëri që harta e Evropës të ndryshojë. Kur u konsolidua shteti gjerman, një numër i konsiderueshëm i danezëve mbetën pjesë e shtetit të ri gjerman. Dëshira për t'u ndarë nga shteti gjerman rezultoi me konflikt në mes të Danimarkës dhe Gjermanisë. Rrjedhimisht, Danimarka, për dallim nga shtetet e tjera nordike, e ka pasur një raport konfliktuoz më të gjatë me Gjermaninë jo vetëm gjatë Luftës së Dytë Botërore. Kjo ka ndikuar që gjatë shekullit XVIII identiteti nacional i një danezi të definohej në oponencë ndaj Gjermanisë. Gjithashtu, gjatë periudhës së luftërave të Napoleonit danezët e zhvilluan një oponencë nacionale edhe ndaj anglezëve, sepse anglezët gjatë kësaj periudhe e sulmuan Danimarkën dhe e grabitën flotën detare daneze.

Danimarka gjatë shekullit XVIII, pasi humbi nga kontrolli politik provincat gjermane dhe territoret e tjera, nuk u preokupua më ta zgjerojë territorin, por në vend të zgjerimit territorial u fokusua në modernizimin e brendshëm të vendit. Kështu që, gjatë shekullit XVIII ndodhi një modernizim i hovshëm në Danimarkë, i karakterizuar kryesisht nga reforma agrare. Reforma agrare u arrit të implementohet krejtësisht deri në fundshekullin XVIII dhe nënkuptonte kalimin në strukturën e re agrare (strukturën agrare familjare).

Partia Agrare daneze, e quajtur Partia e Majtë (Venstre), duke bërë presion, pati ndikim të madh për implementimin e reformës agrare. Duke qenë edhe parti me orientim ideologjik liberal, u bë katalizatore për demokratizimin e plotë të Danimarkës, ku në oponencë e kishte Partinë e Djathtë Konservatore së bashku me pushtetin e mbretit. Periudha e konfliktit pro/kundër demokratizimit të plotë të Danimarkës në mes, nga njëra anë Partisë Agrare, nga ana tjetër Partisë së Djathtë Konservatore dhe pushtetit të mbretit, ka zgjatur më shumë sesa periudha e demokratizimit të plotë të Norvegjisë, sepse ndikimi politik i mbretit (gjatë kësaj periudhe) ishte më i fortë në Danimarkë sesa në Norvegji.

Për dallim nga Finlanda dhe për dallim nga Suedia, Danimarka nuk ka qenë e predispozuar nga një presion ekuivalent nga Bashkimi Sovjetik. Politika e jashtme në Danimarkë pas Luftës së Dytë Botërore ka qenë më shumë e kushtëzuar nga fragmentimi parlamentar, sepse në nivelin skandinav parlamenti danez e ka një traditë më të theksuar

të konfliktit rreth politikës të jashtme. Qeveritë daneze si rezultat i fragmentimit parlamentar në lidhje me politikën e jashtme, një periudhë të gjatë janë detyruar të bëjnë rezervime të caktuara në relacion me politikat e NATO-s dhe SHBA-ve, sepse jo vetëm krahu i majtë politik, por edhe liberalët në mënyrë kontinuale i kanë detyruar qeveritë daneze së paku të mos pajtohen në disa pika me linjën politike të NATO-s.

Norvegjia

Shikuar historikisht, edhe Norvegjia ngjashëm me Danimarkën dhe Suedinë është një vend i karakterizuar nga unifikimi i hershëm si bashkësi shoqërore. Procesi i unifikimit të bashkësisë norvegjeze filloi me mbretin Harald Hårfarge, i cili arriti gjatë gjysmës së dytë të shekullit VIII të pozicionohet si mbret i Norvegjisë mbi mbretëritë e vogla norvegjeze. Disa ndër mbretërit e tjerë norvegjezë, që kanë pasur rol të rëndësishëm në unifikimin e bashkësisë norvegjeze ishin: Håkon Adalsteinfostre (djali i mbretit Harlad Hårfarge) Olav Trygvason, në veçanti Olav Haraldsson, i cili në fillimvitet 1 000, me rolin dhe me sakrificën e tij si mbret, arriti përfundimisht ta implementojë krishterimin në Norvegji.

Para se ta merrte udhëheqjen e pushtetit mbretëror në Norvegji, Olav Haraldsson (që sipas rrëfimeve tradicionale ishte i ndërlidhur në prejardhjen e tij me mbretin Harlad Hårfarge) pushteti mbretëror norvegjez udhëhiqej nga dy djemtë e ish-mbretit norvegjez Håkon Sigurdsson, përkatësisht nga djali Svein Håkonsson dhe djali tjetër jashtë martese, Eirik Håkonsson. Në vitin 1014 Erik Håkonsson (i cili e la djalin Håkon ta zëvendësojë në Norvegji) shkoi në Angli ta ndihmojë mikun e vet (vëllanë e gruas, dajën e Håkon), mbretin e Danimarkës, i cili njëkohësisht ishte edhe mbret i Anglisë, të ashtuquajturin Knutin e madh (Canute the Great). Pas dy vjetësh, në betejën e vitit 1016, Olav Haraldsson e mposhti vëllanë e Erik Håkonsson, Svein Håkonsson, e mori pushtetin mbretëror në Norvegji dhe e shpalli krishterimin fe të gjithë norvegjezëve. Organizimi hierarkik kishtar gjithëpërfshirës, nëpërmes bashkëveprimit politik, religjioz dhe ekonomik me mbretin Olav, ishte vendimtar për forcimin

e unitetit të bashkësisë norvegjeze, duke i vënë kështu edhe themelet e "shtetësisë norvegjeze".

Pas disa vitesh Knuti i madh e sulmoi mbretërinë norvegjeze të Olavit, e detyroi Olavin të largohet nga Norvegjia, e caktoi nipin, Håkon, udhëheqës në Norvegji e, gjatë periudhës 1028 - 1035, e mbajti nën sundim Norvegjinë dhe një pjesë të madhe të Suedisë. Ndërkohë, pasi nipi i Knutit të madh, Håkon, vdiq tragjikisht (u mbyt në ujë gjatë një lundrimi me anije), Olavi u kthye në Norvegji për ta rimarrë pushtetin dhe ra heroikisht në vitin 1930 në betejën në Stiklestad (vend në pjesën veriore të Norvegjisë). Sipas rrëfimeve tradicionale, në mëngjes, para betejës, Olavi kishte parë ëndërr se ishte ngjitur nëpërmes shkallëve në qiell. Kjo ëndërr u bë një pjesë e rëndësishme e legjendës për Olavin, në kuptimin se Olavi u paralajmërua se do të vdesë si martir. Pas rënies së tij në betejë, dhe pasi e varrosën në vendin ku u vra, mendimi për të ndryshojë edhe tek kundërshtarët e tij, fillimisht tek fisnikëria, pastaj edhe tek fshatarësia, sepse filluan thashethemet se ai ishte i shenjtë. Pas një viti kufoma e tij u nxor nga varri dhe meqë kufoma ishte e paprishur, kjo gjë u cilësua si një shenjë e sigurt e shenjtërisë së tij. Mbreti Olav u shpall nga kisha i shenjtë "Mbret i Përjetshëm i Norvegjisë" (Rex Perpetuus Norvegiae) dhe u rivarros i mbështjellë në scrinium në kishën e Klementit të shenjtë (Klemenskirken) në Nidaros, përkatësisht në Trondheim të sotëm (qytet në Norvegji).

Adhurimi për Shën Olavin u përhap me shpejtësi në të gjithë Evropën. Përveç të tjerash, një numër i kishave dhe manastireve u emërtuan me emrin e tij. Pas shenjtërimit të Olavit, konsolidimi dhe pozicioni kishtar në Norvegji u forcua edhe më shumë, e kisha dëshironte që mbretërit e ardhshëm të Norvegjisë të konsiderohen si vasalë të Olavit, në kuptimin që mbretërit e ardhshëm të Norvegjisë t'i nënshtrohen kishës, sepse kisha e reprezantonte Olavin e shenjtë në tokë. Djali i Olavit, Magnus I, i cili ishte i pagëzuar me emrin "Karlmagnus" (Karli i Madh), u bë mbret i Norvegjisë dhe sundoi gjatë periudhës 1035 - 1047, e prej vitit 1042 deri në vitin 1047 edhe mbret i Danimarkës.

Pushteti i mbretërisë norvegjeze gjatë shekujve XI - XII u forcua në raport me kishën dhe aristokracinë norvegjeze. Në shekullin XII, gjatë

periudhës së mbretit norvegjez, Håkon V, Oslo u bë kryeqytet i Norvegjisë. Megjithëkëtë, mbretëria norvegjeze, krahasuar me mbretëritë e tjera evropiane, ballafaqohej me vështirësi më të mëdha ekonomike në përpjekjet e veta për ta financuar zgjerimin e ushtrisë mbretërore dhe aparatin e qeverisjes së vendit.

Me shfaqjen e sëmundjes murtaja e zezë, gjatë periudhës 1347-1351, përpos të tjerash, edhe gjendja ekonomike në Norvegji u keqësua, ngaqë reduktimi i përafërsisht 2/3 të popullsisë norvegjeze ndikoi edhe në reduktimin drastik të çmimeve të tokës, në reduktimin e tarifave për qiranë e tokës dhe në reduktimin e prodhimit bujqësor, gjë që e dobësoi dukshëm forcën ekonomike të mbretërisë dhe aristokracisë norvegjeze. Rrjedhimisht u shkaktua një krizë e madhe ekonomike tek klasa udhëheqëse norvegjeze, që pothuajse ngjashëm përfshiu edhe Suedinë e Danimarkën, sepse të hyrat e mbretërive dhe aristokracive në Skandinavi u reduktuan. Kjo ndikoi të zgjerohet baza e resorëve në mënyrë që t'i rezistohet krizës ekonomike. Me fjalë të tjera, si mbretëritë ashtu edhe aristokracitë në Skandinavi filluan t'i zgjerojnë ripronësimet e tokave dhe ridhëniet e tokave me qira, pa marrë parasysh kufijtë në mes të mbretërisë së Norvegjisë, mbretërisë së Suedisë dhe mbretërisë së Danimarkës, e kjo ndikoi që bashkimi në mes të mbretërive të shihet si një ide e mirë, gjë që rezultoi me etablimin e unionit të përbashkët.

Në vitin 1397 u etablua unioni që, në fakt, ishte një union nordik, jo vetëm skandinav, sepse përbëhej nga mbretëria norvegjeze me territoret e veta, ishujt (Islandën, Færøerne, Grønland) nga mbretëria suedeze që përfshinte edhe regjionet e Finlandës dhe nga mbretëria daneze. Norvegjia kishte një mbretëri vendore deri me vdekjen e mbretit Håkon VI në vitin 1380. Håkon VI ishte i martuar me Margretën, vajzën e mbretit danez Vlademar Atterdag. Pas vdekjes së mbretit danez Valdemar Atterdag, djali i Håkon dhe i Margretës, Olavi, u zgjodh mbret i Danimarkës. Kështu që, Norvegjia e trashëgoi Olavin në union edhe si mbret të Norvegjisë, nëpërmes babait të tij Håkon VI. Aristokracia norvegjeze në unionin nordik (që dominohej nga aristokracia danezo-gjermane) e kishte një pozicion të dobët krahasuar me aristokracitë daneze dhe suedeze, të cilat kishin lidhje më të forta me aristokracitë evropiane dhe mund të mbijetonin më

lehtë. Fillimisht, aristokracia norvegjeze u përpoq të mbijetojë nëpërmes martesave, ku zakonisht vajzat norvegjeze nga familjet aristokrate norvegjeze martoheshin me aristokratët suedezë, danezë ose danezo-gjermanë. Por, aristokracia norvegjeze u zhduk me kohë.

Suedezët filluan gradualisht t'i tregojnë pakënaqësitë e tyre për shkak të influencës së madhe të danezëve në union. Olavi ishte vetëm pesë vjeç kur u kurorëzua mbret i Danimarkës nën mbikëqyrje të nënës së tij, Margretës, e cila e kishte 'de facto' pushtetin real të mbretërisë daneze, njëkohësisht ishte edhe udhëheqëse e unionit. Pas vdekjes së Olavit, i cili vdiq në moshën 17-vjeçare, Margrete nuk kishte më trashëgimtare. Ajo e adoptoi djalin e vajzës së motrës, Bogisllavin, të cilit ia ndryshuan emrin nga Bogisllav në Erik (i njohur historikisht me emrin Eriku nga Pomerania, regjion i ndarë në mes Polonisë dhe Gjermanisë së sotme). Eriku u kurorëzua si mbret i tri mbretërive nordike (Danimarkës, Suedisë dhe Norvegjisë) dhe rrjedhimisht u bë mbret i unionit që gjithnjë e më shumë karakterizohej nga konkurrenca për hegjemoninë nordike në mes të danezëve dhe suedezëve.

Situata u keqësua dukshëm më vonë, kur me ndikimin e aristokracisë danezo-gjermane mbret i unionit u zgjodh Christian I, nga shtëpia e madhe mbretërore e Oldenburgve që, shikuar historikisht, si familje mbretërore ka pasur dhe ka ndikim të madh në monarkitë evropiane. Christian I u kurorëzua mbret i Danimarkës prej vitit 1448, mbret i Norvegjisë prej vitit 1450 dhe mbret i Suedisë prej vitit 1457. Zgjedhja e Christian I si mbret i unionit shkaktoi pakënaqësi të madhe tek suedezët, e kjo pakënaqësi eskaloi në konflikt dhe luftëra në mes të suedezëve dhe danezëve për afër 70 vjet. Pas gjakderdhjes së Stokholmit, kur mbreti i unionit Christian II në vitin 1520 i ekzekutoi 80 fisnikë suedezë, që ishin kundër unionit dhe që dëshironin një mbretëri të pavarur suedeze, u intensifikua rezistenca e suedezëve dhe Suedia arriti të dalë përfundimisht prej unionit nordik në vitin 1523. Në qershor të vitit 1523 aristokrati suedez Gustav Errikson, i ashtuquajturi Gustav Vasa, u shpall mbret i Suedisë.

Norvegjia dhe Danimarka mbetën në unionin e përbashkët që gradualisht me kohë u transformua në dominimin e Danimarkës ndaj Norvegjisë, edhe pse në vitin 1450 lidhja në mes të Norvegjisë dhe

Danimarkës në union u forcua nëpërmes një traktati të përbashkët që nënkuptonte se as Norvegjia dhe as Danimarka nuk do të kenë pushtet dominues ndaj njëra-tjetrës dhe se këshillit vendor norvegjez do t'i sigurohet e drejta gjatë përzgjedhjes së mbretit. Por, ky traktat nuk u respektua në praktikë.

Megjithëkëtë, mund të thuhet se deri në periudhën e reformacionit Norvegjia nuk ishte krejtësisht nën dominimin e Danimarkës. Fillimisht, Norvegjia dhe Danimarka ishin dy vende të barabarta në union, nën një kurorë të përbashkët mbretërore, e gradualisht pushteti real i norvegjezëve u dobësua sepse norvegjezët nuk mund t'i konkurronin pushtetit ekonomik dhe aristokratik danez. Kisha katolike norvegjeze në Trondheim (qytet në Norvegji) ishte i vetmi faktor formal (deri në periudhën e reformacionit) që e ruante autonominë e Norvegjisë në raport me Danimarkën. Me fjalë të tjera, kisha katolike norvegjeze me kryepeshkopin e saj ishte institucioni i vetëm norvegjez i pavarur nga Danimarka dhe gjatë periudhës së reformacionit ra nën kontrollin e shtetit, përkatësisht në kontrollin e Danimarkës. Në këtë kuptim protestantizmi ishte një fatkeqësi kombëtare për Norvegjinë sepse ndikoi që Danimarka ta marrë kontrollin mbi autonominë kishtare norvegjeze dhe rrjedhimisht ta marrë edhe kontrollin e plotë mbi Norvegjinë.

Gjatë luftërave të Napoleonit politika e jashtme danezo-norvegjeze ishte e përcaktuar të bëjë tregti të lirë me shtetet ndërluftuese. Tregtia nëpërmes flotës detare daneze ishte në rritje të shpejtë dhe Britania e Madhe frikohej se flota daneze mund të binte në duart e Francës që kishte krijuar influencë kulturore në Danimarkë. Britania e Madhe e sulmoi Kopenhagën në vitin 1807 dhe e grabiti flotën daneze. Për këtë veprim, mbreti i Danimarkës dhe i Norvegjisë, Fredriku VI, u shpalli luftë britanikëve. Rrjedhimisht, Danimarka (duke e tërhequr me vete edhe Norvegjinë) u bë aleate e Francës, ndërsa Suedia, e udhëhequr prej vitit 1810 nga francezi Jean-Baptiste-Jules Bernadotte, e drejtoi kursin e politikës së jashtme drejt përafrimit me aleancën kundër Napoleonit.

Francezi Jean-Baptiste-Jules Bernadotte e kishte filluar karrierën ushtarake gjatë revolucionit francez në moshë të re. Pas grushtetit të Napoleonit nuk arriti, siç kishte pasur pritjet, të pozicionohet në pozita

të larta në pushtet dhe u zhgënjye, por pas rregullimit të marrëdhënieve me Napoleonin vazhdoi karrierën duke u bërë komandant në Hanover dhe mori titullin ushtarak, marskalk i Francës, ndërsa në vitin 1805 u emërua edhe princ i Ponte Corvos në Itali. Duke krijuar kontakte të forta me rrethet e pushtetit në Suedi, Jean-Baptiste arriti gradualisht të zgjidhet nga parlamenti suedez në vitin 1810 trashëgimtar i fronit mbretëror të Suedisë.

Jean-Baptiste konvertoi në protestanizëm, u adoptua nga mbreti i Suedisë Karl XIII (në Norvegji i njohur si Karl II) dhe u riemërua me emrin mbretëror, Karl Johan XIV (në Norvegji i njohur si Karl Johan III). Meqë mbreti i Suedisë, Karl XIII, ishte i vjetër dhe në gjendje shëndetësore të përkeqësuar, pasardhësi i tij, Karl Johan XIV (Jean-Baptiste), e mori timonin e menaxhimit të shtetit suedez që nga viti 1810, duke vazhduar edhe si mbret i Suedisë prej vitit 1918. Që nga ditët e para si burrështetas i Suedisë, Karl Johan XIV filloi ridizajnimin e politikës së jashtme suedeze. Ishte kundër planeve revanshiste suedeze (pas okupimit të Finlandës në vitin 1809 nga perandoria cariste ruse) për ta rimarrë Finlandën. Strategjia e tij ishte përmirësimi i marrëdhënieve me Rusinë dhe me ndihmën e Rusisë, si kompensim për Finlandën, ta merrte Norvegjinë ngaqë, sipas vlerësimit të tij gjeopolitik, Norvegjia dhe Suedia duhej të bashkoheshin. Rrjedhimisht, Suedia në vitet 1812-1813 hyri në aleancë me Rusinë, Anglinë dhe Prusinë, në luftën kundër Napoleonit dhe mori premtimin se pas fitores kundër Napoleonit, Norvegjia do t'i bashkohet Suedisë. Pas fitores së aleancës kundër Napoleonit, kapitulloi edhe Danimarka në janar 1814 dhe mbreti Fredrik VI u detyrua ta nënshkruajë traktatin në Kil (Traktati i Kilit) që nënkuptonte, pos të tjerash, t'i aneksohet Norvegjia Danimarkës dhe t'i bashkëngjitet Suedisë.

Nipi i mbretit të Danimarkës, Fredrikut VI, princi Christian Fredrik, që ishte në këtë kohë në Norvegji në cilësinë e udhëheqësit të vendit, nuk e pranoi Traktatin e Kilit dhe fillimisht kishte plan që nëpërmes së drejtës trashëguese të shpallet mbret i Norvegjisë. Mirëpo në mbledhjen në Eidsvoll (komunë në Norvegji) më 16 shkurt 1814, princi Christian Fredrik u pajtua me argumentimin e filologut dhe politikanit norvegjez, Georg Sverdrup, se sovraniteti i Norvegjisë tashmë kishte

kaluar tek populli norvegjez dhe rrjedhimisht nuk mund të shpallej askush mbret vetëm në bazë të së drejtës trashëguese.

112 përfaqësuesit (burokratë, fshatarë dhe afaristë) që u tubuan në Eidsvoll më 10 prill 1814, për të marrë vendim për fatin e Norvegjisë, ishin të ndarë në dy rryma politike, përkatësisht në indipendistët dhe në unionistët. Burokratët (shumica prej të cilëve i takonin rrymës independiste) ishin grupimi më i rëndësishëm dhe me më shumë influencë, sepse kishin përvojën politiko-administrative, njëkohësisht kishin njohuri më të mëdha teorike për politikën, jurisprudencën dhe filozofinë. Georg Sverdrup dhe historiani, politikani dhe juristi Christian Magnus (i quajtur edhe babai i Kushtetutës së Norvegjisë) dhe princi Christian Fredrik e përfaqësonin grupimin independist. Grupi tjetër që reprezantohej nga aristokrati norvegjez me prejardhje gjermane, Wedel Jarlsberg, ishte i mendimit se pavarësia e Norvegjisë nuk mund të realizohej në kundërshtim me vendimet e Fuqive të Mëdha, përkatësisht në kundërshtim me Traktatin e Kilit dhe, sipas tyre, zgjidhja më e mirë ishte të negociohen kushtet, në mënyrë që pozicioni i Norvegjisë në unionin me Suedinë të jetë sa më i volitshëm. Këto dy grupime politike, pavarësisht pikëpamjeve të dallueshme, gjetën konsensus gjatë hartimit të kushtetutës, duke u pajtuar me shumicën e parimeve të Kushtetutës. Rrjedhimisht, më 17 maj 1814 u miratua Kushtetuta e Norvegjisë dhe princi Christian Fredrik u zgjodh mbret i Norvegjisë.

Së këndejmi, pasi të gjitha forcat e Napoleonit u mundën nga aleanca, Karl Johan XIV kërkoi mbështetje nga aleanca për ta implementuar vendimin e bazuar në Traktatin e Kilit. Fuqitë e Mëdha të aleancës e dërguan një delegacion në Norvegji për ta bindur mbretin e sapoemëruar të Norvegjisë, Christian Fredrik dhe Qeverinë norvegjeze ta pranojnë vendimin e bazuar në Traktatin e Kilit. Meqë negociatat nuk patën sukses, Karl Johan XIV i dha urdhër ushtrisë suedeze ta sulmojë Norvegjinë. Pavarësisht një beteje të pabarabartë, ushtria norvegjeze bëri rezistencë, por nuk mundi të rezistojë shumë gjatë. Rrjedhimisht, më 14 gusht 1814 mbreti Christian Fredrik dhe Qeveria norvegjeze e nënshkruan Konventën e Mosit, ku u arrit një kompromis që mbreti Christian Fredrik të tërhiqet nga pozicioni i mbretit të Norvegjisë, njëkohësisht Karl Johan XIV premtoi të mos e

ndryshojë Kushtetutën e Norvegjisë përpos ndryshimit të domosdoshëm për aprovimin e unionit suedezo-norvegjez në krye me mbretin Karl XIII. Më 20 tetor 1814 në parlamentin norvegjez u miratua vendimi për unionin në mes të Suedisë dhe Norvegjisë, ndërsa më 4 nëntor 1814 mbreti i Suedisë, Karli XIII, u zgjodh edhe mbret i Norvegjisë.

Edhe pse vera e vitit 1814 ishte periudhë e shkurtër e pavarësisë së Norvegjisë, karakterizohet si periudha që shënoi datën e fillimit të kombshtetndërtimit modern norvegjez. Statusi politik i Norvegjisë në unionin me Suedinë dallonte shumë nga statusi politik që e kishte Norvegjia në unionin me Danimarkën sepse Norvegjia në unionin me Suedinë e kishte pothuajse autonominë e brendshme të plotë. Fillimisht, një ndër mosmarrëveshjet në unionin me Suedinë ishte çështja e festimit nacional të datës 17 maj. Kjo datë lejohej fillimisht të shënohej vetëm në një formë të kufizuar, nën kontrollin e mbretit të unionit.

Një fitore nacionale norvegjeze u arrit kur parlamenti norvegjez i refuzoi amendamentet e propozuara nga mbreti i unionit për ndryshimet kushtetuese që, në fakt, nënkuptonin rritjen e pushtetit të mbretit. Kjo fitore u reflektua edhe gjatë festimit nacional të 17 majit. Prej vitit 1830 e këtej, 17 maji mori karakterin e festimit nacional.

Historianët norvegjezë e cilësojnë periudhën 1814-1884 në Norvegji, si periudhën e "shtetit të zyrtarëve", e udhëhequr kryesisht nga norvegjezët e shkolluar në Universitetin e Kopenhagës, i cili ishte themeluar në vitin 1479. Universiteti i Oslos u hap shumë më vonë, përkatësisht në vitin 1811. Në fakt, shkolla e parë e nivelit të lartë në vendet nordike është hapur përafërsisht 40 vjet pas themelimit të unionit nordik, përkatësisht në kohën kur unioni udhëhiqej nga nipi i Margretës, Bogisllavi, i njohur si mbreti Erik. Kjo shkollë e parë nordike, e quajtur *Studium Generale,* u themelua në vitin 1438 në Lund të Suedisë, e si qëllim parësor kishte t'ua bëjë më praktike qasjen për studime të gjithë nordikasve të interesuar për studime të larta. Para vitit 1438 nordikasit e interesuar për studime të larta duhej të shkonin në Paris dhe në qendra të tjera evropiane.

Shkolla e lartë *Studium Generale* i parapriu themelimit të Universitetit të Lundit në vitin 1666. Rrjedhimisht elita e zyrtarëve

shtetërorë norvegjezë, që tradicionalisht shkollohej në Kopenhagë, u ndikua shumë herët nga idetë e mendimtarëve si Montesquieu, Volteri, Adam Smith etj., prandaj kjo elitë nuk shihte ndonjë kundërthënie të madhe në mes të nacionalizmit politik dhe kozmopolitizmit. Me fjalë të tjera, elita e zyrtarëve shtetërorë norvegjezë ishte një vazhdimësi e burokratëve norvegjezë që nga periudha e para vitit 1814 (gjatë kohës kur Norvegjia ishte ende në union me Danimarkën) dhe rrjedhimisht kjo elitë e zyrtarëve shtetërorë norvegjezë, duke qenë e prirur më shumë nga idetë politike të kombformimit, e reprezantonte një distancë ndaj ideve të nacionalromantizmit, që ishin të pranishme gjatë kësaj kohe në Norvegji, por që fillimisht nuk mund të politizoheshin për shkak të ndikimit të madh që kishte elita e zyrtarëve shtetërorë norvegjezë.

Elita e zyrtarëve shtetërorë norvegjezë, duke qenë e prirë nga ideja iluministe e qeverisjes (shpërndarjes së diturisë, progresit shkencor, tregut të lirë etj.) kontribuoi në modernizimin e Norvegjisë në kuptimin e të ndërtuarit të rrjetit të komunikimit (rrugëve, hekurudhave etj.) zgjerimit të tregtisë së lirë edhe jashtë shtetit nëpërmes transportit detar dhe, gjithashtu, kontribuoi për konsolidimin e bashkësisë kombëtare norvegjeze nëpërmes një sistemi të standardizuar dhe gjithëpërfshirës shkollor. Përfaqësuesit më të spikatur të kësaj elite të zyrtarëve shtetërorë norvegjezë ishin juristi dhe profesori i parë i socio-ekonomisë në Norvegji, Anton Martin Schweigaard dhe juristi, parlamentari dhe politikani Frederik Stang. Megjithëkëtë, e meta e kësaj elite të zyrtarëve shtetërorë norvegjezë karakterizohej nga mendimi i tyre autoritativ, se vetëm ata ishin të denjë dhe të aftë për udhëheqje të vendit, rrjedhimisht u bënë pengesë e demokratizimit të plotë të shoqërisë norvegjeze.

Gjatë shekullit XVIII u forcua linja e konfliktit në mes të elitës politike norvegjeze danishtfolëse (zyrtarëve shtetërorë norvegjezë) dhe Lëvizjes Nacionalpopuliste Norvegjeze e bazuar në idetë e romantizmit, në kuptimin se populli ka të drejtë, e jo elita politike norvegjeze që konsiderohej se ishte lojale ndaj Suedisë dhe Danimarkës. Me fjalë të tjera, gjatë kësaj periudhe fshatarët norvegjezë filluan t'i nacionalromantizojnë heronjtë historikë, t'i shohin me përçmim qytetarët norvegjezë që identifikoheshin me

danezët, njëkohësisht filluan ta konsiderojnë elitën politike norvegjeze si e dëgjueshme e Suedisë dhe Danimarkës.

Lëvizja Nacionalpopulliste Norvegjeze, duke u bazuar në doktrinën herderiane "shpirtin e popullit", filloi ta kultivojë origjinalitetin norvegjez që, në radhë të parë, simbolizohej me "fshatarin e lirë norvegjez", gjithnjë në oponencë me okupuesit. Edhe pse në këtë kohë në Norvegji ekzistonte mendimi se gjuha e shkruar daneze mund të cilësohet edhe si gjuhë norvegjeze (sepse konsiderohej se gjuha daneze kishte bazë norvegjeze po aq sa kishte edhe bazë daneze) ideja herderiane për gjuhën si elementi kryesor për konstituimin e bashkësisë nacionale ndikoi që Lëvizja Nacionalpopuliste Norvegjeze ta konsiderojë gjuhën daneze si gjuhë të huaj. Rrjedhimisht, gjatë kësaj periudhe të forcimit të nacionalizmit kulturor norvegjez dallimi në mes të gjuhës së shkruar daneze dhe gjuhës së folur norvegjeze shihej si problem, që njëkohësisht e sfidoi edhe elitën kulturore norvegjeze për të gjetur një zgjidhje.

Kritiku letrar Johan Sebastian Cammermeyer Welhaven, i cili përfaqësonte grupimin më të vogël, ishte pro akceptimit të gjuhës së shkruar daneze. Ndërsa historiani Peter Andreas Munch mendonte se zgjidhja më e mirë do të ishte të merret pikënisje në një dialekt të periudhës së mesjetës, që ishte më i ngjashmi me gjuhën e folur dhe të shkruar në Norvegji dhe Islandë. Shkrimtari norvegjez Henrik Wegerland (si përfaqësuesi më i spikatur i nacionalizmit kulturor norvegjez, në përpjekjet e tij për të etabluar një kontinuitet historik norvegjez, të bazuar në të kaluarën e përbashkët norvegjeze që nga kohët e lashta) nuk pajtohej me Johan Sebastian Cammermeyer Welhaven, njëkohësisht edhe alternativën e Peter Andreas Munch e konsideronte si alternativë shumë radikale dhe si e vështirë të realizohej në praktikë. Wegerland ishte pro norvegjizimit gradual të danishtes, ngase qëllimi i tij ishte të arrihet një përputhje më e mirë në mes të gjuhës së shkruar dhe gjuhës së folur për arsye letrare, nacionale dhe demokratike. Wegerland argumentonte se norvegjezët kishin nevojë dhe dëshirë të madhe ta përdorin gjuhën e tyre, sidomos për ta përshkruar natyrën e vendit të tyre, e këtë mund ta bënin vetëm nëpërmes një gjuhe të shkruar norvegjeze. Gjithashtu, sipas tij, gjuha norvegjeze, që të mund të bëhej gjuhë nacionale norvegjeze, duhej ta

kishte identitetin e vet të veçantë gjuhësor në mes të gjuhës daneze dhe gjuhës suedeze. Argumentimin demokratik Wegerland e bazonte në një pikënisje iluministe ngaqë, sipas tij, vetëm një gjuhë e shkruar, që ka sa më shumë përputhje me gjuhën e folur, mund të përdorej më shumë dhe mund të kontribuonte më shumë për edukimin e masave popullore norvegjeze, në veçanti për edukimin e shtresës fshatare norvegjeze. Rrjedhimisht, sipas Wegerland, gjuha e shkruar, që kryesisht përdorej vetëm nga zyrtarët shtetërorë norvegjezë, nuk kontribuonte as për edukimin e masave, as për demokratizimin e shoqërisë.

Poeti dhe dramaturgu Bjørnstjerne Bjørnson, i cili kontribuoi për identitetin kulturor norvegjez, përveç të tjerash, duke e norvegjizuar artin skenor në teatër dhe si autor i himnit nacional norvegjez, nuk pajtohej me idenë e historianit Peter Andreas Munch për formësimin e një gjuhe norvegjeze të bazuar në dialekte mesjetare. Bjørnson distancohej nga elementet anakronike kulturore që komplikonin prosperitetin kulturor norvegjez, pa marrë parasysh se sa norvegjeze konsideroheshin këto elemente kulturore. Sipas Bjørnsonit, duhej integruar elemente të reja kulturore, përderisa këto elemente ishin të domosdoshme për prosperitetin kombëtar norvegjez.

Historiani dhe gazetari Ludvig Kristensen Daa, në veçanti linguisti Knud Knudsen, duke u mbështetur në idenë e Wegerlandit, kontribuuan për norvegjizimin e gjuhës së shkruar daneze, e cila tani njihet si gjuhë norvegjeze me emrin Bokmål. E linguisti Ivar Andreas Aasen përkrahu idenë e historianit Peter Andreas Munch, duke u përqendruar në studimet e dialekteve norvegjeze u bë arkitekti i gjuhës norvegjeze që sot e njohim me emrin Ny Norsk. Rrjedhimisht me kohë është arritur konsensus, që të dyja këto gjuhë norvegjeze (bokmål dhe ny norsk) ta kenë statusin e njëjtë si gjuhë norvegjeze. Norvegjia bën pjesë në ato shtete që nuk kanë gjuhë të unifikuar zyrtare dhe është e akceptueshme të flitet në Bokmål dhe Ny Norsk, në radiotelevizion, universitet etj.

Si rezultat i lëvizjes nacional populiste norvegjeze, gradualisht u shfaq një subjekt i fuqishëm politik në parlamentin norvegjez, i cili ishte kryesisht produkt i organizimit të sindikatave të fshatarëve dhe përpjekjes për demokratizimin e plotë të vendit. Ky subjekt politik u

transformua në vitin 1884 në partinë e parë norvegjeze, përkatësisht në Partinë Liberale, e ashtuquajtura Partia e Majtë (Venstre), në krye me juristin dhe politikanin Johan Sverdrup. Në të njëjtin vit u themelua edhe Partia e Djathtë (Høyre), e cila përbëhej nga elita e zyrtarëve shtetërorë norvegjezë dhe fitoi më pak vende në parlament.

Zgjedhja e liderit të Partisë së Majtë (Venstre), Johan Sverdrup, kryeministër i Norvegjisë, shënon në vitin 1884 hyrjen e parlamentarizmit në Norvegji dhe e karakterizon transformimin e shtetit norvegjez nga "shteti i zyrtarëve" në "shtetin e të majtëve" drejt demokratizmit të plotë të shoqërisë norvegjeze. Zhvillimi ekonomik, politik dhe social në Norvegji ndikoi që populli norvegjez ta rritë interesimin për të dalë nga unioni i përbashkët me Suedinë. Megjithëkëtë, shkaku kryesor, përpos shkaqeve të tjera, pse Norvegjia doli nga unioni i përbashkët me Suedinë, ishte mosuniteti rreth konsolidimit të politikës së jashtme të unionit. Në mungesë të gjetjes së konsensusit për konsolidimin e politikës së jashtme të unionit, parlamenti norvegjez mori vendim për etablimin e përfaqësive diplomatike të Norvegjisë në botë, por kjo u kundërshtua ashpër nga mbreti i unionit Oscar II.

Pas shumë peripecive, kërkesa për përfaqësimin diplomatik të Norvegjisë u bë shkak për daljen e Norvegjisë nga unioni me Suedinë nëpërmes referendumit të mbajtur më 13 gusht 1905. Njëkohësisht u ngrit çështja se çfarë forme shtetërore duhet të ketë Norvegjia në të ardhmen. Një grupim brenda Partisë Liberale, e ashtuquajtura Partia e Majtë (Venstre), insistonte për republikë, mirëpo në referendumin pro apo kundër mbretërisë, mbajtur më 12 - 13 nëntor, u vendos që Norvegjia ta ketë mbretërinë e vet.

Mbreti i Suedisë, Oscar II (i cili ishte nip i Jean-Baptiste-Jules Bernadotte, në Suedi, i njohur me emrin Karl Johan XIV, ndërsa në Norvegji i njohur me emrin Karl Johan III), i propozoi Norvegjisë, që një princ nga shtëpia mbretërore Bernadotte ta marrë përsipër fronin mbretëror të Norvegjisë, por ky propozim i tij u refuzua nga parlamenti norvegjez. Parlamenti norvegjez e zgjodhi më 18 nëntor 1905 princin Karl nga Danimarka (me prejardhje nga shtëpia mbretërore e Oldenburgëve) mbret të Norvegjisë, i cili u riemërua me emrin Håkon VII.

Partia Norvegjeze e Punës (Partia Socialdemokrate Norvegjeze), e cila u themelua në vitin 1887 (si rezultat i industrializimit në Norvegji, përkatësisht nevojës së organizimit të sindikatave të punëtorëve dhe konfliktit në tregun e punës në mes të punëdhënësve dhe punëmarrësve), e mori pushtetin në fillimvitet 1930-ta. Partinë Norvegjeze të Punës, me mbajtjen e pushtetit për një kohë të gjatë, e karakterizon transformimi i shtetit norvegjez në "shtetin e punëtorëve" drejt konsolidimit të shtetit socialdemokrat (shtetit të mirëqenies).

Procesi i konsolidimit të kombit dhe shtetit modern norvegjez prej fillimshekullit XVIII është i karakterizuar nga komplementariteti në mes të nacionalizmit politik dhe nacionalizmit kulturor. Nga njëra anë idetë e iluminizmit kontribuuan për një kushtetutë norvegjeze të bazuar në idetë liberale dhe për një parlament që siguroi të drejtat demokratike të Norvegjisë etj. Nga ana tjetër, idetë nacionalromantike kontribuuan që kultura norvegjeze të krijojë një lidhje të ngushtë me politikën norvegjeze. Përvoja e keqe e norvegjezëve në unione gjatë historisë, bëri që "fshatari i lirë norvegjez" të mbetet simbol i identitetit kombëtar norvegjez, në kuptimin që kombi norvegjez ta ruajë lirinë e vet kombëtare dhe të jetë i shqetësuar të jetë më i miri ndër më të mirët.

Pas Luftës së Dytë Botërore Norvegjia bazohej fillimisht në shpresën (si bashkëthemeluese e Kombeve të Bashkuara) se Kombet e Bashkuara do të mund t'ia japin sigurinë e mjaftueshme shtetit norvegjez dhe se në këtë mënyrë shteti norvegjez do të mund të qëndrojë jashtë aleancave dhe jashtë konflikteve eventuale në mes të shteteve. Mirëpo me rritjen e tensioneve në mes të Lindjes dhe Perëndimit politika e jashtme norvegjeze filloi ta marrë orientimin perëndimor, fillimisht nëpërmes pranimit të ndihmës - marshall në vitin 1947. Megjithëkëtë, shkaku kryesor (përveç shkaqeve të tjera) që ndikoi që Norvegjia të marrë hapa konkretë në përcaktimin e politikës së saj të jashtme ishte marrëveshja që iu imponua Finlandës nga Bashkimi Sovjetik, ngase në Norvegji u shtua droja se një marrëveshje e ngjashme mund t'i imponohej edhe Norvegjisë. Fillimisht u forcua bindja për një alternativë skandinave të mbrojtjes, përkatësisht për themelimin e asociacionit skandinav të mbrojtjes.

Ministri i Jashtëm norvegjez, Halvard Lange, i jepte prioritet themelimit të asociacionit skandinav të mbrojtjes, me kushtin që ky asociacion t'i ketë disa pika ndërlidhëse me Perëndimin. Mirëpo këmbëngulja e Suedisë, që asociacioni skandinav i mbrojtjes të jetë krejtësisht i pavarur, çoi në dështimin e negociatave në vitin 1949. Meqë negociatat për themelimin e asociacionit skandinav të mbrojtjes dështuan, Norvegjia dhe Danimarka u anëtarësuan në NATO në prill të vitit 1949. Në këtë mënyrë Norvegjia gradualisht filloi të zhvillojë një politikë të jashtme më proaktive, krahasuar me shtetet e tjera nordike, ngaqë (për dallim të Finlandës) me anëtarësimin në NATO arriti ta evitojë imponimin e ndonjë marrëveshje eventuale nga Bashkimi Sovjetik, por as nuk mbeti neutrale në politikën e jashtme sikurse Suedia, as nuk e kishte në nivel të njëjtë parlamentin e fragmentuar me një opozitë të fortë anti-NATO sikurse Danimarka. Gjithashtu, nuk kishte kushtëzime konstitucionale që kushtëzojnë shumicën parlamentare sikurse Danimarka.

Edhe pse Danimarka sikurse Norvegjia është e karakterizuar nga parlamentarizmi negativ në kuptimin se qeveritë nuk kanë domosdosmërisht nevojë ta kenë besimin nga parlamentet, por vetëm ta evitojnë mosbesimin e parlamenteve. Sistemi politik danez, për dallim nga sistemi politik norvegjez, është i kontrolluar më shumë nga struktura konstitucionale, përkatësisht nga kriteri i referendumit obligues (për shembull ndryshimet kushtetutare nuk mund të bëhen vetëm në bazë të tekeve të politikanëve, por vetëm nëpërmes referendumit si, për shembull, në Zvicër, Irlandë, Australi etj). Gjithashtu, nga kriteri i referendumit fakultativ, që nënkupton se pakica në parlament (1/4 e parlamentit) e ka të drejtën (që nuk e përdor domosdosmërisht gjithmonë, por nganjëherë kur mund të konsiderohet si e domosdoshme) të kërkojë të mbahet referendumi popullor për një ligj që është miratuar nga shumica në parlament.

Për shembull, gjatë viteve '60 pakica në parlamentin danez ka insistuar dhe e ka fituar referendumin popullor kundër shumicës parlamentare në lidhje me ligjet për tokën (kushtet për bujqësinë) duke e ndryshuar ligjin për të drejtën e posedimit të tokës private. Gjithashtu, entuziazmi i Norvegjisë për angazhimin shumëdimensional në marrëdhëniet ndërkombëtare ka të bëjë edhe

me preokupimin e norvegjezëve (të bazuar në identitetin nacional norvegjez) që të jenë shembulli më i mirë ndër më të mirët, në angazhimin e tyre për një rend ndërkombëtar që kontribuon për paqen, sigurinë dhe lirinë në botë.

Politika e jashtme norvegjeze është e karakterizuar nga një kombinim i idealizmit dhe realizmit politik. Duke qenë e preokupuar me ruajtjen e lirisë së vet kombëtare, Norvegjia e kompensoi mosanëtarësimin në Bashkimin Evropian (dhe më vonë, mosanëtarësimin në Unionin Evropian) duke u kyçur dhe duke qenë aktive në kontiniutet, në organizata europerëndimore; si bashkëthemeluese dhe anëtare e Këshillit Evropian që nga themelimi në vitin 1949. E kyçur në Organizatën për Bashkëpunimin Ekonomik Evropian (OEEC) që nga themelimi në vitin 1948, duke vazhduar prej vitit 1961 (pas riorganizimit të OEEC në OECD) në Organizatën për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim. Gjithashtu, duke qenë bashkëthemeluese dhe anëtare që nga viti 1960 e Asociacionit Evropian për Tregti të Lirë (EFTA) dhe që nga viti 1992 nëpërmes nënshkrimit të marrëveshjes në mes të EFTA-s dhe Unionit Evropian u bë pjesë e Zonës Ekonomike Evropiane (EEA).

Menjëherë pas anëtarësimit në NATO, një ndër shkaqet kryesore ishte Lufta e Ftohtë, sepse buxheti i ushtrisë norvegjeze prej vitit 1949 - ’53 u trefishua, shërbimi ushtarak u zgjat deri në 16 muaj, ndërsa në forcën ajrore dhe detare deri në 18 muaj. Norvegjia i dha përkrahje të parezervë vendimit të NATO-s të vitit 1979 për plasimin e sistemit të ri raketor në Evropën qendrore, ku njëkohësisht iu bë ftesë Bashkimi Sovjetik për reduktimin ose heqjen e sistemeve raketore. Në vitin 1981, pas një debati të gjatë, parlamenti norvegjez e miratoi marrëveshjen në mes të Norvegjisë dhe SHBA-ve për magazinimin e pajisjeve luftarake të SHBA-ve në Norvegji.

Në fillimvitet 1970-ta Norvegjia, përveçse mori përmasat e një fuqie ekonomike si rrjedhojë e zbulimit të resorëve të mëdhenj të naftës, duke u cilësuar edhe si “komb i naftës”, u pozicionua edhe si negociatore e rëndësishme për zgjidhjet e konflikteve në mes të popujve në botë. Diplomati norvegjez Knut Frydenlund në fillimvitet ’70-ta e inicioi dialogun me Palestinën. Knut Frydenlund së bashku me diplomatët e mëvonshëm norvegjezë, Thorvald Stoltenberg

dhe Johan Jørgen Holst, konsiderohen si arkitektët e politikës së jashtme norvegjeze (nga Partia e Punës/Partia Socialdemokrate) në periudhën prej fillimviteve ’70-ta deri në fillimvitet ’90-ta.

Në vitin 1974 Frydenlund insistoi t’i jepet fjala Yasir Arafatit në asamblenë e Kombeve të Bashkuara. Për këtë propozim hasi në kritika nga disa politikanë edhe në Norvegji, të cilëve iu përgjigj se insistimi i tij, që t’i jepet e drejta e fjalës Arafatit, ishte “historikisht i qëlluar, por politikisht i gabuar”.

Në vitin 1993 Norvegjia në krye me ministrin e Jashtëm norvegjez Johan Jørgen Holst e arriti marrëveshjen në mes të Izraelit dhe Palestinës, të ashtuquajturën Marrëveshjen e Oslos. Edhe pse procesi i marrëveshjes së Oslos u vështirësua në implementim, kjo marrëveshje cilësohet si arritje e madhe diplomatike dhe ndikoi të rritet prestigji i Norvegjisë në rolin e saj si negociatore, duke negociuar edhe në konflikte të tjera: ish-Jugosllavi, Sri Lankë, Guatemalë etj.

Krahas angazhimeve në kuadër europerëndimor, në kuadër të NATO-s dhe si negociatore e rëndësishme për zgjidhjet e konflikteve në mes të popujve në botë, një kontribut i veçantë i Norvegjisë në bashkëveprimin ndërkombëtar është angazhimi për të drejtat dhe liritë e njeriut nëpërmes procesit të Konferencës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (KSBE) që shërbeu 20 vjet si arenë konferencash për relaksimin dhe përmirësimin e marrëdhënieve në mes të Lindjes dhe Perëndimit.

Pikënisje për etablimin e KSBE-s ishte iniciativa e Bashkimit Sovjetik, përkatësisht iniciativa e ministrit të Jashtëm Vjatsjeslav Molotov, i cili në vitin 1954 lansoi idenë për një konferencë të sigurisë në mes të Lindjes dhe Perëndimit. Gjithashtu, Leonid Bresjnev, gjatë kongresit të partisë në vitin 1966, u bëri thirrje shteteve evropiane për t’i trajtuar/zgjidhur bashkërisht çështjet e sigurisë politiko-ushtarake. SHBA-të fillimisht ishin kundër, ngase iniciativën e Bashkimit Sovjetik e konsideronin si tentim t’i përçajë shtetet evropiane me SHBA-të, në veçanti t’i armiqësojë Francën dhe SHBA-të (duke e marrë parasysh ndikimin që e kishte Franca në Evropë dhe apetitet rivalizuese të Francës ndaj SHBA-ve).

Më vonë presidenti amerikan Richard Nixon dhe ministri i Jashtëm Henry Kissinger ishin skeptikë ndaj iniciativës së Bashkimit Sovjetik

sepse mendonin se pozicioni i fortë i SHBA-ve në NATO dhe në bisedimet bilaterale me Bashkimin Sovjetik mund të dobësohej po qe se SHBA-të bëheshin pjesë e një dialogu multilateral për çështjet e sigurisë politiko-ushtarake. Pas shumë peripecive dhe iniciativave (Deklaratës së Bukureshtit 1966, Apelit të Budapestit 1969 etj.) u miratua Deklarata e Helsinkit gjatë konferencës së KSBE-s në Helsinki të Finlandës në vitin 1975. Deklarata e Helsinkit (që, përveç Shqipërisë, u nënshkrua nga të gjitha shtetet evropiane, SHBA-ja dhe Kanadaja) nuk ishte juridikisht e detyrueshme, por duke e marrë parasysh se pas shumë peripecive ishte një rezultat i suksesshëm i një konsensusi, kryesisht në mes dy superfuqive të kohës (Bashkimit Sovjetik dhe SHBA-ve), konsiderohej politikisht dhe moralisht e detyrueshme. E në këtë kuptim, procesi i KSBE-s prej vitit 1975 shënon fillimin e një faze të rëndësishme politike në marrëdhëniet ndërkombëtare, i njohur si Procesi i Helsinkit.

Në mesin e 10 parimeve të Deklaratës së Helsinkit u përfshi edhe parimi për të drejtat dhe liritë e njeriut dhe u bë faktori kryesor që Procesi i Helsinkit (i cilësuar edhe si Lëvizja e Helsinkit) të marrë një zhvillim të hovshëm: duke e inspiruar dhe inkurajuar angazhimin vullnetar ndërkombëtar për të drejtat dhe liritë e njeriut, në veçanti nëpërmes etablimit të të ashtuquajturve "Grupeve të Helsinkit".

Grupi i parë i Helsinkit, i njohur edhe si Moscow Helsinki Watch Group, u themelua në Moskë në vitin 1976, me iniciativën e Yuri Orlov, Andrei Sakharov etj., me qëllim ta monitorojë respektimin dhe implementimin e parimit të Deklaratës së Helsinkit për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut. Për këtë qëllim në Poloni u formua Komiteti për Mbrojtjen e Punëtorëve (KOR) në vitin 1976 dhe në vitin 1977 Lëvizja për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Drejtave Qytetare (ROPCiO). KOR dhe ROPCiO gradualisht rezultuan në aleancën në mes të punëtorëve, intelektualëve dhe kishës dhe themeluan Solidarnostin në vitin 1980 dhe Komitetin Polak të Helsinkit në vitin 1982. Gjithashtu, në vitin 1977 u themelua Charta 77 në Çekosllovaki në krye me Havelin etj., të cilët kishin shumë ngjashmëri me grupet e Helsinkit.

Autoritetet shtetërore sovjetike, çekosllovake dhe polake iu përgjigjen me represion aktivistëve për të drejtat e njeriut. Në veçanti

autoritetet shtetërore sovjetike iu përgjigjen me represion të ashpër (arrestime, burgosje dhe internime të brendshme) pjesëtarëve të grupit të Helsinkit në Moskë, e kjo shkaktoi indinjatë tek shtetet anëtare të KSBE-së. Kjo indinjatë rezultoi edhe me themelimin e "Grupeve të Helsinkit" në shtetet perëndimore, që qëllim parësor kishin mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në Lindje. Në Norvegji u themelua shumë herët Grupi i Helsinkit (Komiteti Norvegjez i Helsinkit), përkatësisht në vitin 1977. Gjithashtu, në vitin 1979 u formalizua themelimi i Grupit të Helsinkit në Amerikë (Helsinki Watch Amerikan).

Helsinki Watch Amerikan pati ndikim të madh në politikën amerikane, ngase në këtë periudhë, nën udhëheqjen e presidentit Jimy Carter, të drejtat dhe liritë e njeriut u bënë prioriteti kryesor në politikën e jashtme amerikane. Rrjedhimisht, çështja e të drejtave dhe lirive të njeriut dominonte në kontiniutet në diskursin në mes të shteteve anëtare të KSBE-s gjatë Procesit të Helsinkit, që nuk ishte vetëm një proces ndërshtetëror, por edhe një proces civil. Shtetet perëndimore i kritikonin vazhdimisht shtetet e lindjes për shkelje të drejtave politike dhe civile, ndërsa shtetet e lindjes e refuzonin kritikën e shteteve perëndimore duke iu referuar njërit ndër parimet e Deklaratës së Helsinkit për mosndërhyrje në punët e brendshme të shteteve (moscenim të sovranitetit), njëkohësisht i kritikonin shtetet perëndimore për shkelje të të drejtave ekonomike dhe sociale.

Gjatë procesit të Helsinkit, në nivelin shtetëror, Norvegjia si anëtare e KSBE-s e kishte një rol shumë të rëndësishëm ngase ishte pjesë e grupit të NATO-s që, si grup shtetesh, i koordinonin pikëpamjet dhe konsultoheshin gjatë konferencave të KSBE-s. Madje gjatë takimit të Madridit filluan t'i bëjnë praktikë takimet joformale nëpërmes të ashtuquajturit "klubi i drekës", ku përfaqësuesit e SHBA-ve, Britanisë së Madhe, Gjermanisë, Francës, Norvegjisë dhe Holandës i realizonin takimet e rregullta joformale gjatë drekave të përbashkëta.

Gjatë Procesit të Helsinkit në nivelin civil (që karakterizohej nga shkëmbimi i informacionit në mes të komiteteve të pavarura të Helsinkit për shkeljen e të drejtave të njeriut në Lindje) komiteti i pavarur norvegjez i Helsinkit, në pajtueshmëri dhe në bashkëpunim me komitetet e tjera të pavarura të Helsinkit (Austrisë, SHBA-ve,

Belgjikës, Kanadasë, Francës, Holandës dhe Komitetin e Helsinkit Suedez të sapothemeluar), në vitin 1982 e themeluan Federatën Ndërkombëtare të Helsinkit, me qëllim (përveç qëllimeve të tjera) që të forcohet bashkëpunimi në mes të komiteteve ekzistuese, të vijojë themelimi i komiteteve dhe të inkurajohen forcat opozitare në lindje.

Presidenti Carter dhe Grupet e Helsinkit, nëpërmes Procesit të Helsinkit, kanë pasur rol vendimtar për unifikimin e shteteve perëndimore nëpërmes një diskursi të përbashkët për të drejtat e njeriut kundër Bashkimit Sovjetik. Shtetet perëndimore në mënyrë unike gjithnjë e më shumë e rritnin presionin ndaj Bashkimit Sovjetik në lidhje me të drejtat e njeriut, në kuptimin se të drejtat e njeriut nuk mund të cilësoheshin vetëm si çështje të brendshme të shteteve, siç i konvenonte Bashkimit Sovjetik dhe shteteve të tjera totalitare dhe autoritare. Gjithashtu, politika reformiste e Gorbaçovit ka qenë vendimtare që sistemet totalitare dhe autoritare të fillojnë të hapen ndaj parimit të Deklaratës së Helsinkit për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut.

Parimi i Deklaratës së Helsinkit për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut, në vazhdën e Procesit të Helsinkit, i parapriu dhe i legjitimoi (pas shembjes së murit të Berlinit) intervenimet humanitare në Somali, Ruandë, Jugosllavi dhe vende të tjera. Norvegjia si anëtare aktive e KSBE-së vazhdoi të jetë aktive edhe pasi KSBE në vitin 1995 u institucionalizua në Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE).

Gjatë periudhës së luftës në Kosovë, kryetar i OSBE-së ishte ministri i Jashtëm i Norvegjisë, z. Knut Vollebæk.

Në nivelin nordik Norvegjia është aktive në kuadër të kështillit nordik (si organ për bashkëpunimin në mes të parlamenteve nordike) që u themelua në vitin 1952, me iniciativë të kryeministrit danez Hans Hedtoft, si rezultat i zhgënjimit për dështimin e themelimit të asociacionit skandinav të mbrojtjes në vitin 1949. Gjithashtu, prej vitit 1971 Norvegjia është aktive në kuadër të kështillit të ministrave nordikë (si organ për bashkëpunimin në mes të qeverive nordike). Me kalimin e kohës bashkëpunimi në mes të shteteve nordike është forcuar edhe më shumë. Një ndër indikatorët e rëndësishëm për evoluimin e këtij bashkëpunimi është kërkesa e ministrave të jashtëm të shteteve

nordike drejtuar diplomatit norvegjez z. Thorvald Stoltenberg më 16 qershor 2008, që të përpilojë një raport me propozime në lidhje me forcimin e bashkëpunimit nordik në politikën e jashtme dhe të sigurisë, të cilin raport e dorëzoi më 9 shkurt 2009.

Veprimtaria me qendër në Oslo në kuadër të Lëvizjes Popullore të Kosovës (LPK-së) startoi në fillimvitin 1987. Konsolidimi i veprimtarisë së LPK-së në Norvegji, në shtetet e tjera nordike dhe në përgjithësi në shtetet perëndimore ndërlidhet drejtpërdrejt me organizimin e mbledhjes së parë të përgjithshme të LPK-së në vitin 1987, me delegatë nga brenda dhe jashtë vendit. E nevoja për organizimin e LPK-së në Norvegji ishte e domosdoshme, përveç të tjerash, sepse propaganda serbo-jugosllave pas Luftës së Dytë Botërore arriti të ketë ndikim të madh në Norvegji, duke e shtrirë këtë ndikim propagandistik në shtetet e tjera nordike.

Propaganda serbo-jugosllave e arriti fillimisht suksesin propagandistik, duke e përdorur si mjet propagandistik historinë e të burgosurve jugosllavë të luftës në Norvegji (gjatë Luftës së Dytë Botërore) në kuptimin se vetëm serbët kanë qenë anti-nazifashistë të devotshëm: nga njëra anë duke i bashkëlidhur nocionet serb-partizan-antinazifashist-jugosllav, nga ana tjetër duke aluduar se popujt e tjerë në Jugosllavi kanë qenë më shumë bashkëpunëtorë të nazifashistëve sesa kundërshtarë të nazifashitësve. Në bazë të kësaj propagande, Serbia e stimulonte miqësinë me Norvegjinë edhe për arsyen se Norvegjia pas Luftës së Dytë Botërore rezultoi si shteti nordik më proaktiv (krahasuar me shtetet e tjera nordike) në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Konsolidimi i veprimtarisë së LPK-së në Norvegji ishte gjithashtu i domosdoshëm sepse, pas demonstratave shqiptare në Jugosllavi në vitin 1981, shqiptarët filluan gradualisht të emigrojnë edhe në Norvegji si rezultat i politikës nacionalshoviniste serbe që e krijoi një situatë të stër-rënduar politiko-ekonomike për shqiptarët në Jugosllavi, me qëllim të pastrimit etnik gradual të shqiptarëve.

Nordikasit në përgjithësi dhe norvegjezët në veçanti me kulturën e tyre të theksuar humaniste janë të prirur t'i mbështesin përpjekjet për liritë dhe të drejtat e popujve të shtypur. Kështu që, jorastësisht socialantropologia norvegjeze, znj. Berit Backer, ishte e vetmja

studiuese në shtetet perëndimore që pati guximin intelektual të vihet praktikisht në veprim për ta sfiduar propagandën e historiografisë dhe politikës nacionalshoveniste serbe, e cila propagandë e kishte indoktrinuar dhe vazhdonte ta indoktrinonte popullin serb për t'i urryer dhe shtypur shqiptarët.

Znj. Backer, si studiuese e spikatur e kulturës dhe historisë së shqiptarëve, njëkohësisht si një eksperte e pazëvendësueshme e shteteve nordike, në përgjithësi e shteteve perëndimore për çështjet politike në Ballkan, ishte e mirinformuar se shqiptarët janë një popull i lashtë me prejardhje iliro-pellazge, të cilët, duke qenë në kontinuitet nën trysnitë dhe nën okupimet e perandorive (romake, bizantine, serbe, osmane etj.), u dobësuan dhe u ndan fetarisht, por nuk u gjunjëzuan ngase arritën ta ruajnë trashëgiminë etno-linguistike dhe kujtesën historike, duke u konsoliduar si komb etnolinguistik-multifetar gjatë periudhës së kombformimve në shekullin XVIII.

Znj. Backer ishte e mirinformuar se populli shqiptar e pati fatin historik edhe më të hidhur se populli norvegjez, ngaqë jo vetëm se u okupua nga fqinjët, por sistematikisht u persekutua dhe u copëtua politikisht nga fqinjë dhe se ky copëtim politik me ndikimin e Rusisë u miratua në Kongres të Berlinit në vitin 1878 dhe në Konferencën e Ambasadorëve në Londër në vitin 1913. Rrjedhimisht znj. Backer e dinte se si konsekuencë e kësaj padrejtësie historike shumica e territoreve të banuara me shqiptarë mbetën jashtë shtetit amë, Shqipërisë, duke e përfshirë edhe Kosovën që u riokupua nga Serbia në vitin 1912, e që u riokupua prapë me ndikim të Serbisë nga Jugosllavia në vitin 1945. Megjithëkëtë, znj. Backer, duke qenë një humaniste e përkushtuar, nuk besonte se popujt mund ta arrijnë paqen në bazë të drejtave historike dhe në bazë të hakmarrjeve për padrejtësitë historike, por si humaniste dhe idealiste, me të drejtë besonte se paqja në mes të popujve arrihet vetëm në bazë të respektimit të drejtave dhe lirive të njeriut, duke e përfshirë edhe të drejtën e popujve të shtypur për vetëvendosje.

Znj. Backer deri në vitin 1987 ishte studiuese e pasionuar e kulturës shqiptare, e nga viti 1987, kur u bë pjesë e veprimtarisë me qendër në Oslo, në kuadër të LPK-së, u bë veprimtare e pakompromis për lirinë dhe të drejtat legjitime të shqiptarëve. Me dijen, guximin intelektual,

kontaktet dhe respektin që gëzonte në shtetet perëndimore, znj. Backer ishte një institucion në vete, më shumë se një ambasadore e Kosovës në shtetet perëndimore. Por, duke qenë e tillë, u bë pengesë e madhe për regjimin fashist të Millosheviqit.

Veprimtaria me qendër në Oslo, në kuadër të LPK-së, ishte e përqendruar dhe e përkushtuar në prioritetet vepruese në vijim:

1. Angazhimin në mediet norvegjeze për sensibilizimin e opinionit norvegjez dhe në përgjithësi për sensibilizimin e opinionit në shtetet nordike lidhur me situatën politike të shqiptarëve në ish-Jugosllavi.

2. Kujdesin për dhe organizimin e azilkërkuesve shqiptarë.

3. Organizimin e demonstratave në kryeqendrat e Skandinavisë, me kërkesën "Kosova Republikë".

4. Angazhimin për t'i informuar qeveritë në shtetet nordike nëpërmes raportimit të gjerë me shkrim (duke mbledhur sistematikisht informacion për dhunën e pushtetit serbo-jugosllav në viset shqiptare në ish-Jugosllavi), gjithashtu informimin nëpërmes takimeve me institucionet shtetërore.

5. Angazhimin në Amnesty International në Londër dhe informimin gjatë takimeve në Londër për situatën politike të shqiptarëve në ish-Jugosllavi.

6. Organizimin e udhëtimit/qëndrimit në Kosovë, të ekspertes norvegjeze të gazetarisë hulumtuese në lidhje me situatën politike në Kosovë gjatë grevave të minatorëve në vitin 1988.

7. Angazhimin për kyçjen e çështjes shqiptare në Procesin e Helsinkit:

Angazhimin (para shembjes së murit të Berlinit) nëpërmes Komitetit Norvegjez të Helsinkit (duke mbledhur sistematikisht informacion për dhunën e pushtetit serbo-jugosllav në viset shqiptare në ish-Jugosllavi) për ta informuar Federatën Ndërkombëtare të Helsinkit në lidhje me situatën politike të shqiptarëve në ish-Jugosllavi.

- Angazhimin nëpërmes Komitetit Norvegjez të Helsinkit (para shembjes së murit të Berlinit) që të shkojë në Kosovë një delegacion i ekspertëve të Federatës së Helsinkit dhe Helsinki Watch-Amerikan

(Human Rights Watch) për ta vëzhguar gjendjen e të drejtave të njeriut. Delegacioni i përbërë nga ekspertët e Federatës së Helsinkit dhe Helsinki Watch Amerikan (i orientuar, i ndihmuar dhe i shoqëruar për në Kosovë nga znj. Berit Backer në kuadër të Grupit për Ballkanin të Komitetit Norvegjez të Helsinkit) udhëtoi për në Kosovë në shtator të vitit 1989, e pas vëzhgimit të situatës në Kosovë, në mars 1990 u botua raporti i parë për situatën në Kosovë nga ky delegacion, përkatësisht nga autori z. Kenneth Andersson, me titull "Crisis in Kosovo".

- Angazhimin për Kosovën (në kuadër të Komitetit Norvegjez të Helsinkit) gjatë pjesëmarrjeve në konferenca ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut.
- Angazhimin nëpërmes Komitetit Norvegjez të Helsinkit (në kuadër të inkurajimit dhe promovimit të alternativave politike opozitare) për organizimin e vizitave zyrtare të përfaqësuesve shqiptarë nga Kosova në Norvegji, e nga Norvegjia në shtetet e tjera perëndimore. Përveç të tjerash, organizmin e vizitës së parë zyrtare të z. Ibrahim Rugovës në shtetet perëndimore: në Norvegji dhe nga Norvegjia në shtetet e tjera perëndimore. Gjithashtu, në kuadër të organizimit të vizitave lobiste në Evropë me nisje nga Oslo: organizimin e vizitës së delegacionit të Kuvendit të Kosovës në Norvegji, pas shpalljes së Deklaratës për Kosovën Republikë (z. Bujar Gjyrgjeala, z. Skënder Skënderi, z. Muharrem Shabani).
- Angazhimin nëpërmes Komitetit Norvegjez të Helsinkit për themelimin dhe ndihmën për Qendrën për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut dhe për Rehabilitimin e të Përndjekurve Politikë nga regjimi totalitar në Shqipëri, si bërthamën e parë (nga jashtë) në Shqipëri, për të drejtat e njeriut dhe demokratizim. Gjithashtu, angazhimin që Shqipëria të marrë pjesë në takimin e ekspertëve të KSBE-së.
- Angazhimin nëpërmes Komitetit Norvegjez të Helsinkit për themelimin dhe ndihmesën e Komitetit të Helsinkit në Kosovë, Komitetit të Helsinkit në Shqipëri dhe Këshillit për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut në Kosovë.

8. Angazhimin për përkrahjen politike, logjistike dhe diplomatike të UÇK-së.

REFERENCAT

Rokkan, Stein (1987): *Stat, nasjon, klasse*. Oslo: Universitetsforlaget.

Arter, David (1999): *Scandinavian politics today*. Manchester: Manchester University Press.

Heidar, Knut og Berntzen, Einar (1998): *Nordisk konsensuspolitikk*. Oslo: Universitetsforlaget.

Rommetvedt, Hilmar (2002): *Politikkens allmenngjøring og den ny-pluralistiske parlamentarismen*. Bergen: Fagbokforlaget.

Nina Sandberg (1997): *Stats- og kommunalkunnskap. En innføring*. Oslo: Spartacus Forlag.

Christensen, Tom og Lægreid, Per (2001): *New Public Management i norsk statsforvaltning*, i B.S. Tranøy og Ø.Østerud (red.): Den fragmenterte staten. Oslo: Gyldendal Akademisk. -k.

Østerud, Øyvind (2002): *Statsvitenskap. Innføring i politisk analyse*, Oslo: Universitetsforlaget.

Bjørklund, Tor (2005). Hundre år med folkeavstemninger. Norge og Norden 1905 – 2005. Oslo: Universitetsforlaget.

Derry, T.K. *A History of Scandinavia: Norway, Sweden, Denmark, Finland and Iceland*. London, 1979 (UHS)

Norsk historie 800–2000 (6 bd., nyutg. 1999. Medarbeidere: J. V. Sigurdsson, G. A. Ersland, H. Andvik, S. Dyrvik. T. Pryser, J. Nerbøvik, B. Furre)

Sørensen, Øystein (2001): *Kampen om Norges sjel 1770-1905, Norsk idéhistorie, bind III,* red: Trond Berg Eriksen og Øystein Sørensen, OSLO: Aschehoug.

Seip, Jens Arup (1963): Fra embedsmannsstat til ettpartistat og andre essays. Oslo: Universitetsforlaget.

Narve Bjørgo, Rian Øystein, Kaartvedt Alf (1995): Norsk utenrikspolitikks historie. Bd 1. Oslo: Universitetsforlaget.

Tamnes, Rolf (1997): Norsk utenrikspolitikks historie. Bd 6. Oslo: Universitetsforlaget.

Fry, John (2003): *The Helsinki Process. Negotiating Security and Cooperation in Europe*. University Press of Pacific. Hawaii.

Heraclides, Alexis (1993): *Security and co-operation in Europe. The Human Dimension 1972-1992*. Frank Cass & Co. LTD, London.

Mevik, Leif (1990): *Undervei Europa*. Oslo: Aventura.

Mevik, Leif (1992): *Sikkerhet i Samarbeid. Hovedlinjer i norsk KSSE-politikk*. Oslo: Universitetsforlaget.

Brett, Rachel: *Den menneskelige dimensjonen i KSSE* i *Mennesker og rettigheter*. Nr. 1 (10) 1992: 13-18.

Rapport om *Nordisk samarbeid om utenriks og sikkerhetspolitikk*: http://www.regjeringen.no/upload/UD/Vedlegg/nordiskrapport.pdf

Intervistë e Nufri R. Lekajt dhënë revistës "Drini" në kuadër të shënimit të 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë (2012)

Një rrëfim i Nufri R. Lekës për veprimtarinë e tij në kuadër të organizatës Lëvizja Popullore e Kosovës (LPK-së)

Në kuadër të shënimit të 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, revista "Drini" e intervistoi veprimtarin e njohur të çështjes kombëtare në Oslo të Norvegjisë, z. Nufri R. Lekaj, i cili iu përgjigj pozitivisht kërkesës sonë për ta intervistuar, duke e bërë kështu një rikthim retrospektivë për punën e tij në favor të çështjes së Kosovës dhe të çështjes shqiptare në përgjithësi nga ana e tij si dhe miqve të tij, duke ofruar fakte e dëshmi të shumta, dokumente tejet interesante që flasin për një kohë tejet dramatike që ka kaluar populli shqiptar dhe Kosova e robëruar, duke e shpaluar veprimtarinë e tij politike, lobiste dhe diplomatike kundër regjimit serbo-jugosllav dhe duke dëshmuar për përkrahjen logjistike, politike dhe diplomatike në mbështetje të UÇK-së.

Kush është Nufri R. Lekaj?

Kam lindur në vitin 1962 dhe rrjedh nga një familje rugovase, nga fshati Koshutan i Rugovës, përkatësisht nga vëllazëria e Lekajve të Koshutanit të Rugovës. Thënë ndryshe, nga Koshutani i Gjekë Prenit. Malësori i Mbishkodrës, Gjekë Preni, i biri i Pren Martinit të Martin Kolës së Kolë Gjonit, llogaritet të jetë ndër të parët që u vendos, përafërsisht para 400 vjetëve, në fshatin Koshutan të Rugovës, ndërsa vëllai i tij, Marash Preni, vendoset po të njëjtën kohë në fshatin Haxhaj të Rugovës.

Gjekë Preni kishte atëkohë mbi 1 000 dele, e Koshutani i përshtatej shumë me hapësirën që kishte që nga Dromodoli, i cili dikur quhej Dromodoli i Malësorëve. Do të thotë, edhe më parë malësorët e Mbishkodrës i shfrytëzonin kullotat e Rugovës për blegtori.

Gjekë Preni, përveç Dromodolit, për kullota shfrytëzonte edhe Hajlen e Koshutanit dhe një pjesë të asaj e cila tani quhet Hajla e

Vranocit dhe me punën e tij që bënte me blegtori, u bë shumë i kamur dhe kishte shumë punëtorë.

Pushteti otoman i shtrëngonte fshatarët me tatime të mëdha, sidomos ata të kamurit, saqë edhe tokën që e shfrytëzonin këta të fundit i detyronte të mos e konsiderojnë si pronë të tyre, por si pronë të mbretit. Kështu që, në atëkohë kur Kadia otoman kishte shkuar bashkë me tagrambledhësit dhe me një numër të madh nizamësh në Koshutan për t'i kërkuar taksat, bien në konflikt me Gjekë Prenin ngase, përveç taksave, kishin kërkuar nga Gjekë Preni që, kur të pyetej se e kujt është kjo tokë, të përgjigjej se kjo tokë është e Zotit dhe mbretit. Gjekë Preni refuzoi të përgjigjet sipas dëshirës së Kadisë, me gjasë edhe për shkak të dhunës dhe dyndjeve që bënte Perandoria Osmane ndaj shqiptarëve në përgjithësi dhe ndaj kelmendasve në veçanti, në vend të përgjigjes së pritur nga Kadia, Gjekë Preni i thotë Kadisë se kjo tokë është e Zotit dhe e Gjekë Prenit. E pas kësaj përgjigjeje fillon përleshja, pasi nizamët me urdhër të Kadisë kishin tentuar ta arrestojnë Gjekë Prenin, e Gjeka e fillon luftën me ta, ku, përveç të bijve, i urdhëron edhe punëtorët t'i rrokin armët, ato armë që i kishin atëherë në disponim, e arrijnë t'ia asgjësojnë gati tërë ushtrinë që kishte me vete Kadia, edhe Kadin vetë.

Vendi ku u pre Kadia nga Gjekë Preni që nga atëherë e deri me sot quhet Guri i Kadisë dhe shtrihet në krye të fshatit ku veronte Gjeka, përkatësisht në Kodër të Lekajve. Që nga ajo kohë Gjekë Preni e merr epitetin Gjekë Stanishi, pasi kjo ngjarje kishte ndodhur pikërisht në Dbane (Stane) dhe rrjedhimisht ishte bërë edhe më i kërkuari nga pushteti otoman, të cilin pushtet Gjekë Stanishi-Rugovalia nuk e njihte fare. Pasi pushteti otoman nëpërmes tradhtisë e arreston Gjekë Stanishin-Rugovalin, e ekzekuton menjëherë me urdhër të Pashait otoman në Pejë.

Gjek Stanishi-Rugovalia la pas vetës katër djem: Dedën, Lekën, Lucen dhe Palin. Rrjedhimisht vëllazëria e Muriqit në Koshutan përbëhet kryesisht nga katër lagje/vëllazëri: Kurt Dedajt, Lekajt, Lucajt dhe Palajt. Vija e trungut familjar nga unë deri te Gjeka është: Nufriu-Rexhepi-Ujkani-Haziri-Selmani-Uka-Osmani-Leka-Gjeka.

Koshutanasit dhanë disa ndër figurat më të njohura rugovase në lëvizjen e rezistencës kombëtare që nga Lidhja e Prizrenit (1878): Sali

Jahën, Zhujë Selmanin, Kadri e Hysen Bajrin, Zekën e Sykut, Kajë Shabanen, Sak Faslin, Rizë Zymerin dhe shumë të tjerë.

Kur jeni kyçur në lëvizjen ilegale, kur jeni burgosur dhe kur jeni arratisur nga Kosova?

Pas mbarimit të shkollës tetëvjeçare në Pejë tentova të regjistrohem në Shkollën e Mesme Ushtarake ngaqë kisha dëshirë të bëhem ushtarak, por më thanë haptas se nuk më pranojnë për shkak të së kaluarës së babait tim si i ish-burgosur dhe i diferencuar si armik i Jugosllavisë; se babai im, Rexhep Ujkan Lekaj, ishte pjesë e njësive vullnetare të bajraktarit të Rugovës, Sak Faslis dhe pjesëmarrës i shumë luftërave dhe betejave që nga Moknat, Qakorri, Smilovica, Peja, Plava, Gucia e vende të tjera. Në betejën e Smilovicës më 13 qershor 1942, kur heroikisht ra Bajram Shari, Rexhep Ujkan Lekaj qe plagosur. Pas Luftës së Dytë Botërore, për t'i shpëtuar arrestimit nga pushteti serbo-jugosllav që u bëhej në kohën e pas Luftës së Dytë Botërore anëtarëve të Lëvizjes Kaçake të Rugovës dhe me gjerë, babai im shpërngulet në Mal të Zi, ku kishte nipat në shtëpinë e madhe të Nimon Ukës në Hakaj dhe dajallarët në shtëpinë e madhe të Alush Smajl Hotit (bajraktarit të Hotit) në Hot. Por, në vitin 1950 OZNA malazeze e kishte diktuar dhe burgosur.

Në fillimvitet 1960-ta, pasi martohet me nënën time, Hasnije Feratin (e bija e Ramë Feratit nga Gucia, luftëtar dhe i plagosur në një nga betejat kundër pushtuesve malazezë), vendoset me familje pranë kushërinjve të vet në Rugovë, përkatësisht pranë familjes së madhe dhe bujare të Ibralijajve në fshatin Haxhaj të Rugovës, e pas një kohe shpërngulet në Pejë, me qëllim që të mund t'i shkollojë fëmijët.

Në lëvizjen ilegale të kohës kam filluar angazhimin si simpatizant i grupeve ilegale duke lexuar dhe shpërndarë literaturë ilegale. Këtë angazhim e kam filluar si nxënës i shkollës së mesme në Pejë në vitin 1978, e si frymëzues kisha Isa Demajn dhe bashkëveprimtarët e tij. Në vazhdën e këtij angazhimi në lëvizjen ilegale të kohës më arrestojnë për pjesëmarrje në demonstrata të pranverës së vitit 1982 dhe më përjashtojnë nga Universiteti i Prishtinës po të njëjtin vit. Pas disa muajsh autoritetet ushtarake më dërgojnë thirrjen për shërbim ushtarak dhe nën kërcënim të përndjekjes penale detyrohem, pa

dëshirën time, të shkoj në shërbim ushtarak nga fundi i vitit 1982. Në fillim të vitit 1983 më arrestojnë së bashku me gjashtë ushtarë shqiptarë me të cilët shërbeja në Slloveni. Pas një hetuesie gati njëvjeçare, nën akuzën për organizim të grupit ilegal, me qëllim të ngritjes së popullit në kryengritje kundër regjimit jugosllav, dënohem nga regjimi serbo-jugosllav me 5.5 vjet burgim ushtarak nga Gjykata Ushtarake e Lubjanës. Nga fundi i vuajtjes së dënimit, përkatësisht nga fundi i vitit 1986, si pasojë e një provokimi të rëndë nga një serb i Nishit, i cili ishte një huligan dhe i burgosur për kriminalitet, bie në konflikt me serbin dhe, duke vepruar, në vetëmbrojtje serbi mbetet i plagosur. Për këtë plagosje, së bashku me mua e akuzojnë edhe Xhavit Morinën nga Drenoci, i cili kishte provuar ta ndalë konfliktin. Na dërgojnë në izolim për një muaj dhe nis hetuesia ndaj nesh nga Gjykata Ushtarake e Lubjanës, me akuzën se plagosja është bërë mbi baza nacionale. Kjo akuzë e vjeshtës së vitit 1986 më përcjell pasi kisha dalë nga burgu.

Në bisedat e rregullta dhe të detyruara nga ana e UDB-së në Pejë, në mars të vitit 1987 më thonë se aktpadia ishte bërë gati dhe se së shpejti duhet të llogaris të dalë para gjyqit. Me këtë akuzë mbi supe dhe angazhimin në strukturat ilegale si dhe rrezikut për jetë detyrohem të arratisem për Zvicër. E kisha informacionin - lidhjen për të kontaktuar me Lëvizjen Popullore për Republikën e Kosovës - LPRK-në (LPK-në) që kishte selinë në Zvicër. Kufirin në Austri e kalova ilegalisht me lehtësi, sepse nga koha e shërbimit ushtarak në afërsi të Mariborit, në Slloveni, i dija mirë pikat kufitare në mes të Sllovenisë dhe Austrisë. Më tutje, gjatë rrugës, si rezultat i një bisede me një shok, e ndërrova destinacionin për në Norvegji, ku kishte nevojë për ta organizuar mërgatën shqiptare ngase Norvegjia shquhej si një vend mik i Jugosllavisë dhe në këto vite rritej numri i të mërguarve shqiptarë në këtë vend.

Na tregoni për disa nga momentet e veprimtarisë suaj patriotike në kuadër të mërgatës shqiptare prej viteve '80-ta deri në kryengritjen e armatosur në Kosovë në fund të viteve '90-ta, që mund të vërtetohen në bazë të dokumenteve apo dëshmitarëve.

Deklaratën e parë në shtypin norvegjez për situatën në Kosovë e

kam bërë në vitin 1987, duke e informuar opinionin norvegjez për përdorimin e torturës ndaj të burgosurve politikë shqiptarë, për përndjekjet politike ndaj shqiptarëve në Jugosllavi, për kërkesën Kosova Republikë dhe për një rezyme historike të popullit shqiptar si popull me prejardhje ilire.[1]

Ambasada Jugosllave në Norvegji, si reagim ndaj deklaratës sime, duke e përdor si mjet miqësinë jugosllavo-norvegjeze të formuar gjatë Luftës së Dytë Botërore, ndikoi që organet shtetërore norvegjeze ta nënvlerësojnë në shtypin norvegjez vërtetësinë e deklaratës sime. Në veçanti këtë nënvlerësim e bëri zëvëndësministrja e Jashtme në atë kohë, znj. Helga Hernes, e cila, në emër të Ministrisë së Jashtme norvegjeze që udhëhiqej nga z. Thorvald Stoltenberg (i cili prej vitit 1961 deri në vitin 1964 ka qenë sekretar i parë i Ambasadës Norvegjeze në Beograd), deklaroi se nuk ndodh përdorimi i torturës dhe shkelja e të drejtave nga pushteti jugosllav në Kosovë.

Njëkohësisht, Ambasada Jugosllave në Norvegji, duke qenë e informuar se unë isha personalisht viktimë e torturës dhe e përndjekjes politike nga pushteti serbo-jugosllav, ndikoi që shteti norvegjez të hezitojë të më japë azil politik që kisha kërkuar në këtë shtet, në mënyrë që të mos prishet imazhi i Jugosllavisë në Norvegji, duke i dhënë azil politik një armiku dhe propaganduesi kundër Jugosllavisë.

Pas deklaratës sime në mediet norvegjeze më kontaktoi avokati Arild Farstadvoll dhe më tha se e kishte kontaktuar Ministria e Drejtësisë nëpërmes një bisede telefonike duke e njoftuar se, si pasojë e deklaratës sime në mediet norvegjeze për situatën në Kosovë, kërkesën time për azil e kishte marrë për shqyrtim Ministria e Jashtme, me pretekst se duhet të vlerësojë se, nëse dhënia e azilit për mua mund t'i prishë marrëdhëniet me një palë tjetër dhe, eventualisht: ose të negociojë një vend tjetër për strehim dhe se në rastin tim do të ishte Zvicra, sepse në përputhje me konventën për statusin e azilit, Zvicra ishte vendi i cili "pranonte" personat të cilët ishin "problem" për vendet e tjera, ose të më jepet leja e qëndrimit në

[1] *(Shih në lidhje me këtë tek referencat, referencën nr. 1, përkatësisht deklaratën time në gazetën norvegjeze "Dagbladet" në vitin 1987)*

baza humanitare e jo në bazë të statusit të azilantit politik. Unë i thash avokatit se në këtë çështje ka ndikim vetëm propaganda e diplomacisë serbo-jugosllave, përkatësisht Ambasada Jugosllave në Norvegji, sepse më konsideron si kërcënim për prishjen e imazhit të Jugosllavisë në Norvegji, duke përfshirë edhe shtetet e tjera nordike; dëshiron të ma mbyllë gojën në këtë mënyrë, duke provuar të ndikojë që Norvegjia të më largojë jashtë shtetit. Po ashtu, i thashë avokatit Farstadvoll se në Norvegji kam ardhur pikërisht për ta thënë të vërtetën për Jugosllavinë, sepse shqiptarët në Jugosllavi janë populli më i shtypur në Evropë nga regjimi serbo-jugosllav, prandaj do t'i përdor të gjitha të drejtat juridike të bazuara edhe në konventat ndërkombëtare që ta marr lejen e qëndrimit në bazë të statusit të azilantit politik në Norvegji. Nuk pranoj të shkoj në një shtet tjetër (Zvicër) dhe as nuk pranoj leje qëndrimi në Norvegji në bazë humanitare sepse Norvegjia, për shkak të miqësisë me Jugosllavinë, nuk duhet të manipulohet nga propaganda serbo-jugosllave kur janë në pyetje shkeljet e të drejtave të shqiptarëve nga regjimi serbo-jugosllav, e unë jam i vendosur të vazhdoj ta them të vërtetën për regjimin serbo-jugosllav.

Duke vazhduar edhe më shumë të insistoj nëpërmes medieve norvegjeze, për ndërkombëtarizimin e dhunës nga regjimi serbo-jugosllav ndaj shqiptarëve në Jugosllavi, sidomos duke e marrë përkrahjen publike nga Amnesty në shtypin norvegjez dhe nga avokati Arild Farstadvoll, arritëm nga njëra anë të fillojmë ta dobësojmë ndikimin e propagandës të Ambasadës Jugosllave në Norvegji, nga ana tjetër aktiviteti ynë në medie i bëri presion edhe Ministrisë së Jashtme norvegjeze ta rivlerësojë vërtetësinë e deklaratave të mia në mediet norvegjeze në lidhje me shkeljet e të drejtave të shqiptarëve nga regjimi serbo-jugosllav në Kosovë. Rrjedhimisht, ministri i Jashtëm i Norvegjisë, në atë kohë z. Thorvald Stoltenberg, e korrigjoi zëvendësministren e tij, znj. Helga Hernes, duke deklaruar publikisht në shtypin norvegjez, përveç të tjerash, se nuk mund të përjashtohet mundësia se ndodh përdorimi i torturës dhe persekutimet politike nga pushteti jugosllav ndaj shqiptarëve në Kosovë. Por, megjithëkëtë, z. Stoltenberg precizoi hapur se Norvegjia ka lidhje shumë të veçanta me

Jugosllavinë.[2]

Ky ishte një fillim fitore kundër diplomacisë jugosllave (Ambasadës Jugosllave në Norvegji), e cila u zemërua shumë sepse filloi t'i prishet imazhi Jugosllavisë në shtetet nordike. Njëkohësisht që nga viti 1987, në kuadër të LPK-së, përkatësisht Këshillit të LPK-së për Norvegji, që në fillet e aktivitetit të vet përfshinte dhjetëra anëtarë dhe qindra simpatizantë, u bë një mobilizim i madh dhe veprimtari e konsiderueshme informative për mërgimtarët, si dhe një organizim i jetës kulturore. Formuam Shoqatën Kosova, Klubin Futbollistik Kosova dhe Radion Kosova, të cilat më vonë i riemërtuam: Shoqata Rilindja, Klubi Futbollistik Rilindja dhe Radio Rilindja, në mënyrë që t'i përfshijë të gjithë bashkatdhetarët nga të gjitha viset shqiptare me banim në Norvegji. Gjithashtu, nga viti 1987, në kuadër të LPK-së, filluam edhe organizimin e demonstratave në Oslo dhe në qendrat e tjera në Skandinavi, duke demonstruar kundër shkeljeve të të drejtave të shqiptarëve nën serbo-jugosllavi dhe për kërkesën Kosova Republikë, duke brohoritur gjatë demonstratave edhe emrat e themeluesve të LPK-së, Jusuf Gërvallës, Kadri Zekës dhe Bardhosh Gërvallës.

Në anën tjetër, diplomacia jugosllave e intensifikoi ofensivën e vet edhe më shumë kundër nesh dhe rezultoi edhe me replikën/debatin në mes meje dhe Ambasadës Jugosllave në radion shtetërore norvegjeze, ku diplomatit jugosllav i thashë se po gënjen në mënyrën më të paskrupullt, ngase diplomati jugosllav thoshte se shqiptarët në Jugosllavi i kanë të gjitha të drejtat dhe nuk janë të diskriminuar. Pas këtij reagimi aty, filluan të më kërcënojnë në mënyra të ndryshme që të mos propagandoj kundër Jugosllavisë, pos të tjerash, edhe duke më thënë "mos luaj me zjarr", në kuptimin se mund të më kushtojë shtrenjtë propagandimi kundër Jugosllavisë. Këtë kërcënim në njëfarë mënyre e bënë edhe nëpërmes gazetës serbe "NIN", duke shkruar edhe për polemikën në mes meje dhe diplomatit jugosllav në radion shtetërore norvegjeze.

Këshilli i LPK-së në Norvegji u themelua me iniciativën e z. Ali Aliut

[2] *(Shih referencën nr. 2: në lidhje me përkrahjen publike nga avokati Farstadvoll dhe Amnesty në shtypin norvegjez, dhe referencën nr. 3: në lidhje me korrigjimin publik në shtypin norvegjez të ministrit të Jashtëm norvegjez z. Thorvald Stoltenberg)*

(nga Shkupi) dhe me mbështetjen e drejtpërdrejtë (në vazhdimësi) nga Kryesia e LPK-së, konkretisht me praninë dhe ndihmën e z. Xhavit Halitit. Pas formimit të këshillit të LPK-së në Norvegji ndihmën për veprimtarinë logjistike të LPK-së e dha aktivisti i hershëm i LPK-së, z. Qani Dehari nga Sllupqani i Kumanovës.[3]

Nga fundi i vitit 1987 dhe fillimi i vitit 1988, në bashkëpunim me znj. Berit Backer, morëm iniciativë dhe shkruam raportin enkas për Qeverinë e Norvegjisë dhe të Suedisë, duke mbledhur informacion për dhunën serbe në viset shqiptare nën Jugosllavi. Raporti u botua me emrin "Straff og Politikk i Kosova" (Politika dhe dënimet në Kosovë) dhe mund të thuhet se ky raport u bë një bazë për kuptimin e situatës në Kosovë dhe se me vite ishte pikë referimi e shumë ministrive të jashtme në Evropë, në veçanti në shtetet nordike. Lidhur me punën në këtë raport dhe për organizimin e një demonstrate në Oslo na u bashkua nga Suedia edhe z. Milaim Zeka.

Në vitin 1988, pas korrespondencës me letër dhe komunikimit me Qendrën e Amnesty International në Londër, përkatësisht me znj. Melanie Anderson, mora ftesën nga znj. Anderson për t'u angazhuar drejtpërdrejt në Amnesty, ku gjatë fundit të verës së vitit 1988 si punë vullnetare bëra regjistrimin e disa qindra të burgosurve politikë shqiptarë në regjistrin qendror në Amnesty International në Londër. Shpesh kishte vështirësi të regjistroheshin të burgosurit politikë shqiptarë si të "burgosur të ndërgjegjes" për shkak se aktakuzat serbo-jugosllave ishin të bazuara në "veprimtari armiqësore subverzive" dhe Amnesty International i regjistronte këta të burgosur, por nuk i klasifikonte si "të burgosur të ndërgjegjes". Me punën disamuajshe arrita ta tregoj praktikën e "akuzave" serbe dhe të "dënimeve", ku doli në pah se dënimet ishin "politike" e jo "subverzivo-armiqësore". Kjo ndikoi që mbi 300 të burgosur të kohës nga numri i madh i të burgosurve në listat e Amnesty International të adaptohen si të "burgosur të ndërgjegjes".

Gjithashtu, gjatë angazhimit vullnetar në Amnesty International në Londër pata rastin të takoj njerëz me influencë shoqëroro-politike në

[3] *(Shih në lidhje me këtë, referencën nr. 4: fragmentin e përkthyer në shqip nga gazeta serbe 'Politika' dhe referencën nr. 5: fragmentin e përkthyer në shqip nga revista serbe 'NIN' që, pos të tjerash, shkruan edhe për polemikën në mes meje dhe diplomatit jugosllav)*

Angli dhe t'i informoj më detajisht për situatën në Kosovë. Në Londër më ka pritur në shtëpinë e tij z. Ihsan Toptani, personalitet historik, organizator i mbledhjes së Mukjes, me qëllim të Bashkimit në Frontin Nacionalçlirimtar Shqiptar gjatë Luftës së Dytë Botërore. Zotëri Toptani kishte referenca për mua nga znj. Melani Anderson dhe znj. Berit Backer, si dhe autori i librit "Artfull albanian", Jon Halliday ("Shqiptari dinak": biografi e parë e paautorizuar për Enver Hoxhën, botuar në vitin 1988). Me z. Halliday kisha biseda rreth situatës në ish-Jugosllavi dhe padyshim se ai kishte kontakte të forta në Ministrinë e Jashtme britanike. Me z. Toptanin biseduam për situatën politike në ish-Jugosllavi, sidomos për situatën e shqiptarëve. Ai më tha se ishte i lumtur të takonte një kosovar i cili drejtpërsëdrejti e njoftoi për situatën dhe i cili vlerësohet nga të huajt. Vërejtja e tij ishte se "duhen distancuar kosovarët nga E. Hoxha". Në Angli kisha një bisedë edhe me një zyrtar të Ministrisë së Jashtme britanike, i cili u interesua për të burgosurit politikë në ish-Jugosllavi. Ndihmën për Amnesty International e vazhdova me informata relevante edhe pasi u ktheva nga Londra në vjeshtën e vitit 1988.

Znj. Berit Backer, në kuadër të kontakteve me personalitete të rëndësishme të jetës shoqëroro-politike angleze, kishte edhe një lidhje të traditës familjare, ngase gjyshi i saj (babai i nënës së saj), z. Edvard Christian Danielsen, ishte (gjatë LDB-së) agjenti i parë norvegjez i shërbimit informativ britanik (Secret Intelligence Service - SIS, gjithashtu i njohur me emrin M16), i cili në mënyrë të suksesshme e udhëhoqi operacionin e rëndësishëm "oldell" të lidhëmbajtjes - informacionit në mes të Norvegjisë dhe Britanisë së Madhe. Më pastaj u emërua admiral i Marinës Norvegjeze dhe është një personalitet i mirënjohur për udhëheqjen e luftës kundër okupimit të vendit nga gjermanët. Gjithashtu, babai i saj, z. Ole Friele Backer (me profesion fotograf), u detyrua gjatë LDB-së të shpërngulet në Londër, pasi fotografitë e tij për gjendjen e luftës në Norvegji (si pasojë e sulmit gjerman) u publikuan jashtë Norvegjisë. Ai u punësua si fotograf në Zyrën e Informacionit të Qeverisë norvegjeze në ekzil në Londër. Kontributi i tij si fotograf (për familjen mbretërore norvegjeze, për aktivitetet e Qeverisë në ekzil, për personelin ushtarak norvegjez, kampet e luftës etj.) bëri që të fitojë publicitet të gjerë, duke iu

publikuar fotot jo vetëm në Britaninë e Madhe, por edhe në SHBA.[4]

Po në të njëjtin vit, më 1988, në bashkëpunim me znj. Berit Backer, e organizuam udhëtimin për në Kosovë, të ish-nxënëses së znj. Berit Backer, politologes dhe gazetares norvegjeze znj. Gro Holm, për të bërë intervista me aktivistë të ilegales dhe të tjerë në lidhje me grevat e minatorëve dhe në lidhje me situatën e përgjithshme politike në Kosovë. Në Kosovë zonjës Gro Holm iu organizua pritja/qëndrimi në mënyrë ilegale nga babai im, Rexhep Ujkan Lekaj, i cili u ndihmua nga djali i tij më i vogël dhe stërnipi i tij.

Znj. Holm që nga viti 1982 ka qenë e angazhuar në sektorin e lajmeve të jashtme, tani është redaktore në NRK (Televizionin Shtetëror Norvegjez). Është bashkëshortja e z. Kai Eides, diplomatit norvegjez i cili u angazhua për zgjidhjen e statusit politik të Kosovës.

Në vitin 1989, në bashkëpunim me znj. Berit Backer, morëm një iniciativë tjetër për në Kosovë. Përkatësisht gjatë kohës kur fillova punën si konsulent në Drejtorinë për Emigracion në Norvegji, e konsoliduam edhe Grupin për Ballkanin që e kishim iniciuar/formuar gjatë kohës kur u ktheva nga Anglia dhe fillova studimet e shkallës së parë në shkencat politike pranë Universitetit të Oslos, në vjeshtën e vitit 1988.

Grupi për Ballkanin u bë në vitin 1990 edhe zyrtarisht pjesë e Komitetit Norvegjez të Helsinkit, i udhëhequr nga unë dhe avokati norvegjez z. Pål Haugland. Gjithashtu, znj. Berit Backer në vitin 1990 u bë udhëheqëse e projektit Action Norway-Albania (Aksioni Norvegji - Shqipëri) dhe unë koordinator i këtij projekti, në kuadër të Komitetit Norvegjez të Helsinkit. Ky projekt sponsorohej plotësisht nga Ministria e Jashtme e Norvegjisë.

Në fillimvitin 1989, pasi e konsoliduam Grupin për Ballkanin, iniciuam, sidomos me ndihmën e znj. Berit Backer, i sugjeruam dhe i argumentuam Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit për të dërguar një delegacion të specialistëve në Kosovë. Përveç të tjerash, insistonim se tek shtetet perëndimore ishte një përshtypje e gabuar për Jugosllavinë që e dallonin "si më e mira ndër më të këqijat" krahasuar

[4] *(Shih referencat nr. 6, 7 dhe 8, përkatësisht disa pjesë nga korrespondenca me shkrim me znj. Melanie Anderson)*

me shtetet e tjera autoritare dhe totalitare në Evropën lindore, kur ishin në pyetje të drejtat e njeriut, në veçanti kur ishin në pyetje të drejtat e njeriut në Kosovë. Pas këtij sugjerimi znj. Berit Backer u ftua dhe u bë pjesë e delegacionit të parë për në Kosovë, në shtator 1989, i përbërë nga specialistët e Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit dhe Helsinki Watch - Amerikan (Human Rights Watch) si koordinatore e rëndësishme e këtij delegacioni, ndërsa unë e ndihmova këtë delegacion duke e orientuar nëpërmes kontakteve të mia në Kosovë, në koordinim/këshillim me znj. Berit Backer.

Në mars të 1990-s botohet raporti i parë për situatën në Kosovë nga delegacioni i përbashkët i Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit dhe Helsinki Watch - Amerikan (Human Rights Watch), përkatësisht nga autori z. Kenneth Andersson, me titull "Crisis in Kosovo". Në vazhdën e këtij koordinimi në mes meje dhe znj. Berit Backer, në bashkëpunim me z. Gazmend Pula, u ndihmua edhe themelimi i Komitetit të Helsinkit në Prishtinë. Pastaj ndihmuam Këshillin për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut në Prishtinë, që udhëhiqej nga z. Adem Demaçi. Bashkëpunimi me z. Demaçi bëri të organizohej edhe ndihma konkrete për të burgosurit politikë në Kosovë, të cilët ishin në një gjendje tepër të vështirë. Zotëri Demaçi u ftua disa herë nga Ministria e Jashtme e Norvegjisë, nga organizatat për të drejtat e njeriut dhe nga institucionet e tjera, i cili, me stoicizmin e tij për kauzën kombëtare, krijonte respekt. Rrjedhimisht u bë një lobim për ndarjen e çmimit për të drejtat e njeriut për z. Adem Demaçi, i akorduar nga Universiteti i Oslos. Mikes sime të afërt dhe mikes së madhe të shqiptarëve, znj. Berit Backer, ia ndaluan hyrjen në Jugosllavi sepse filluan ta konsideronin bashkëpunëtore të nacionalistëve shqiptarë.[5]

Në vitin 1989, në kuadër të përpjekjeve të diplomacisë joformale të Kosovës, e takova personalisht, së bashku me profesorin Trond Nordby dhe znj. Berit Baker, diplomatin e shquar dhe pasardhësin e z. Thorvald Stoltenberg, z. Johan Jørgen Hølst, i cili është i mirënjohur edhe ndërkombëtarisht për arsye se, në cilësinë e ministrit të Jashtëm të Norvegjisë, ka pasur rol vendimtar në Marrëveshjen e Oslos të vitit

[5] *(Shih referencën nr. 9: CV-në e Nufri R. Lekës nga Komiteti Norvegjez i Helsinkit dhe referencën nr. 10 në lidhje me këtë: pjesën nga hyrja në librin e znj. Berit Backer, shkruar nga znj. Ann Kristin Ekk, duke iu referuar z. Kenneth Andersson, z. Harry Hodgkinson dhe të tjerëve).*

1993, e cila përfaqëson një përparim të rëndësishëm në negociatat mes Palestinës dhe Izraelit.

Zotëri Hølstinin e njoftova detajisht për situatën në Kosovë, duke argumentuar edhe kërkesën Kosova Republikë, përkatësisht duke i sqaruar se është kërkesë minimaliste e parashtruar nga elita politike shqiptare si zgjidhje kompromisi nëpërmes mjeteve politike në të mirë të paqes në Ballkan. Po ashtu, i bëra me dije se kërkesa maksimaliste e shqiptarëve jashtë shtetit amë, Shqipërisë, është bashkimi me Shqipërinë. Në vazhdën e këtij takimi me z. Hølst, në vitin 1990 e bëmë edhe organizimin dhe pritjen e z. Ibrahim Rugovës dhe z. Shkëlzen Maliqit si delegacioni i parë i përfaqësuesve politikë nga Kosova në botën perëndimore pas pluralizmit politik në ish-Jugosllavi. Edhe vetë isha pjesë e këtij delegacioni, ku takuam disa ministra dhe personalitete të rëndësishme në Norvegji.

Zotëri Ibrahim Rugovën e shoqërova edhe në takimin me disa profesorë të Universitetit të Oslos, ndër të tjerë, edhe me ekspertin e Ballkanit, profesor Svein Mønnesland, të cilëve iu la shumë përshtypje me qetësinë dhe kulturën akademike. Unë u ndihmova gjatë bisedës që zhvilluan duke u përkthyer. Gjatë bisedave me z. Rugovën, mësova se ai ishte nip i fshatit tonë: koshutanasve të Rugovës, e kjo prejardhje ndikoi të jemi më të lirë me njëri-tjetrin në bisedë. Zotëri Rugova më përgëzoi për kontaktet dhe për miqësinë që kisha krijuar në këtë shtet në të mirë të Kosovës dhe për përshtypjen e mirë që kisha krijuar tek miqtë norvegjezë. Aludonte në profesorin Kristofer Gjøterud, i cili ishte personalitet i njohur në shkencën e fizikës, por edhe aktivist i madh për të drejtat e njeriut, si dhe të tjerë që kishte takuar. Dhe kërkoj mendimin tim për mënyrën se si duhet organizuar diasporën shqiptare në kuptimin e formimit të një baze të LDK-së në diasporë, ku kisha mundur ta jap kontributin tim. Në këtë kohë LDK-ja ende s'kishte degë në diasporë.

Unë në përgjigjen time i bëra një rezyme për diasporën shqiptare duke marr pikënisje në Jusuf Gërvallën etj., i cili luajti rol kyç për ta bashkuar diasporën shqiptare në kuadër të LPK-së dhe e njoftova se prej vitit 1982, sidomos prej vitit 1987, LPK-ja kishte bërë një organizim solid të diasporës shqiptare pa dallim të bindjeve politike, krahasuar me kohën e mëparshme të diasporës shqiptare.

Rrjedhimisht, meqë isha pjesë e strukturave udhëheqëse të LPK-së në atë kohë, përkatësisht anëtar i Këshillit të Përgjithshëm të LPK-së, i thashë z. Ibrahim Rugovës se LPK-ja me këtë pikënisje të Jusuf Gërvallës është e kurdisur të veprohet në diasporë vetëm në mënyrë të bashkuar ngase angazhimi ynë në diasporë vetëm kështu ka efekt. Mora si shembull formimin e bashkësive shqiptare në diasporë, që do të kishte mundësi të koordinohen nga një komision i përbashkët për diasporën, i përbërë nga të deleguarit e LPK-së dhe nga të deleguarit e LDK-së. Gjithashtu, i thashë se për marrëveshje/vendime eventuale duhet të bisedohet direkt me kryesinë e LPK-së. Zotëri Rugova m'u falënderua për këtë rezyme të shkurtër për diasporën dhe për mendimin tim se si mund të riorganizohet diaspora, duke u pajtuar se diaspora shqiptare duhet të jetë unike që të mund ta ndihmojë më shumë Kosovën sepse të gjithë e kemi një qëllim. Ndër të tjera, më tha se LDK-ja sapo është formuar dhe për të gjithat duhet të konsultohet edhe me bashkëformuesit e LDK-së.

Në kuadër të Grupit për Ballkanin të Komitetit Norvegjez të Helsinkit, znj. Berit Backer e ka dhënë kontributin e veçantë, për këtë vizitë të parë zyrtare dhe historike të delegacionit të Kosovës në shtetet perëndimore, përkatësisht në Norvegji dhe me nisje nga Norvegjia në shtetet e tjera perëndimore. Ngaqë znj. Backer, përveç të tjerash, duke pasur kontakte të drejtpërdrejta me strukturat e KSBE-s në shtetet perëndimore, është kujdesur që nëpërmjet realizimit të vizitës zyrtare të delegacionit të Kosovës në Norvegji, t'i hapen dyert delegacionit të Kosovës edhe nga qeveritë e tjera perëndimore, me qëllim të faktorizimit të Kosovës në bashkëveprimin ndërkombëtar.

Duke e marrë parasysh evoluimin e pluralizmit politik në Kosovë, sidomos ardhjen e madhe të refugjatëve shqiptarë në Norvegji dhe në Skandinavi, më shtohej brengosja se po vonohemi me organizimin e mirëfilltë dhe efektiv të diasporës. Prandaj, iniciova formimin e Bashkësisë Shqiptare në Norvegji, me qëllim që ta inkurajojmë formimin e Bashkësive Shqiptare në Skandinavi dhe në shtetet perëndimore që, si diasporë shqiptare, të veprojmë në mënyrë unike në të mirë të Kosovës. Fatkeqësisht, Bashkësinë Shqiptare në Norvegji erdhi dhe e zhbëri z. Jusuf Buxhovi, duke e keqpërdorur autoritetin e LDK-së. Z. Buxhovi, duke mos pasur përkrahjen e shumicës së të

pranishmëve, e zhbëri Bashkësinë Shqiptare në Norvegji. Në vend të saj e formoi Degën e LDK-së në Norvegji dhe, rrjedhimisht, duke mos e pasur legjitimitetin demokratik ta bëjë këtë, z. Buxhovi tha se "legjitimitet kam autoritetin tim".

Shumica e të pranishmëve ishin kundër zhbërjes së Bashkësisë Shqiptare në Norvegji sepse mund të gjendej konsensus që Dega e LDK-së në Norvegji të bëhet pjesë e Bashkësisë Shqiptare në Norvegji dhe nuk kishte nevojë të zhbëhej Bashkësia Shqiptare në Norvegji. Shumica e të pranishmëve u irrituan nga z. Buxhovi dhe deshën ta zgjedhin problemin me të në mënyrë primitive (me grushta). I ndalova ngase isha rreptësisht kundër të krijojmë traditë konflikti në diasporën shqiptare në Norvegji, sepse ia kishim nisur mirë e me konfliktet në mes vete vetëm e dobësonim diasporën shqiptare në përgjithësi dhe, edhe më shumë i vështirësonim bashkëpunimet në mes vete në të ardhmen.

Mendoj se "përjashtimi" i z. Buxhovi nga LDK-ja ka qenë veprim i mirë, sepse z. Buxhovi figurën e Jusuf Gërvallës dhe LPK-në e Jusuf Gërvallës i kishte halë në sy. Megjithëkëtë, veprimtaria e z. Buxhovit në LDK la pasoja.

Në fund të vitit 1997 iniciova riaktivizimin e Bashkësisë Shqiptare në Norvegji në përkrahje të luftës për çlirimin e Kosovës.

Para se të themelohet fondi i 3 % për Norvegji (i Qeverisë së Kosovës në ekzil) e kishim në funksion një aktivitet solidariteti për familjet skamnore në Kosovë, që realizohej nëpërmes Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Prishtinë, përkatësisht nëpërmes z. Adem Demaçit. Kjo formë e ndihmave ishte konkrete dhe u tregua efektive ngase ishin me qindra familje të cilat u ndihmuan dhe raportonin për ndihmat që u arrinin nga mërgata shqiptare në Norvegji, por ky aktivitet u zhbë si rezultat i formimit të fondit të 3 % për Norvegji (i Qeverisë së Kosovës në ekzil).

Në vazhdën e grevave të minatorëve në Kosovë, kur regjimi fashist i Millosheviqit i largoi mijëra punëtorë shqiptarë nga vendet e tyre të punës, u konsolidua një formë e re e rezistencës, e cila ta krijonte mundësinë për një "Solidarnost të Kosovës" , që udhëhiqej nga Sindikatat e Pavarura të Kosovës, të cilave atëkohë u printe z. Hajrullah Gorani. LPK-ja me të gjithë potencialin e vet, si brenda

vendit dhe në diasporë, u vu në mbështetje të lëvizjes së rezistencës së punëtorëve në Kosovë. Në këtë drejtim u porositën këshillat popullore të LPK-së në diasporë të organizojnë tubime solidariteti për punëtorinë në Kosovë dhe të grumbullojnë mjete materiale për ta.

Më kujtohet se z. Dukagjin Gorani, i cili në emër të sindikatave ishte në një turne nëpër Evropë, vjen në Oslo dhe qëndron tek unë disa ditë, ku patëm disa takime me bashkatdhetarë, të cilët grumbulluan ndihma materiale që u transferuan nga Norvegjia në xhirollogarinë e sindikatave të pavarura të Kosovës në Slloveni. Edhe vazhdimësia e ndihmave për punëtorinë në Kosovë u zhbë nga fondi i 3 % për Norvegjinë (i Qeverisë së Kosovës në ekzil).

Në vitin 1990 u botua raporti hulumtues i titulluar "Har alle forstått?" (A e kanë kuptuar të gjithë?) në lidhje me situatën e azilkërkuesve në Norvegji. Këtë raport e shkruam një grup autorësh në kuadër të punës në Drejtorinë e Emigracionit në Norvegji, me kërkesë të Ministrisë së Pushtetit Lokal. Gjatë kësaj kohe, në vazhdën e aktivitetit mediatik për Kosovën, përkraha azilkërkuesit shqiptarë në Norvegji sepse politika norvegjeze, duke mos qenë e mirinformuar për gjendjen e rëndë të të drejtave të njeriut në Kosovë, ua refuzonte dhënien e qëndrimit shumicës së azilkërkuesve shqiptarë. Kishte raste kur organet shtetërore norvegjeze i kthenin në Kosovë azilkërkuesit shqiptarë pa ua shqyrtuar përfundimisht ankesën e çështjes së azilit, siç ishte shembulli në strehimoren e refugjatëve në Solvang të Norvegjisë, të cilëve u dola konkretisht në ndihmë.

Për gazetat norvegjeze deklaroja se ikja e shqiptarëve nga Kosova në Norvegji dhe në vende të tjera nuk është ikje e vullnetshme, por e detyruar dhe se, rrjedhimisht, azilkërkuesit shqiptarë në Norvegji dhe në shtetet e tjera evropiane i përmbushin kriteret për qëndrim së paku në bazë të parimit *non refoulment* të konventës mbi statusin e refugjatit, përkatësisht parimit që nënkupton moskthimin e azilkërkuesit në një vend ku jeta dhe liria e saj/tij është në rrezik për shkak të bindjeve politike etj. Njëkohësisht, sugjeroja që politika norvegjeze të jetë më aktive në kuadër të bashkëveprimit ndërkombëtar, që t'i dënojë më seriozisht shkeljet e të drejtave të njeriut në Kosovë nga regjimi i Millosheviqit, i cili regjim, me qëllim të

spastrimit etnik, po i detyron shqiptarët të ikin nga vendi i tyre.[6]

Prej datës 18 deri më 21 tetor 1990, në cilësinë e delegatit nga Komiteti Norvegjez i Helsinkit, u ftova të marr pjesë në mbledhjen themeluese të Asamblesë Qytetare të Helsinkit në Pragë, e cila mbledhje ishte e sponsoruar nga një ndër iniciuesit e saj, z. Vaclav Havel. Zotëri Havel, gjithashtu edhe disidenti tjetër çek z. Jarosllav Shabata, në mënyrë implicite ishin për krijimin e strukturave të reja panevropiane, që nënkuptonte një riorganizim panevropian, duke filluar nëpërmes Asamblesë Qytetare të Helsinkit. Isha edhe vetë përkrahës i kësaj ideje, ngase shpresoja se Kosova do të mund të faktorizohej politikisht nëpërmes konceptit të drejtave të njeriut, duke u anëtarësuar në një ristrukturim të ri organizativ panevropian në përpjekjet për t'u dekolonizuar nga Serbia, në bazë të parimit për vetëvendosje. Por, ideja e sllovenit Tomazh Mastnak përkrahej më shumë, që Asambleja Qytetare e Helsinkit të mbetet një organizatë e asociacioneve të ndryshme joqeveritare të qytetarëve.

Në kuadër të kësaj mbledhje, më 20 tetor u mbajt një tribunë e veçantë për Kosovën, Irlandën veriore dhe Transilvaninë, ku i bëra një kritikë qasjes që dominonte diskursin e politikës perëndimore që, duke u thirrur në emër të një Evrope të bashkuar dhe të integruar, njëkohësisht ndërkomunikohej e drejta për vetëvendosje për shqiptarët në Jugosllavi. Rrjedhimisht, shpresën për një Evropë të bashkuar dhe të integruar, që parashihte ta përfshinte edhe Ballkanin dhe që nuk merrte parasysh zgjidhjen e çështjes shqiptare në Jugosllavi, në fjalimin tim në këtë tribunë e cilësova si: një eufori utopike që vetëm zëvendëson euforinë utopike të socializmit nga e cila mezi kishim dalë dhe se nuk guxojmë të mashtrohemi prapë, sidomos ne shqiptarët, sepse pa u zgjidhur çështjet e pazgjidhura nacionale në Evropë, në veçanti çështja shqiptare në Jugosllavi, nuk mund të shpresojmë për një Evropë të bashkuar dhe të integruar. I pranishëm ishte edhe delegacioni nga Kosova i kryesuar nga z. Shkëlzen Maliqi.

[6] *(Shih referencën nr. 11: deklaratën time në gazetën norvegjeze në mbështetje të azilkërkuesve shqiptarë, dhe referencën nr. 12: fragmentin informativ në bazën e bibliotekës së Oslos, ku mund të porositet raporti hulumtues për refugjatët në Norvegji në formë libri, që e shkruam një grup hulumtuesish-autorësh, me porosinë e Ministrisë së Pushtetit Lokal).*

Në kuadër të organizimit të vizitave lobiste në Evropë me nisje nga Oslo, organizuam vizitën e delegacionit të Kuvendit të Kosovës pas shpalljes së Deklaratës për Kosovën Republikë (z. Bujar Gjyrgjeala, z. Skënder Skënderi, z. Muharem Shabani). Delegacionet që vinin nga Kosova i kishin dyert e hapura nga shteti norvegjez. Në kuadër të Komitetit Norvegjez të Helsinkit ndihmuam në promovimin e lidhjes shqiptaro-amerikane në Evropë, organizuam konferencën në Oslo për z. Josef Diogardin, z. Osman Osmanin, z. Mehdi Hajdarin etj. Konferenca përfshinte edhe Këshillin për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut në Prishtinë, që vazhdimisht ndihmohej nga ne në kuadër të Komitetit Norvegjez të Helsinkit.

Më 30 janar të vitit 1991 mora pjesë në emër të shqiptarëve në varrimin e mbretit Olav të Norvegjisë, e për këtë mora një falënderim me shkrim nga lartmadhëritë e tyre, mbreti Harald dhe mbretëresha Sonja. Pas iniciativës dhe angazhimit tim lobist në Komitetin Norvegjez të Helsinkit, por edhe sqarimit të perspektivës politike për çështjen e shqiptarëve në ish-Jugosllavi, në mbledhjen vjetore të Komitetit Norvegjez të Helsinkit, mbajtur në godinën e parlamentit norvegjez më 19.3.1991, sekretari gjeneral i Komitetit Norvegjez të Helsinkit, z. Bjørn Catto Funnemark, propozon dhe unanimisht aprovohet si një nga pikat e "këshillimit" të politikës së jashtme norvegjeze: "Kosova Republikë është zgjidhja më e mirë e problemeve serioze e të drejtave të njeriut në Jugosllavi". Ky amendamentim nga ana e një organizate gjysmështetërore mund të thuhet se është rasti i parë kur bëhen propozime për zgjidhje politike dhe një forcim i ndikimit lobist dhe i diplomacisë joformale të Kosovës në Norvegji dhe në përgjithësi në Skandinavi.

Në shtator të vitit 1991, me propozim të Komitetit Norvegjez të Helsinkit, u ftuam unë dhe z. Ole Drolsum në darkën solemne (në Kështjellën e Oslos) të organizuar nga kryeministrja znj. Gro Harlem Brundtland, ku ishin të ftuar edhe një numër i konsiderueshëm i ekspertëve ndërkombëtarë, si shenjë mirënjohje për të pranishmit për kontributin e tyre për të drejtat e njeriut në plan global. Në këtë solemnitet takova disa personalitete të rëndësishme si, për shembull, z. Bogdan Karunden, personalitet i rëndësishëm i Solidarnostit, kontin Shvarcenberg të Çekisë e shumë të tjerë.

Gazeta zyrtare APPELL e Komitetit Norvegjez të Helsinkit, duke pasur ndikim në diskursin mediatik, në veçanti duke e marrë parasysh se në atë kohë iniciuam që përmbajtja e gazetës APPELL të përkthehet dhe të shpërndahet në kuadrin e informacionit për Federatën Ndërkombëtare të Helsinkit, duke e përfshirë edhe Human Rights Watch, shkruaja kolumne të rregullta për këtë gazetë, në veçanti në lidhje me situatën në Kosovë.

Në vazhdën e shkrimeve për gazetën APPELL, në vitin 1991 bëra një shkrim kritik ndaj qasjes së shteteve të fuqishme evropiane për zgjidhjen e konfliktit në Jugosllavi, sepse shtetet e fuqishme evropiane, duke e cilësuar konfliktin në ish-Jugosllavi si kërcënim për paqen në rajon dhe Evropë, duke u fokusuar vetëm në Kroaci dhe Slloveni, njëkohësisht e ndërkomunikonin çështjen e Kosovës. Përveç të tjerash, nëpërmes këtij shkrimi rikujtova se shtetet e fuqishme evropiane nuk mund t'i neglizhojnë kërkesat e shqiptarëve sikurse në konferencën e Londrës dhe në Versajë, ngase në një Evropë të sotme (të vitit 1991), ku fjalët më të dashura janë demokracia dhe liria, kërkesat e shqiptarëve dhe të popujve të shtypur në Evropë nuk mund të neglizhohen. Duke shtuar se, për dallim të republikave të tjera në ish-Jugosllavi, çështja e pazgjidhur e Kosovës kërcënon më shumë paqen në rajon sesa Kroacia dhe Sllovenia, sepse Shqipëria nuk mund të rrijë indiferente ndaj dhunës së vazhdueshme në Kosovë, prandaj apelova në këtë shkrim se është shumë me rëndësi që shtetet e fuqishme evropiane t'i marrin më seriozisht kërkesat e politikës paqësore në Kosovë.

Në vazhdën e angazhimit dhe lobimit për Kosovën në kuadër të Komitetit Norvegjez të Helsinkit si pjesë e Federatës së Helsinkit, në vitin 1992, prej 17 deri më 20 shtator, në Veronë (Itali) mora pjesë në konferencën "Forumi për Paqe dhe Pajtim në ish-Jugosllavi" ku, përveç të tjerëve, morën pjesë përfaqësues nga Federata e Helsinkit, Asambleja Qytetare e Helsinkit, Jugofax (Londër) dhe nga Instituti për të Drejtat e Njeriut në Oslo. Konferenca u udhëhoq nga një komitet prej 13 personash, në krye me z. Alexander Langer (anëtar i Parlamentit Evropian dhe president i Grupit Greens/EFFA në Parlamentin Evropian) dhe nga znj. Marijana Grandits nga Austria. Konkretisht, konferenca kishte të bënte me propozimet për gjetjen e

zgjidhjes së krizës politike në Jugosllavi. Në këtë konferencë ishim dy persona në delegacionin nga Norvegjia, profesori i filozofisë, z. Tore Lindholm, tani profesor pranë Institutit Norvegjez për të Drejtat e Njeriut dhe unë.

Gjatë kësaj konference, në kuadër të delegacionit skandinav, pata rastin të marr pjesë në një darkë joformale me z. Alexander Langer dhe gjatë një bisede me të, duke menduar se jam norvegjez dhe, pasi e kuptoj se jam shqiptar, u bë kurioz të dijë më shumë për Kosovën. Pos të tjerash, z. Langer i thashë se kërkesa e shqiptarëve për një republikë të Kosovës, që si rezultat i zhbërjes së Jugosllavisë do të mund të pavarësohet, është një kërkesë kompromisi nga ana e elitës politike të shqiptarëve, me shpresën që nëpërmes mjeteve politike dhe parimit për vetëvendosje të çlirohet Kosova nga regjimi i Millosheviqit dhe kështu t'i shërbehet paqes në Ballkan dhe një Evrope të re dhe të integruar. Përndryshe, siç e dini, shqiptarët janë i vetmi komb në Evropë, ku gjysma e kombit dhe e territoreve shqiptare shtrihen jashtë vendit amë, Shqipërisë, e kërkesa maksimaliste e shqiptarëve është bashkimi me Shqipërinë. Zotëri Langer u përgjigj duke thënë: "Kam menduar se kërkesa e shqiptarëve të Kosovës për një Republikë në kuadër të Jugosllavisë është kërkesë maksimaliste, megjithëkëtë është mirë që elita politike e shqiptarëve ka sens për kompromis në të mirë të paqes në Ballkan, ngase elita politike serbe nuk po tregon pothuajse aspak sens për kompromis në të mirë të paqes në Ballkan".

Gjatë kësaj konference e takova edhe z. Arbër Xhaferin, i cili ishte pjesëmarrës në cilësinë e përfaqësuesit të Këshillit për të Drejtat e Njeriut në Kosovë.

Gjatë pjesëmarrjes në konferencat këshilluese, në vitin 1993 u ftova në cilësinë e përfaqësuesit të Komitetit të Helsinkit Norvegjez të marr pjesë në konferencën këshilluese në lidhje me situatën politike në Kosovë dhe çështjen e azilkërkuesve shqiptarë në Norvegji. Në këtë konferencë ishin të pranishëm përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë së Norvegjisë, znj. Berit Fossheim dhe përfaqësuesit e partive politike norvegjeze që, njëkohësisht, ishin edhe deputetë në Parlamentin e Norvegjisë.

Ministria e Drejtësisë, përkatësisht përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë, znj. Fossheim, deklaronte se në Kosovë nuk është gjendje

lufte dhe nuk ka rrezik për luftë dhe se, në bazë të informatave të Ministrisë së Drejtësisë për situatën në Kosovë, ishte legjitim vendimi për t'i kthyer azilkërkuesit shqiptarë nga Norvegjia në Kosovë. Në mediet norvegjeze dhe në këtë konferencë deklaroja se është i gabueshëm konstatimi i Qeverisë norvegjeze dhe i qeverive të vendeve të tjera se nuk ka rrezik për luftë në Kosovë, duke u bazuar se populli në Kosovë është i paarmatosur dhe i përcaktuar për politikën paqësore, sepse kufijtë e durimit janë duke u strukur dhe se, po qe se Kosova nuk përfshihet së bashku me Bosnjën në një marrëveshje për paqe të garantuar nga bashkësia ndërkombëtare, Millosheviqi do ta vazhdojë politikën e aparteidit në Kosovë, e si pasojë e kësaj do të rezultojë lufta. Pra, sugjeroja që Qeveria norvegjeze ta ndryshojë vendimin dhe t'u japë qëndrim të përkohshëm azilkërkuesve shqiptarë, ta dërgojë një delegacion në Kosovë për ta observuar situatën për së afërmi dhe nëpërmes bashkëveprimit ndërkombëtar të ndikojë në shtimin e presionit më të madh ndaj Millosheviqit, që ta ndalë dhunën ndaj shqiptarëve në Kosovë.

Gjithashtu, në vitin 1993, në vazhdën e ftesave për të ligjëruar në lidhje me situatën politike në Kosovë, morëm ftesë, profesori dhe eksperti për çështjen e Ballkanit, z. Svein Mønnesland dhe unë, për një ligjëratë gjithëpërfshirëse për Ballkanin - Kosovën.[7]

Në cilësinë e koordinatorit të projektit Action Norway Albania në kuadër të Komitetit Norvegjez të Helsinkit, i cili projekt sponsorohej plotësisht nga Ministria e Jashtme e Norvegjisë dhe udhëhiqej nga znj. Berit Backer, fillimisht realizuam ndihmat emergjente nga Ministria e

[7] *(Shih referencën nr. 13: shkrimin e z. Shkëlzen Maliqit në lidhje me Asamblenë Qytetare të Helsinkit në Pragë në gazetën "Koha" në vitin 1990. Referencën nr. 14: letrën falënderuese me porosi nga mbreti Harald dhe mbretëresha Sonja për pjesëmarrjen në emër të shqiptarëve në varrimin e mbretit Olav. Referencën nr. 15: shkrimin tim informativ për gazetën "Shkëndija" në Kosovë në lidhje me aprovimin e propozimit për Kosovën Republikë nga Komiteti Norvegjez i Helsinkit. Referencën nr. 16: shkrimin kritik në lidhje me qasjen e shteteve perëndimore ndaj çështjes së Kosovës në gazetën APPELL të Komitetit Norvegjez të Helsinkit. Referencën nr. 17: informimi dhe konkluzat në gazetën APPELL nga konferenca për krizën në Jugosllavi e mbajtur në Veronë/Itali. Referencën nr. 18: një ndër deklaratat për situatën në Kosovë dhe çështjen e azilkërkuesve shqiptarë dhënë agjencisë telegrafike norvegjeze. Referencën nr. 19: në lidhje me konferencën këshilluese për çështjen e azilkërkuesve shqiptarë dhe për situatën politike në Kosovë. Referencën nr. 20: një nga deklaratat e mia në gazetat norvegjeze për situatën politike në Kosovë dhe për çështjen e azilkërkuesve shqiptarë, dhe referencën nr. 21: në lidhje me ftesën për të mbajtur një ligjëratë gjithëpërfshirëse për Ballkanin - Kosovën).*

Jashtme e Norvegjisë për në Shqipëri. Etabluam NGO-n e parë në Shqipëri në vitin 1991, përkatësisht Qendrën për të Drejtat e Njeriut dhe për Rehabilitimin e të Përndjekurve Politikë nga Regjimi Totalitar. Në fakt, kjo është NGO e parë e regjistruar në Shqipëri, e cila vazhdon të funksionojë edhe sot, duke u udhëhequr nga znj. Kozara Kati. Rehabilitimi i të përndjekurve politikë nga sistemi totalitar përfshinte studimin për çështjet e tyre dhe regjistrimin e kushteve të tyre jetësore. Si ish i burgosur politik, isha shumë i motivuar për t'i ndihmuar ish të burgosurit politikë në Shqipëri. Mora pjesë edhe në grevën e tyre në Tiranë në vitin 1991. Ndihmuam që Shqipëria të marrë pjesë në takimin e ekspertëve të KSBE-së, edhe pse nuk ishte anëtare e Këshillit Evropian. Ndihmuam themelimin dhe e ndihmuam Komitetin e Helsinkit në Shqipëri, në bashkëpunim me profesor Arben Puton dhe z. Kujtim Çashkun. Gjithashtu, ndihmuam edhe në implementimin e mësimit për të drejtat e njeriut në shkollat shqiptare nëpërmes Qendrës për të Drejtat e Njeriut në Tiranë. Thënë shkurtimisht, ishim bërthama e parë (nga jashtë) në Shqipëri për të drejtat e njeriut dhe demokratizim.

Në vitin 1993 vdiq tragjikisht mikja ime e afërt dhe mikja e madhe e shqiptarëve, znj. Berit Backer. Në varrimin e saj morën pjesë shumë personalitete vendore dhe ndërkombëtare. Në varrimin e saj erdhën përfaqësues nga Kosova dhe Shqipëria, z. Adem Demaçi, z. Gazmend Pula, z. Ibrahim Kelmendi në cilësinë e përfaqësuesit të LPK-së, ambasadori i Shqipërisë, z. B. Kokalari, z. Sali Berisha dërgoi telegram ngushëllimi, ndërsa nga z. Ibrahim Rugova mora një telefonatë pas vdekjes tragjike të znj. Backer, i cili shprehi dëshirën që në emrin e tij, në mediet norvegjeze t'i shprehë ngushëllime popullit norvegjez, gjë të cilën e bëra në gazetën "Dagbladet".

Vdekja e znj. Backer i tronditi gjithë miqtë e saj anekënd botës, që ishin të shumtë dhe me influencë politiko-shoqërore. Po ashtu, vdekja e saj i tronditi shqiptarët që bëri aq shumë për ta dhe që i donte aq shumë. Vdekja e saj, në veçanti i tronditi ata shqiptarë që e njihnin edhe personalisht dhe që ishin të vetëdijshëm për kontributin e saj për shqiptarët në kuadër të Këshillit të LPK-së për Norvegji, në rolin e saj si këshilltare prej vitit 1987.

Znj. Berit Backer deri në vitin 1987 ishte një studiuese e pasionuar e

kulturës shqiptare e nga viti 1987, në kuadër të Këshillit të LPK-së në Norvegji, u bë aktiviste e pakompromis për të drejtat e shqiptarëve në ish-Jugosllavi, duke e vënë tërë potencialin e saj në këtë drejtim. Znj. Berit Backer ishte aq e preokupuar t'i ndihmonte shqiptarët në të gjitha drejtimet saqë ndihmojë të vinte edhe grupi i parë i studentëve shqiptarë nga Shqipëria në Universitetin e Oslos dhe i rregulloi bursat e studimeve për ta. Për shembull, znj. Anila Nauni, e cila si studente e suksesshme u bë doktore e shkencës së sociologjisë pranë Universitetit të Oslos.

Si miku dhe bashkëpunëtori më i afërt i znj. Berit Backer, vdekja e saj më ka prekur thellë në shpirt dhe ndjej mungesën e saj edhe sot në çdo aspekt.

Ish-ambasadori i Suedisë në Jugosllavi dhe Shqipëri gjatë periudhës 1987-1992, z. Jan Af Silen, në shkrimin e tij në gazetën "Aftenpoften" në mars të 1993-s, në lidhje me vdekjen tragjike të znj. Backer, shkruan: "Me vdekjen e znj. Berit Backer shtetet nordike kanë humbur një studiuese dhe observatore të situatës së shqiptarëve, që nuk mund ta zëvendësojë ndonjë tjetër. Ajo vdiq në një kohë kur njohuritë e saj ishin më se të nevojshme se ndonjëherë tjetër. Mendimet tona shkojnë tek të gjithë ata të cilët ishin të afërt me znj. Berit Backer dhe tek shumë shqiptarë në Shqipëri dhe Kosovë të cilët i ka prekur vdekja e saj tragjike dhe i ka kapluar zija për humbjen e një mike dhe përkrahëse të pashoqe".

Në vitin 1993 Ministria e Jashtme e Norvegjisë, e udhëhequr nga ministri z. Johan Jørgen Hølst, më ngarkoi me detyrë që, përveç koordinatorit të projektit Action Norway Albania, të vazhdoj edhe si udhëheqës i këtij projekti. Në vitin 1993 si përfaqësues i Norvegjisë dhe si pjesë e koordinimit të Qendrës për Rehabilitimin e të Burgosurve Politikë në Tiranë me Qendrat Ballkanike, mora iniciativën në takimin në Greqi për etablimin e Qendrës në Kosovë për rehabilitimin e ish të burgosurve politikë shqiptarë, e cila qendër u jetësua në vitin 2000 nga znj. Feride Rushiti. Në vazhdën e shkrimeve për gazetën APPELL të Komitetit Norvegjez të Helsinkit, në vitin 1993 e shkrova një shkrim në lidhje me ndërkomunikimin e situatës politike të shqiptarëve në Maqedoni.

Gjatë vizitave në Shqipëri prej vitit 1990, në cilësinë e koordinatorit të projektit Action Norway Albania, prej vitit 1993 edhe në cilësinë e udhëheqësit të projektit Action Norway Albania, takohesha rregullisht me z. Xhavit Halitin, përgjegjës i sektorit të veçantë në LPK, po ashtu duke vazhduar ta mbaj kontaktin me të.[8]

Në kuadër të LPK-së si anëtar i Këshillit të Përgjithshëm të LPK-së dhe si nismëtar/përgjegjës për aktivitetin e këshillit të LPK-së për Norvegji prej vitit 1987, po ashtu duke qenë i angazhuar në koordinimin e aktivitetit politik të LPK-së për Skandinavi prej vitit 1987, në vazhdimësi duke qenë në kontakt me njerëzit e LPK-së - UÇK-së. Njëkohësisht, isha i motivuar të angazhohem në Komitetin Norvegjez të Helsinkit deri në vitin 1995, deri kur filloi të sinjalizohet qartë se çështja e Kosovës nuk do të jetë pjesë e agjendës së bashkësisë ndërkombëtare për zgjidhjen e krizës në ish-Jugosllavi, që rezultoi me Konferencën e Dejtonit. Përkatësisht isha i motivuar të angazhohem për Kosovën edhe nëpërmes Komitetit Norvegjez të Helsinkit prej vitit 1988, edhe zyrtarisht prej vitit 1990 deri në vitin 1995, sepse propaganda e Serbisë për Kosovën ishte në avantazh të madh në shtetet perëndimore: si në aspektin e diplomacisë formale nëpërmes ambasadave serbo-jugosllave, ashtu edhe nëpërmes traditës së gjatë të propagandimit të historisë serbe për Kosovën.

Aktiviteti nëpërmes të drejtave të njeriut ishte e vetmja formë për ta dekonstruktuar këtë propagandë serbe dhe, në fakt, kjo ishte në atëkohë pika më e dobët e serbo-Jugosllavisë për prishjen e imazhit të saj në Perëndim ngase, përveç të tjerash, edhe Jugosllavia ishte nënshkruese e Deklaratës së Helsinkit.

Nëpërmes Komitetit Norvegjez të Helsinkit, si pjesë e Federatës Ndërkombëtare së Helsinkit, motiv parësor kisha që nëpërmes inicimeve, sugjerimeve dhe ndihmës të kontribuoj sa më shumë si në aspektin e informimit ashtu edhe në aspektin e mbledhjes së fakteve

[8] *(Shih referencën nr. 22: shkrimin e ambasadorit të Suedisë në lidhje me vdekjen tragjike të znj. Backer. Referencën nr. 23: shkrimin nga Milaim Zeka për znj. Berit Backer. Referencën nr. 24: deklaratën time në gazetën "Dagbladet" pas telefonatës të z. I. Rugovës në lidhje me vdekjen tragjike të znj. B. Backer. Referencat nr. 25, 26, 27 në lidhje me rrjetin Ballkanik të Qendrave për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës dhe referencën nr. 28: shkrimin në gazetën APPELL të Komitetit Norvegjez të Helsinkit në lidhje me ndërkomunikimin e situatës politike të shqiptarëve në Maqedoni).*

dhe këshillimit: që fokusi i Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit të jetë sa më shumë i orientuar kah shkeljet e të drejtave të njeriut në Kosovë. Gjithashtu, si delegat nga Komiteti Norvegjez i Helsinkit më jepej mundësia nëpër konferenca ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të takoj personalitete me influencë politike, ku e shfrytëzoja rastin në maksimum edhe gjatë bisedave joformale, duke i informuar më detajisht për shkeljet e të drejtave të shqiptarëve në Jugosllavi dhe duke argumentuar për kërkesën Kosova Republikë si zgjidhje kompromisi dhe si zgjidhje që stabilizon politikisht Ballkanin.

Në fakt, raportet dhe informatat në lidhje me situatën në Kosovë, kur ua dërgonin shtetarëve në shtetet perëndimore nga Federata Ndërkombëtare e Helsinkit, duke e përfshirë Helsinki Watch Amerikan (Human Rights Watch), e kishin peshën e vet të padiskutueshme si në aspektin e besueshmërisë, si në aspektin e të kuptuarit më objektiv të situatës politike në Kosovë dhe si në aspektin e prishjes së imazhit të serbo-Jugosllavisë.

Veprimtaria politike, lobiste dhe e diplomacisë joformale e shqiptarëve në vitet 1980-'90 (LPK, përfshirë edhe Grupin për Ballkanin pranë Komitetit Norvegjez të Helsinkit në kuadër të Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit; Komiteti i Kosovës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Belgjikë; Komiteti i Kosovës për Informimin e Opinionit Botëror në Zvicër; Shoqata Migjeni në Slloveni; Liga Qytetare Shqiptaro-Amerikane në Amerikë; Komiteti i Helsinkit në Kosovë; Këshilli për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut në Kosovë; LDK etj.) kontribuoi që para Konferencës së Dejtonit të njoftohen objektivisht shtetet perëndimore për shkeljet e të drejtave/dhunën ndaj shqiptarëve në ish-Jugosllavi. Gjithashtu, kjo veprimtari kontribuoi që shtetet perëndimore të njoftohen më objektivisht, se me zhbërjen e Jugosllavisë kërkesa Kosova Republikë si shtet i pavarur është zgjidhje realiste që e qetëson Ballkanin. Por, fatkeqësisht, shtetarët perëndimorë, duke e kalkuluar realpolitikisht forcën e faktorit politik shqiptar në ish-Jugosllavi karshi forcës së regjimit të Millosheviqit në kuadër të paradigmës së stabilitetit në Ballkan, nuk i morën seriozisht kërkesat e shqiptarëve në Dejton.

Shtetarët perëndimorë, duke pasur më shumë ose më pak vetëm keqardhje për situatën politike të shqiptarëve në Kosovë, njëkohësisht

duke i mbyllur sytë ndaj dhunës së regjimit fashist të Millosheviqit në Kosovë, i dhanë prioritet politikës serbe për Kosovën në Dejton. Ndërkohë, u forcua bindja se Kosova nuk mund të çlirohet vetëm me mjetet politike, lobiste dhe me diplomacinë joformale, por duhej shtuar edhe kryengritja e armatosur. Megjithëkëtë, veprimtaria e shqiptarëve (politike, lobiste dhe e diplomacisë joformale) në vitet 1980-'90-ta nuk shkoi huq, por e pati rëndësinë e vet për t'i dhënë legjitimitet edhe më të madh luftës së lavdishme të UÇK-së, si mjet i fundit për çlirimin e shqiptarëve në ish-Jugosllavi.

Për dallim nga subjektet e tjera politike shqiptare në ish-Jugosllavi dhe në diasporë, LPK-ja ishte e vetmja organizatë e fuqishme politike e shqiptarëve në ish-Jugosllavi dhe në diasporë që nuk e përjashtonte kryengritjen e armatosur si traditë çlirimtare në historinë e shqiptarëve dhe si mjet të fundit për çlirimin e shqiptarëve në ish-Jugosllavi. Fatkeqësisht, ka ekzistuar një propagandë dhe shumë paragjykime tendencioze ndaj LPK-së nga njerëz të caktuar që nga formimi i LPK-së në vitin 1982, që shkonte në interes të Serbisë, duke i identifikuar dhe margjinalizuar veprimtarët e LPK-së (tek masat e gjëra popullore shqiptare) si enveristë, që s'dinë gjë tjetër vetëm të përshëndesin me grusht.

Në fakt, LPK-ja, si trashëguese e lëvizjes së rezistencës dhe ilegales shqiptare në viset shqiptare në ish-Jugosllavi dhe trashëguese e demonstratave 1968 dhe 1981, ishte e inspiruar nga lëvizja e rezistencës kombëtare, përkatësisht nga Lidhja e Lezhës (Gjergj Kastrioti-Skënderbeu etj.), Lidhja e Prizrenit (Abdyl Frashëri etj.), Komiteti i Kosovës (Hasan Prishtina etj.) Adem Demaçi, Metush Krasniqi etj., në veçanti nga themeluesit e saj, vëllezërit Gërvalla dhe Kadri Zeka. Simbolin e grushtit gjithnjë e kemi konsideruar dhe e konsideroj në radhë të parë simbol bashkimi - fuqie, duke u bazuar në postulatin e Skënderbeut se bashkimi bën fuqinë.

Ishim mirënjohës për ndihmën që na dha shteti shqiptar sepse, kur gjenerata e Adem Demaçit, nëpërmes rezistencës, mobilizimit të lëvizjes ilegale dhe demonstratave të vitit 1968 u bë faktori kryesor i brendshëm në Kosovë që ndikoi t'i fitojmë disa të drejta, përveç të tjerash, edhe të drejtën e hapjes së Universitetit të pavarur të Prishtinës, ishte shteti shqiptar ai që dërgoi kuadrin, përkatësisht

profesorët për ta ndriçuar me dije këtë universitet dhe rininë e Kosovës. Ishte i vetmi shteti shqiptar që na përkrahu haptas në demonstratat e vitit 1981, bile së paku moralisht për neve kjo nënkuptonte se po na përkrah Shqipëria në kërkesat tona për Republikë, e kjo kishte rëndësi për inkurajimin tonë.

Klika komuniste jugosllave e Kosovës, në krye me z. Fadil Hoxhën, z. Mahmut Bakallin, z. Azem Vllasin dhe bashkëveprimtarët-bashkëmendimtarët e tyre, nuk e patën *guximin politik* ta përkrahin hapur kërkesën për Kosovën Republikë. Nuk patën as *guxim diplomatik* të deklarohen se janë kundër demonstratave si "formë e gabuar" që të kërkohet Republika e Kosovës nëpërmes demonstratave, njëkohësisht të deklarohen se përkrahin kërkesën për Republikën e Kosovës, si kërkesë realiste në kuadër të barazisë së popujve në Jugosllavi. Nuk e kishin as *guximin juridik* ngase nuk e ngritën kurrë zërin kundër torturave ndaj të burgosurve politikë shqiptarë në Jugosllavi, së paku duke u bazuar në konventa ndërkombëtare që ndalonin përdorimin e torturës dhe dhunës. Disa prej këtyre konventave nuk ishin vetëm të nënshkruara nga Jugosllavia (duke qenë kushtëzim moral), por edhe të ratifikuara (duke qenë kushtëzim juridik). Gjithashtu, shumica e akademikëve të Kosovës, të cilët si anëtarë të lidhjes komuniste-jugosllave të Kosovës, duke qenë të preokupuar nga interesat individuale dhe afatshkurtra, nuk e patën *guximin akademik* ta përkrahin hapur kërkesën për Republikën e Kosovës në vitin 1981, përveç z. Ukshin Hotit dhe bashkëveprimtarëve të tij dhe ndonjë shembulli tjetër të izoluar.

LPK-ja punonte në dy drejtime, përpos aktivitetit politik-lobist dhe diplomacisë joformale, e kishte menduar me kohë si alternativë përgatitjen e kryengritjes së armatosur si mjet të fundit për çlirimin e shqiptarëve në ish-Jugosllavi. Në fakt, pas demonstratave të vitit 1981 LPK-ja kishte filluar, krahas veprimtarisë politike, lobiste dhe të diplomacisë joformale, edhe fillet e rezistencës së saj të armatosur në mënyrë të organizuar: Rexhep Mala, Nuhi Berisha, Bajram Bahtiri, Afrim Zhitia, Fahri Fazliu etj.

Pas mbledhjes së parë të përgjithshme të LPK-së, që u mbajt në vitin 1987 jashtë vendit (në Zvicër) me delegatë edhe nga brenda vendit (nga trojet shqiptare në ish-Jugosllavi), u përpilua edhe

programi i LPK-së që, pos të tjerash, nënkuptonte se nuk përjashtohet kryengritja e armatosur si mjet i fundit për çlirimin e shqiptarëve në ish-Jugosllavi, pasi të gjitha mjetet e tjera politike, lobiste dhe të diplomacisë joformale shpenzohen.

Pas mbledhjes së dytë të përgjithshme të LPK-së, e cila u mbajt në vitin 1989 jashtë vendit (në Zvicër) me delegatë edhe nga brenda vendit (nga trojet shqiptare në ish-Jugosllavi), u formua edhe sektori i rëndësisë së veçantë për ta bërë përgatitjen për koordinimin-organizimin e kryengritjes së armatosur të shqiptarëve në ish-Jugosllavi. Gjatë mbledhjes së parë të përgjithshme kam bërë një natë në banesë te z. Xhavit Haliti së bashku me z. Ahmet Haxhiun, përfaqësues i LPK-së brenda vendit, i cili ishte me vite nyje lidhëse në mes të strukturave të organizuara brenda vendit me ato jashtë vendit, me të cilin u njoftova dhe patëm një bisedë personale. Më kujtohet se ia bëra dhuratë një brisk "zviceran", e që shumë vite më vonë do të dëgjoj se i nderuari, baca Ahmet, kishte thënë se e kishte kujtim nga një shok i degës nga jashtë. Në atë kohë, në komunikim mes vete përdorej konspiracioni dhe ne e njihnim njëri-tjetrin me pseudonime. Po gjatë mbledhjes së dytë të përgjithshme kam takuar në banesën e z. Xhavit Halitit, z. Azem Sylën, i cili në këtë kohë vepronte brenda vendit. Për të mos u hyrë në hak të gjithë shokëve të tjerë të cilët nuk po i përmend, potencova këta të dy, sepse në kohën kur i takova ishin duke vepruar brenda vendit. Pas mbledhjes së tretë dhe të katërt të përgjithshme të LPK-së, që u mbajtën në vitin 1991 dhe 1993 brenda vendit (në trojet shqiptare në ish-Jugosllavi), me insistimin e grupeve të armatosura brenda vendit, kryesia e LPK-së merr vendim për fillimin e lëshimit të komunikatave, përkatësisht më 17.11.1994 u lëshua komunikata e parë ushtarake dhe kryesia e LPK-së mori vendim që organizimi i ri ushtarak të quhet Ushtria Çlirimtare e Kosovës - UÇK. Në Llaushë të Drenicës, gjatë varrimit të mësuesit Halit Gecaj, i vrarë nga forcat e policisë serbe më 28 nëntor 1997, në praninë e qindra njerëzve, tre pjesëtarë të UÇK-së dolën haptas para të pranishmëve dhe u thanë se UÇK-ja ekziston.

Ju e keni bërë deklaratën e parë publike në diasporën shqiptare në përkrahje të UÇK-së në vitin 1997. Pse? Cili ka qenë roli juaj në

kuadër të UÇK-së?

Edhe pas Konferencës së Dejtonit, nga njëra anë deri në fillim të vitit 1998, vihej në dyshim ekzistenca e UÇK-së ngase shumica e bashkatdhetarëve në diasporë karakterizoheshin nga një pikëpamje apatike politike, që nënvlerësonte trashëgiminë, kontiniutetin dhe potencialin e lëvizjes së rezistencës dhe ilegales shqiptare në ish-Jugosllavi dhe të aktivistëve dhe përkrahësve të kësaj lëvizje, sidomos të njerëzve të sakrificës së kësaj lëvizje, që si pjesë e organizuar në LPK, në Kosovë dhe diasporë, njëherësh si pjesë e ndërlidhur me LPK-në, në Kosovë dhe diasporë, do të mund ta organizojë kryengritjen e armatosur - UÇK-në - kundër regjimit fashist të Millosheviqit, pasi të shpenzohen të gjitha format e tjera politike, lobiste dhe të diplomacisë joformale, si përpjekje për t'u çliruar nga Serbia.

Nga ana tjetër, shtetarët perëndimorë karakterizoheshin nga një pikëpamje paragjykuese, përkatësisht nga kalkulimi realpolitik, që nënkuptonte se shqiptarët në asnjë mënyrë nuk do të mund ta organizojnë kryengritjen e armatosur kundër regjimit të Millosheviqit, duke e konsideruar regjimin e Millosheviqit si regjim total kontrollues ndaj shqiptarëve në Kosovë. Prandaj, në bazë të paragjykimit të tillë, shtetarët perëndimorë mendonin se vetëm Millosheviqi në mënyrë të izoluar e kishte potencialin të vendoste për krizën politike të Kosovës. Rrjedhimisht shtetarët perëndimorë, edhe pse kishin keqardhje më shumë ose më pak për situatën e rëndë të shqiptarëve në Kosovë, nuk kishin vizion konkret për zgjidhjen e krizës politike të Kosovës, njëkohësisht ishin të ç'koordinuar të ndërmerrnin hapa konkretë për ta ndaluar/ndëshkuar dhunën e regjimit fashist të Millosheviqit dhe ta shpërblejnë politikën paqësore në Kosovë, që sakrifikonte me vite në kurriz të shqiptarëve për zgjidhje politike paqësore dhe për ruajtjen e stabilitetit në Ballkan.

Në vitin 1996, në pritjen/takimin tonë si delegacion i përbërë nga z. Adem Demaçi, z. Arbër Xhaferi dhe unë, nga përfaqësuesit e lartë politikë të Ministrisë së Jashtme norvegjeze, ku pas një analize të situatës në Kosovë nga ana ime, duke u thënë se ekziston një qasje alternative tek shqiptarët për realizmin e të drejtave të tyre, që nënkupton kryengritjen e armatosur dhe se ka struktura të cilat mund ta vënë në jetë këtë alternativë. Në mënyrë eksplicite në këtë takim na

u tha se kjo është e pamundur sepse Millosheviqi ka kontroll të fortë dhe se kjo do të sjellë deri tek një kasaphane ndaj jush dhe se alternativa e vetme e shqiptarëve është ajo paqësore.

Zotëri Demaçi u zemërua shumë dhe tha se këta zotërinj nuk paskan dije për potencialet tona dhe se po frikësohen nga kasaphana më shumë se ne vetë. Krijohej përshtypja edhe më shumë se qarqet politike perëndimore nuk kishin vizion të qartë për ta zgjidhur krizën politike në Kosovë. As nuk ishin në gjendje ta shpërblejnë politikën paqësore të shqiptarëve, duke e detyruar Millosheviqin të bëjë ndonjë kompromis, as nuk ishin në gjendje të kenë kuptueshmëri t'i shohin zgjidhjet alternative si zgjidhje të paevitushme për zgjidhjen e krizës politike në Kosovë, ngase shqiptarët me vite kishin tentuar ta zgjidhin krizën politike në Kosovë nëpërmes mjeteve politike dhe politikës paqësore e kjo nuk kishte dhënë rezultate.

I indinjuar nga këto dy pikëpamje (nga apatia politike e një pjese të konsiderueshme të shqiptarëve dhe nga mungesa e vizionit dhe ç'koordinimi i bashkësisë ndërkombëtare për ta zgjidhur krizën politike në Kosovë) dhe duke qenë në dijeni për organizimin dhe potencialin e kryengritjes së armatosur - UÇK-së, sidomos duke e pasur parasysh rëndësinë e madhe që UÇK-ja të përkrahet në kohë të duhur, në mënyrë të duhur dhe masivisht nga diaspora shqiptare, bëra deklaratën publike në vitin 1997, dhënë radiotelevizionit norvegjez "Në përkrahje të UÇK"-së, duke thënë se UÇK-ja ekziston dhe se shqiptarët në Norvegji dhe më gjerë në diasporë janë duke u mobilizuar për ta ndihmuar UÇK-në financiarisht dhe ushtarakisht. Kjo deklaratë u emitua në mediet skandinave dhe më gjerë në Evropë, po ashtu edhe në mediet serbe. Fillimisht kjo deklaratë u konsiderua nga apatikët politikë si e çuditshme, por gradualisht u ndërrua mendimi, duke e quajtur të qëlluar dhe inkurajuese, sidomos bashkatdhetarët në Skandinavi, në veçanti bashkatdhetarët në Norvegji që u mobilizuan më herët dhe në mënyrë të duhur dhe të dinjitetshme në mbështetje të UÇK-së.

Deklarata pati konsekuenca edhe për punën time profesionale si gazetar, meqenëse punoja në radiotelevizionin norvegjez (NRK) si bashkëpunëtor i jashtëm. Disa ditë pas deklaratës sime në përkrahje të UÇK-së, m'u komunikua se redaksia e aktualiteteve ku punoja nuk e

sheh me sy të mirë deklaratën time sepse në këtë mënyrë politizohej televizioni. Kam dyshimet e mia se Ambasada Serbe kishte bërë ankesat e veta, pse të lejohet që një njeri i UÇK-së të punojë për televizionin norvegjez, por kjo nuk m'u tha asnjëherë nga ana e televizionit, por mendoj se ky ishte shkaku sepse më vonë u "shua" nevoja për kontributin tim në televizion, me arsyetimin se nuk kishin nevojë. Arsyeja, mendoj unë, është për shkak se bëra deklaratën publike në përkrahje të UÇK-së dhe se vazhdimisht vazhdova përkrahjen për UÇK-në në mediet norvegjeze dhe më gjerë.

Në vazhdën e deklaratës publike në përkrahje të UÇK-së, iniciova riaktivizimin e Bashkësisë Shqiptare në Norvegji (BSHN), e cila përfshiu brenda vetes të gjitha subjektet politike dhe kulturore shqiptare në Norvegji, pa dallim bindjesh politike dhe fetare, me një qëllim: në përkrahje logjistike, politike dhe diplomatike të UÇK-së.

Pjesë e BSHN-së u bë edhe Dega e LDK-së për Norvegjinë në krye me z. Fatmir Zymberajn. BSHN-ja u bë shembull uniteti në diasporën shqiptare por, fatkeqësisht, mbeti shembull unik gjatë tërë luftës, ngase në shtetet e tjera shqiptarët nuk arritën të jenë unikë në përkrahje të UÇK-së.

I bashkuam edhe fondet, përkatësisht fondin Vendlindja Thërret në Norvegji, për të cilin fond isha përgjegjës dhe fondin e 3 % për Norvegji (të Qeverisë së Kosovës në ekzil), për të cilin fond ishte përgjegjës z. Fatmir Zymberaj. Fondi Vendlindja Thërret në Norvegji është formuar me praninë dhe ndihmën e z. Jashar Salihut dhe z. Ibrahim Kelmendit, i cili që nga themelimi i Këshillit të LPK-së në Norvegji i dha mbështetje veprimtarisë së LPK-së në Norvegji. BSHN-ja zgjodhi këshillin e përgjithshëm të përbërë nga 70 anëtarë, kryesinë nga 7 anëtarë, kryetarin z. Qatip Halitin nga Tetova dhe dy nënkryetarë, z. Fatmir Zymberajn - nënkryetar, mua nënkryetar dhe zëdhënës të BSHN-së.

Radioja shqiptare (Radio Rilindja në Oslo) intensifikoi angazhimin e vet në mbështetje të aktiviteteve të BSHN-së, përkatësisht në mbështetje të UÇK-së. Qendrat fetare shqiptare në Norvegji dhanë kontributin e tyre në grumbullimin e ndihmave humanitare dhe transportit. Filluam menjëherë ndihmën financiare për UÇK-në dhe intensifikuam aktivitetin lobist, mediatik dhe diplomatik në përkrahje

të UÇK-së. Po ashtu, organizuam demonstratën e parë në diasporën shqiptare në përkrahje të drejtpërdrejtë të UÇK-së. Këtë e bëmë edhe simbolikisht, ngase 10 djem veshën uniformën ushtarake me emblemën e UÇK-së dhe parakalonin në fillim të rreshtit të demonstratës që kishte disa mijëra demonstrues, duke bartur banderolat "Rroftë UÇK-ja" dhe flamujt kombëtarë shqiptarë. Mund të thuhet se ishte demonstrata më e madhe në qytetin e Oslos organizuar nga ndonjë organizatë jonorvegjeze. Kjo e kishte rëndësinë e vet ngase z. Gilbart e kishte pasur në vizitë në Ambasadën Amerikane në Beograd z. Adem Demaçin dhe i kishte thënë se UÇK-ja është terroriste, ku nga ai takim kemi atë thënien stoike të z. Adem Demaçit: "Çlirimtare, çlirimtare, çlirimtare…".

Për shqiptarët kishte rëndësi të tregojnë unitet rreth përkrahjes ndaj UÇK-së, sidomos para opinionit ndërkombëtar dhe se, pa marrë parasysh si do ta quajnë të tjerët UÇK-në, UÇK-ja ishte për shqiptarët çlirimtare dhe se të "gjithë" ishim UÇK.

Duhet t'i rikujtojmë rrethanat e asaj kohe. UÇK-ja kishte dalë haptas para popullit në nëntor 1997. Gjatë gjithë kësaj kohe veprohej në mënyrë të organizuar që UÇK-ja të bëhet e njohur për partnerët perëndimorë, posaçërisht për SHBA-të dhe Britaninë e Madhe, sepse duhej të viheshin kontakte të drejtpërdrejta me udhëheqjen e UÇK-së. Edhe unë këtu në Oslo kisha kontakte me sekretarin e parë të Ambasadës Britanike, z. A Cordery. Kontakti filloi menjëherë pas deklaratës sime publike në përkrahje të UÇK-së në radiotelevizionin norvegjez, kur një telefonatë pak e pazakontë m'u drejtua me këto fjalë: "Z. Lekaj, unë jam z. A. Cordery. Do të doja të takohesha me ty të bisedonim në lidhje me Kosovën". Iu përgjigja pozitivisht për takim dhe nënkuptova se zotëria duhet t'i takonte sektorit për informacion. Nuk hezitova dhe i thashë se do të jem i hapur me ju zotëri sepse interesi ynë është t'ua bëjmë të njohur qasjen që ka UÇK-ja në lidhje me çështjen e Kosovës. Kështu filloi kontakti ynë dhe vazhdoi për muaj të tërë deri në verën e vitit 1999.

Takimi i z. Demaçi me z. Gilbart dhe deklarata z. Gilbard në Beograd, se UÇK-ja është terroriste, tregonte se përgatitej diçka. Shërbimet sekrete serbe, civile dhe ushtarake kishin vënë në qarkullim informacionet për ambasadat e Perëndimit, me theks të veçantë ishin

duke përgatitur planin për "shkatërrimin" e UÇK-së, në veçanti për "shkatërrimin" e komandës së UÇK-së. Kjo më bën ta kujtoj ditën pas masakrës së Prekazit dhe takimin me z. Cordery. Nuk ishin bërë të njohura krejtësisht detajet dhe z. Cordery i Ambasadës Britanike më thërret urgjentisht për të pirë kafe në një lokal ku zakonisht takoheshim, "Hansken", afër Kështjellës së Oslos. Isha bërë vrer, se lajmet që kisha marr thoshin se forcat serbe kishin vrarë komandantin e UÇK-së, Adem Jasharin dhe shumë të tjerë. Në takimin me z. Cordery kuptova më shumë mes fjalëve të tij se Millosheviqi paska "marrë" dritën e gjelbër për ta shkatërruar komandën e UÇK-së, e pritej konfirmimi i kësaj "të vërtete serbe". Në fakt, dihet botërisht se z. Gilbard dhe shtetet perëndimore u "mashtruan" nga Millosheviqi, i cili bëri masakrën e njohur mbi familjen Jashari. Gjithashtu, për shkak të oportunizmit, ç'koordinimit dhe jovendosmërisë së bashkësisë ndërkombëtare për t'i bërë presion edhe më të madh Millosheviqit, krijohej klima politike që UÇK-ja të margjinalizohej ndërkombëtarisht dhe, po ashtu, të fragmantohet edhe më shumë faktori politik brendashqiptar. Prandaj, mobilizimi dhe përkrahja morale e popullit pro UÇK-së ishte jetike.

Më kujtohet se duke shkuar në takim atë mëngjes mora një konfirmim se familja Jashari ishte masakruar dhe nxitova ta njoftoj z. A. Cordery. Sapo u ula, m'u drejtua: Z. Lekaj, çka tani? Komandanti Jashari dhe komanda e UÇK-së janë shkatërruar. Si do t'ia bëni? Ia ktheva se nuk është shkatërruar UÇK-ja dhe se, në fakt, është masakruar familja e komandantit Adem Jashari, por është turp për qeverinë tuaj, e cila u beson gënjeshtrave të Millosheviqit. Zotëri Cordery u ndje pak i habitur në këtë përgjigje, krejtësisht jodiplomatike nga unë, por kishim një marrëveshje të jemi të hapur dhe të flasim ashtu siç mendojmë. Ditët në vijim do të tregonin se kisha të drejtë dhe rrjedhimisht z. Cordery kërkonte shpesh të takoheshim, sidomos gjatë kohës së bisedimeve në Rambuje, para fillimit të bombardimeve të NATO-s, gjatë bombardimeve të NATO-s, sidomos në përgatitjen e planeve për veprime ushtarake tokësore të NATO-s, në kuptimin se si do të mund të koordinoheshin.

Për bisedimet dhe kontaktet me z. Cordery ishte i njoftuar sektori

përkatës i UÇK-së.[9]

Përkrahjen logjistike, politike dhe diplomatike në mbështetje të UÇK-së e vazhdova me intensitet edhe më të madh edhe pas marsit 1998, edhe në cilësinë e përfaqësuesit politik të UÇK-së për Skandinavi, i emëruar nga z. Adem Demaçi, duke e bërë një aktivitet mediatik dhe lobist të konsiderueshëm krahas punës si koordinator i logjistikës, respektivisht unifikimit të fondeve për UÇK-në. Në mars të vitit 1998 kemi edhe nisjen e ushtarit të parë të UÇK-së nga Norvegjia në Kosovë, z. Esat Kadriaj, e pastaj i janë bashkuar edhe dhjetëra të tjerë, ndër ta edhe dy norvegjezë.

Gazetarin e njohur norvegjez z. Pål Refsdal e ndihmuam ta kalojë kufirin dhe të futet në Kosovë për të dokumentuar për luftën heroike dhe për qëllimet demokratike të luftës së UÇK-së. Ai plagoset së bashku me dy ushtarë të UÇK-së nga minat e serbëve të vendosura në brezin kufitar dhe qëndron një muaj në spital të UÇK-së. Dokumentimi i luftës nga ana e z. Refsdal kishte rëndësi, sepse ishte i pari gazetar i huaj i cili jetonte me UÇK-në, por edhe ndante fatin me të. Raportimet e tij nga Kosova në televizionin shtetëror norvegjez (NRK), por të huazuara edhe nga agjencitë e tjera informative botërore BBC, CNN etj., krijonin një imazh pozitiv për luftën tonë dhe qëllimet e saj çlirimtare dhe demokratike, ngase propaganda serbe e paraqiste luftën tonë si dhe qëllimet e luftës sonë si të motivuara e të ndihmuara nga fanatizmi fetar islamik. Gjatë kësaj periudhe e kundërshtova në mediet norvegjeze propozimin e deputetes norvegjeze znj. Grete Fossum për ndalesën e grumbullimit të mjeteve financiare në përkrahje të UÇK-së.

Në korrik-gusht 1998, së bashku me z. Isa Thaçin, në emër të Këshillit të Përgjithshëm të Bashkësisë Shqiptare në Norvegji ishim për të asistuar dhe përgatitur terrenin për vendosjen e Spitalit Fushor nga Norvegjia në zonën e kufirit Shqipëri - Kosovë. Ky spital është sponsoruar nga Ministria e Jashtme e Norvegjisë dhe stafi mjekësor i organizatës humanitare norvegjeze NORWAC. Kirurgu i njohur norvegjez z. Erik Fosse ishte udhëheqës i spitalit. Koordinatore e

[9] *(Shih referencat nr. 29, 30, përkatësisht deklaratën time në përkrahje të UÇK-së dhënë radios shtetërore norvegjeze në vitin 1997, e botuar në vitin 1997 edhe në mediet shqiptare; gazetën "Bujku", gazetën "Rilindja" dhe në Qendrën për Informim të Kosovës (QIK).*

përgjithshme ishte Bashkësia Shqiptare në Norvegji. Gjatë gjithë kohës kishim të pranishëm në spital përfaqësuesit e Bashkësisë Shqiptare nga Norvegjia. Në këtë spital u shpëtua jeta e shumë ushtarëve të plagosur të UÇK-së. Në fund të luftës ky spital iu fal TMK-së.

Gjatë qëndrimit me z. Isa Thaçin në korrik-gusht 1998, pranë Shtabit të UÇK-së për zonën e brezit kufitar dhe logjistikës, u vumë në dispozicion të shtabit. Aty takova Bekim Berishën-Abenë si dhe shumë shokë të tjerë. Në kujtesë kam koordinimin e pranimit të plagosurve gjatë ofensivës së korrikut në spitalin e Bajram Currit. Në emër të shtabit kam takuar edhe delegacionin e OSBE-së, anëtarët e të cilit kishin ardhur t'i takojnë të plagosurit, të cilëve kishte rëndësi t'u shpjegohej se artileria serbe kishte bombarduar caqet civile në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe se kanë pësuar civilët. Delegacionit i printe deputeti shqiptar z. Namik Dokle. Atyre u jam prezantuar me prapavijën time, si aktivist i të drejtave të njeriut, duke përfshirë mbrojtjen e të drejtave të refugjatëve.

Kur puna e Bashkësisë Shqiptare në Norvegji gjatë vitit 1998 mori formën e vet mobilizuese më të vrullshme në ndihmë për UÇK-në, fatkeqësisht sikurse në vitin 1991, kur z. Buxhovi e sulmoi Bashkësinë Shqiptare në Norvegji duke e zhbërë, tash këtë sulm ndaj Bashkësisë Shqiptare në Norvegji e bëri z. Isa Mustafa me padronin e tij, z. Bujar Bukoshin, por këtë herë dështuan.

Zotëri Isa Mustafa, duke bërë presione, iu kundërvu hapur kryesisë së fondit të 3 % në Norvegji, duke e kërcënuar me ndjekje penale z. Fatmir Zymberajn dhe anëtarët e tjerë të kryesisë së fondit të 3 % në Norvegji. Kur e pa se e kishte të kotë, sepse bashkimi ynë brenda Bashkësisë Shqiptare në Norvegji në përkrahje të UÇK-së ishte i palëkundshëm, atëherë z. Mustafa reagoi në media, duke thënë se do ta formojë fondin e ri të 3 % në Norvegji, të cilën e bëri por, fatmirësisht, bashkatdhetarët në Norvegji nuk dhanë ndihma të ndonjë shumë domethënëse në këtë fond të "ri" të z. Isa Mustafës, i cili administronte fondet e z. Bukoshit. Ne iu përgjigjem në media. E shkrova komunikatën në emër të Bashkësisë Shqiptare në Norvegji, duke ua bërë z. Mustafës dhe z. Bukoshit të njohur premtimin të cilin e kishin dhënë nëpërmes televizionit: se kanë marrë vendim për të dhënë gjithçka për luftën. Rrjedhimisht, e vazhduam punën tonë të

bashkuar nëpërmes Bashkësisë Shqiptare në Norvegji në përkrahje të UÇK-së. Fatmirësisht, UÇK-ja vetëm forcohej dita-ditës, duke u përkrahur nga atdhetarët, pa marrë parasysh subjektet politike që u takonin, gjithashtu nga atdhetarët me profesionalizëm ushtarakë. Çuditërisht, LDK-ja, duke pasur në radhët e veta veprimtarë kredibilë për postin e kryetarit të LDK-së, z. Isa Mustafa arriti të bëhet edhe kryetar i LDK-së në vitin 2010. [10]

Të vërteta na dolën fjalët që i tha z. Demaçi më vonë, se Perëndimit iu dashtë t'i mësonte emrat e fshatrave të Kosovës për të ndryshuar mendje. Përkatësisht u nevojit që me shumë sakrifica të shqiptarëve të dëgjohet në mediet e shteteve perëndimore për masakrat si ajo e Prekazit, e Reçakut dhe dhjetëra masakra të tjera së bashku me luftën e vendosur të UÇK-së para se shtetet perëndimore të koordinohen dhe ta vendosnin seriozisht në agjendën e tyre Kosovën. Njëkohësisht, shtetet perëndimore ballafaqoheshin me një dilemë të madhe, që nënkuptonte se ose duhej të vazhdonin të rrinin indiferente dhe të papërgjegjshme ndaj dhunës së Millosheviqit në Kosovë, duke lejuar zhvillimin e një lufte më të madhe ku implikohej Shqipëria dhe shtetet e tjera, rrjedhimisht i tërë Ballkani të përfshihej në luftë, ose duhej ndihmuar me armatim të sofistikuar luftën legjitime të UÇK-së kundër regjimit fashist të Millosheviqit.

Shtetet perëndimore, në krye me SHBA-të dhe Britaninë e Madhe, nuk e panë të arsyeshme ta ndihmojnë me armatim të sofistikuar luftën legjitime të UÇK-së, por vendosën të mos rrinë edhe më tutje indiferente dhe të papërgjegjshme ndaj realitetit të ri politik në Ballkan që u shkaktua nga UÇK-ja, por jo me fajin e UÇK-së sepse, pas krimeve dhe dhunës sistematike të regjimeve serbe ndaj shqiptarëve dhe pas përpjekjeve të ndryshme të shqiptarëve, që nëpërmes zgjidhjeve politike dhe politikës paqësore t'i realizojnë të drejtat e tyre, UÇK-ja e kishte legjitimitetin e vet të padiskutueshëm. Ky realitet i ri, jo me faj të shqiptarëve, e rrezikonte Ballkanin, njëkohësisht e

[10] *(Shih referencën nr. 31: në lidhje me reagimin tim kundër propozimit të anëtares së parlamentit norvegjez, znj. Grete Fossum, për ndalesën e mjeteve financiare në ndihmë për UÇK-në dhe referencën nr. 32: komunikatën e Bashkësisë Shqiptare në Norvegji të botuar në gazetën "Koha Ditore" në vitin 1998 si reagim ndaj z. Isa Mustafës dhe z. Bujar Bukoshit).*

determinonte domosdoshmërinë e demokratizimit të njëmendët të Ballkanit dhe barazinë nacionale të shqiptarëve me fqinjët e tyre, duke e përfshirë edhe respektimin e ndërsjellë dhe simetrik të të drejtave të njeriut në mes fqinjëve ballkanikë, pa dallim të kufijve shtetërorë.

Gjithashtu, kriza humanitare në Kosovë, si pjesë e Evropës, prekte thellë ndërgjegjen e shteteve perëndimore, sidomos duke e marrë parasysh keqmenaxhimin e krizës humanitare në Bosnjë nga shtetet perëndimore. E tëra rezultoi me organizimin e konferencës së Rambujesë. Me vendosmërinë dhe marrjen e përgjegjësisë për paqen dhe demokratizimin e njëmendtë të Ballkanit nga SHBA-të dhe Britania e Madhe erdhi intervenimi kundër regjimit fashist të Millosheviqit, duke u përkrahur ky intervenim edhe nga shtetet e tjera demokratike, duke e përfshirë edhe Norvegjinë.

Norvegjia (si shtet shumë aktiv dhe me besueshmëri të veçantë në marrëdhëniet ndërkombëtare), përveç angazhimeve për zgjidhje politike të krizës në ish-Jugosllavi, u bë edhe pjesë e intervenimeve të NATO-s kundër regjimit fashist të Millosheviqit dhe dha kontribut të madh për demokratizimin (e vendeve të postkonfliktit) në Ballkan. Gjithashtu, shërbimi inteligjent norvegjez, përkatësisht njësiti E14 (seksioni për mbledhjen e informacionit të veçantë, i themeluar në vitin 1995) ka qenë aktiv në Kosovë edhe para ardhjes së trupave ushtarake norvegjeze në Kosovë. Njësiti E14 është themeluar me qëllim të marrjes së informacionit në Ballkan. Gjithashtu, ky njësit ka operuar më vonë edhe në vende të tjera të botës: Sudan, Libanon, Siri, Irak, Afganistan etj. deri në vitin 2006. Ekzistenca e njësitit E14 është bërë publike në vitin 2011. Burime të ndryshme, përfshirë edhe ish-ministrat, kanë konfirmuar për shtypin norvegjez se shërbimi inteligjent norvegjez (nga mesi i viteve 1990-ta) ka arritur rezultate mahnitëse dhe se informacioni që në një masë të madhe është mbledhur nga njësiti top-sekret E14 ka ndikuar që shërbimi inteligjent norvegjez të marrë mirënjohje ndërkombëtare.

Z. Jørgen Kosmo, i cili ka qenë ministër i Mbrojtjes, kur njësiti E14 është themeluar, e ka lavdëruar angazhimin e këtij njësiti (në gazetën norvegjeze VG të datës 04.02.2011) ngase, sipas tij, njësiti E14 e ka bërë një punë shumë të suksesshme. Në këtë mënyrë shërbimi inteligjent norvegjez e ka forcuar pozicionin e vet në lidhje me

shkëmbimin (dhënien/marrjen) e informacionit, në raport me shërbimet inteligjente të shteteve aleate (SHBA-ve, Britanisë së Madhe etj).

Të interesuarit mund të informohen më shumë në lidhje me këtë në librin (e botuar në vitin 2012) e titulluar: "Heroi i luftës, historia e marinsit dhe zëvendësshefit të seksionit E14 të shërbimit Informativ Norvegjez, Trond Bolles", ku shkruan më gjerësisht për kontaktet e Trond Bolles me UÇK-në dhe Ibrahim Rugovën, përveç të tjerash (në fq. 114-115, 141): *"Gjatë kontakteve/bisedave me kryengritësit e UÇK-së, Trond Bolle së bashku me kolegët e tij arritën të marrin informacion në lidhje me pozicionet serbe. Ky informacion iu dërgua më tutje aleatëve të Norvegjisë, në radhë të parë amerikanëve".*

"Bolle gradualisht arriti të sigurojë informacion shumë të saktë për pozicionet serbe që do të bombardoheshin në Kosovë. Ai bleu GPS të thjeshtë dhe i shpërndau tek ushtarët e UÇK-së. Guerilët i morën GPS-të dhe mblodhën koordinatat e pozicioneve serbe dhe caqeve të tjera që mund të bombardoheshin. Koordinatat iu dërguan udhëheqësve të UÇK-së nëpërmes telefonit satelitor. Udhëheqësit e UÇK-së ia dhanë këto koordinata Bolles dhe agjentëve të tij, e më tutje koordinatat u dërguan në sistem. Me ndihmën e koordinatave të sakta, aeroplanët luftarakë amerikanë i bombarduan caqet që i kishte përzgjedhur UÇK-ja. Kjo e ka rritur mundësinë që aeroplanët luftarakë amerikanë t'i godasin caqet e duhura, duke i bërë goditjet nga ajri shumë efektive".

"Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së kishte simpati për Trond Bollen dhe kolegët e tij. Agjentët norvegjezë e arritën shpejt besueshmërinë tek udhëheqja e lartë e UÇK-së dhe asnjë nga shërbimet informative që operonin në këtë zonë nuk e kishin besimin nga UÇK-ja në nivel kaq të madh. Në një rast shefi i Shtabit të Përgjithshëm, menjëherë pas takimit me sekretaren amerikane të Shtetit, Madeleine Albright, shkoi drejt në takim të ri me agjentin efektiv norvegjez".

"Një nga arritjet e mëdha të Bolles dhe agjentëve të tij në këtë periudhë ishte krijimi i lidhjeve të ngushta me njeriun i cili më vonë u bë presidenti i parë i zgjedhur i Kosovës, Ibrahim Rugovën. Ishte 'Bamse' (Ariu) ai që vuri në kontakt Bollen dhe Rugovën. Udhëheqja

në Sh. I. e kuptoi më herët se shkrimtari dhe profesori i letërsisë, Ibrahim Rugova, do të jetë forca bashkuese sapo të arrihet paqja. Nëpërmjet tyre Rugovës iu mundësua dërgimi i sinjaleve tek pushtetarët norvegjezë në Norvegji. Burimet e informacionit dhënë agjentëve norvegjezë, u dhanë liderëve norvegjezë një pozicion unik në raport me kolegët ndërkombëtarë. Për këtë arsye Trond Bolle dhe kolegët e tij u kujdesën për mirëmbajtjen e kontaktit me Rugovën disa herë në javë gjatë një periudhe të gjatë. Shërbimi Informativ Amerikan dhe Anglez kishin ardhur në përfundimin se Ushtria Çlirimtare e Kosovës do të bëhet faktori kryesor politik në Kosovën e lirë. Por, siç edhe ndodhi, analiza parashikuese e shërbimit informativ norvegjez, e bazuar në informatat nga agjentet e vet, rezultoi e saktë".

Në vazhdën e pjesëmarrjes në mediet e shkruara, radion shtetërore dhe televizionet norvegjeze, në përkrahje të UÇK-së, u ftova të marr pjesë në debatin televiziv në lidhje me legjitimitetin e intervenimit të NATO-s në Kosovë. Ndër pjesëmarrësit në këtë debat ishte edhe kryeministri i tanishëm i Norvegjisë, i cilësuar edhe baba i kombit norvegjez, z. Jens Stoltenberg. Gjithashtu, për gazetën "Stavanger Afenblad" e trajtova çështjen e rekrutimit/mobilizimit për UÇK-në.

Duke e marrë parasysh se NATO-ja në vitin 1999 kishte nevojë për intensifikim të veprimeve të veta në terren në formë të operacioneve në shkallë të gjerë, UÇK-ja në anën tjetër kishte nevojë të ndihmohet me teknikë të sofistikuar ushtarake. Në prill të vitit 1999, në një bisedë në mes të delegacionit të Bashkësisë Shqiptare në Norvegji dhe përfaqësuesve të Ministrisë së Jashtme norvegjeze, në emër të delegacionit të Bashkësisë Shqiptare në Norvegji dhe si përfaqësues politik i UÇK-së për Skandinavinë kërkuam të na mundësohet leja për të blerë pajisje ushtarake nga Fabrika e Armatimeve dhe Municioneve Raufoss, sepse kjo fabrikë i kishte në listën për asgjësim (u skadonte afati) 1 000 copë mortajash dore për një përdorim, shumë efektive për luftë kundër mjeteve të blinduara. Këtë kërkesë e bëmë, të shtyrë nga dëshira ta shtojmë fuqinë goditëse të UÇK-së mbi forcat okupatore të Millosheviqit, për t'i detyruar të kapitullojnë më shpejt. Zyrtarët norvegjezë mbetën për një moment të menduar dhe thanë se ata kanë një linjë të qartë se nuk do ta armatosin UÇK-në, edhe pse UÇK-ja

ishte në linjë me qëllimet e NATO-s për ta detyruar Millosheviqin të kapitullojë, por thanë se bëjnë vetëm veprime humanitare, siç është ndihma me spitalin fushor ushtarak.

Në vitin 1999 organizuam vizitën e z. Hashim Thaçi, i cili u prit zyrtarisht në kohën e luftës nga kryeministri norvegjez z. Kjell Magne Bondevik dhe ministri i Jashtëm z. Knut Volebæk. Gjithashtu, në cilësinë e përfaqësuesit diplomatik të Kosovës në Norvegji, i emëruar nga Qeveria e Përkohshme e Kosovës në vitin 1999, përpos aktivitetit të konsiderueshëm diplomatik dhe mediatik, në periudhën e maj - qershorit 1999 e organizuam kalimin dhe e shoqëruam për në Kosovë gazetaren dhe regjisoren znj. Maria Fugelvåg Warshinskin për ta realizuar filmin dokumentar, por edhe për të mbledhur fakte për krimet serbe gjatë luftës në Kosovë. Filmi i znj. Warshinski është i llojit të vet dhe i vetmi film i cili është klasifikuar nga Gjykata e Hagës si dokument dëshmie në gjykimin kundër Sllobodan Millosheviqit. Në shtator 1999 m'u dha mirënjohja për kontribut të veçantë për çlirimin e Kosovës, akorduar nga Qeveria e Përkohshme e Kosovës, respektivisht Ministria e Mbrojtjes, e firmosur nga ministri z. Azem Syla.

Në vjeshtën e vitit 1999 u bë hapja solemne e përfaqësisë diplomatike të Kosovës në Norvegji, ku ishin të pranishëm personalitete të rëndësishme politiko-shoqërore të Norvegjisë: Ministri Erik Solheim, kryetari i Komitetit për Politikë të Jashtme i Parlamentit Norvegjez, z. Håkon Blankenborg, profesor universiteti, përfaqësues të organizatave joqeveritare, gazetarë dhe miq të shumtë të Kosovës dhe shqiptarëve. Ditën e nesërme Ambasada Ruse e bëri një reagim në mediet norvegjeze kundër etablimit të Përfaqësisë së Kosovës në Norvegji. Të njëjtën ditë e bëmë një kundërreagim ndaj Ambasadës Ruse. Veprimtaria e koordinuar në mes NORWAC dhe Përfaqësisë së Kosovës në Norvegji u vazhdua dhe rezultoi me angazhimin e parë të Norvegjisë (pas luftës në Kosovë) në ndërtimin dhe rehabilitimin e disa spitaleve në Kosovë.

Duke pasur lidhje të mëhershme me Komitetin Norvegjez të Helsinkit, në vazhdën e aktiviteteve të Përfaqësisë së Kosovës në Norvegji, gjatë një vizite të udhëheqësisë së Komitetit Norvegjez të Helsinkit në Zyrën e Përfaqësisë së Kosovës u shfaq kërkesa për një

projekt për Kosovën në kuadër të Komitetit Norvegjez të Helsinkit. Përfaqësia e Kosovës sugjeroi që zëdhënësi i saj, z. Sylo Taraku, të punësohet në kuadër të Komitetit Norvegjez të Helsinkit për këtë projekt për Kosovën, me qëllim që ta vazhdojmë edhe më tutje lidhjen me këtë organizatë. Z. Sylo Taraku tani ka një pozitë të anëtarit të bordit në këtë organizatë.

Në vazhdën e ftesave për të mbajtur ligjërata për Kosovën - Ballkanin, nga data 29 maj deri më 7 qershor të vitit 2000 u mbajt një seminar i nivelit të lartë me ligjërues të ndryshëm në lidhje me artin e menaxhimit të konflikteve. Më 5 qershor u ftuam, unë në cilësinë e përfaqësuesit të Zyrës së Kosovës në Norvegji dhe një përfaqësues nga Ministria e Jashtme Norvegjeze, të ligjërojmë në lidhje me artin e menaxhimit të konflikteve. Duke e marrë parasysh se Qeveria e Përkohshme e Kosovës u detyrua të inkorporohet në Këshillin e Përbashkët Administrativ me OKB-në, UNMIK-un, përfaqësia diplomatike e Kosovës në Norvegji ngriu funksionin e vet diplomatik në vitin 2000, sepse Këshilli i Përbashkët Administrativ nuk kishte departament për punë të jashtme, e kjo nënkuptonte se nuk mund të kishte as përfaqësim diplomatik të Kosovës në botë.[11]

A e vazhduat aktivitetin patriotik deri në njohjen zyrtare të pavarësisë së Kosovës nga shteti i Norvegjisë në vitin 2008, apo u tërhoqët nga angazhimet e deriatëhershme aq të mëdha e të nduarnduarshme në favor të çlirimit të Kosovës?

Pas çlirimit të Kosovës, përkatësisht prej vitit 2000 deri në vitin 2008, aktiviteti im politik ndryshon si për nga rëndësia ashtu edhe për nga pesha dhe intensiteti, krahasuar me aktivitetin tim politik të viteve

---

[11] *(Shih referencën 33: deklaratën time në gazetën "Stavanger Aftenblad" në lidhje me çështjen e rekrutimit/mobilizimit për UÇK-në.*
Shih në youtube debatin në lidhje me legjitimitetin e intervenimit të NATO-s në Kosovë në vitin 1999: www.youtube.com/watch?v=VLR_ANnuk1E&feature=share
Shih në youtube hapjen solemne të përfaqësisë diplomatike të Kosovës në Norvegji në vitin 1999: http://www.youtube.com/watch?v=uRyl1UeeRxU
Shih në youtube reagimin e Ambasadës Ruse kundër hapjes solemne të përfaqësisë diplomatike të Kosovës në Norvegji në vitin 1999: www.youtube.com/watch?v=c21YAcWN6Zk.
Shih referencën nr. 34: disa nga deklaratat me shkrim të përfaqësisë diplomatike të Kosovës në Norvegji në vitin 1999 dhe referencën nr. 35: ftesën për ligjëratën në lidhje me artin e menaxhimit të konflikteve).

të ’80-’90-ta, por kjo nuk nënkupton se kam qenë krejtësisht pasiv.

Duke marrë parasysh se pas luftës në Kosovë, përkatësisht pas vitit 2000, diplomacia serbe ndërmori një ofensivë cinike, duke u përkrahur edhe nga disa qarqe mediatike në Perëndim, po ashtu duke përfshirë edhe disa qarqe mediatike në Norvegji, që t’i barazojnë krimet e regjimit të Millosheviqit me disa raste të izoluara të dhunës në Kosovë. Gjithashtu, duke marrë parasysh se një pjesë e këtyre mediumeve ishin në pikënisje të kurdisura që ta dëmtojnë imazhin e UÇK-së, duke kriminalizuar luftën e UÇK-së dhe duke qenë kundër pavarësimit të Kosovës ngase, sipas tyre, pavarësimi i Kosovës do ta destabilizojë Ballkanin. Në veçanti, duke marrë parasysh se diplomacia serbe nëpërmjet këtyre medieve ishte në avantazh, ngase diaspora shqiptare nuk kishte nga Kosova asnjë autorizim për ndonjë lloj përfaqësimi të Kosovës që të mund t’i kundërvihet në emër të institucioneve të Kosovës këtyre zërave mediatikë tendenciozë dhe cinikë që sulmonin vlerat dhe rolin historik të UÇK-së dhe kundërshtonin pavarësimin e Kosovës.

Diaspora shqiptare pas vitit 2000 nuk kishte më legjitimitet të flasë në emër të Kosovës sikurse në kohën kur Kosova ishte nën robëri. Fjala e diasporës shqiptare për Kosovën pas vitit 2000 nuk e kishte as rolin dhe as peshën e vet siç e kishte para vitit 2000. Për shkak të arsyeve të sipërpërmendura, në dhjetor të vitit 2000 i dërgova një projekt-propozim për përfaqësim të Kosovës në Botë në nivelin e zyrave të Kosovës, z. Ibrahim Rugovës, z. Hashim Thaçit dhe z. Rexhep Qosjes.

Projekt-propozimi ka elaboruar një formë të avancuar, por jo në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare për përfaqësim të zyrave Liaison (ndërlidhëse), të cilat do ta përfaqësonin Kosovën dhe do të ishin vazhdimësi e përpjekjeve dhe arritjeve të shumta të diplomacisë joformale dhe formale të diasporës shqiptare në botë. Po të etabloheshin këto zyra të Kosovës, Liaison (ndërlidhjes), me legjitimitet institucional nga Kosova, do ta kishin përgatitur terrenin për njohjen më të shpejtë të pavarësisë së Kosovës nga shumica e vendeve të botës, por edhe do të shërbenin si iniciativa të rëndësishme për investime në Kosovë.

Këto zyra, duke e pasur legjitimitetin institucional të Kosovës, do t’u

kundërviheshin fuqishëm dhe me kohë zërave që dëmtojnë imazhin e vlerave historike dhe çlirimtare të UÇK-së dhe zërave kundër pavarësimit të Kosovës. Se sa do të kishin qenë të nevojshme këto zyra mund ta shohim edhe tani në vitin 2012, duke qenë ende të vonuar me konsolidimin dhe përfaqësimin e mirëfilltë të diplomacisë së Kosovës në Botë, po ashtu duke qenë të vonuar me njohjen e pavarësisë së Kosovës në botë, njëherësh duke qenë të vonuar për investimet në Kosovë. Por, le të jetë detyrë e historisë ta gjykojë këtë.

Edhe në ditët e sotme, çuditërisht, Ministria e Jashtme e Kosovës (MPJ) nuk e shfrytëzon mundësinë e hapjes së zyrave të Kosovës, Liaison (ndërlidhjes), në shtetet të cilat nuk e kanë njohur Kosovën, së paku në ato shtete ku ka potencial për ta njohur pavarësinë e Kosovës. Hapja e këtyre zyrave mund të bëhet pa ndonjë problem në shtetet përkatëse, duke i regjistruar si Zyra Interesi të Kosovës. Në fakt, këto zyra, duke pasur legjitimitet nga institucionet e Kosovës, do ta luanin rolin "de facto" të përfaqësive të shtetit të Kosovës në shtetin përkatës. Së paku duhet t'i kishim këto zyra në Rumani, Spanjë, Greqi, Sllovaki, Qipro, por edhe në shumë vende të tjera që s'e kanë njohur ende Kosovën.

Nga kush presim të bëhen ndryshime të politikës në këto shtete karshi Kosovës nëse nuk ka iniciativa lobiste nga vetë vendorët?! Kosova do të kishte mundësi, për shembull, ta ketë zyrën e Kosovës në Rumani, e cila nuk do të kishte fillimisht status diplomatik, por do të regjistrohej si Zyrë Interesi e Kosovës me legjitimitet nga institucionet e Kosovës. Aty do të koncentroheshin resurset njerëzore dhe materiale për të bërë veprime lobiste brenda Rumanisë duke iniciuar debate, konferenca, shkrime në gazeta, por edhe lidhje afariste në mes të Rumanisë dhe Kosovës.

Duhet marrë parasysh se për njohjen e Kosovës nga shtetet që ende nuk e kanë njohur është rrënjësisht e rëndësishme që iniciativat për njohje të Kosovës të vijnë nga brenda në këto shtete. Kjo vlen në radhë të parë për Rumaninë, ku nëpërmes lobimit intensiv nga vendësit, në shoqërinë civile, mediet etj., mund të ndikohet që gradualisht një deputet apo një grup parlamentar ta vë në rend dite çështjen e njohjes së Kosovës dhe nisma për njohjen e Kosovës nga shteti rumun të hyjë në proces.

Gjithashtu, të lobohet që Asociacioni i Biznesit Rumun të kërkojë nga Qeveria lehtësim për investime etj. Kemi një diasporë tradicionale në Rumani me intelektualë shqiptarë, intelektualë rumunë me lidhje të hershme me shqiptarët. Kemi edhe rektorin e tashëm të Universitetit të Bukureshtit, z. Kyçyku, po ashtu shqiptar. Nuk është vetëm kanali i diplomacisë amerikane që duhet pritur se do t'i rregullojë të gjitha punët tona për njohjen e Kosovës. Shtetet sovrane janë të mësuara ta kenë pavarësinë e tyre në vendimet e politikës së jashtme, sidomos kur janë në pyetje çështjet e rëndësishme siç është njohja e shteteve etj. dhe shpesh qortohen nga qarqet akademike dhe mediatike për politikat e jashtme të "vazalit" ndaj Amerikës.

Duhet ta kujtojmë të kaluarën se si i kemi bindur shtetet në Perëndim, të cilat fillimisht nuk kishin disponim për t'u bindur se kërkesat politike të shqiptarëve (për barazi nacionale me kombet fqinje dhe për respektim të ndërsjellë dhe simetrik të drejtave të njeriut me kombet fqinje) janë legjitime. Një pikënisje e mirë do të ishte të krijohej me iniciativën e Qeverisë së Kosovës Asociacioni i Miqve të Kosovës për personalitete - shtetas të huaj të cilët kanë kontribuar për Kosovën dhe do t'u jepej mundësia ta japin kontributin e tyre të mëtutjeshëm për Kosovën. Sa e sa nga këta miq të vjetër e të rinj të Kosovës janë harruar dhe nuk kemi nevojë për ta. Fatkeqësisht, kemi harruar se këta miq kanë bërë shumë për Kosovën dhe mund të bëjnë edhe më shumë. Çuditërisht, tani kur kemi shtetin tonë, po i humbim apo lëmë në harresë këta miq sikur të ishim ne shtet shumë i superfuqishëm në bashkëveprimin ndërkombëtar dhe të "mund të bënim si të donim vetë".

Përfaqësuesit politikë në Kosovë, në vazhdën e mosgjetjes së kompromiseve në të mirë të Kosovës në historinë e re të Kosovës, nuk gjetën kompromis as në lidhje me projekt-propozimin tim të dërguar në vitin 2000 për përfaqësim të Kosovës në botë. Megjithëkëtë, duke pasur parasysh se Kosova ende nuk ishte e pavarur, vendosëm në vitin 2001 që sadopak të vetëriorganizohemi në kuadër të Zyrës së Kosovës në Norvegji, duke e regjistruar si Zyrë Interesi e Kosovës me emrin "Kosova Office in Norway", por pa legjitimitet nga institucionet e Kosovës: si aktivitet vullnetar në mbrojtje të vlerave çlirimtare të UÇK-së dhe për njohjen e pavarësisë së Kosovës nga shtetet nordike.

"Kosova Office in Norway" nuk e kishte forcën e duhur sepse nuk e kishte legjitimitetin institucional të Kosovës por, megjithatë, u përshëndet nga kryeministri norvegjez z. Kjel Magne Bondevik nëpërmes letrës së tij dërguar kësaj zyre më 29 tetor 2001.[12]

Pas propozimit të Shoqatës së Gazetarëve Profesionistë në Norvegji, me arsyetimin se kam pasur rol të rëndësishëm në krijimin e opinioneve për dhjetëvjeçarin e fundit, në vitin 2001 më ndahet mirënjohje nga Organizata Ndërkombëtare Who's Who për Profesionalistët për vitin 2000. Gjatë luftës në Maqedoni kam përkrahur publikisht në mediet televizive dhe në shtypin norvegjez kryengritjen e armatosur të shqiptarëve - Ushtrinë Çlirimtare Kombëtare (UÇK) në Maqedoni ngaqë, pas përpjekjeve të gjata dhe të dështuara të shqiptarëve në Maqedoni, që t'i arrijnë të drejtat e tyre nëpërmes mjeteve politike, kjo luftë kishte legjitimitet si mjet i fundit për t'u arritur të drejtat e shqiptarëve në Maqedoni.

Duke pasur parasysh se ish-strukturat e LPK-së organizuan luftën çlirimtare edhe në viset shqiptare në Maqedoni, kisha njohuri për këtë organizim strukturor që nga koha e formimit të sektorit të veçantë të LPK-së, ku ishte edhe z. Ali Ahmeti. Prandaj, duke e konsideruar si pjesë të pandarë të planit për çlirimin kombëtar dhe në përputhje me programin e LPK-së, vura në dispozicion veten për ta organizuar në Norvegji logjistikën dhe planin e përkrahjes për Ushtrinë Çlirimtare Kombëtare (UÇK-në) në viset shqiptare në Maqedoni, por edhe për Ushtrinë Çlirimtare për Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc (UÇPMB). Konkretisht, i rivumë në funksion strukturat e Bashkësisë Shqiptare në Norvegji, duke grumbulluar mjete financiare dhe mobilizim të njerëzve për luftën. Jam i lumtur që arritëm një mobilizim të mirë, për të cilën gjë më përgëzuan z. Ali Ahmeti dhe z. Fazli Veliu, me rastin e pritjes në selinë e tyre në Tetovë pas çlirimit.

Më 14 mars 2001 u ftova në debatin në lidhje me UÇPMB-në, ku merrnin pjesë ekspertë ushtarakë norvegjezë etj. Debati kishte të bënte me UÇPMB-në dhe marrëveshjen në mes të NATO-s dhe

[12] *(Shih referencën nr. 36: letrën përshëndetëse nga kryeministri i Norvegjisë, z. Kjel Magne Bondevik, dërguar Zyrës së Kosovës në Norvegji (Kosova Office in Norway) më 29 tetor 2001).*

Serbisë, për t'i lejuar serbët të operojnë me armatim të rëndë dhe aviacion në zonën e "demilitarizuar" rreth Kosovës. Për Serbinë kjo nënkuptonte "dritën e gjelbër" për ta vënë në veprim ofensivën e vet kundër UÇPMB-së, e cila kontrollonte këtë zonë, por edhe brendësinë në territorin "serb", dmth. Luginën e Preshevës.

Serbia e akuzonte NATO-n se po lejon shqiptarët nga Kosova dhe Maqedonia ta armatosin UÇPMB-në, por edhe të marrin pjesë në aksione kundër forcave serbe. Qëndrimi im në këtë debat ishte të mos i lejohet Serbisë ta merrte kontrollin në zonën e "demilitarizuar", por në vend të kësaj të bëhen bisedime me UÇPMB-në për demilitarizim, e në vend të UÇPMB-së dhe ushtrisë serbe, këtë territor ta kontrollojë NATO-ja, duke argumentuar se: nëse ushtria serbe merr kontrollin do të bëjë spastrim etnik në këtë territor të banuar me shqiptarë.

Duke marrë parasysh se NATO-ja kishte mandat të bënte veprime që sigurojnë paqen, sipas mendimit tim, kontrollimi i kësaj zone nga NATO-ja nuk ishte në kundërshtim me Rezolutën 1244, për të krijuar kështu një ambient të sigurt politik për Luginën e Preshevës. Fatkeqësisht, politikanët shqiptarë nuk bënë përpjekjet e duhura për të krijuar një "paralele" me gjendjen e Mitrovicës, e cila "de facto" u nda dhe kontrollohej nga serbët, por "de jure" ishte nën kontrollin e NATO-s.

Sikur të imponohej ky reciprocitet do të kishim një situatë më të favorshme për negociatat e tanishme dhe nuk do të na krijohej situata, ku Lugina e Preshevës është bërë poligon i operacioneve të spastrimit etnik dhe trysnive nga regjimi i Beogradit. Pjesëmarrësit e tjerë në debat e "mbronin" vijën "politike" të NATO-s, duke thënë se Serbia ka të "drejtë" ta kontrollojë territorin e vet. Por, në pyetjen time: pse atëherë nuk u lejohet institucioneve të Kosovës ta kontrollojnë territorin e vet në veri të Kosovës?, u munduan të sqaronin se atë territor e kontrollon NATO.[13]

Në kuadër të "Kosova Office in Norway" vazhdimisht kam reaguar me vetiniciativë, duke i kontaktuar dhe duke u ankuar tek disa redaksi,

[13] *(Shih referencën nr. 37: informacioni në lidhje me këtë debat dhe informatat për pjesëmarrësit në këtë debat).*

kur disa gazetarë në mënyrë tendencioze spekulonin kundër UÇK-së dhe që, njëkohësisht, spekulonin kundër pavarësimit të Kosovës. Në vazhdën e angazhimit të argumentimit për rëndësinë e pavarësimit të Kosovës, e shkrova një shkrim (në prag të shpalljes së pavarësisë) për revistën prestigjioze politiko-shoqërore "Ny-Tid", që u botua më 15 shkurt 2008, duke argumentuar se pavarësia e Kosovës është një fillim i ri për Kosovën që e stabilizon politikisht Ballkanin.

Më 18 shkurt 2008 mora pjesë në debatin televiziv në lidhje me shpalljen e pavarësisë së Kosovës (debat pro et contra) me z. Steinar Bryn, i cili me vite është angazhuar duke ftuar dhe inkurajuar intelektualë shqiptarë dhe serbë nga Kosova dhe intelektualë serbë nga Serbia, që nëpërmes dialogut të arrihet një pajtim/zgjidhje për çështjen e Kosovës në kuadër të Serbisë.

Më 20 shkurt 2008 Ministria e Jashtme e Norvegjisë në deklaratën e vet u deklarua se do ta njohë pavarësinë e Kosovës, e kjo na gëzoi shumë. Këtë deklaratë e përjetuam si një dush të ftohtë në dimër, kur në të (në ditën kur u shpall pavarësia e Kosovës, duke e marrë parasysh se Serbia ende mbahej ndërkombëtarisht përgjegjëse për mosarrestimin e të akuzuarve për gjenocid, Ratko Mlladiqin dhe Radovan Karaxhiqin) Ministria e Jashtme norvegjeze e nënvizoi edhe "lidhjen e afërt" në mes të Norvegjisë dhe Serbisë dhe liderëve serbë. Posaçërisht u prononcua në deklaratë se: "I japim rëndësi të madhe ruajtjes së lidhjes sonë plot besim me Serbinë dhe bashkëpunimit tonë me Serbinë që e kemi kultivuar me vite".

Në deklaratën e Ministrisë së Jashtme norvegjeze nuk ishte caktuar asnjë afat për formalizimin/zyrtarizimin e njohjes së pavarësisë së Kosovës nga shteti norvegjez. Nga kontaktet e mia mora vesh se Ministrisë së Jashtme norvegjeze nuk i ngutej ta bëjë sa më shpejt formalizimin/zyrtarizimin e njohjes së shtetit të Kosovës. U ftova për një intervistë nga revista e njëjtë, ku bëra shkrimin më herët, përkatësisht nga revista "Ny-Tid", për ta dhënë komentin tim lidhur me formulimin e deklaratës së Ministrisë së Jashtme norvegjeze. Gjatë intervistës bëra një falënderim, njëkohësisht një kritikë ndaj një pjese të deklaratës së Ministrisë së Jashtme norvegjeze, e cila kritikë nga intervistuesi u interpretua në mënyrë edhe më të ashpër seç ishte duke u keqinterpretuar pjesërisht, sepse edhe intervistuesi e konsideronte

deklaratën e Ministrisë së Jashtme norvegjeze jo të mirëmenduar në formulim. Prandaj, e njoftova Ministrinë e Jashtme norvegjeze nëpërmes letrës, se nuk marr përgjegjësi për interpretimin e ashpër dhe keqinterpretimin e pjesshëm të intervistës sime nga intervistuesi, por marr përgjegjësi vetëm për atë se çka kam deklaruar në intervistë, përkatësisht marr përgjegjësi vetëm për komentin tim. E komenti im ishte ky: "E falënderojmë shumë Qeverinë e Norvegjisë që në deklaratën e Ministrisë së Jashtme shprehu gatishmërinë e vet për ta njohur pavarësinë e Kosovës dhe kemi kuptueshmëri se Qeveria e Norvegjisë dëshiron ta mbajë bashkëpunimin e mirë me Serbinë. Njëkohësisht, një pjesë të deklaratës së Ministrisë së Jashtme e kemi përjetuar si një dush të ftohtë në dimër, kur mu në ditën e shpalljes së pavarësisë së Kosovës Ministria e Jashtme norvegjeze nënvizon rëndësinë e lidhjes së veçantë në mes të Norvegjisë dhe Serbisë dhe liderëve serbë, posaçërisht formulimit të Ministrisë së Jashtme norvegjeze në deklaratë se i japim rëndësi të madhe ruajtjes së lidhjes sonë plot besim me Serbinë dhe bashkëpunimit tonë me Serbinë që e kemi kultivuar me vite. Rrjedhimisht, e konsiderojmë deklaratën e Ministrisë së Jashtme norvegjeze pjesërisht të zhbalancuar dhe jo të mirëmenduar në aspektin diplomatik për shkak të mënyrës së formulimit të deklaratës nga Ministria e Jashtme norvegjeze 'për lidhjen e afërt' në mes të Norvegjisë dhe Serbisë, duke marrë parasysh se Serbia mbahet ndërkombëtarisht përgjegjëse për mosarrestimin e të akuzuarve për gjenocid, Ratko Mlladiqit dhe Radovan Karaxhiqit. Gjithashtu, na vjen keq pse në deklaratë të Ministrisë së Jashtme norvegjeze nuk përmendet gatishmëria e shtetit norvegjez për lidhje miqësie me shtetin e ri të Kosovës, por shpresojmë që shteti norvegjez do ta shprehë këtë gatishmëri në të ardhmen". E kjo kritikë e imja u përkrah në mënyrë implicite edhe nga eksperti për Ballkanin, Jon Kværne, në shkrimin e tij pas një jave për të njëjtën revistë, përkatësisht revistën "Ny-Tid".

Ndërkohë, e bëra një reagim ndaj një shkrimi në gazetën "VG" të datës 24 shkurt 2008 në lidhje me shpalljen e pavarësisë së Kosovës, duke e kontaktuar redaksinë dhe duke argumentuar se UÇK-ja nuk ka pasur asnjë lidhje me trafiqet e narkotikëve, por është financuar në mënyrë të organizuar dhe të ndershme nga diaspora shqiptare, sepse

në këtë shkrim i jepej njëkohësisht pasqyrim negativ luftës së UÇK-së dhe shpalljes së pavarësisë së Kosovës, duke shkruar për z. Hashim Thaçin se është i dyshuar për trafikim të narkotikëve.

Duke e marrë parasysh rëndësinë e njohjes sa më të shpejtë formale/zyrtare të pavarësisë së Kosovës nga shteti norvegjez dhe duke e marrë parasysh se Ministrisë së Jashtme norvegjeze nuk i ngutej ta bëjë këtë sa më shpejt, kontaktova Ministrinë e Jashtme norvegjeze, duke insistuar/argumentuar se për Kosovën ka rëndësi të madhe njohja sa më e shpejtë formale/zyrtare nga shteti norvegjez. Arrita ta organizoj takimin në Ministrinë e Jashtme norvegjeze më 28.03.2008 në orën 10:00. Gjeta gatishmëri nga z. Xhavit Haliti dhe z. Sabri Hamiti, përkatësisht udhëheqës të Komisionit për Politikë të Jashtme pranë Parlamentit të Kosovës, të vijnë në Norvegji në takimin që e kisha paracaktuar në Ministrinë e Jashtme të Norvegjisë.

Më 28.03.2008 në orën 10:00 sekretarja e parë e ministrit të Jashtëm norvegjez në takim, ku ishin të pranishëm z. Hamiti, z. Haliti, z. Daut Haxhaj dhe unë, na njoftoi se mbretëria norvegjeze sot, më 28.03.2008, në orën 09:30, ka njohur zyrtarisht Republikën e Kosovës. Të njëjtën ditë në mbrëmje e bëmë një festë për njohjen formale/zyrtare të pavarësisë së Kosovës nga shteti norvegjez dhe Zyra e Kosovës (Kosova Office in Norway) deklaroi të njëjtën ditë në mbrëmje se e përfundoi misionin e vet. Edhe pas njohjes zyrtare të pavarësisë së Kosovës nga Norvegjia nuk i kam ikur përgjegjësisë, obligimit dhe përkushtimit për Kosovën. Nëpërmjet një letre e kam njoftuar Ministrinë e Jashtme të Kosovës se jam i gatshëm, pa pagesë, të zbatoj ndonjë detyrë të re të Ministrisë së Jashtme të Kosovës në Norvegji.

Norvegjia, edhe pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, vazhdoi të jetë një aktore e rëndësishme në kuadër të bashkëveprimit ndërkombëtar për paqen në Ballkan. Këtë e dëshmon edhe deklarata e ministrit të Jashtëm norvegjez, z. Espen Barth Eides, në lidhje me marrëveshjen Kosovë - Serbi.

Gazeta "Aftenposten" më 24 prill 2013 informon: *"Ai është udhëheqësi i parë nga ndërkombëtarët që viziton Serbinë, pas asaj që e quan marrëveshje historike me Kosovën. Të dy vendet ranë dakord pas bisedimeve të mundimshme për t'i normalizuar marrëdhëniet"*.

"Tani dëshirojmë të bashkëpunojmë në lidhje me implementimin, thotë Eide, pasi e ka bërë të qartë se Norvegjia gjatë tre vjetëve ka punuar në prapaskenë, përderisa UE udhëhoqi bisedimet midis Serbisë dhe Kosovës. Kjo është një punë që Eide e quan mbështetje të procesit dhe tregon për disa takime sekrete në Oslo. Ai përshkruan një marrëdhënie të gjatë dhe të mirë në mes të Serbisë dhe Norvegjisë që, gjithashtu, zgjati edhe gjatë luftërave në Ballkan. Kjo ishte një arsye e rëndësishme që Norvegjia të mund të veprojë si një arenë jozyrtare krahas arenës së negociatave zyrtare në Bruksel. Kemi investuar shumë, por ky investim është gjithashtu një kapital për ne, thotë Eide në lidhje me mënyrën se si kjo ka rezultuar me besueshmërinë ndaj norvegjezëve, duke e marrë parasysh se gjërat e vështira është dashur të diskutohen.

Ministri i Jashtëm vendosi të shkojë në Ballkan menjëherë pasi marrëveshja u bë publike. Të mërkurën do të takohet me zëvendëskryeministrin serb Aleksandar Vuçiq. Pastaj udhëton për në Prishtinë për takime me kryeministrin e Kosovës, Hashim Thaçin dhe ministrin e Jashtëm, Enver Hoxhaj. Nuk ka qenë aspak proces i lehtë për Serbinë të hyjë në marrëveshje me Kosovën, që u shpall e pavarur në vitin 2008. Akoma ka ndjenja shumë të forta ndaj asaj që dikur ishte një krahinë serbe. Ende jetojnë rreth 100 000 serbë etnikë në Kosovë, dhe Eide nënvizon se tani do të varet që Kosova të dëshmojë se mund të përballet me përgjegjësinë e saj dhe t'i respektojë të drejtat e minoriteteve".[14]

Prej vitit 1987, duke qenë aktiv në kontiniutet në mediet norvegjeze, në lidhje me shkeljet e të drejtave të shqiptarëve në ish-Jugosllavi nga regjimi serbo-jugosllav dhe në lidhje me çështjet e azilkërkuesve

---

[14] *(Shih referencën nr. 38: shkrimin në prag të shpalljes së pavarësisë më 15 shkurt 2008 në gazetën "NyTid", duke argumentuar se pavarësia e Kosovës është një fillim i ri për Kosovën që e stabilizon politikisht Ballkanin.*

Shih referencën nr. 39: shkrimin në gazetën "VG" të datës 24 shkurt 2008, në lidhje me shpalljen e pavarësisë së Kosovës dhe z. Hashim Thaçin.

Shih në youtube debatin televiziv në lidhje me shpalljen e pavarësisë së Kosovës: www.youtube.com/watch?v=DqKR20-qiWQ

Shih në youtube festimin për njohjen zyrtare të pavarësisë së Kosovës nga shteti norvegjez, ku morën pjesë edhe z. Xhavit Haliti dhe z. Sabri Hamiti:

http://www.youtube.com/watch?v=g2e7aJ4Bt4w).

shqiptarë, duke vazhduar të përkrah në media luftën çlirimtare të UÇK-së, nuk kam hezituar që në mediet norvegjeze të bëj në emër të shqiptarëve distancimin tim publik nga dukuritë e këqija (kriminale) që bënte ndonjë shqiptar për ta prishur imazhin e shqiptarëve në Norvegji dhe të shqiptarëve në përgjithësi.

Vazhdimisht kam apeluar dhe shfrytëzoj rastin që edhe nëpërmes kësaj interviste të apeloj tek shqiptarët në Norvegji, për të qenë mirënjohës duke respektuar ligjet, shtetin dhe popullin norvegjez për ndihmën e Norvegjisë ndaj shqiptarëve si në planin individual duke na strehuar, si në planin kolektiv duke e marrë anën e drejtë; duke u bërë pjesë e aleancës perëndimore kundër regjimit fashist të Millosheviqit dhe duke njohur pavarësinë e Kosovës.

Gjithashtu, shfrytëzoj rastin të apeloj tek të gjithë shqiptarët në shtetet nordike dhe në përgjithësi tek shqiptarët në shtetet perëndimore, për të qenë mirënjohës ndaj popujve dhe shteteve perëndimore që nuk na harruan krejtësisht, por na ndihmuan në kohët më të vështira si në planin individual duke na strehuar, si në planin kolektiv duke e përkrahur luftën legjitime të UÇK-së kundër regjimit fashist të Millosheviqit.

Ju uroj juve, stafit të revistës "Drini" dhe të gjithë shqiptarëve kudo që janë, 100-vjetorin e pavarësisë së Shqipërisë. Posaçërisht miqve dhe bashkëpunëtorëve gjatë të gjitha këtyre viteve të veprimtarisë, prej kyçjes në lëvizjen ilegale në vitin 1978 deri në njohjen zyrtare të pavarësisë së Kosovës nga shteti i Norvegjisë në mars të vitit 2008.

P. s.

Duke marrë parasysh se nëpërmes kësaj interviste në këtë rrëfim të dokumentuar kam qenë i kufizuar të shkruaj për të gjitha detajet dhe referencat relevante në lidhje me historikun e LPK-së në Norvegji, për këtë arsye nuk janë dhënë të gjitha detajet. Po për arsye të ndryshme nuk kam shkruar për disa të dhëna të tjera. Shpresoj që lexuesit të kenë mirëkuptim për këtë.

Intervistoi: **Gjergj Kabashi**

Referencat e intervistës në origjinal dhe shqip

Dagbladet UTENRIKS Tirsdag 29. september 1987 19

«Torturistene trakk ut tåneglene mine»

I sju måneder, ofte under tortur, satt jeg i enecelle, med sterkt lys på hele tida. Jeg satt med hendene og føttene lenket sammen. Bare når jeg skulle spise, ble håndjernene fjernet.

Av JAN-ERIK SMILDEN

Det er den jugoslaviske asylsøkeren Leka (26) som forteller dette. Leka som er av albansk opprinnelse, ble plassert i militært fengsel uten kontakt med omverdenen etter at han deltok i oppstanden i Kosovo-provinsen i 1981.

— Jeg deltok i spontandemonstrasjoner, lagde paroler og var medlem av en liten sosialistisk ikke-voldsgruppe kalt Besa (Æresordet), forteller Leka. Vi drev celle-virksomhet og hadde bare ti medlemmer. Stort sett var aktiviteten vår å arrangere studiesirkler, lage løpesedler og skrive slagord på veggene. Målet vårt var at Kosovo skulle bli en selvstyrt jugoslavisk republik sier den 26-årige asylsøkeren.

Leka var en av flere tusen som ble arrestert etter Kosovo-opprøret. Oppholdet i militærfengslet har satt spor for livet.

Torturert

— Torturistene slo ut flere av tennene mine, de trakk ut to storfingler av føttene mine, og de slo og sparket meg over hele kroppen. Nyrene ble ødelagt,og jeg mistet håret på hodet og kroppen, sier Leka og viser oss blant annet et tatovert nasjonalsymbol, den albanske ørn, på brystet.

— En av torturistene ville skjære bort merket med barberblad, men en av hans kolleger fikk stoppet ham forteller 26-åringen.

Etter sju måneder i militærfengsel, fulgte fem måneder i sivil varetekt før saken hans kom opp. Dommen — for «illegal virksomhet» lød på fem års fengsel. I mars i år ble Leka løslatt og vendte tilbake til hjembyen.

— Jeg studerte til elektroingeniør og ville gjenoppta studiene mine etter løslatelsen. Da jeg spurte om å få studieplassen min tilbake, svarte rektor at det skulle jeg få etterat jeg hadde fått republikken min.

— Jeg fikk heller ingen jobb, sier Leka. Arbeidsgiverne krever vandelsattest, den får man ikke utlevert av politiet når man har vært politisk fange.

Leka forteller at han hadde meldeplikt hos politiet hver dag etter løslatelsen og at han av og til ble hentet til avhør, også midt på natta. Han hadde også forbud mot å bevege seg utenfor hjembyen.

Ingen framtid

— Til slutt orket jeg ikke mer, det var ingen framtid for meg i Kosovo og Jugoslavia. Jeg bestemte meg for å dra til Norge fordi landet lå så langt unna Jugoslavia og fordi det ikke var så mange hemmelige jugoslaviske agenter der, sier Leka.

Urosenter vil ha indre selvstyre

Kosovo-provinsen kom i verdens søkelys i 1981, da den albanske majoriteten gjorde opprør mot den jugoslaviske regjeringen i Beograd. De etniske albanerne krevde at Kosovo skulle få status som selvstyrt republikk innen den jugoslaviske føderasjonen. I dag er bare Kosovo et såkalt autonomt område.

Av de ca. 2,5 millioner etniske albanerne i Jugoslavia, bor mellom 1,6 og 1,7 millioner i Kosovo. Ellers utgjør Kosovo-befolkningen 200 000 serbere og montegrinere.

Illyrere

Albanerne stammer fra de såkalte illyrerne, et indo-europeisk folk som kom til det sørlige Albania ca. år 1000 f.Kr. De dannet flere stammefyrstedømmer og bredte seg utover deler av Balkan-området, inntil de måtte gi tapt for tyrkerne i begynnelsen av 1400-tallet. Da Albania og Jugoslavia oppsto som nasjoner i tida rett før og etter den 1. verdenskrig, ble den albanske befolkningen splittet.

Jugoslavene hevder at Kosovo-albanerne arbeider for gjenforening med det strengt kommunistiske Albania. Alle forsøk på politisk opposisjon blir slått hardt ned. Amnesty International kan berette om arrestasjoner, vilkårlige fengslinger og tortur.

Smågrupper

Kosovo-albanerne arbeider politisk i smågrupper, og hevder at de ikke ønsker noen gjenforening med Albania. Trolig er bare et lite mindretall for en slik gjenforening.

Asylsøkere i Norge hevder at det i dag sitter 5000 etniske albanere fengslet for politisk virksomhet i Jugoslavia. Jugoslaviske myndigheter har selv oppgitt at ca. 3000 etniske albanere er blitt dømt til fengsel i Kosovo siden 1981.

Striden mellom befolkningsgruppene i Kosovo tilspisser seg. Tidligere i år kom det til oppløyer etter at serbere og montegrinene demonstrerte mot det de kaller overgrep fra den albanske majoriteten i området.

Kosovo-provinsen ligger på grensa til Albania.
(Kart: Vidar Karlsen)

Referenca nr. 1

Gazeta "Dagbladet", lajmet e jashtme, e martë, 29 shtator 1987

"Torturistët m'i kanë nxjerrë thonjtë e gishtave"

Gjatë shtatë muajve, shpesh nën tortura, kam qëndruar i mbyllur në qeli, me një dritë të fortë gjatë gjithë kohës dhe i lidhur me pranga këmbë e duar. Vetëm kur kam ngrënë m'i kanë hequr prangat.

Nga JAN-ERIK SMILDEN

Këtë e thotë azilkërkuesi nga Jugosllavia, Leka (26), i cili është shqiptar, pjesëmarrës i demonstratave të vitit 1981 dhe i burgosur gjatë shërbimit ushtarak. Ai tregon se ka marr pjesë në demonstrata, ka shkruar parulla dhe ka qenë anëtar i një grupi jo të dhunshëm majtist. "Aktiviteti ynë kishte të bënte me organizimin e qarqeve studentore, duke shpërndarë fletushka, duke shkruar parulla në mure dhe duke e pasur si qëllim kryesor që Kosovës t'i njihet statusi i Republikës", thotë azilkërkuesi 26-vjeçar. Leka është një nga mijëra të tjerë të cilët u arrestuan pas demonstratave në Kosovë. Qëndrimi në burgun ushtarak i ka lënë pasoja për tërë jetën.

I torturuar

"Torturistët m'i kanë thyer pothuajse të gjithë dhëmbët, m'i kanë nxjerrë dy thonjtë e gishtave të mëdhenj të këmbëve, më kanë rrahur dhe shqelmuar në të gjithë trupin. Veshkat m'i kanë dëmtuar, kam humbur flokët për një kohë të shkurtër", thotë Leka dhe më tregon një simbol kombëtar, shqiponjën shqiptare të tatuar në gjoks.

Njëri nga torturistët ka dashur t'ia presë simbolin kombëtar në gjoks me brisk rroje, por është ndaluar nga një koleg i tij, thotë 26-vjeçari. Pas shtatë muajsh në burg ushtarak dhe pesë muaj në paraburgim civil, para se lënda e tij të dalë në gjyq, aktgjykimi për "aktivitet ilegal" i shqipton pesë vjet burgim. Në mars të këtij viti Leka është liruar dhe kthyer në vendlindjen e tij.

"Kam studiuar inxhinierinë elektrike dhe kam dashur t'i vazhdoj studimet pas lirimit. Kur pyeta për t'i vazhduar studimet, mora përgjigje se studimet mund t'i vazhdoj pasi ta kem fituar republikën

time. Gjithashtu, si ish i burgosur politik nuk kisha mundësi të punësohesha", tregon Leka, i cili rrëfen se pas lirimit nga burgu ishte i detyruar të lajmërohet në polici çdo ditë, nganjëherë edhe gjatë natës e kanë marr në pyetje dhe e ka pasur të ndaluar lëvizjen jashtë qytetit të vendlindjes.

Pa ardhmëri

"Së fundi u stërlodha nga agjentët, nuk kishte të ardhme për mua në Kosovë dhe Jugosllavi. Vendosa të vij në Norvegji ngase Norvegjia është shumë larg gjeografikisht nga Jugosllavia, me shpresën se në Norvegji nuk ka shumë agjentë sekretë jugosllavë", thotë Leka.

Vendi i trazuar kërkon vetëvendosje të brendshme

Krahina e Kosovës u ekspozua në qendër të vëmendjes botërore në vitin 1981, kur shumica shqiptare bëri revoltë kundër Qeverisë jugosllave në Beograd. Shqiptarët etnikë kërkuan që Kosova ta ketë statusin e republikës në kuadër të federatës jugosllave. Kosova vazhdon ende të jetë vetëm një regjion autonom. Nga përafërsisht 2.5 milionë shqiptarë etnikë në Jugosllavi, në Kosovë banojnë në mes 1.6 - 1.7 milion. Përndryshe, popullsinë e Kosovës e përbëjnë edhe 200 000 serbë dhe malazias.

Ilirët

Shqiptarët me origjinë rrjedhin nga të ashtuquajturit ilirët, një popullatë indo-evropiane që u dynd në jug të Shqipërisë përafërsisht 1 000 vjet para Krishtit. Ata formuan principatat fisnore dhe u shtrinë mbi pjesë të Ballkanit, derisa u okupuan nga turqit në fillim të shekullit 14. Kur Shqipëria dhe Jugosllavia u konsoliduan si kombe në periudhën para dhe pas Luftës së Parë Botërore, populli shqiptar u nda. Sipas jugosllavëve, shqiptarët e Kosovës angazhohen për ribashkim me Shqipërinë totalitare. Të gjitha këto angazhime të shqiptarëve si opozitë politike ndëshkohen rëndë. Amnesti Internacional ka informata që dëshmojnë për arrestime, burgosje arbitare dhe tortura.

Grupe të vogla

Shqiptarët e Kosovës janë të angazhuar politikisht në grupe të vogla dhe argumentojnë se nuk duan ndonjë bashkim me Shqipërinë. Ndoshta vetëm një pakicë e vogël e përkrah një bashkim të tillë. Azilkërkuesit në Norvegji pohojnë se për momentin 5 000 shqiptarë etnikë janë të burgosur për veprimtari politike në Jugosllavi. Edhe autoritetet jugosllave kanë deklaruar se rreth 3 000 shqiptarë etnikë janë dënuar me burg në Kosovë që nga viti 1981. Konflikti në mes grupeve etnike në Kosovë është duke u rritur edhe më shumë. Në fillim të këtij viti kanë ndodhur trazira, serbët dhe malazezët demonstruan kundër asaj që ata e quajnë abuzim nga shumica shqiptare në këtë zonë. Krahina e Kosovës kufizohet edhe me Shqipërinë.



VG Fredag 5. august 1988 NYTT 17

Torturoffer KASTEBALL

AV HARALD BERG SÆVEREID

Tør ikke Norge lenger gi politisk asyl til søkere fra Jugoslavia? Spørsmålet er relevant, mener advokat Arild Farstadvoll, etter at alban-jugoslaven Noufri Lekaj (26) er blitt en «kasteball» mellom Justisdepartementet og Utenriksdepartementet.

I snart to år har Lekaj ventet på en avgjørelse på søknaden om politisk asyl i Norge.

Noufri Lekaj ble torturert i de fem årene han satt fengslet, dømt for politisk aktivitet i militæret. I dag har Lekaj fysiske og psykiske skader som følge av torturen.

— Hvis ikke Noufri Lekaja tilfelle kvalifiserer til å bli innvilget politisk asyl, så lurer jeg på hva som i det hele tatt gjør det. Jeg synes behandlingen av hans sak er mistenkelig, og det er grunn til å lure på om det er andre forhold enn den rent juridiske vurderingen som blir lagt til grunn, sier advokat Farstadvoll.

Godt forhold

Norges spesielle og gode forhold til Jugoslavia skriver seg fra de nære vennskapsbånd som ble knyttet mellom jugoslaviske krigsfanger i Norge og nordmenn som hjalp dem under nazistenes okkupasjon. Sentrale norske politikere føler fremdeles stor sympati for Jugoslavia.

— Vi er på ville veier om vårt vennskapsforhold til Jugoslavia skal komme i veien for å gi torturofre politisk asyl, fordi det kunne komme til å støte de jugoslaviske myndighetene, sier Arild Farstadvoll.

Amnesty International kjenner godt til at Noufri Lekaj og hans kamerat Galip Chillivoda sonet strenge fengselsstraffer i Jugoslavia for politisk aktivitet. Galip Chillivoda greide å rømme fra fengselet i vår, og han har også søkt om politisk asyl i Norge. Begge de to asylsøkerne kommer fra Kosovo-provinsen i Sør-Jugoslavia.

— Vi kan ikke se at det foreligger politisk forfølgelse av albanere i Kosovo-provinsen, og vi har heller ikke fått noen indikasjoner på at det forekommer tortur, sier statssekretær Helga Hærnes i Utenriksdepartementet.

— Hvor henter UD sin informasjon om forholdene i Kosovo fra?

— Vi baserer oss på det grundige arbeidet som vår ambassade i Beograd gjør i denne saken, sier Helga Hærnes. Hun vil ikke gå inn på noen enkelttilfeller, og viser til Justisdepartementet, som tar den offisielle avgjørelsen om hvorvidt Noufri Lekaj skal få politisk asyl eller få bli i Norge på humanitært grunnlag.

— For en søker er det stor forskjell på å få politisk asyl eller bare opphold på humanitært grunnlag. En som har fått politisk asyl, har langt flere rettigheter. For Lekaj vil det bety at han kan komme i gang med studier, og få hjelp til å skaffe seg et akkelig sted å bo, sier advokat Arild Farstadvoll.

Justisdepartementet kan ikke gi noe svar på hva utfallet av Noufri Lekajs søknad om politisk asyl vil bli. Saken har de hatt til behandling i over et år, og den har gått i «skytteltrafikk» mellom Justisdepartementet og Utenriksdepartementet.

FORUNDRET: Advokat Arild Farstadvoll har mistanke om at norske myndigheter legger andre forhold enn de juridiske til grunn ved behandlingen av Noufri Lekajs asylsøknad. Foto: TROND SOLBERG

Referenca nr. 2

Gazeta "VG", e premte, 5 gusht 1988, LAJM

Viktima e torturës
TOP LOJE

Nga HARALD BERG SÆVEREID

A nuk guxon Norvegjia të vazhdojë t'u japë azil politikë azilkërkuesve nga Jugosllavia? Pyetja është relevante, thotë avokati Arild Farstadvoll, pasi shqiptaro-jugosllavi Nufri Lekaj (26) është

bërë një "top loje" në mes të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme. Lekaj ka pritur më shumë se një vit për një vendim mbi kërkesën e tij për azil politik në Norvegji.

"Nufri Lekaj është torturuar gjatë pesë vjetëve që ka qëndruar në burg i dënuar për veprimtari politike në ushtri. Qëndrimi në burg i ka shkaktuar Lekajt lëndime fizike dhe psikike si pasojë e torturës. Nëse rasti i Nufri Lekajt nuk kualifikohet për t'i dhënë azil politik, atëherë pyes veten se çka duhet ta karakterizojë një rast që të mund të kualifikohet për azil. Unë mendoj se trajtimi i rastit të Lekajt është i dyshimtë dhe ka bazë për të shtruar pyetje se mos ka faktorë të tjerë që po merren për bazë përveç vlerësimit të pastër juridik", thotë avokati Farstadvoll.

Marrëdhëniet e mira

Marrëdhëniet e veçanta dhe të mira të Norvegjisë me Jugosllavinë burojnë nga miqësia e ngushtë e ndërlidhur gjatë Luftës së Dytë Botërore në mes të burgosurve jugosllavë të luftës dhe norvegjezëve që i ndihmuan këta të burgosur gjatë pushtimit nazist. Figurat qendrore politike norvegjeze ende ndjejnë simpati të madhe për Jugosllavinë.

"Ne jemi në rrugë të gabuar në qoftë se miqësia jonë me Jugosllavinë do të na pengojë t'u japim viktimave të torturës azil politik, vetëm e vetëm se kjo mund të bjerë ndesh me autoritetet jugosllave", thotë Arild Farstadvoll.

"Amnesty Internacional është e informuar se Nufri Lekaj dhe shoku i tij Galip Zhilivoda kanë qenë të burgosur dhe të dënuar me dënime të ashpra për veprimtari politike në Jugosllavi. Galip Zhilivoda arriti të arratisej nga burgu në pranverë. Edhe ai ka kërkuar azil politik në Norvegji. Të dy këta azilkërkues vijnë nga provinca e Kosovës, e cila shtrihet në jug të Jugosllavisë. Sipas burimeve tona, nuk mund të vërejmë se ndodh persekutimi politik ndaj shqiptarëve në provincën e Kosovës dhe as nuk kemi ndonjë indikacion se ndodh përdorimi i torturës", thotë Helga Hærnes, zëvendësministre e Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Ku i merr informatat Ministria e Punëve të Jashtme për situatën në Kosovë?

Ne bazohemi në punën e përpiktë që ambasada jonë në Beograd bën në lidhje me këtë rast, thotë Helga Hærnes. Ajo nuk dëshiron t'i diskutojë më shumë rastet individuale dhe i referohet Ministrisë së Drejtësisë, e cila merr vendimin zyrtar nëse Nufri Lekajt do t'i jepet azil politik apo qëndrim në bazë humanitare.

Për një azilkërkues është dallim i madh të marrë leje qëndrimi në bazë të azilit politik ose leje qëndrimi në bazë humanitare. Një azilkërkues që merr azil politik ka të drejta shumë më të mëdha. Për Lekajn kjo do të thotë se ai mund t'i fillojë menjëherë studimet dhe të ketë një vend të duhur për banim, thotë avokati Arild Farstadvoll.

Ministria e Drejtësisë nuk mund të japë ndonjë përgjigje se cili do të jetë epilogu i çështjes së Nufri Lekajt në kërkesën e tij për azil politik. Lënda e tij është duke u shqyrtuar qe më shumë se një vit dhe ka mbetur në "trafikun e shkuarje-ardhjes" në mes të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme.

I BEFASUAR: *Avokati Arild Farstadvoll dyshon se autoritetet norvegjeze janë duke i marrë më shumë për bazë faktorët e tjerë sesa faktorin juridik për shqyrtimin e kërkesës për azil të Nufri Lekajt.*

STOLTENBERG KORRIGERER

13/8-88

Av HARALD BERG SÆVEREID og AAGE STORLØKKEN (foto)

Utenriksminister Thorvald Stoltenberg har overfor VG korrigert uttalelsene fra statssekretær Helga Hernes om forholdene i Kosovo-provinsen i Jugoslavia. — Forholdene her er meget vanskelige, og vi utelukker ikke at det kan forekomme politisk forfølgelse, sier Stoltenberg.

Thorvald Stoltenberg ønsker å presisere at UD ikke beskylder kosovo-albanerne Nufri Lekaj og Galip Zhilivoda for å fare med løgn. De ble begge fengslet og torturert og har nå søkt politisk asyl i Norge fordi de frykter for sine liv om de blir sendt tilbake til Jugoslavia.

— Men om vi ikke utelukker at politisk forfølgelse forekommer, kan ikke den norske regjering gå ut med en slik påstand uten å kunne dokumentere den. Det har vi ikke kunnet, men dermed er det ikke sagt at det ikke skjer, sier utenriksministeren.

— Gjør den norske regjeringen nok for å finne ut hva kosovo-albanere som har søkt politisk asyl i Norge er utsatt for?

God vilje

— Det skorter ikke på viljen. Vi støtter oss på opplysninger fra offisielle kanaler i Beograd og i Kosovo, på opplysninger fra folk som kjenner området godt, og på arbeidet som gjøres i de andre nordiske landene. Nettopp fordi vi ikke utelukker politisk forfølgelse, så har vi individuell behandling av søknadene om oppholdstillatelse i Norge, sier Stoltenberg.

— Det er blitt hevdet at Norges nære og spesielle forhold til Jugoslavia gjør at vi ikke tør gi politisk asyl til jugoslaver av frykt for å støte de jugoslaviske myndighetene?

Innfløkt

— Jeg innrømmer gjerne at vi har et meget spesielt forhold til dette landet og nettopp dette gode forholdet bruker vi i våre samtaler med jugoslavene. Det går an å uttrykke seg presist og direkte til venner. Forholdene i Kosovo er meget innfløkte. Der er stor fattigdom og mye politisk uro, og vi har fått oppgitt spesielle tilfeller hvor navngitte mennesker er blitt fengslet. Men hverken Norge eller noen av de andre nordiske landene har kunnet påvise dette, sier utenriksministeren.

Amnesty International rapporterer om fengsling og tortur av kosovo-albanere. Stoler ikke UD på Amnestys opplysninger?

— **Vi har stor tillit til Amnestys tall og rapporter. Det er i stor grad Amnestys arbeid vi bygger vårt materiale på.**

PRESISERER: — Selvsagt kan vi ikke utelukke at det forekommer politisk forfølgelse i Jugoslavia, men den norske regjering kan ikke påstå noe som ikke har latt seg dokumentere, sier utenriksminister Thorvald Stoltenberg.

Referenca nr. 3

Gazeta "VG", 13.08.88

STOLTENBERGU KORRIGJON

Nga HARALD BERG SÆVEREID dhe AAGE STORLØKKEN

Ministri i Jashtëm Thorvald Stoltenberg në gazetën "VG" ka korrigjuar deklaratat e zëvëndësministres së Jashtme Helga Hernes në lidhje me rrethanat në krahinën e Kosovës në Jugosllavi. Rrethanat në Kosovë janë mjaft të vështira dhe ne nuk e përjashtojmë mundësinë se ndodhin persekutimet politike, thotë Stoltenberg.

Thorvald Stoltenberg dëshiron të precizojë se Ministria e Jashtme nuk i akuzon shqiptaro-kosovarët Nufri Lekaj dhe Galip Zhilivoda se po merren me gënjeshtra. Ata që të dy kanë qenë të burgosur dhe të torturuar, tani kanë kërkuar azil politik në Norvegji dhe kanë frikë për jetën e tyre nëse dërgohen prapa në Jugosllavi. Por nëse ne nuk e përjashtojmë mundësinë se persekutimi politik ndodh në Kosovë, Qeveria norvegjeze nuk mund të dalë me një pohim të tillë pa qenë në gjendje ta dokumentojë atë. Ne nuk kemi qenë në gjendje ta dokumentojmë, por në këtë mënyrë nuk është thënë se persekutimi politik nuk ndodh, thotë ministri i Jashtëm.

PRECIZON: *Natyrisht nuk mund ta përjashtojmë mundësinë se ndodh persekutimi politik në Jugosllavi, por Qeveria norvegjeze nuk mund të pohojë për diçka që nuk është në predispozim të dokumentohet, thotë ministri i Jashtëm Thorvald Stoltenberg.*

A po angazhohet mjaftueshëm Qeveria norvegjeze për t'u informuar se ndaj çfarë rreziku janë të ekspozuar shqiptaro-kosovarët që kanë kërkuar azil politik në Norvegji?

Vullneti i mirë

Nuk ka mungesë vullneti. Ne mbështetemi në informata nga kanalet zyrtare në Beograd dhe në Kosovë, në informata nga njerëzit të cilët e njohin mirë zonën dhe në informatat në të gjitha vendet nordike. Pikërisht për arsyen se ne nuk e përjashtojmë mundësinë se ndodhin persekutimet politike, e kemi lënë të hapur mundësinë për shqyrtimet individuale të kërkesave për leje qëndrimi në Norvegji, thotë Stoltenberg.

Flitet se lidhja e afërt dhe e veçantë e Norvegjisë me Jugosllavinë ndikon që ne të mos guxojmë t'u japim azil politik jugosllavëve për shkak të frikës së përballjes me autoritetet jugosllave?

Komplikuar

Unë e pranoj me kënaqësi se ne kemi një marrëdhënie shumë të veçantë me Jugosllavinë dhe ne e përdorim pikërisht këtë marrëdhënie të mirë në bisedat tona me jugosllavët. Kështu që, është e mundur për t'u shprehur me saktësi dhe drejtpërdrejt miqve. Rrethanat në Kosovë janë shumë të komplikuara. Është varfëri e madhe me shumë rrëmujë politike dhe neve na kanë ardhur të dhëna për raste të veçanta, për persona të arrestuar me emër dhe mbiemër. Por, as Norvegjia e as ndonjë nga shtetet e tjera nordike nuk kanë mundur ta vërtetojnë këtë, thotë ministri i Jashtëm.

Amnesti Internacional raporton për burgosje dhe tortura ndaj shqiptaro-kosovarëve. A nuk i beson Ministria e Jashtme informacionit të Amnestit?

Ne kemi besim të madh në shifrat dhe raportet e Amnestit. Ne i bazojmë materialet tona në një shkallë të lartë në punën e Amnestit.

Referenca nr. 4

"POLITIKA" e Beogradit më 23.11.1987, fq. 2

Ndër të tjera, shkruan:

VEPRIMTARIA E NACIONALISTËVE SHQIPTARË NË SKANDINAVI

PRESION NGA RRUGA NË VENDËSIT

"Për dy javë tri herë janë organizuar demonstrata antijugosllave me parullën 'Kosova Republikë'".

Nga reporteri specij. i TANJUGUT

STOKHOLM

"Në pesëmbëdhjetë ditët e fundit tri herë kanë demonstruar këtu: Së pari në Oslo, pastaj në Malmo, më në fund në kryeqytetin e Suedisë. Sikur në çdo aksion të koordinuar, të gjitha këto demonstrata kishin të njëjtin karakter antijugosllav".

"Pushteti norvegjez, thotë sekretari i Ambasadës së Jugosllavisë në Norvegji, Milorad Djurovic, punoi në bazë të njohjes së mirë të Jugosllavisë dhe miqësisë së pashkëputshme në mes dy shteteve".

"Ndër ata që presin për azil ka edhe nga ata që kanë ardhur të organizuar në veri të Evropës. Kjo dëshmohet me organizimin e demonstratave në OSLO".

Përkthim nga serbokroatishtja

нистарства, незванично се објашњава жељом да се не оживе сећања на некадашње министарство пропаганде и Хитлеровог човека од поверења министра Јозефа Гебелса.

Клајн ће имати нимало лак задатак да новој влади обезбеди нови, бољи имиџ. Многи, међутим, унапред сумњају у успех ове акције већ и зато што је Клајн такође из ЦСУ, а искуства из ранија два случаја, када представник за штампу није био припадник исте странке као и канцелар, нису баш најбоља. Наравно, Клајнов (не)успех понајвише ће зависити од успешности владе, односно од резултата које ће дати Колов „нови почетак".

Аналитичари последњих неуспеха коалиције на покрајинским изборима тврде да се добар део њихових бирача окренуо крајњим екстремима – и на левици и на десници. Тако се и објашњава да је главна опозициона странка – социјалдемократи, на чијем је челу сада Ханс Јохен Фогел – тек мало профитирала од осипања коалиције.

„ДРУШТВО ДВЕ ТРЕЋИНЕ"

Зна се и које се групе становништва у последње време све више окрећу левици, односно „зеленима" – то су, најчешће, боље стојећи и боље образовани бирачи. Крајњој десници гласове су дали људи са друге стране друштвене лествице – мање образовани, они који не живе у изобиљу, као и млади. Иза оваквих анализа многи виде и социјалне проблеме.

Све чешће се, наиме, говори о „друштву две трећине", односно о једној трећини становништва коју чине незапослени, сиромашни и сви они који не уживају благодети „друштва изобиља". Трећина становништва од укупно шездесет милиона и није тако мало, па многи управо у овом податку и траже узроке пада популарности владе која је – ако се земља гледа у целини – остварила заиста импресивне економске резултате.

Да ли ће Хелмут Кол са новом владом успети да нађе решење и за многе друге проблеме – политичке, социјалне, еколошке, међународне – који све више оптерећују житеље земље сталног привредног просперитета, треће економске силе света, „земље благостања"? Очигледно је да благостање није више успешна предизборна парола, то је нешто што се већ само по себи подразумева.

Зато су вероватно у праву они који тврде да ће водећа Хришћанско-демократска унија и њен шеф Хелмут Кол морати да понуде много више нових, свежих идеја, јасан правац и визију, неоспорни ауторитет руковођења. Да ли ће Хелмут Кол, коме као највеће врлине истичу смиреност, солидност и привржености традицији, успети да врати поверење бирача?

Многи верују у Колов „нови почетак". Али, има и немало оних који опет подсећају на Харолда Макмилана. Он је, наиме, пре него што је морао да напусти место премијера, такође, извршио велику реконструкцију владе – променио је чак тринаест министара.

Но, можда оваквом историјском поређењу ипак нема места.

■ ХАРИ ШТАЈНЕР

НИН — 23. април 1989.

НОРВЕШКА

ћошак поларног круга

Албански сепаратисти уживају извесну наклоност норвешких редакција, али се последњих дана чула и друга страна

Традиција је изневерана узнемирењем из увоза. Осло није био метропола уобичајеног ускршњег спокоја дан после сагласности Скупштине Косова са Предлогом амандмана на Устав Србије и само неки дан уочи свечаности проглашења новог републичког Устава. Норвешка празнична тишина је нарушена демонстрацијама албанских сепаратиста у познатом знаку поклича и транспарената против Југославије, непосредније против Србије, најизричитије против Београда, „београдска полиција мора са Косова".

Пете демонстрације у пријатељској земљи биле су најмасовније. „Југословени албанског порекла", како себе легитимишу у поворци дугој четири стотине демонстраната прошли су главном улицом „Карл Јохан гате, и дужом Драменсвеиен, седиштем неколиких дипломатских мисија, до амбасаде СФРЈ

Каменовали су зграду, полетело је неколико ножева, гађало се и новчићима који су потврдили да је испомоћ стигла из Шведске (шведске су биле металне паре). У гомили су били рутинирани крстарећи демонстранти из Данске, Швајцарске, Аустрије. Ругајући се, фућкали су или, како извештава „Афтенпостен", „на крају су одржали концерт звиждања".

ПАРАСТОС ПОД МАСКАМА

Норвешки полицајци на лицу места морали су да траже појачање како би обуздали демонстранте, што се раније није дешавало. Подразумева се да су демонстрације организоване легално, уз формални параф власти.

Иако у маси већој него икад у норвешкој престоници, неки су се плашили својих погледа на Југославију и себе, па су били сакривених лица. Гротескна слика је имала премијеру на демонстрацијама с почетка године када је неколицина била под маскама. Маскенбалски парастос је темпиран на „годишњицу смрти тројице познатих албанских интелектуалаца које је убила југословенска полиција 17. јануара 1982. године код Штутгарта" (!), како су убеђивали пролазнике штампаним летком који су делили уз пут – као да је држава Савезна Република Немачка приватно ловиште државе СФРЈ.

Јануарске демонстрације (број 4) нису одјекнуле међу норвешким новинарима. Ускршњи случај је скренуо пажњу масовношћу и жестином. Уследили су одјеци на радију и телевизији, али који правичније сервирају косовску истину и фалсификат. Помак је вредан уочавања, јер се чула и друга страна.

ИСКРИВЉЕНА ИСТИНА: ИЛУСТРАЦИЈА УЗ ЧЛАНАК „БЕС СРБА" ОБЈАВЉЕН У ДНЕВНИКУ „ДАГБЛАДЕ" 30. МАРТА 1989.

Други програм Радија емитовао је разложну реч првог секретара амбасаде Милорада Ђуровића. Следећег дана огласио се републиком политички азилант Нуфри Лека, не слутећи да се поигравао бумерангом када је „противаргументом" јавно вређао југословенског дипломату за кога је рекао да „лаже, лаже, лаже". Испрве и спонтано реаговало је неколико гастарбајтера, Југословена југословенског порекла.

АЗИЛАНТИ

Југословени албанског порекла који се надају азилу нису малобројни, али их нема колико их је било. Не бирајући изговоре, мање је придошлих из Југославије вапило за останком у Норвешкој 1988. г. (455) него 1987 (1238), али више него 1986. г. (177). Збир белосветских азиланата 1989. у Норвешкој износи 6602. Стрепећи да не буде враћена кућама, чилеанска група притиска штрајком глађу. Норвешка је на муци, иако је смирила увоз странаца.

Југословенски азиланти су предусретљиво дочекани у редакцијама које нису презале да на целим страницама објаве свакојаке њихове изјаве: и да се албанским мајкама на Косову ваде материце како не би рађале и да се за ношење кечета иде на робију, и тако даље фалси-

43

Referenca nr. 5

Revista "NIN", Beograd, 23.04.1989, fq. 43

Norvegjia
Në fundin e rrethit polar

Separatistët shqiptarë gëzojnë një dozë përkrahje nga redaksitë norvegjeze, por është dëgjuar edhe pala tjetër

Tradita është prishur me importimin nga jashtë. Oslo nuk ishte metropol i zakonshëm ditën e vendimit nga ana e Kuvendit të Kosovës për ndryshimet kushtetuese të propozuara në amendamentet e Kushtetutës së Republikës së Serbisë. Qetësinë e përditshme e prishën demonstratat e separatistëve shqiptarë me klithmat e njohura dhe transparente kundër Jugosllavisë, drejtpërsëdrejti kundër Serbisë dhe Beogradit, "Jashtë policia e Beogradit nga Kosova".

Demonstratat e pesta në vendin mik ishin masive. "Shqiptarët nga Jugosllavia", siç prezantohen në një varg prej katërqind vetash, parakaluan rrugës kryesore të "Karl Johan gate", duke vazhduar Dramensveien, rrugë me shumë përfaqësi diplomatike deri tek Ambasada e RSFJ-së. Goditën me gurë ndërtesën, gjuajtën disa thika metalike, të cilat vërtetonin se u kishin ardhur ndihmat nga Suedia. (Metalikët ishin suedezë). Në grumbullin e tyre ishin demonstrues nga Danimarka, Zvicra, Austria, duke klithur dhe bërë zhurmë. Ashtu siç shkruan "Afteposten". Në fund mbajtën një koncert fishkëllimash.

Të mbuluar me maska

Policët norvegjezë u detyruan të kërkonin përforcime për t'i mbajtur demonstruesit. Një gjë e tillë nuk kishte ndodhur përpara. Kuptohet se demonstratat ishin organizuar në mënyrë legale me mbështetjen formale të pushtetit. Në masën aq të madhe që nuk ishte parë ndonjëherë, disa frikoheshin ta shihnin Jugosllavinë dhe kishin fshehur fytyrën. Një fotografi e njëjtë groteske është parë edhe në fillim të vitit kur, po ashtu, disa ishin me maska. Ky maskeball u bë

me rastin e "përvjetorit të vrasjes së tre intelektualëve të njohur shqiptarë më 17 janar 1982 në Shtutgard nga ana e policisë jugosllave", duke i bindur kalimtarët sikur Gjermania të ishte bërë terren gjahu privat për shtetin e RSFJ-së.

Demonstratat e janarit (numër 4) nuk kishin aq bujë tek gazetarët norvegjezë. Rasti i tanishëm i Pashkëve ka tërhequr vëmendjen me forcën dhe masivitetin. Ka vazhduar prezantimi në televizion dhe radio. Kush prezanton të vërtetën dhe falsifikimin, kësaj radhe është dëgjuar edhe pala tjetër.

Programi i dytë i radios ka emituar fjalën e arsyeshme të sekretarit të parë të ambasadës Milorad Djurovic. Menjëherë me replikën e tij paraqitet refugjati politik Nufri Leka, i cili, duke mos menduar se po luan me bumerang, i është drejtuar me "kundërargument", duke ofenduar publikisht diplomatin jugosllav me: gënjen, gënjen, gënjen. Menjëherë ndaj kësaj kanë reaguar disa qytetarë jugosllavë me përkatësi jugosllave.

Azilkërkuesit

Numri i shqiptarëve nga Jugosllavia, të cilët shpresojnë ta marrin statusin e refugjatit, nuk është i vogël. Ata të cilët kërkuan në vitin 1988 ishin 455, por më pak se në vitin 1987 (1 238), por më shumë se në vitin 1986 (177). Numri i gjithëmbarshëm i azilkërkuesve në Norvegji për vitin 1989 është 6 602. Disa nga azilkërkusit nëpërmjet gazetave dhe redaksive norvegjeze kanë akuzuar rënd autoritetet jugosllave duke falsifikuar të vërtetën.

amnesty international

INTERNATIONAL SECRETARIAT
1 Easton Street London WC1X 8DJ
United Kingdom

Our reference: MA/LS/88

Direct line:

Mr Nufri Leka
c/o Ms Berit Backer
Leirfallsgata 7
0550 OSLO 5
Norway

8 February 1988

Dear Mr Leka,

Please excuse the delay in replying to your letter. The account you give of conditions in prisons in Slovenia and your experiences there is very interesting and exactly the kind of supplement to the information provided by Borba which I was looking for. Thank you very much for having taken the time and trouble to send me this information.

Thank you also for the other information you sent, including press clippings. Although Amnesty International's (AI) information is not at all complete I must explain that AI only works on certain problems - those of political prisoners and prisoners of conscience and the death penalty. Because time is limited we are unable to collect and make use of a great deal of background information of the kind that you sent - although we are aware of these problems. I would therefore ask you only to send us the sort of information that relates directly to AI's work!

I hope that I shall one day have the opportunity to meet you and in the meantime send you my best wishes for your life in Norway.

My greetings also to Berit,

Yours sincerely,

Melanie Anderson

Melanie Anderson
Research Department

☎ 01-833 1771 Telegrams: Amnesty London WC1 Telex: 28502

Amnesty International is an independent worldwide movement working impartially for the release of all prisoners of conscience, fair and prompt trials for political prisoners and an end to torture and executions. It is funded by donations from its members and supporters throughout the world. It has formal relations with the United Nations, Unesco, the Council of Europe, the Organization of African Unity and the Organization of American States.

Referenca nr. 6

Amnesty
International
1 Easton Street London WC1X 8DJ
Mbretëria e Bashkuar

SEKRETARIATI NDËRKOMBËTAR,
referenca jonë: MA/LS/88
linja direkte:

Z. Nufri Leka
c/o Znj. Berit Backer
Leirfallsgata 7
0550 OSLO 5
Norvegji

8 shkurt 1988

I dashtuni z. Leka,

Na falni për vonesën në përgjigjen e letrës suaj. Shpjegimi juaj në lidhje me kushtet në burgun e Sllovenisë dhe përjetimi juaj aty është shumë interesant dhe pikërisht një lloj informacioni plotësues i informacionit nga Borba që unë isha duke kërkuar ta gjej. Ju faleminderit shumë për kohën që keni shpenzuar dhe për mundin që të më dërgoni këtë informacion.

Gjithashtu, ju faleminderit për informacionin tjetër që keni dërguar, përfshirë edhe artikujt e prerë nga gazetat. Megjithëse informacioni i Amnesty International (AI) nuk është aspak i kompletuar, më duhet të shpjegoj se AI punon vetëm për probleme të caktuara - ato të burgosurve politikë, të burgosurve të ndërgjegjes dhe të dënimeve me vdekje. Prandaj, për shkak të kohës së kufizuar, nuk jemi në gjendje të merremi me tërë llojin e informacionit që na keni dërguar, megjithëse jemi vetëdijësuar për këto lloj probleme. Prandaj, do t'ju kërkoj të na dërgoni llojin e informacionit që lidhet drejtpërdrejt me punën e AI.

Shpresoj se do të kam rastin t'ju takoj një ditë, ndërkaq ju dëshiroj çdo të mirë në jetën tuaj në Norvegji!

Gjithashtu, përshëndetje nga unë për Beriten!

E juaja sinqerisht,
Melanie Anderson
Departamenti i Hulumtimeve



amnesty international

with the compliments of • avec les compliments de • con atentos saludos de

3.11.1988

Many thanks for your help; I am sendng you this report from Oslobodjenje in case you later learn more about the case.

With my best wishes

Melanie Ander.

☎ 01-833 177. Telex: 28502
INTERNATIONAL SECRETARIAT 1 Easton Street London WC1X 8DJ United Kingdom

Referenca nr. 7

Amnesty
International

3.11.1988

Ju faleminderit shumë për ndihmën! Po ju dërgoj këtë raport nga Oslobogjenje, në rast se pastaj merr vesh diçka më shumë në lidhje me këtë çështje.

Ju dëshiroj çdo të mirë!

Melanie



amnesty international

with the compliments of • avec les compliments de • con atentos saludos de

15.2.1989

Dear Nufri,

Please try and find out when the trial is to take place. AI would then try and send observers.

Regards

Melanie

☎ 01-833 177 . Telex: 28502
INTERNATIONAL SECRETARIAT 1 Easton Street London WC1X 8DJ United Kingdom

Referenca nr. 8

Amnesty International

15.02.1989

I dashtuni Nufri,

Të lutem përpiqu të informohesh se kur do të mbahet gjykimi dhe AI do të përpiqet t'i dërgojë observatorët.

Të fala,
Melanie

Den Norske Helsingforskomité
The Norwegian Helsinki Committee
Member of the International Helsinki Federation for Human Rights

Oslo, January 2000

TO WHOM IT MAY CONCERN

Mr. Nufri Lekaj worked with the Norwegian Helsinki Committee in the period from 1990 to 1994, as a project-coordinator, establishing the so-called Action Norway-Albania, together with Ms. Berit Backer. In their work they succeeded in establishing a rehabilitation-center for victims of torture in Tirana, made a survey of living-standard among former political prisoners, organized humanitarian assistance, and established human rights education. The human rights education project later developed into the Albanian Human Rights Education Center in Tirana.

Mr. Nufri Lekaj was for a period responsible for the Balkan-group within the Norwegian Helsinki Committee, which established the basis for the later human rights engagement of the Committee in the Balkan area. During the period Mr. Nufri Lekaj worked for the Committee, he traveled extensively within the Balkan area, including up to 4 months every year in Albania.

In 1994 did Mr. Nufri Lekaj leave his position within the Committee to start studies at the Norwegian School of Journalism.

We strongly appreciate the work Mr. Nufri Lekaj did within the Norwegian Helsinki Committee. The work of Mr. Nufri Lekaj was always done according to the highest standards and he showed a remarkable high quality of understanding concerning the Balkan situation.

Mr. Bjørn Engesland
Secretary-General
Norwegian Helsinki Committee

Den Norske Helsingforskomite
Urtegt. 50
N-0187 OSLO

Menneskerettighetshuset
Urtegt. 50, N-0187 Oslo
Web: www.nhc.no

Tel.+47 22 57 00 70
Fax.+47 22 57 00 88
E-mail: nhc@nhc.no

Bankgiro: 5001.06.26061
Postgiro: 0807 228 1897
Org.nr.: 959 196 451

Referenca nr. 9

Komiteti Norvegjez i Helsinkit
Anëtar i Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut

Oslo, janar 2000

I DREJTOHET KUJT T'I INTERESOJË NË LIDHJE ME KËTË ÇËSHTJE

Z. Nufri Lekaj ka punuar në Komitetin Norvegjez të Helsinkit në periudhën 1990-1994 si koordinator i projektit për themelimin e të ashtuquajturit Aksioni Norvegji - Shqipëri së bashku me zonjën Berit Baker. Në punën e tyre ata patën sukses me themelimin e një qendre rehabilitimi për viktimat e torturës në Tiranë, duke bërë një hulumtim për kushtet jetësore të ish të burgosurve politikë, duke organizuar ndihmë humanitare dhe duke themeluar projektin e edukimit për të drejtat e njeriut. Më pastaj, projekti i edukimit për të drejtat e njeriut evoluoi në Qendrën Shqiptare për Edukimin e të Drejtave të Njeriut.

Z. Nufri Lekaj gjatë një periudhe ishte përgjegjës për Grupin e Ballkanit brenda Komitetit Norvegjez të Helsinkit, i cili krijoi bazën për angazhimin e mëpastajmë të Komitetit për të Drejtat e Njeriut në zonën e Ballkanit. Gjatë periudhës kur z. Nufri Lekaj punoi për Komitetin Norvegjez të Helsinkit, udhëtoi vazhdimisht në zonën e Ballkanit, duke përfshirë qëndrimin deri në katër muaj çdo vit në Shqipëri. Në vitin 1994 z. Nufri Lekaj u tërhoq nga pozita e tij në Komitet për t'i filluar studimet në Shkollën Norvegjeze të Gazetarisë.

Ne e çmojmë shumë punën e z. Nufri Lekajt në kuadër të Komitetit Norvegjez të Helsinkit. Puna e z. Nufri Lekajt u realizua gjithnjë në përputhje me standardet më të larta dhe ai tregoi një shquarje të kualitetit të lartë të kuptueshmërisë së situatës në Ballkan.

Z. Bjørn Engesland
Sekretar i përgjithshëm
Komiteti Norvegjez i Helsinkit

The British expert on the Albanians, Harry Hodgkinson, showed Berit his great respect in a letter written to her in 1987:

"It was a pleasure to meet you at Doreen and Anton Logoreci's, and a great privilege to be able to profit from your immense stock of knowledge and compassionate understanding of the Kosovars. I very much fear that we all took advantage of your kindness, and must have exhausted you by our questions and speculations. It was forbearing of you to undertake that impromptu seminar with such goodwill and kindness... When next you visit your friends in Manor House, perhaps we might arrange a luncheon party round the corner here with Anton and Doreen and Ishan Toptani…"

Because of her work for the Kosovar Albanians, Berit Backer was contacted by the International Helsinki Federation (IHF) to participate both as a consultant, interpreter and guide for the first "fact- finding mission" to Kosova in September 1989. The report published after this journey was to a great extent based on the information gathered by Berit Backer. It details the cunning methods used by the Serbian authorities against Albanian intellectuals and politicians, in the process of reducing the autonomous province of Kosova to a mere part of Serbia in March 1989. On the same occasion, Berit helped start a Helsinki Committee in Prishtina, the first human rights organisation among the Albanians which was tolerated by the Serbian authorities. For this she was later denounced in the Serbian press as a "Kosovar Albanian separatist", alongside Demaçi who was still in prison.

Berit Backer, whose name is pronounced "Berita" by Albanians, gradually received the nickname "Merita" because of the reputation and respect in which she was held by Kosovar Albanians for her profound knowledge of their people, and for her unrelenting work to inform the rest of Europe of their situation.

She also worked very actively to introduce Kosovar Albanian politicians such as Ibrahim Rugova and Shkëlzen Maliqi to Norwegian and Western European politicians, and helped politically active Kosovar Albanians in the diaspora to organize themselves. The LPK, Lëvizja Popullore e Kosovës, is one of the oldest political movements among the Kosovar Albanians, and Berit was one of the first foreigners to visit the leaders of this group in Switzerland in 1987. With her friends in Norway, Berit Backer also started an information centre for Kosovar Albanians in exile, continuously providing the media with press releases.

Because of her work in the planning and administration of ANA, Berit never managed to complete her report on living conditions among ex-political prisoners. The work was, however, concluded in 1993 after her death by Nufri Lekaj, Berit's close friend, collaborator and advisor for many years. The work at ANA terminated in 1995, and was later carried on by an Albanian information centre for human rights, active in promoting schools and the general public in Albania.

After Berit Backer's death, Adem Demaçi visited Norway, and paid a visit to her mother on several occasions. He gave his views on Berit to the present writer in 1998:

"I met her in person for the first time here in Norway... She knew the Albanians very well. She was fully occupied with matters concerning us and helped us immensely. She collected 19,000 Deutschmarks for our Human Rights Council, to be distributed to Albanians in Serbian prisons. She wrote a great deal, and gave us advice on many difficult questions... I will never forget Berit, her death was so tragic..."

Ref:

Letter from Harry Hodgkinson, London, 22 April 1987. Anton Logoreci was an Albanian in exile who wrote "The Albanians: Europe's forgotten survivors", London 1977. Ishan Toptani was another of the leading Albanians in exile in London. Quoted with permisson from Bejtullah Destani, London.

Kenneth Anderson: "Yugoslavia: Crisis in Kosovo," International Helsinki Federation and Human Rights Watch, New York 1990.

"Politika Ekspres," 7 February 1990.

The LPK later formed the UÇK, the Kosova Liberation Army, in the mid 1990s.

After being released from prison in 1991, Adem Demaçi became the president for the Council for Human Rights and Freedom in Prishtina until 1998, and in 1998-99 he was the political spokesman for UÇK, the Kosova Liberation Army.

Ann Christine Eek

Ann Christine Eek is a professional photographer from Sweden who works for the University Museum of Cultural Heritage (of which the Ethnographic Museum became part in 1999) in Oslo, Norway. She made the acquaintance of Berit Backer in Albania in 1975 while trying to make a photographic report on the country and its people. Together, they visited the Albanian village of Isniq in Kosova in 1976, making a film about women of the village. Later, they worked on other projects, including the exhibition "Albanian Traditions" in 1991. Eek is currently working on a book about Albanians.

1 2

Referenca nr. 10

Pjesë nga hyrja në librin e znj. Berit Backer, shkruar nga znj. Ann Kristin Ekk, duke iu referuar z. Kenneth Andersson, z. Harry Hodgkinson dhe të tjerëve

Studiuesi britanik i shqiptarëve, Harry Hodgkinson, në letrën e tij dërguar Berites në vitin 1987, tregoi respekt të madh ndaj saj: "Ishte kënaqësi t'ju takoj tek Doreen dhe Anton Logoreci, dhe një privilegj i madh të mund të përfitoj nga dituria juaj e madhe dhe mirëkuptimi për kosovarët. Kam drojë se ne, duke e shfrytëzuar zemërgjerësinë tënde, të kemi stërlodhur me pyetjet dhe spekulimet tona. U treguat shumë e durueshme duke ndërmarrë aty për aty e pa parapërgatitur ta realizoni seminarin, me aq dashamirësi dhe përzemërsi. Herën tjetër kur i viziton miqtë tuaj në Manor House, ndoshta kishim mundur të organizojmë një drekë të përbashkët me Antonin, Doreen dhe Ishan Toptanin".

Për shkak të angazhimit të saj për shqiptarët e Kosovës, Berit Backer u kontaktua nga Federata Ndërkombëtare e Helsinkit (FNH) që të marrë pjesë si konsultante, përkthyese dhe udhëzuese e misionit të parë faktmbledhës për në Kosovë në shtator 1989. Raporti i publikuar pas këtij udhëtimi ishte në një masë të madhe i bazuar në informatat e mbledhura nga Berit Backer dhe shpjegonte në mënyrë të detajuar përdorimin e metodave dinake të autoriteteve serbe kundër intelektualëve dhe politikanëve shqiptarë gjatë procesit të reduktimit të autonomisë së Kosovës duke e bërë Kosovën edhe më shumë pjesë të Serbisë në mars të 1989-s. Gjatë këtij udhëtimi Berita e ndihmoi edhe formimin e Komitetit të Helsinkit në Prishtinë, si organizatën e parë shqiptare për të drejtat e njeriut që u imponua të tolerohet nga autoritetet serbe. Për këtë u denoncua pastaj në shtypin serb si një "shqiptare-seperatiste" përkrah Adem Demaçit, i cili ishte ende në burg.

Berit Backer, emrin e së cilës shqiptarët e shqiptojnë Berita, gradualisht e mori pseudonimin "Merita" si rrjedhojë e reputacionit dhe respektit të shqiptarëve ndaj saj për njohuritë e saj të thella për popullin shqiptar dhe për punën e saj të pakompromis për t'i informuar shtetet perëndimore për situatën e shqiptarëve në Kosovë. Ajo u angazhua në mënyrë aktive për t'i prezantuar politikanët shqiptarë nga Kosova si Ibrahim Rugovën dhe Shkëlzen Maliqin tek politikanët norvegjezë dhe tek politikanët në shtetet perëndimore. Po ashtu, i ndihmoi shqiptarët aktivë politikisht për organizimin e tyre në diasporë.

Lëvizja Popullore e Kosovës (LPK) është një nga lëvizjet më të vjetra politike të shqiptarëve të Kosovës. Berita ishte një nga të parët nga të huajt që vizitoi liderët e këtij grupi në Zvicër në vitin 1987. Gjithashtu, me miqtë e saj në Norvegji, Berit Backer formoi një qendër informacioni për shqiptarët e Kosovës në ekzil, duke vënë vazhdimisht në qarkullim publikime për mediet.

Berita, në angazhimin e saj në planifikimin dhe administrimin e ANA-s (Aksionit Norvegji - Shqipëri), nuk arriti ta kompletojë raportin e saj për kushtet jetësore të ish të burgosurve politikë në Shqipëri. Megjithëkëtë, ky angazhim u kompletua pas vdekjes së saj në vitin 1993 nga Nufri Lekaj, mik i ngushtë Berites, bashkëpunëtor

dhe këshilltar për shumë vite. Projekti ANA përfundoi në vitin 1995, pastaj u vazhdua nga një qendër informative shqiptare për të drejtat e njeriut, duke i ndihmuar në mënyrë aktive shkollat dhe publikun e përgjithshëm në Shqipëri.

Pas vdekjes së Berit Backerit, Adem Demaçi, gjatë vizitave në Norvegji, në shenjë respekti vizitoi disa herë nënën e Berites. Ai shprehu mendimin e tij për Beriten tek autorja e këtij teksti në vitin 1998: "E takova personalisht për herë të parë këtu në Norvegji. Ajo kishte njohuri të mëdha për shqiptarët. Ishte tërësisht e preokupuar me çështjet e lidhura me ne dhe na ndihmoi së tepërmi. Ajo mblodhi 19 000 marka gjermane për Këshillin tonë për të Drejtat e Njeriut, për t'ua shpërndarë si ndihmë të burgosurve politikë shqiptarë. Ajo shkroi shumë dhe na dha këshilla për shumë çështje të vështira. Unë kurrë nuk do ta harroj Beriten. Vdekja e saj ishte shumë tragjike".

Ref:

[14] Letra nga Harry Hodgkinson, 22 prill 1987, Londër. Anton Logoreci ishte një shqiptar në ekzil dhe autor i librit: "Shqiptarët: të mbijetuarit e harruar të Evropës", Londër, 1977. Ishan Toptani ishte një nga udhëheqësit e shqiptarëve në ekzil në Londër. Cituar me leje të Bejtullah Destanit, Londër.

[15] Kenneth Anderson: "Jugosllavia: Kriza në Kosovë", Federata Ndërkombëtare e Helsinkit dhe Human Rights Watch, New York 1990.

[16] "Politika Ekspres", 7 shkurt 1990.

[17] LPK-ja gjatë viteve 1990-ta formoi UÇK-në, Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

[19] Adem Demaçi, pasi u lirua nga burgu në vitin 1991, u bë kryetar i Këshillit për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut në Prishtinë deri në vitin 1998, e në periudhën 1998-'99 ishte zëdhënës politik i UÇK-së, Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

[23] Ann Christine Eek është një fotografe profesioniste nga Suedia, e cila punon për Muzeun e Universitetit të Trashëgimisë Kulturore (pjesë e të cilit u bë edhe Muzeu Etnografik në vitin 1999) në Oslo të Norvegjisë. Ajo krijoi shoqëri me Berit Bakerin gjatë përpjekjes së tyre për të realizuar një raport fotografik për vendin dhe popullin në

Shqipëri në vitin 1975. Së bashku e vizituan fshatin shqiptar Isniq në Kosovë në vitin 1976 dhe e realizuan një film që kishte të bënte me gratë e fshatit. Më vonë, punuan me projekte të tjera, duke e përfshirë edhe ekspozitën "Traditat shqiptare" në vitin 1991. Eek tani është duke u angazhuar me një libër për shqiptarët.

Utvist av landet før klagen er behandlet

Gëzim Haçku (28) fra Kosovo-provinsen i Jugoslavia, kan når som helst bli kastet ut av Norge. Han har søkt om politisk asyl i Norge og bor på Solvang mottak i Namsos. Han fikk avslag på sin søknad, men har benyttet seg av sin klagemulighet til Justisdepartementet. Problemet er at han ikke har fått oppholdstilatelse i Norge i ventetiden. Derfor blir han utvist uten å ha fått sin klage ferdigbehandlet i Justisdepartementet.

NA - Ola Flyum

Teoretisk sett kan Haçku få medhold i sin klage til departementet, men da sitter han nede i Kosovo med få muligheter til å reise tilbake til Norge. Politiet i Jugoslavia vil konfiskere passet hans med det samme han lander. Han må også i gjennom knallharde forhør.

Haçku vil derfor ikke si så mye om hva han har gjort som kvalifiserer til politisk asyl i Norge. Hans usikre situasjon krever en svært lav profil.

Mange rømmer

Han og de andre Kosovo-albanerne i Namsos er svært ulykkelige over norsk asylpolitikk. De vil derfor informere om sin situasjon og til hjelp hadde de fått Nufri R. Lekaj fra Oslo. Han snakker svært godt norsk og er selv politisk flyktning fra Kosovo.

Han sier at i løpet av de siste 20 åra har 250 000 kosovo-albanere rømt fra Jugoslavia. Han viser også til at 98 prosent av alle søknader fra kosovo-albanere blir avslått. Lekaj mener at dette grunner i en liten forståelse for hva som faktisk skjer i Jugoslavia. Han og de andre asylsøkerne ved mottaket mener at norske myndigheter skal fordømme de bruddene på menneskerettighetene i Kosovo-provinsen. Til nå har det være en altfor slapp holdning til dette spørsmålet fra norsk side, hevder de.

De forstår at Norge ikke kan motta alle kosovo-albanere som vil inn i Norge, men krever likevel en lavere terskel på å bli godtatt som politisk asylsøker enn det som er tilfelle i dag.

Utvist mens de venter

De er også svært misfornøyd med at de ikke kan få bli i Norge mens de venter på at deres klage skal bli ferdigbehandlet i Justisdepartementet. Saksbehandlingstiden kan ta opptil seks måneder. Blir de utvist i mellomtiden, kan de heller ikke prøve å få politisk asyl i noe annet land. Det nye landet vil vise til at vedkommende asylsøker har en klage på gang i Norge og at de må avvente behandlingen av denne.

Samlebåndspreg

Hans advokat Arne Snaprud jobber mye med asylsøkere, og alle de kosovo-albanerne han har representert er utvist. Han er ikke den eneste advokaten som har slike dårlige resultater å vise til. Snaprud føler at det blir et visst rutine- og samlebåndspreg på behandlingen av slike søknader i Utlendingsdirektoratet.

I tilfelle Haçku mener Snaprud at det er de norske myndigheter som bør sørge for å få han til Norge igjen, om han skulle få medhold i sin klage.

Snaprud sier at den norske holdningen til asylsøkere er svært varierende. Det gjelder særlig dette med oppsettende virkning. Det vil si at asylsøkerne får en midlertidig oppholdstillatelse mens de venter på at deres klage til Justisdepartementet skal bli behandlet.

For tre til fire måneder siden var Jugoslavia i medias søkelys. Da fikk mange bli i landet mens de ventet på klagesaken. I dag blir de fleste sendt rett ut etter at de har fått sin søknad avslått i Utlendingsdirektoratet.

Borgerkrig på julaften?

Situasjonen i Jugoslavia er uhyre spent. Provinsen Slovenia skal lille julaften ha en folkeavstemning. Det skal stemmes over om man ønsker en stat med indre selvstyre innenfor føderasjonen Jugoslavia. Sentralregjeringen som kontrolleres av serbere, vil ikke godta en slik uavhengig stilling og har truet med militær maktovertakelse.

Kosovo-albaneren Nufri R. Lekaj har stadig kontakt med forsvarsministeren i Slovenia, Janes Janta, som han har delt fengselscelle sammen med. Janta sier at provinshæren er i høyeste beredskap.

Slovenia vil i motsetning til folk i Kosovo kjempe med våpen mot de serbiske undertrykkerne. Skjer det, vil hele Jugoslavia bli kastet ut i en blodig borgerkrig, tror Lekaj.

Selv om han ikke liker at konflikten blir redusert ned til en etnisk konflikt, innrømmer han at politiske krefter har klart å skille folket i Jugoslavia. Det er spesielt kommunistpartiet i Serbia som spiller på de etniske spenningene i landet. Omkring 90 prosent av folkene i regjeringen, politi og hæren, består av folk fra den serbiske befolkningsgruppen.

Kommmunistene har som mål et storserbia og vil samle alle serbere i ett land. I Kosovo-provinsen er det en serbisk minoritet. Dermed blir alle kosovo-albanerne undertrykt av serberne.

Lekaj sier at det meste av provinsen er i dag lammet. Kosovo-albanerne vil ikke bli styrt av sentralregjeringen i hovedstaden Beograd. De krever uavhengighet og selvbestemmelse over sin egen provins og har også laget en egen grunnlov. De ønsker imidlertid ikke å forlate føderasjonen Jugoslavia.

Dette kravet har vært uendret i mange år, men skjøt fart etter at Jugoslavias sterke mann, Josip Broz Tito, døde for ti år siden.

Etter en generalstreik i sommer, ble alle arbeiderne kastet fra arbeidsplassene sine. Unntakstilstand ble innført og de serbiske sentralmyndighetene krevde en lojalitetserklæring før arbeiderne, lærerne, legene etc., kunne få arbeidet tilbake. Til nå har de ikke fått en underskrift, hevder Lekaj. Resultatet er at det meste mangler. Folk har ikke arbeid, de får ikke skikkelig legehjelp og skolegang for å nevne noen områder.

Namdal Arbeiderblad, Desember 1990

Referenca nr. 11

Gazeta "Namdal Arbeiderblad", dhjetor 1990

Dëbohen nga shteti para se t'u shqyrtohet ankesa

NGA Ola Flyum

Gëzim Haçku (28) nga krahina e Kosovës në Jugosllavi mund të dëbohet nga Norvegjia në çdo moment. Ai ka kërkuar azil politik në Norvegji dhe jeton në kampin e azilkërkuesve Solvang, në Namsos. Haçkut i është refuzuar kërkesa për azil, por e ka përdorur të drejtën juridike për t'u ankuar dhe e ka dërguar ankesën në Ministrinë e Drejtësisë. Problemi është se nuk i është dhënë ndonjë leje qëndrimi për periudhën derisa t'i shqyrtohet ankesa në Ministrinë e Drejtësisë. Prandaj do të dëbohet nga Norvegjia pa iu shqyrtuar përfundimisht ankesa në Ministrinë e Drejtësisë.

Teorikisht Haçkut mund t'i aprovohet ankesa në ministri, por ai do të gjendet në këtë periudhë në Kosovë me mundësi të vogla për t'u kthyer në Norvegji. Policia në Jugosllavi do t'ia konfiskojë pasaportën sapo të mbërrijë në Kosovë. Ai duhet t'i nënshtrohet një procesi të vështirë hetues për marrje në pyetje. Prandaj Haçku nuk dëshiron të tregojë më shumë për arsyen që e kualifikon për azil politik në Norvegji. Kjo situatë e pasigurt e detyron të mbajë një profil shumë të ulët.

Haçku dhe shqiptarët e tjerë të Kosovës në Namsos janë shumë të pafat në raport me politikën norvegjeze të azilit. Për këtë arsye dëshirojnë të informojnë për situatën e tyre dhe për ndihmën që kanë marrë nga Nufri R. Lekaj nga Oslo. Lekaj e flet tejet mirë gjuhën norvegjeze dhe është i arratisur politik nga Kosova. Ai thotë se gjatë 20 vjetëve të fundit, 250 000 shqiptaro-kosovarë janë arratisur nga Jugosllavia. Ai gjithashtu vë në dukje se 98 për qind e të gjitha kërkesave të shqiptarëve të Kosovës për azil refuzohen. Lekaj mendon se kjo ndodh për arsye se ekziston një kuptueshmëri shumë e vogël për atë që faktikisht ndodh në Jugosllavi. Lekaj dhe azilkërkuesit apelojnë tek autoritetet norvegjeze t'i dënojnë shkeljet e të drejtave të njeriut në Kosovë. Sipas tyre, deri më tani autoritetet norvegjeze nuk kanë bërë shumë në këtë drejtim. Azilkërkuesit shqiptarë e kuptojnë

se Norvegjia nuk mund t'i pranojë të gjithë shqiptarët që hyjnë në Norvegji, por kërkojnë një kriter më të ulët për t'u pranuar si azilkërkues politikë krahasuar me këtë kriter që është sot.

Azilkërkuesit shqiptarë janë gjithashtu shumë të pakënaqur që nuk mund të qëndrojnë në Norvegji gjatë periudhës së pritjes derisa ankesat e tyre të shqyrtohen përfundimisht nga Ministria e Drejtësisë. Kohëzgjatja e shqyrtimit të ankesave mund të zgjasë deri në gjashtë muaj. Në rast dëbimi nga shteti norvegjez nuk e kanë mundësinë të përpiqen të kërkojnë azil politik në ndonjë shtet tjetër, sepse një shtet tjetër do t'i referohet parimit juridik, që do të thotë se azilkërkuesi që e ka ende ankesën për azil në shqyrtim në një shtet tjetër duhet të presë derisa t'i shqyrtohet ankesa për azil.

Avokati Arne Snaprud është shumë i angazhuar me azilkërkuesit. Të gjithë shqiptarët që ai i reprezanton janë dëbuar nga shteti dhe nuk është avokati i vetëm që ka rezultate negative për të treguar. Snaprud e ka përshtypjen se në Drejtorinë e Emigracionit është formësuar një lloj rutine që po ndikon tek shqyrtuesit gjatë shqyrtimit të kërkesave për azil. Për rastin e Haçkut, Snaprud mendon se autoritetet norvegjeze do të duhej të kujdesen që ta sjellin prapë në Norvegji po qe se i aprovohet ankesa.

Snaprud thotë se qëndrimi norvegjez ndaj azilkërkuesve varion shumë. Kjo vlen në veçanti në lidhje me efektin pezullues. Kjo nënkupton se azilkërkuesve t'u jepet leja e përkohshme e qëndrimit, derisa presin që ankesa e tyre në Ministrinë e Drejtësisë të shqyrtohet. Para tre-katër muajsh Jugosllavia ka qenë në qendër të vëmendjes në media, e gjatë kësaj periudhe shumë azilkërkuesve iu lejua të qëndrojnë në Norvegji derisa t'u shqyrtohet ankesa, ndërsa tani shumica dëbohen nga shteti pasi u refuzohet kërkesa për azil nga Drejtoria e Emigracionit.

Luftë civile në prag të Krishtlindjeve?

Situata në Jugosllavi është shumë e tendosur. Sllovenia do të mbajë një referendum në prag të krishtlindjeve. Do të hidhet në votim dëshira për një shtet slloven me vetëvendosje të brendshme në kuadër

të Jugosllavisë. Qeveria qendrore jugosllave, e kontrolluar nga serbët, nuk do të pranojë një status të tillë të pavarësisë për Sllovenínë dhe e ka kërcënuar me pushtim ushtarak.

Shqiptari i Kosovës, Nufri R. Lekaj, ka kontakte me ministrin e Mbrojtjes së Sllovenisë, Janes Jansa, me të cilin njihet që nga koha e qëndrimit në burg. Ushtria në Slloveni është në gatishmëri të lartë. Sllovenia, për dallim të Kosovës, do t'u bëjë rezistencë të armatosur agresorëve serbë. Nëse kjo ndodh, e tërë Jugosllavia do të zhytet në një luftë të përgjakshme civile, thotë Lekaj. Edhe pse Lekajt nuk i pëlqen që konflikti po reduktohet vetëm në një konflikt etnik, ai pranon se forcat politike kanë arritur t'i ndajnë popujt në Jugosllavi në baza etnike. Në veçanti, Partia Komuniste e Serbisë është duke i përdorur tensionet etnike në vend. Rreth 90 për qind të njerëzve në Qeveri, polici dhe ushtri janë me përkatësi etnike serbe. Komunistët serbë synojnë një Serbi të madhe, që përfshin të gjithë serbët në një shtet. Në provincën e Kosovës është një minoritet serb. Prandaj shqiptarët në Kosovë shtypen nga regjimi serb. Lekaj thotë se shumica e provincës është e bllokuar.

Shqiptarët e Kosovës nuk dëshirojnë të qeverisen nga pushteti qendror në Beograd. Ata kërkojnë pavarësinë dhe vetëvendosjen për Kosovën, gjithashtu kanë hartuar kushtetutën e vet. Shqiptarët e Kosovës gjatë shumë viteve e kanë kërkuar republikën në kuadër të Jugosllavisë, e kjo kërkesë është përshpejtuar pasi Josip Broz Tito vdiq dhjetë vjet më parë. Pas një greve të përgjithshme në verë, të gjithë punëtorët u përjashtuan nga vendet e tyre të punës. U shpall gjendja e jashtëzakonshme dhe qeveria qendrore serbe lansoi kërkesën e nënshkrimit të një deklarate-lojaliteti nga punëtorët, mësuesit, mjekët etj., si kusht që të mund të kthehen prapë në vendet e punës. Deri më tani nuk kanë marrë nënshkrime të tilla, thotë Lekaj. Rezultati është se gjendja është e mjerueshme. Njerëzit janë të papunë dhe, përveç të tjerash, nuk kanë qasje dhe trajtim të duhur mjekësor dhe arsimor.



Referenca nr. 12

Raporti për Ministrinë e Pushtetit Lokal

Titulli: “A e kanë kuptuar të gjithë?”: në lidhje me informimin dhe komunikimin në kampet e azilkërkuesve 1990

Autorët: Berit Backer, Berit Berge, Hussain Gulaid, Nufri Lekaj, Shahin Rahimzadeh

Drejtoria e Emigracionit, Botimi (2)

Vendi: Baza e Bibliotekës

Publikuar në: [Oslo]

Botues: [Drejtoria e Emigracionit]

Raport për Ministrinë e Pushtetit Lokal.

P. s. Informacioni për këtë raport mund të gjendet edhe nëpërmes këtij linku:

https://ask.bibsys.no/ask2//html/?sourcetag=biblio&cql=cql.serverChoice%20all%20'nufri%20lekaj

11/09/1990 21:27 FROM DUKAGJIN GORANI'S FAX TO 93472570888 P.02

people to people
PRAGUE '90 19 20 OCTOBRE 21

ASAMBLEJA QYTETARE E HELSINKIT — PRAGË 1990

INSTITUCION I LIRISË

SHKËLZEN MALIQI

Muajin që shkoi, prej 18 deri më 21, në Pragë u mbajt mbledhja themeluese e Asamblesë Qytetare të Helsinkit (Helsinki Citizens' Assambly) me më shumë se 700 pjesëmarrës nga të gjitha vendet e Evropës, pos Shqipërisë. Asambleja u konvokua në mbështetje të iniciativës të një grupi ish-disidentësh të Evropës Lindore, të disa intelektualëve të angazhuar në lëvizjet shoqërore dhe të organizatave që merren me mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të qytetarëve dhe të pakicave të të gjitha llojeve (pakicat kombëtare dhe gjinore, emigrantët dhe azilantët, të handikepuarit, homoseksualët etj.), të cilët në pranverë të këtij viti e shpallën Apelin e Pragës 1990 të Qytetarëve të Helsinkit. Porosia kryesore e këtij Apeli ka qenë se procesi i Helsinkit, gjegjësisht i sigurisë dhe i bashkëpunimit në Evropë, është tejet i rëndësishëm që të lihet vetëm në duart e qeverive dhe të politikanëve, të cilët në veprimet dhe vendosjet e tyre janë të kufizuar nga obligimet dhe prioritetet nacionale. Asambleja u paraqitë si një forum i përkrehëm dhe publik i grupeve për paqe dhe i shoqërive civile, si dhe i individëve dhe instucioneve që reprezentojnë mendimet dhe inicitativat e ndryshme qytetare. Në projektin e konvokuesve të Asamblesë ihuhej se kapacitetet i ndasive në Evropë dhe integrimi i saj nuk është vetëm obligim i qeverive, por i të gjithëve, sidomos shoqërisë civile (civil society), i qytetarëve që bashkëveprojnë në shoqata, lëvizje, institucione. Inicitiva dhe klubet të vetorganizuara që synojnë kapërcimin e kufijve nacionalë, formimin e raportove të reja shoqërore dhe të forumeve për dialog dhe negociata me qeveri të dhe të tjerët, duke përdorur edhe e presionet ndaj institucioneve politike që të zgjidhen çështjet jetike me vetiniciativë dhe pa përzierje direkte të pushtetit, dhe, më në fund, që të angazhohen për zhvillimin e sferës së aktiviteteve publike (d.m.th. joshtetërore dhe joprivate) dhe të opinionit publik evropian.

Vaclav Haveli, njëri nga inicitorët e këtij forumi dhe sponzori kryesor politik i tij, në bajtjen e seancës së parë plenare u deklarua për krijimin e strukturave të reja panevropiane, duke i dalur në krah ideve të «shtëpisë evropiane», për të cilën flet Gorbaçovi, apo konfederatës së Miterranit, pra të një Evrope të re që do të jetë «çuak e pagës».

Organizatë qeveritare apo qytetare?

Nisma e Asamblesë, megjithatë, nuk ishte aspak e mbarë. Madje para se ajo të konstituohej si duhet dhe para se t'i bëjë hapat e parë, vetë, anëtarët e Këshillit organizativ kishin mosmarrëveshje konceptuale se çfarë duhet të jetë ky forum i qytetarëve të Evropës. Jaroullav Shabata, dhidenti i njohur çek, duke vlerësuar ndryshimet në Evropën Lindore, doli me konstatimin se këtu shoqëria civile të ka ardhur në pushtet dhe se është arritur demokracia. Ndaj këtij pohimi reagoi adhpër Tomash Mastnak nga Sllovenia, duke thënë se shoqëria civile nuk është shaka dhe se ajo nuk mund të identifikohet me shoqërinë ekzistuese, e aq më pak me pushtetet e reja parlamentare të Lindjes. Me rëndësi e një sistemi totalitar dhe zgjedhje të lira nuk janë bërë ndryshime radikale, dhe tashtë gjithkund po paraqiten shenjat e qarta të vendosjes së totalitarizmit të ri nacional (nacionalizmat vendosjnë Evropën Lindore). Thënë ndryshe, këtu janë bërë vetëm lapat e parë drejt demokracisë së njëmendtë. Po edhe akar pushteti i ri të ishte krejtësisht demokratik, duhet dalluar pushtetin nga shoqëria civile - konkludoi Mastanku. Shabota për paraqitjen e këtij të tha se është ultrarradikale dhe se me të mohohet legjitimiteti i zgjedhjeve që thyen sistemin njëpartiak dhe inaugurun demokracinë parlamentare. Mos, kështu, Mastnaku e mohon edhe vullnetin e shprehur lirisht të qytetarëve në Evropën Lindore?

Prapavija e këtij konflikti kishte të bëjë me dilemat rreth strukturës organizative të AQSH, se a do të përbëhet ajo Asamble vetëm nga përfaqësuesit joqeveritarë dhe jopolitikë (që kuptimin e ngushtë të fjalës) apo, edhe nga përfaqësuesit e partive politike, madje edhe të qeyre që janë në pushtet. Konkretisht dilema shtrohej rreth disidentëve të dikurshëm që tani kanë ardhur në pushtet? A duhet përjashtuar ata nga ky forum i qytetarëve? Mos vallë ata taabil po reprezentojnë idealet të ndryshme dhe të kundërta nga ato kur kanë qenë të nëjëkur dhe kur ishin në rradhët e para të luftës për të drejtat e njeriut dhe shoqërinë civile?

Analitikët më të thellë në ten denotin për futjen e strukturave legale të qeverive në këtë Asamble Qytetare identifikuan tendencën e shndërrimit të kësaj inicitive në një institucion të parë të integrimit shtetëror gjithevropian, gjegjësisht ambicien e Havelit dhe të Shabotës që Praga të marrë primatin nga Helsinki dhe sidomos Strasburgu, duke e shndërruar gradualisht Asamblenë Qytetare në Parlamentin e Konfederatës apo Federatës Evropiane e Pragën në kryeqytet të Evropës.

Megjithatë, kjo polemikë përfundoi me fitoren e vijës së Mastnakut, sepse në këtë tubim kishte pak qeveritarë: AQSH-ja mbeti organizatë e asociacioneve të ndryshme joqeveritare të qytetarëve, si forum i përkrehëm me seli në Pragë që do të siguronte më shtetësi e sigurtësi dhe të pajtonte Evropë, të çarmatimit dhe demilitarizimit, të drejtave të njeriut dhe përfshirë këtu edhe të drejtat e pakicave kombëtare, të zhvillimit ekonomikë dhe problemeve të rinajtjes se ambientit të jetës, të zgjidhjes së konflikteve të ndryshme shoqërore e nacionale (nacionalizmi e të tjera), të shoqërisë civile dhe të institucionalizimit të procesove të integrimit të Evropës, të pozitës së femrës, të shtresimit social, të emigrantëve etj.

Endrrat dhe ëndrrallat e Evropës

«Endrrat janë pjesa esenciale e realitetit» thotë Haveli. Çfarë është realitet i Evropës dhe çfarë është ëndrra mbi të? Nga fjalët e shumë diskutuesve si në mbledhjet plenare, ashtu edhe në ato të komisioneve dhe nënkomisioneve të shumta, del se ky realitet, megjithatë është më i bollshur se sa dukej dhe se ëndrrat mbi Evropën ndjeheshin me fuqërallë të shumta. Në Asamblenë e Pragës u qanë pothuajse të gjitha hallet dhe problemet që politika syrtare nuk i shoh apo i minimizon dhe i zbukuron me shifra mashtruese të nënatarave statistikore e që në jetën e përditshme krijojnë até tablo të zymtë të fatalitetit të shtresave shoqërore të margjinalizuara. Msue edhe nuk ka mundur të gjendet vend më i përshtatshëm për t'u ambientuar në até njëkohësi të madhështisë dhe të zymtësisë së Evropës, që është Praga sot me bukurinë e papërfukrarshme të godinave, të kishave, të pallateve dhe të uravе të saja të vjetra dhe me zhvarrësinë e varfërisë e jetës se njerëzve që jetojnë këtu dhe që sillen si fantazma të pashpirta, të ngrysur, me fytyra robotike që të lënë përshtypjen e korbisë dhe të anemiaë së përgjithshme. Socialitmi dhe pushtimi gjakpirës 45-vjeçar sovjetik Pragën vërtet e shndërroi në atë kështjellë të ankthit nga ëndrrat e këqia letrare të Franc Kafkës, qytetar i këtij vendi përvallor, ku bukuria e zezdeve duket aq e lëmtarshme.

Veçë cekët dhe sllovakët ankohenhin: ajë vlu pas revolucionin këtu asgjë esencialisht nuk ka ndryshuar. Po kështu ankohenhin lituanezët, ukrainasit, rumunët, hungarezët, por edhe ueisët, basket, irlandezët nga Alsteri... Se edhe Evropa Perëndimore nuk është parajsë e demokracisë fugishëm dëshmoi paktimaeeja . Roshtën Dhujtjiboi, gazetare dhe regjisore e filmit, duke folur për dekolonizimin e pabarazinë dhe katastrofën psikologjike të qyteteve industriale në Evropë, të getove të zezakëve, të arabëve, të indusëve é të refugjatëve, emigrantëve ekonomikë dhe aftësitëve politikë të ndryshëm që asteni nuk mund të integrohen në Evropën dhe asteni nuk mundë të bëhen evropianë deri sa dominon mentaliteti racist eurocentrik sipas të cilit këta arrdhencakë përgjithmonë mbesin «të huaj».

Kosova, Irlanda veriore, Transilvania

Më 20 tetor në mbrëmje u mbajt një tribunë e veçantë çështnae problemeve të Kosovë, Irlandës Veriore dhe Transilvanisë, ku morën pjesë, ndër të tjerët, shkrimtarja e re Nerimane Kamberi dhe autori i këtij shënimi. Nerimanja prezentoi gjendjen aktuale në Kosovë (shih tekstin në korniţë), e dëgjuesit kërkuan sqarim dhe pozitën rreth rezistencës së padhunshme: si është e mundur një rezistencë e tillë në kushtet e represionit aq të ashpër, dhe a është kjo një gjë e rastit apo e programuar? Qytetarët e Evropës, aktivistët e lëvizjeve paqëruese, shprehnin një admirim të thellë ndaj rezistencës së tillë shqiptare. Kjo trilumë e mbrëmjen, nikur edhe e gjithë puna e Asamblesë, bëri vetën një inventurë të problemeve dhe përvakësi; format e para organizative, dhe kornizat e para të drejtimeve të zhvillimit të punës së këtij forumi të parë të lirë të gjithevropian, që u quajt edhe institucion i lirisë, sepse, siç u tha jo një herë, edhe liria kërkon institucione e vete.

Takuam në këtë tubim edhe një shqiptar të arratisur nga Kosova, Nuftí Jakaju, azilant në Norvegji, ish i burgosur politik dhe ish – anëtar i Lëvizjes marksiste – leniniste, intelektual brilant dhe aktivist i Federatës së Helsinkit për të drejtat e njeriut, i cili po ashtu, duke shkruar gjithë atë kornë të reprezentëve të margjinalëve të Evropës, vërtetoi fatlët e pakitanezës. Roshan Dhujtjiboi dhe ua tha të gjithë neodim të holit të cilin duhet mbajtur mend: «Çjithë kjo nafori mbi Evropen e bashkuar në të integruar më duket si një utopi e re që po e pë vendin e ëndrrës së socializmit nga e cila meri dolëm të gjithë! Mos të mashtrohemi edhe nga kjo ëndërr sidomos ne shqiptarët!»

Po e përfundoj këtë shkrim me një grafit nga një murë i qytetit të vjetër Hradgani, që shpreh po aspektu shqetësime të ngjashme dhe fryméz e përgjithshme të kohës dhe ambientit ku u mbajt Asamblea Qytetare: «Porsaçe u se byt porazeny?» (Të ngjëndhënjesh e të mos jesh i ngadhënjyer?).

A është e mundur, pra, të ngadhënjejë Evropa e të mos jenë të ngadhënjyer qytetarët e saj?

42

KOHA
1 NËNTOR
1990

Referenca nr. 13

"Koha", nëntor 1990

ASAMBLEJA QYTETARE E HELSINKIT, PRAGË 1990

INSTITUCION I LIRISË

SHKËLZEN MALIQI

Muajin që shkoi, prej 18 deri më 21, në Pragë u mbajt mbledhja themeluese e Asamblesë Qytetare të Helsinkit (Helsinki Citizens Assambly) me më shumë se 700 pjesëmarrës nga të gjitha vendet e Evropës, pos Shqipërisë. Asambleja u konvokua në mbështetje të iniciativës të një grupi ish-disidentësh të Evropës Lindore, të disa intelektualëve të angazhuar në lëvizjet shoqërore dhe të organizatave që merren me mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të qytetarëve dhe të pakicave të të gjitha llojeve (pakicat kombëtare dhe gjinore,

emigrantët dhe azilantët, të hendikepuarit, homoseksualët etj.), të cilët në pranverë të këtij viti shpallën Apelin e Pragës 1990 të Qytetarëve të Helsinkit. Porosia kryesore e këtij Apeli ka qenë se procesi i Helsinkit, gjegjësisht i sigurisë dhe i bashkëpunimit në Evropë, është tejet i rëndësishëm të lihet vetëm në duart e qeverive dhe të politikanëve, të cilët në veprimet dhe vendosjet e tyre janë të kufizuar nga obligimet dhe prioritetet nacionale.

Asambleja është paramenduar si një forum i përhershëm dhe publik i grupeve për paqe dhe i shoqërive civile, si dhe i individëve dhe institucioneve që reprezantojnë mendimet dhe iniciativat e ndryshme qytetare. Në projektin e konvokuesve të asamblesë thuhej se kapërcimi i ndasive në Evropë dhe integrimi i saj nuk është vetëm obligim i qeverive, por i të gjithëve, sidomos shoqërisë civile (civil society), i qytetarëve që bashkëveprojnë në shoqata, lëvizje, institucione, iniciativa dhe klube të vetorganizuara që synojnë kapërcimin e kufijve nacionalë, formimin e raporteve të reja shoqërore dhe të forumeve për dialog dhe negociata me Qeverinë dhe të tjerët, duke përdorur edhe presionet ndaj institucioneve politike që të zgjidhen çështjet jetike me vetiniciativë dhe pa përzierje direkte të pushtetit dhe, më në fund, të angazhohen për zhvillimin e sferës së aktiviteteve publike (dmth. joshtetërore dhe joprivate) dhe të opinionit publik evropian.

Vaclav Haveli, një nga iniciatorët e këtij forumi dhe sponsori kryesor politik i tij, në hapjen e seancës së parë plenare u deklarua për krijimin e strukturave të reja panevropiane, duke u dalë në krah ideve të "shtëpisë evropiane", për të cilën flet Gorbaçovi, apo konfederatës së Miteranit, pra të një Evrope të re që do të jetë "oazë e paqes".

Organizatë qeveritare apo qytetare?

Nisma e Asamblesë nuk ishte aspak e mbarë. Madje para se ajo të konstituohej si duhet dhe para se t'i bëjë hapat e parë, vetë anëtarët e Këshillit Organizativ kishin mosmarrëveshje konceptuale se ç'farë duhet të jetë ky forum i qytetarëve të Evropës.

Jarosllav Shabata, disidenti i njohur çek, duke i vlerësuar ndryshimet në Evropën Lindore, doli me konstatimin se këtu shoqëria

civile ka ardhur në pushtet dhe se është arritur demokracia. Ndaj këtij pohimi reagoi ashpër Tomazh Mastnak nga Sllovenia, duke thënë se shoqëria civile nuk është shaka dhe se ajo nuk mund të identifikohet me shoqërinë ekzistuese, aq më pak me pushtetet e reja parlamentare të Lindjes. Me rënien e një sistemi totalitar dhe zgjedhje të lira nuk janë bërë ndryshime radikale, e tash gjithkund po paraqiten shenjat e qarta të vendosjes së totalitarizmit të ri nacional (nacionalizmat sundojnë Evropën lindore). Thënë ndryshe, këtu janë bërë vetëm hapat e parë drejt demokracisë së njëmendtë. Po edhe sikur pushteti i ri të ishte krejtësisht demokratik, duhet dalluar pushtetin nga shoqëria civile - konkludoi Mastanaku.

Shabota për paraqitjen e këtillë tha se është ultraradikale dhe se me të mohohet legjitimiteti i zgjedhjeve që thyen sistemin njëpartiak dhe inauguruan demokracinë parlamentare.

Mos, kështu, Mastnaku e mohon edhe vullnetin e shprehur lirisht të qytetarëve në Evropën Lindore?

Prapavija e këtij konflikti kishte të bëjë me dilemat rreth strukturës organizative të AQSH-së, se a do të përbëhet kjo asamble vetëm nga përfaqësuesit joqeveritarë dhe jopolitikë (në kuptimin e ngushtë të fjalës) apo edhe nga përfaqësuesit e partive politike, madje edhe të atyre që janë në pushtet. Konkretisht dilema shtrohej rreth disidentëve të dikurshëm që tani kanë ardhur në pushtet. A duhet përjashtuar ata nga ky forum i qytetarëve? Mos vallë ata tashti po reprezantuakan ideale të ndryshme dhe të kundërta nga ato kur kanë qenë të ndjekur dhe kur ishin në radhët e para të luftës për të drejtat e njeriut dhe shoqërinë civile?

Analitikët më të thellë në tendencën për futjen e strukturave legale të qeverive në këtë asamble qytetare identifikuan tendencën e shndërrimit të kësaj iniciative në një institucion të parë të integrimit shtetëror gjithevropian, gjegjësisht ambiciet e Havelit dhe Shabotës që Praga ta marrë primatin nga Helsinki, sidomos Strasburgun, duke e shndërruar gradualisht Asamblenë Qytetare në Parlamentin e Konfederatës apo Federatës Evropiane e Pragën në kryeqytet të Evropës. Megjithatë, kjo polemikë përfundoi me fitoren e vijës së Mastnakut, sepse në këtë tubim kishte pak qeveritarë: AQSH-ja mbeti organizatë e asociacioneve të ndryshme joqeveritare të qytetarëve, si

forum i përhershëm me seli në Pragë që do të merret me çështjet e sigurisë dhe të paqes në Evropë, të çarmatimit dhe demilitarizimit, të drejtave të njeriut, përfshirë këtu edhe të drejtat e pakicave kombëtare, të zhvillimit ekonomik dhe problemeve të ruajtjes së ambientit të jetës, të zgjidhjes së konflikteve të ndryshme shoqërore e nacionale (nacionalizmat e të tjera), të shoqërisë civile dhe të institucionalizimit të proceseve të integrimit të Evropës, të pozitës së femrës, të shtresimit social, të emigrantëve etj.

Ëndrrat dhe andrallat e Evropës

"Ëndrrat janë pjesë esenciale e realitetit", - thotë Haveli. Çfarë është realiteti i Evropës dhe çfarë është ëndrra mbi të? Nga fjalët e shumë diskutuesve si në mbledhjet plenare, ashtu edhe në ato të komisioneve dhe nënkomisioneve të shumta, del se ky realitet është më i hidhur sesa duket dhe se ëndrrat mbi Evropën ndeshen me andralla të shumta. Në Asamblenë e Pragës u qanë pothuajse të gjitha hallet dhe problemet që politika zyrtare nuk i sheh apo i minimizon dhe i zbukuron me shifra mashtruese të mesatareve statistikore e që në jetën e përditshme krijojnë atë tablo të zymtë të fatalitetit të shtresave shoqërore të margjinalizuara. Mbase edhe nuk ka mundur të gjendet vend më i përshtatshëm për t'u ambientuar në atë njëkohësi të madhështisë dhe të zymtësisë së Evropës, siç është Praga sot me bukurinë e papërshkrueshme të godinave, të kishave, të pallateve dhe të urave të saj të vjetra dhe me zbrazëtinë e varfërinë e jetës së njerëzve që jetojnë këtu dhe që sillen si fantazma të pashpirta, të ngrysura, me lëvizje robotike që ta lënë përshtypjen e kotësisë dhe të anemisë së përgjithshme. Socializmi dhe pushtimi gjakpirës 45-vjeçar sovjetik Pragën vërtet e shndërroi në atë kështjellë të ankthit nga ëndrrat e këqija letrare të Franc Kafkës, qytetar i këtij vendi përrallor, ku bukuria e sendeve duket aq e llahtarshme.

Vetë çekët dhe sllovakët ankoheshin: një vit pas revolucionit këtu asgjë esencialisht nuk ka ndryshuar. Po kështu ankoheshin lituanezët, ukrainasit, rumunët, hungarezët, por edhe uelsët, baskët, irlandezët nga Alsteri.

Se edhe Evropa perëndimore nuk është parajsë e demokracisë fuqishëm dëshmoi pakistanezja Roshan Dhunjiboi, gazetare dhe

regjisore e filmit, duke folur për dekolonizmin e papërfunduar dhe katastrofën psikologjike të qyteteve industriale në Evropë, të getove të zezakëve, të arabëve, të hindusëve e të refugjatëve, emigrantëve ekonomikë dhe azilantëve politikë të ndryshëm që assesi nuk mund të integrohen në Evropë dhe assesi nuk mund të bëhen evropianë derisa dominon mentaliteti racist europocentrik, sipas të cilit, këta ardhacakë përgjithmonë mbesin "të huaj".

Kosova, Irlanda veriore, Transilvania

Më 20 tetor në mbrëmje u mbajt një tribunë e veçantë kushtuar problemeve të Kosovës, Irlandës veriore dhe Transilvanisë, ku morën pjesë, ndër të tjerë, shkrimtarja e re Nerimane Kamberi dhe autori i këtij shënimi. Nerimanja prezantoi gjendjen aktuale në Kosovë (shih tekstin në kornizë), e dëgjuesit kërkuan sqarim dhe plotësim rreth rezistencës së padhunshme: si është e mundur një rezistencë e tillë në kushtet e represionit aq të ashpër, dhe a është kjo një gjë e rastit apo e programuar?

Qytetarët e Evropës, aktivistët e lëvizjes paqësore, shprehnin një admirim të thellë ndaj rezistencës së tillë shqiptare. Kjo tribunë e mbrëmjes, sikur edhe e gjithë puna e Asamblesë, bëri vetëm një inventurë të problemeve dhe përcaktoi format e para organizative dhe kornizat e para të drejtimeve të zhvillimit të punës së këtij forumi të parë të lirë gjithevropian, që u quajt edhe institucion i lirisë sepse, siç u tha jo një herë, edhe liria kërkon institucionet e veta.

Takuam në këtë tubim edhe një shqiptar të arratisur nga Kosova, Nufri Lekajn, azilant në Norvegji, ish i burgosur politik dhe ish-anëtar i lëvizjes marksiste-leniniste, intelektual brilant dhe aktivist i Federatës së Helsinkit për të drejtat e njeriut, i cili, po ashtu, duke shikuar gjithë atë turmë të reprezentëve të margjinalëve të Evropës, vërtetoi fjalët e pakistanezes, Roshan Dhunjiboi, dhe na tha një mendim të hollë të cilin duhet mbajtur mend: "Gjithë kjo eufori mbi Evropën e bashkuar dhe të integruar më duket si një utopi e re që po e zë vendin e ëndrrës së socializmit nga e cila mezi dolëm të gjithë! Mos të mashtrohemi edhe nga kjo ëndërr, sidomos ne shqiptarët".

Po e përfundoj këtë shkrim me një grafit nga një mur i qytetit të vjetër Hradçani, që shpreh shqetësime të ngjashme, edhe frymën e

përgjithshme të kohës dhe ambientit ku u mbajt Asambleja Qytetare: "Porazyt a ne byt porazeny" (Të ngadhënjesh e të mos jesh i ngadhënjyer).

A është e mundur, pra, të ngadhënjejë Evropa e të mos jenë të ngadhënjyer qytetarët e saj?

Referenca nr. 14

Sekretariati i Kabinetit të N. T. Mbretit

Pallati Mbretëror, Oslo

Shkurt 1991

Bashkësia Shqiptare në Norvegji
v/Nufri Lekaj
Enerhauggaten 3
0651 OSLO 6



H. M. Kongens Kabinettssekretariat

Det Kgl. Slott, Oslo

Februar 1991

Albansk Riksforbund i Norge
v/Nufri Lekaj
Enerhauggaten 3
0651 OSLO 6

DD.MM. Kongen og Dronningen har gitt meg i oppdrag å takke for vennlig deltakelse og oppmerksomhet ved H.M. Kong Olavs bortgang.

Vennlig hilsen

Carl-Erik Grimstad

Naltmadhëritë e Tyre, Mbreti dhe Mbretëresha,

Më kanë dhënë për detyrë t'ju falënderoj për pjesëmarrjen dhe vëmendjen miqësore gjatë varrimit të Naltmadhërisë së Tij, Mbretit Olav.

Të fala të përzemërta,
Carl - Erik Grimstad

Referenca nr. 15

"Shkëndija", prill 1991
ENKAS PËR "SHKËNDIJEN"

NORVEGJIA FILLON TË REAGOJË

4 Shkëndija PRILL 1991

ENKAS PËR «SHKËNDIJËN»

NORVEGJIA FILLON TË REAGOJË

Populli shqiptar në Jugosllavi publikisht dhe juridikisht bëri deklarimin e vet rreth zgjedhjes së fatit të vet, zgjedhje që në mënyrë paqësore dhe njerëzore u kurorëzua me shpalljen e Kosovës shtet të pavarur në kuadër të federatës apo konfederatës jugosllave.

Këtë vendim historik të shpalljes juridike të shtetit të dytë shqiptar, politika serbe shpejt e shpalli jo të ligjshëm, sepse qenka bër në ilegalitet, por ato vendime historike bota i regjistroi me një interesim të madh dhe me simpati ndaj luftës paqësore të popullit shqiptar në Jugosllavi. Si rezultat i kësaj ishin shumë deklarata e rezoluta nga të gjitha anët e botës.

E tillë ishte Rezoluta e miratuar më 19 mars 1991 në Oslo të Norvegjisë prej anës të KOMITETIT KOMBËTAR NORVEGJEZ TË FEDERATËS SË HELSINKUT – për të drejtat dhe liritë e njeriut.

Kongresi KKNH u mbajt në sallën e plotë të Parlamentit Norvegjez (Stortinget). Për të treguar për rëndësinë e këtij vendimi duhet shpjeguar se çfarë roli luan KKNG në relacion me politikën e jashtme të Norvegjisë në përgjithësi e në fushën e të drejtave të njeriut në veçanti të cilat shikohen përmes prizmit të Marrëveshjes së Helsinkit, që në realitet është një akt politik dhe çdo shtet që bie nën thumbin e kritikës të KKNH vëhet për refleksin e politikës norvegjeze ndaj atij shteti (kushtetuta Norvegjeze ndërtohet në tri themele kryesore e njëri ndër to është e drejta dhe liria e plotë e njeriut). Në anën tjetër, KKNH në radhët e veta ka personalitete të rëndësishme politike (P.sh Reulf Steen, nënkryetar i partisë në pushtet Arbeiderpartis) që është zgjedhur kryetar këshilli të KKNH-s, njerëz nga jeta kulturore, e humanistë të njohur që deri dje kanë qenë në Komitetit për dhënien e Çmimit Nobël për paqe.

Prandaj, rezoluta e miratuar është një vendim dmth. si fillim i reagimit zyrtar të shtetit norvegjez në lidhje me Republikën e Kosovës.

Për ta bërë të njohur këtë rezolutë po e shënojmë të përkthyer nga norvegjishtja:

«IV rezolutat

JUGOSLLAVIA/KOSOVA: Kongresi i KKNH-së kërkon që të gjithë të burgosurit politikë të lirohen menjëherë. Tani gjenden më shumë se 100 të burgosur politikë në Jugosllavi – që të gjithë shqiptarë nga Kosova.

Kongresi i KKNH kërkon nga Qeveria (norvegjeze) ta diskutojë këtë dhe shkeljet e tjera të rënda të njeriut në mënyrë direkte me pushtetin në Beograd. Kongresi posaçërisht veçon sjelljen e gjendjes së urisë te shqiptarët në Kosovë dhe mbylljen e shkollave dhe të universitetit në gjuhën shqipe.

Kongresi i KKNH-së mendon se shqiptarëve duhet t'u jepen të drejta të barabarta si popujve të tjerë në Jugosllavi. KKNH mendon se ky është kusht i domosdoshëm, i cili do të sjellë deri zbutjen e situatës në vend. Kongresi i KKNH-së mendon se kërkesa për Republikën e Kosovës në kuadër të federatës apo konfederatës jugosllave është një kërkesë e drejtë, e cila do ta zbutë situatën e tendosur në Jugosllavi».

Nga kjo Rezolutë shihet se Evropa përkrah ngadalë kërkesat tona dhe ngadalë ia paguan borxhet e veta popullit shqiptar. Mirëpo, ne duhet të përgatitemi mirë që të jemi ata të cilët kurorëzojnë fitoret e bota duhet t'i përkrahë, sepse ne jemi ata që duhet përkrahur, se bëjmë luftë paqësore dhe të drejtë. Kushti kryesor për t'ia dalë punës në fund është vendosmëria jonë për të shkuar më tutje dhe jetësuar vendimet e Kaçanikut. Posaçërisht kjo vendosmëri na duhet tani kur si shumë herë më parë fatin e Jugosllavisë e vendosin serbët dhe kroatët, por tani s'ka vendim që do të jetë koherent pa dëshirën e popullit shqiptar. Këtë e ka kuptuar bota e shpresojmë se do ta kuptojnë edhe serbët e kroatët.

Nufri R. LEKAJ
Oslo, Norvegji

Populli shqiptar në Jugosllavi publikisht dhe juridikisht bëri deklarimin e vet rreth zgjedhjes së fatit të vet, zgjedhje që në mënyrë paqësore dhe njerëzore u kurorëzua me shpalljen e Kosovës shtet të pavarur në kuadër të federatës apo konfederatës jugosllave. Këtë vendim historik të shpalljes juridike të shtetit të dytë shqiptar politika serbe shpejt e shpalli jo të ligjshëm, sepse qenka bër në ilegalitet, por ato vendime historike bota i regjistroi me një interesim të madh dhe me simpati ndaj luftës paqësore të popullit shqiptar në Jugosllavi. Si rezultat i kësaj ishin shumë deklarata e rezoluta nga të gjitha anët e botës.

E tillë ishte Rezoluta e miratuar më 19 mars 1991 në Oslo të Norvegjisë nga Komiteti Kombëtar Norvegjez i Federatës së Helsinkit për të drejtat dhe liritë e

njeriut. Kongresi i KKNH u mbajt në sallën e plotë të Parlamentit norvegjez (Stortinget). Për të treguar për rëndësinë e këtij vendimi duhet shpjeguar se çfarë roli luan KKNH-ja në relacion me politikën e jashtme të Norvegjisë në përgjithësi dhe në fushën e të drejtave të njeriut në veçanti, të cilat shikohen nëpërmjet prizmit të Marrëveshjes së Helsinkit, që në realitet është një akt politik dhe çdo shtet që bie nën thumbin e kritikës të KKNH-së vihet për refleksin e politikës norvegjeze ndaj atij shteti (Kushtetuta norvegjeze ndërtohet në tri themele kryesore e një ndër to është e drejta dhe liria e plotë e njeriut). Në anën tjetër, KKNH në radhët e veta ka personalitete të rëndësishme politike (P.sh Reulf Steen, nënkryetar i partisë në pushtet - Arbeiderpartis) që është zgjedhur kryetar i Këshillit të KKNH-s, njerëz nga jeta kulturore dhe humanistë të njohur që deri dje kanë qenë në Komitetin për dhënien e Çmimit Nobel për Paqe. Prandaj, rezoluta e miratuar është një vendim, dmth. fillim i reagimit zyrtar të shtetit norvegjez në lidhje me Republikën e Kosovës. Për ta bërë të njohur këtë rezolutë po e shënojmë të përkthyer nga norvegjishtja:

"IV rezolutat

JUGOSLLAVIA/KOSOVA: Kongresi i KKNH-së kërkon që të gjithë të burgosurit politikë të lirohen menjëherë. Tani gjenden më shumë se 100 të burgosur politikë në Jugosllavi, që të gjithë shqiptarë nga Kosova.

Kongresi i KKNH-s kërkon nga Qeveria (norvegjeze) ta diskutojë këtë dhe shkeljet e tjera të rënda të njeriut në mënyrë direkte me pushtetin në Beograd. Kongresi posaçërisht veçon sjelljen e gjendjes së urisë te shqiptarët në Kosovë dhe mbylljen e shkollave dhe të universitetit në gjuhën shqipe.

Kongresi i KKNH-s mendon se shqiptarëve duhet t'u jepen të drejta të barabarta si popujve të tjerë në Jugosllavi. KKNH mendon se ky është kusht i domosdoshëm, i cili do të sjellë deri në zbutjen e situatës në vend. Kongresi i KKNH-s mendon se kërkesa për Republikën e Kosovës në kuadër të federatës apo konfederatës jugosllave është një kërkesë e drejtë, e cila do ta zbutë situatën e tendosur në Jugosllavi".

Nga kjo Rezolutë shihet se Evropa përkrah ngadalë kërkesat tona dhe ngadalë ia paguan borxhet e veta popullit shqiptar. Mirëpo, ne

duhet të përgatitemi mirë që të jemi ata të cilët kurorëzojnë fitoret e bota duhet t'i përkrahë, sepse ne jemi ata që duhet përkrahur se bëjmë luftë paqësore dhe të drejtë. Kushti kryesor për t'ia dalë punës në fund është vendosmëria jonë për të shkuar më tutje dhe jetësuar vendimet e Kaçanikut. Posaçërisht kjo vendosmëri na duhet tani kur, si shumë herë më parë, fatin e Jugosllavisë e vendosin serbët dhe kroatët, por tani s'ka vendim që do të jetë koherent pa dëshirën e popullit shqiptar. Këtë e ka kuptuar bota. Shpresojmë se do ta kuptojnë edhe serbët e kroatët.

Nufri R. LEKAJ
Oslo, Norvegji

APPELL

Utgitt av Den Norske Helsingforskomité APPELL NR. 2 1991

Kosovo og albanerne glemt av Europa

Av Nufri R. Lekaj

Den siste tiden har vi sett mange nyhetsbilder fra konfliktområdene i Jugoslavia med spesiell vekt på det som skjer i Kroatia og Slovenia. I den forbindelse påpekes det at konflikten er en trussel mot sikkerheten i området og Europa forøvrig.

Når det gjelder Kosovo tenker vi på det vi tidligere har lest og hørt: vold, terror og drap, og som professor Vojin Dimitrievic fra Beograd nylig uttalte på et åpent møte i Oslo: «I Kosovo har vi nå en sterk rasistisk holdning fra serbisk side mot albanerne». Vi får altfor lite informasjon i norske media om hva skjer i Kosovo, fordi det kommer i skyggen av krigen i Kroatia. Vesten og særlig EF er engasjert for en fredelig løsning av konflikten, men man blir usikker på mulighetene til en slik løsning når man undervurderer albanerne og deres ønske om å være tilstede under forhandlingene. En fredelig løsning på konflikten i Jugoslavia vil ikke lykkes hvis man ikke tar hensyn til det albanerne i Kosovo dag krever, og dette er moderate krav. Albanerne vil at Jugoslavia skal bevares innenfor dagens grenser og omorganiseres til å bli en løs union av suverene stater med selvstendig utenriks- og innenrikspolitikk. Albanerne krever likestilling i en «Ny» Jugoslavisk Union.

Unionsavtalen skal sikre unionens grenser og danne grunnlag for et felles økonomisk marked. Albanerne vet idag at det er helt umulig å danne en stat som kan samle en hel nasjon. Folkegruppene i Jugoslavia er innstilt på at de kan få leve i forskjellige jugoslaviske republikker. Det forutsettes en avtale, med hjemmel i internasjonal lov, som skal danne grunnlaget for en forsikring om minoritetenes rettigheter.

Som eksempel kan det refereres til «Den nye Kosovo republikkens grunnlov» som ble vedtatt av parlamentet i Kosovo den 15.09.90 og som ikke er anerkjent av den serbiske okkupasjonsmakten i Kosovo: «Kosovo er en demokratisk republikk bestående av albanere (90%), serbere og andre (10%) folkegrupper (man har benyttet dette isteden for minoriteter) som bærer republikkens suverenitet». Det må påpekes at albanerne aldri har krevd løsrivelse fra Jugoslavia og at deres kamp har vært rettet mot selvstendighet og likestilling innenfor den jugoslaviske union. Dette kravet har imidlertid blitt en kostbart krav for Kosovo og albanerne de siste 10 år. Noen hundre har blitt drept under demostrasjoner og folkemøter, flere hundre har blitt såret og tusenvis har blitt fengslet på politisk grunnlag og internert. Ca. 100 000 har blitt oppsagt fra sine stillinger på politisk grunnlag (postverket, rettsvesen, administrasjon, helsevesen, politi, universitetet, skoleverket osv.) I disse stillingene er det nå bare serbiske kolonialister som mottar dobbelt så stor lønn som da det var kosovo-albanere i disse stillingene. Kosovo er idag et «autonomt område» som okkuperes av en kolonimakt med navnet «Den Serbiske stat». Kosovo og albanerne har blitt ekskludert av andre republikker i Jugoslavia i de resultatløse forhandlingene om en løsning av konflikten i Kosovo. Albanerne har forstått denne holdningen fra de andre jugoslaviske republikkene (alle av slavisk opprinnelse) slik at de ikke er villige til å ha albanerne i et nytt Jugoslavia og at disse skal etterlates i en serbisk koloni på Balkan. Etter en innsats fra Vesten begynte albanerne igjen å håpe på en bedre fremtid. Europarådet har fordømt Serbia for grove brudd på menneskerettighetene i Kosovo. Det samme har Kongressen i USA og mange andre, såvel politiske partier som menneskerettighetsorganisasjoner. Albanerne med sin demokratiske ledelse og «albanernes Ghandi» professor Ibrahim Rugova har tjent mye på den politiske linje mot det harde serbiske undertrykkelsesapparatet.

Uansett provokasjonene fra serbisk side i Kosovo har ingen serber blitt skadet eller såret av albanerne. Dette viser hvilken type konflikt man har å gjøre med her: en ren frigjøringskamp med demokratiske midler mot en kolonimakt. Det håp som albanerne har hatt i forhold til Europa og verdenssamfunnet forøvrig har nå begynt å svinne. EF har innkalt alle de jugoslaviske republikkene til forhandlinger i Haag, men de glemte å innkalle den syvende jugoslaviske republikken Kosovo. Hvorfor?. Skal Kosovo ofres for serbiske og kroatiske interesser ?. Skal Europa forsøke å gjenta London- og Versailes-avtalen om Jugoslavia, og igjen ofre albanerne for Serbia ?.

Denne neglisjeringen av albanerne i Jugoslavia viser at EF forbereder en ny avtale om Jugoslavia uten å ivartea albanernes interesser. I London og Versailles var dette dengang lettere å gjøre. Men nå når situasjonen er en helt annen i et Europa hvor demokrati og frihet er de mest elskede ord for undertrykte nasjoner, blir det vanskelig for en hvilken som helst stat eller EF å neglisjere de enkelte folkegruppers skjebne. Ikke minst når det gjelder albanerne er dette et farlig spill. Man skal ikke glemme at albanerne er det tredje største folkeslag i Jugoslavia (3 millioner). Det er like mange som hele befolkningen i Albania. Hvis man setter albanerne utenfor kan de bli tvunget til, hva vi alle må forsøke å forhindre, en væpnet konflikt med den serbiske kolonimakten. Dette kan igjen føre til at Albania griper inn for å stanse nedslaktingen av albanerne i Kosovo (Hvilken militærteknologi Serbia besitter vises ikke minst gjennom deres eksport av våpen til Irak). Det er innlysende at man ikke ønsker en slik utvikling på Balkan. Det er derfor meget viktig for alle parter ved forhandlingsbordet å ikke glemme albanerne som er samarbeidsvillige og ønsker å delta i forhandlinger.

Borgerkrigens glemte politiske fanger

Mens Europa glemte å innkalle albanerne til forhandlingsbordet i Haag, har jugoslaviske myndigheter glemt sitt løfte overfor Vesten om å løslate alle politiske fanger i Jugoslavia. Det viser seg at det fremdeles sitter rundt 50 politiske fanger, alle albanere, i serbiske- og makedonske fengsler. De har blitt dømt for å ha deltatt i demonstrasjoner mot de serbiske myndigheter eller være medlemmer av forbudte albanske organisasjoner. De albanske samvittighetsfangene har blitt arrestert i tidsrommet fra 1982 og fram til idag. Mange er dømt til høye straffer. Et eksempel er Rafi Halilis skjebne, den ca. 40 år gamle læreren fra Tetova i Makedonia som først ble dømt til 10 års fengsel i 1971 for «verbal propaganda» og dernest til 15 år i 1982 for forsøk på å organisere en illegal politisk opposisjon. De politiske fangene soner lange straffer. Gjennomsnittstraffen er på 6 år. Albanske menneskerettighetsforkjempere i Kosovo og Makedonia frykter idag for livet til de politiske fangene. Flere av dem har den siste tiden blitt truet på livet i serbiske fengsler.

Disse politsike fangene soner dommer på 10 år eller mer:
Riza Xhakli (20), Abdylxchemail Alimani (20), Rifat Kafexholli (15), Shaqir Ruhani (15), Nuhi Bunjaku (15), Rafi Halili (15), Adil Arifi (15), Sadik Jashari (14), Emin Krasniqi (14), Muslim Dobruna (14), Pajazit Aliu (13), Afrim Mehmeti (13), Nahit Thaqi (13), Haxhi Sertilli (11), Xhavit Marjai (11), Naser Krasniqi (10), Avdi Lajqi (10), Riza Zeqiraj (10).

Referenca nr. 16

APEL, NR. 2, 1991
Publikuar nga Komiteti Norvegjez i Helsinkit

Kosova dhe shqiptarët, të harruar nga Evropa

Nga Nufri R. Lekaj

Kohët e fundit mediet e ndryshme kanë raportuar dhe sjell pamje të shumta nga zonat e konfliktit në Jugosllavi, duke fokusuar veçanërisht në Kroaci dhe Slloveni dhe duke vënë në dukje se ky konflikt është një kërcënim për sigurinë në zonën e Ballkanit dhe për sigurinë e Evropës në përgjithësi. Sa i përket situatës në Kosovë, vazhdojnë të ndodhin ato që tashmë i kemi lexuar dhe dëgjuar: dhuna, terrori dhe vrasjet.

Profesori nga Beogradi, Vojin Dimitrievic, rishtazi në një mbledhje të hapur në Oslo, deklaroi: "Në Kosovë tani kemi një qëndrim të ashpër racist nga ana serbe kundër shqiptarëve". Në media kemi shumë pak informacion rreth situatës në Kosovë, sepse Kosova është lënë nën hije për shkak të luftës në Kroaci. Perëndimi, sidomos BE-ja, janë të angazhuara për një zgjidhje paqësore të konfliktit në Jugosllavi, por një zgjidhje e tillë nuk është e mundshme përderisa nuk merret seriozisht situata në Kosovë dhe përderisa nënvlerësohet dëshira e shqiptarëve për të qenë të pranishëm në negociata.

Një zgjidhje paqësore e konfliktit në Jugosllavi nuk do të ketë sukses në qoftë se nuk merren parasysh kërkesat e shqiptarëve në Kosovë. Kërkesat e shqiptarëve të Kosovës janë të moderuara, sepse qëllimi i shqiptarëve nuk është shkatërrimi i Jugosllavisë, por barazia me popujt e tjerë në një union të lirë - jugosllav, i përbërë nga shtetet sovrane që janë të pavarura në politikat e tyre të brendshme dhe të jashtme.

Marrëveshja për unionin do t'i sigurojë kufijtë e unionit dhe do ta krijojë bazën për një treg të përbashkët ekonomik. Shqiptarët janë të vetëdijshëm se në situatën që gjenden sot, e kanë të pamundur të formojnë një shtet që përfshin tërë popullin shqiptar në Jugosllavi. Pakicat në Jugosllavi janë të kurdisura të vazhdojnë të jetojnë në republikat e Jugosllavisë. Prandaj, një marrëveshje e unionit e

ngulitur në të drejtën ndërkombëtare e krijon bazën për sigurinë e të drejtave të minoriteteve. Si shembull për këtë mund t'i referohemi Kushtetutës së re të Republikës së Kosovës e miratuar nga Parlamenti i Kosovës më 15.09.90, e cila nuk njihet nga forcat okupuese serbe: "Kosova është republikë demokratike e përbërë nga shqiptarët (90 %), serbët dhe pakicat e tjera kombëtare (10 %) si bartës të sovranitetit të Republikës".

Duhet ripërsëritur se përpjekjet e shqiptarëve të Kosovës nuk kanë qenë kurrë të drejtuara për ta shkatërruar Jugosllavinë, por gjithnjë kanë qenë përpjekje për pavarësinë dhe barazinë e shqiptarëve në raport me republikat e tjera. Këto përpjekje u kanë kushtuar shqiptarëve shumë, në veçanti në 10 vjetët e fundit. Disa qindra janë vrarë gjatë demonstratave dhe protestave, qindra të tjerë janë plagosur dhe mijëra të tjerë janë burgosur dhe internuar për veprimtari politike. Përafërsisht 100 000 shqiptarë janë përjashtuar nga vendet e tyre të punës (nga sistemi gjyqësor, administrata, shëndetësia, policia, posta, universiteti, shkollat etj.) për shkak të bindjeve të tyre politike. Tani në këto vende të punës, në vend të shqiptarëve, janë kyçur kolonialistët serbë, të cilët marrin paga të dyfishuara krahasuar me pagat që kishin shqiptarët në këto vende të punës.

Rrjedhimisht, Kosova është një "zonë autonome" e okupuar nga një fuqi koloniale me emrin "shteti i Serbisë". Republikat e tjera në Jugosllavi e kanë ekskluduar Kosovën dhe shqiptarët në përpjekjet për një zgjidhje të konfliktit në Kosovë. Shqiptarët e kanë kuptuar këtë qëndrim të republikave të tjera jugosllave (të populluara kryesisht me banorë me origjinë sllave) që nënkupton se nuk dëshirojnë t'i pranojnë shqiptarët të jenë të barabartë me popujt e tjerë në një Jugosllavi të re, duke i lënë kështu shqiptarët të mbesin një koloni e Serbisë. Mbas një përpjekje nga ana e Perëndimit, shqiptarët filluan të shpresojnë për një të ardhme më të mirë.

Këshilli i Evropës i ka dënuar shkeljet e të drejtave të njeriut nga regjimi serb në Kosovë. Të njëjtën gjë e ka bërë Kongresi Amerikan, gjithashtu edhe partitë politike dhe organizatat për të drejtat e njeriut. Shqiptarët me udhëheqjen e tyre demokratike dhe "Gandin e shqiptarëve", dr. Ibrahim Rugovën, kanë krijuar simpati në vijën e

tyre politike kundër regjimit shtypës serb.

Pavarësisht provokimeve dhe represioneve nga ana serbe, asnjë serb në Kosovë nuk është dëmtuar, plagosur ose vrarë nga shqiptarët. Kjo tregon se me çfarë lloj konflikti kemi të bëjmë: një luftë e pastër çlirimtare me mjete demokratike kundër një pushtuesi kolonialist. Shpresat e shqiptarëve për ndihmë nga Perëndimi kanë filluar të zbehen. BE-ja i ka ftuar të gjitha republikat jugosllave në negociatat në Hagë, por ka harruar ta ftojë edhe republikën e shtatë, republikën e Kosovës. Pse? A duhet Kosova të sakrifikohet për interesat serbe dhe kroate? A do ta përsëritë Evropa, Londrën dhe marrëveshjen e Versajës për Jugosllavinë, e përsëri t'i sakrifikojë shqiptarët për Serbinë?

Ky neglizhim ndaj shqiptarëve në Jugosllavi tregon se BE-ja po e përgatit një marrëveshje të re për Jugosllavinë, që nuk merr parasysh interesat e shqiptarëve. Në Londër dhe Versajë ka qenë më e lehtë për të bërë këtë. Por tani situata është krejtësisht ndryshe në Evropë, ku demokracia dhe liria janë fjalët më të dashura të kombeve të shtypura dhe do të jetë e vështirë për çdo shtet tjetër dhe për BE-në për të luajtur me fatin popujve të shtypur. Në veçanti kur është fjala për shqiptarët, kjo është një lojë e rrezikshme. S'duhet të harrohet se shqiptarët në Jugosllavi janë populli i tretë për nga madhësia demografike (3 milionë) sa e gjithë popullsia në Shqipëri. Nëse vazhdohet të shpërfillen shqiptarët, ata do të detyrohen për atë që ne të gjithë duhet të përpiqemi ta parandalojmë, për një konflikt të armatosur me pushtetin kolonial serb. Një situatë e tillë mund të çojë edhe në ndërhyrjen nga Shqipëria për t'i ndaluar krimet e luftës ndaj shqiptarëve në Kosovë (çfarë teknologjie ushtarake ka Serbia tregohet edhe nëpërmes eksportit të armëve të Serbisë në Irak). Është e qartë se nuk dëshirojmë të ndodhë një zhvillim i tillë në Ballkan. Prandaj është shumë e rëndësishme për të gjitha palët në tryezën e bisedimeve të mos i harrojnë shqiptarët të cilët kanë vullnet për bashkëpunim dhe duan të marrin pjesë në negociata.

Të burgosurit politikë, të harruar

Përderisa Evropa harroi t'i ftojë shqiptarët në tryezën e bisedimeve në Hagë, autoritetet jugosllave e kanë harruar premtimin

e vet ndaj Perëndimit për lirimin e të gjithë të burgosurve politikë në Jugosllavi. Ende rreth 50 të burgosur politikë, të gjithë shqiptarë, mbahen në burgjet serbe dhe maqedonase. Ata janë dënuar për shkak të pjesëmarrjeve në demonstratat kundër autoriteteve serbe ose për shkak se kanë qenë anëtarë të organizatave ilegale shqiptare. Të burgosurit shqiptarë të ndërgjegjes janë arrestuar vazhdimisht, shumë prej tyre janë dënuar me dënime të ashpra. Një shembull është rasti i Rafi Halilit, 40-vjeçar, mësues nga Tetova në Maqedoni, i cili në vitin 1971 u dënua fillimisht me 10 vjet burg për "propagandë verbale" dhe më vonë, në vitin 1982, u dënua me 15 vjet burg për përpjekjen për të organizuar një opozitë politike ilegale.

Të burgosurit politikë vuajnë dënime të gjata. Dënimi mesatar është 6 vjet. Veprimtarët e të drejtave të njeriut në Kosovë dhe Maqedoni janë tejet të brengosur për jetën e të burgosurve politikë. Kohët e fundit, shumica e të burgosurve politikë në burgjet serbe janë kërcënuar me vdekje. Këta të burgosur politikë vuajnë dënime prej 10 vjet apo më shumë: Riza Xhakli (20), Abdylxhemail Alimani (20), Rifat Kafexholli (15), Shaqir Ruhani (15), Nuhi Bunjaku (15), Rafi Halili (15), Adil Arifi (15) Sadik Jashari (14), Emin Krasniqi (14), Muslimi Dobruna (14), Pajazit Aliu (13), Afrim Mehmeti (13), Nahit Thaqi (13), Haxhi Sertilli (11), Xhavit Marjai (11), Naser Krasniqi (10), Avdi Lajqi (10), Riza Zeqiraj (10).

Konklusjoner fra Veronakonferansen

"Forum for fred og forsoning i ex-Jugoslavia" møttes i Verona 17-20 september 1992. Tilstede var 52 deltagere fra mer enn 50 forskjellige frivillige organisasjoner og politiske partier fra alle regioner i det tidligere Jugoslavia. Videre deltok 50 observatører fra hele Europa, inklusive representanter fra International Helsinki Federation, Helsinki Citizen Assembly, Yugo-Fax (London) og Institutt for Menneskerettigheter (Oslo). Konferansen ble ledet av en komite på 13 personer, med Marijana Grandits (Østerrike) og Alexander Langer (italiensk medlem av Europaparlamentet), som formenn.

KONFERANSEN TOK SIKTE PÅ FØLGENDE:

Å få fram nye og alternative forslag til fred og forsoning ved å trekke inn et vidt spekter av representanter fra det sivile samfunnsliv i det tidligere Jugoslavia.
Dessuten, at konferansen skulle fungere som en innledning til en mer permanent dialog mellom partene, og ved å påvirke den internasjonale fredsprosessen. Dette søkes gjennomført ved å utvikle samarbeidet med den alternative konferansen for fred på Balkan (London, august og "Citizens Peace Conference" (Ohrid, Makedonia, november 1992) og ved å trekke inn nye grupper og parter i samarbeidet.

GENERELLE PRINSIPPER:

Forumet konstaterte;

1) Massive brudd på internasjonale menneskerettigheter og humanitær lovgivning.

2) Garantert ekspansjon av konflikten.

3) Den internasjonale fredsprosess' manglende vilje til å gjenopprette fred og orden.

4) Mangelen på en politisk løsning som omfatter hele Balkan-området.

5) At grunnleggende demokratisk tankegods og menneskerettigheter aldri har fått riktig fotfeste i området.

FORUTSETNINGER FOR EN RESOLUSJON:

1) Umiddelbare og permanente forholdsregler for å stoppe volden, herunder bombing, skyting, fordrivelse, tortur, terror, etnisk utrenskning og andre måter å føre krig på.

2) Å påpeke nødvendigheten av å respektere alle internasjonale resolusjoner, avtaler og lover, og i særdeleshet det som vedrører humanitære forhold. I denne sammenheng nevne overgripernes personlige straffeansvar etter folkeretten.

3) Opprette demokratiske institusjoner og styrke det sivile samfunnsliv ved å stimulere demokratiske krefter og bruk av internasjonale fredsskapende sanksjoner.

4) Territorial og demografisk status quo ante som vil danne basis for fremtidige bosettinger.

5) Partene i den offisielle fredsprosess, både det internasjonale samfunn og partene fra det tidligere Jugoslavia, må bestrebe seg på å sette egne interesser til side for å oppnå resultater.

FORSLAG TIL Å STOPPE KRIGEN I BOSNIA-HERCEGOVINA;

Forumet ble enig om at den eneste mulige løsning på lengre sikt er å opprette et protektorat administrert av FN. Administrasjonen skal ha full kontroll over hele Bosnia-Hercegovina, og søke å demilitarisere og oppløse militsen og fornye den politiske struktur.

Referenca nr. 17

APEL

Publikuar nga Komiteti Norvegjez i Helsinkit

Konkluzionet e Konferencës së Veronës

Forumi për Paqe dhe Pajtim në ish-Jugosllavi u mbajt në Veronë prej 17 deri 20 shtator 1992. Të pranishëm ishin 52 pjesëmarrës nga më shumë se 50 OJQ të ndryshme dhe partitë politike nga të gjitha

rajonet e ish-Jugosllavisë. Gjithashtu, morën pjesë 50 vëzhgues nga e gjithë Evropa, duke përfshirë përfaqësues nga Federata Ndërkombëtare e Helsinkit, Asambleja Qytetare e Helsinkit, YugoFax (Londër) dhe Instituti për të Drejtat e Njeriut (Oslo). Konferenca u drejtua nga një komitet prej 13 personash, në krye me Marijana Grandits (Austri) dhe Alexander Langer (anëtar i Parlamentit Evropian).

KONFERENCA PËRCAKTOI SYNIMET NË VIJIM:

Të paraqesë propozime të reja dhe alternative për paqen dhe pajtimin, duke e përfshirë një spektër të gjerë të përfaqësuesve të shoqërisë civile në ish-Jugosllavi. Të shërbejë si një hyrje për një dialog më permanent në mes palëve, duke ndikuar kështu në procesin e paqes ndërkombëtare. Kjo synohet të realizohet duke zhvilluar bashkëpunim me konferencën alternative për paqen në Ballkan, (Londër, gusht) dhe Konferencën për Paqen Qytetare (Ohër, Maqedoni, nëntor 1992) dhe duke përfshirë grupe dhe palë të reja në bashkëpunim.

PARIMET E PËRGJITHSHME:

Forumi konstatoi:

1) Shkelje masive të të drejtave të njeriut dhe së drejtës ndërkombëtare humanitare.

2) Ekspansionin e sigurt të konfliktit.

3) Mungesën e vullnetit në procesin ndërkombëtar të paqes për t'i rivendosur paqen dhe rendin.

4) Mungesën e një zgjidhje politike që e përfshin të gjithë rajonin e Ballkanit.

5) Idetë themelore demokratike dhe të drejtat e njeriut kurrë nuk kanë zënë vend si duhet në këtë zonë.

PARAKUSHTET PËR NJË REZOLUTË:

1) Marrja e masave të menjëhershme dhe të përhershme për ta ndaluar dhunën, bombardimet, të shtënat, dëbimin, përdorimin e

torturës, spastrimin etnik etj.

2) Të theksohet domosdoshmëria e të respektuarit e të gjitha rezolutave ndërkombëtare, marrëveshjeve dhe ligjeve, në veçanti ato që kanë të bëjnë me çështjet humanitare. Në lidhje me këtë të nënvizohet përgjegjësia penale individuale e abuzuesit sipas ligjit ndërkombëtar.

3) Krijimin e institucioneve demokratike dhe forcimin e shoqërisë civile, duke inkurajuar forcat demokratike dhe përdorimin e sanksioneve ndërkombëtare paqeruajtëse.

4) Ruajtjen e status quos territoriale dhe demografike që do ta formojë bazën për vendbanimet e ardhshme.

5) Palët në procesin zyrtar të paqes, si bashkësia ndërkombëtare ashtu edhe palët nga ish-Jugosllavia, duhet të përpiqen për t'i vënë interesat e tyre mënjanë në mënyrë që të arrihen rezultatet.

Referenca nr. 18

Agjencia telegrafike norvegjeze,
9 shkurt 1993

SERBËT JANË DUKE E ZBATUAR APARTEIDIN NË KOSOVË

Oslo (agjencia telegrafike norvegjeze Nina Haabeth): Shumë organizata për të drejtat e njeriut paralajmërojnë të mos dëbohen azilkërkuesit shqiptarë në Kosovë, ku tashmë serbët janë duke zbatuar gjendje të ngjashme me aparteidin. Udhëheqësi i frikshëm i gueriles serbe, Arkan, është shef i policisë në provincën e Kosovës. Arkan është një kriminel i kërkuar për t'u arrestuar nga shumë vende të botës.

Veprimtari për të drejtat e njeriut, Nufri Lekaj, i cili punon në Komitetin Norvegjez të Helsinkit në Oslo, e konfirmon për agjencinë telegrafike norvegjeze se udhëheqësi i frikshëm i gueriles serbe, Arkan, tani është përgjegjës për forcën policore në Kosovë. Gjatë zgjedhjeve të fundit Arkani u votua nga minoriteti serb në Kosovë. Ai për këtë arsye u kthye në zonën e tij zgjedhore në Prishtinë dhe tani është sekretar në Ministrinë e Brendshme, ku, përveç të tjerash, është përgjegjës për forcat policore, thotë Lekaj.

NTB 9. februar 1993

SERBERE HAR INNFØRT APARTHEID I KOSOVO

(Til red.: Sammenholdes med "albanere-norge" og "kosovo-partier")

Oslo (NTB-Nina Haabeth): Flere menneskerettsorganisasjoner advarer mot at kosovo-albanere tilbakesendes til Kosovo, der serberne er i ferd med å innføre apartheid-liknende tilstander. Den fryktede serbiske geriljalederen "Arkan", er sjef for politiet i den serbisk-styrte provinsen. "Arkan" er en ettersøkt forbryter i store deler av verden.

Den kosovo-albanske menneskerettsforkjemperen Nufri **Lekaj**, som arbeider i Helsingforskomiteen i Oslo, bekrefter overfor NTB at den fryktede serbiske geriljalederen Arkan har ansvaret for politistyrken i Kosovo.

- Under sist valg ble Arkan valgt av den serbiske minoriteten i Kosovo. Han har derfor flyttet tilbake til sin valgkrets i Pristina, og er sekretær for innriksdepartementet, der han blant annet har ansvaret for politistyrkene, sier **Lekaj**.

Den serbiske geriljalederen, som går under kallenavnet Arkan, er en etterlyst forbryter i store deler av verden, og beskyldes for å stå bak grusomme massakre både i Kroatia og Bosnia-Hercegovina. **Lekaj** mener det er betegnende for situasjonen at Arkan nå er sjef for politiet i Kosovo, og beskriver situasjonen som svært, svært vanskelig for kosovo-albanerne.

- Ingen vet hva som er skjedd med de kosovo-albanerne som allerede er sendt tilbake fra Norge og Sverige, men vi vet at flere kosovo-albanere som kommer tilbake fra vestlige land har problemer med å komme inn i Kosovo. Politiet ved grensen hindrer dem, og det er også meldt om arrestasjoner. Vi vet dessuten at flere kosovo-albanere, som har fått avslag på asyl i ett land, ofte prøver å reise til et nytt, forteller **Lekaj**,

som selv fikk politisk asyl i Norge for seks år siden.

Etnisk rensing

Sosialantropolog og Albania-ekspert Berit Backer vil ikke kommentere Justisdepartementets avgjørelse om å returnere kosovo-albanere som har fått avslag på asyl i Norge. Men hun beskriver situasjonen i Kosovo som svært spent.

- Serberne foretar en skrittvis etnisk rensing av Kosovo. Etniske albanere får ikke jobb, eller blir sparket fra sine stillinger. De blir fratatt skolegang og helsetilbud. Serbia har dessuten et klart bosettingsprogram, der de forsøker å få serbere fra blant annet Bosnia-Hercegovina til å slå seg ned i Kosovo. Selv om det ikke blir lett å fjerne alle albanere fra Kosovo (albanere utgjør 90 prosent av befolkningen), frykter jeg at det vil bli flere rene serbiske områder, sier Backer til NTB.

Hun understreker at Kosovo, som tidligere hadde utstrakt selvstyre, nå i virkeligheten er okkupert av serberne, etter at den serbiske presidenten Slobodan Milosevic besluttet å innføre direkte styre i 1989.

Både Norsk flyktningeråd og Norsk organisasjon for asylsøkere (NOAS) advarer sterkt mot å sende etniske albanere tilbake til Kosovo på grunn av den spente situasjonen og de utstrakte bruddene på menneskerettighetene.

Lederen for Institutt for menneskerettigheter i Oslo, Asbjørn Eide, sier til NTB at situasjonen i Kosovo er altfor labil til at Regjeringen bør sende flyktninger tilbake.

Apartheid

Lederen for Institutt for menneskerettigheter i Danmark, Morten Kjerum, mener at tidspunktet for tilbakesendelse er uheldig.

- Albanere blir systematisk forfulgt av serberne. I realiteten holder serberne på å innføre et apartheid i Kosovo, der albanere blir erstattet av serbere i de viktigste samfunnsposisjonene. Også FN bekrefter at situasjonen er uhyre vanskelig, sier Kjerum.

Han mener at det er svært viktig at internasjonale organisasjoner raskt går inn i Kosovo for å overvåke situasjonen, og at det internasjonale presset blir sterkere. I dag har både FN og Konferansen for sikkerhet og samarbeid i Europa (KSSE) representanter i Kosovo.

- Debatten om hjemsendelse av kosovo-albanere er vanskelig. Serberne ønsker jo nettopp at kosovo-albanerne skal flykte landet. I dagens situasjon ville jeg imidlertid vært svært forsiktig med tilbakesendelse. Det trekker opp til svært mørke skyer over Kosovo, sier Kjerum.

Lideri i gueriles serbe, alias Arkan, është një kriminel i kërkuar për t'u arrestuar nga shumë vende të botës dhe akuzohet se është përgjegjës për masakra të tmerrshme në Kroaci dhe në Bosnjë-Hercegovinë. Lekaj mendon se kjo është indikative për situatën në Kosovë, duke e marrë parasysh se Arkan tani është shef për policinë në Kosovë dhe e përshkruan situatën në Kosovë si shumë, shumë të vështirë për shqiptarët.

Nuk dihet se çfarë ka ndodhur me azilkërkuesit shqiptarë të Kosovës, të cilët tashmë janë dëbuar nga Norvegjia dhe Suedia në Kosovë, por kemi informata se shumë shqiptarë që kthehen nga vendet perëndimore hasin në probleme gjatë hyrjes në Kosovë. Policia i ndalon në kufi dhe ka raportime edhe për arrestime. Gjithashtu, kemi informata se shumë shqiptarë të Kosovës, të cilëve u është refuzuar kërkesa për azil në një shtet, shpesh përpiqen të udhëtojnë në një shtet tjetër për të kërkuar azil, thotë Lekaj, i cili edhe vetë ka marrë azil politik në Norvegji gjashtë vjet më parë.

Spastrimi etnik

Socialantropologia dhe ekspertja për Shqipërinë, Berit Backer, nuk dëshiron ta komentojë vendimin e Ministrisë së Drejtësisë për kthimin e azilkërkuesve shqiptarë të Kosovës, të cilët kanë marrë refuzim në kërkesën e tyre për azil në Norvegji. Por, ajo e përshkruan situatën në Kosovë si shumë të tensionuar. Serbët kanë filluar të realizojnë një spastrim etnik gradual të Kosovës. Shqiptarët janë të përjashtuar nga vendet e tyre të punës, të privuar nga qasja në arsim dhe nga kujdesi shëndetësor. Madje Serbia e ka një program të caktuar për rivendosjen e vendbanimeve, duke u përpjekur t'i marrë serbët nga Bosnja-Hercegovina dhe t'i vendosë në Kosovë. Edhe pse nuk është e lehtë për t'i shpërngulur të gjithë shqiptarët nga Kosova (shqiptarët përbëjnë 90 për qind të popullsisë), kam frikë se do të formohen më shumë zona të pastra etnike serbe, thotë Backer për agjencinë telegrafike norvegjeze. Ajo nënvizon se Kosova, që e kishte një autonomi të gjerë, tani është e pushtuar nga serbët, pasi presidenti serb Sllobodan Millosheviq mori vendim në vitin 1989, ta vendosë sundimin e drejtpërdrejtë në Kosovë.

Organizata Norvegjeze për Refugjatë (flyktningerråd) dhe

Organizata për Azilkërkuesit (NOAS) protestojnë fuqishëm kundër dërgimit të azilkërkuesve shqiptarë në Kosovë për shkak të situatës së tensionuar dhe shkeljeve në masë të gjerë të të drejtave të njeriut.

Kryetari i Institutit për të Drejtat e Njeriut në Oslo, Asbjørn Eide, për agjencinë telegrafike norvegjeze thotë se situata në Kosovë është shumë labile, prandaj Qeveria nuk duhet t'i kthejë azilkërkuesit shqiptarë mbrapa në Kosovë.

Aparteid

Udhëheqësi i Institutit për të Drejtat e Njeriut në Danimarkë, Morten Kjerum, mendon se momentumi nuk është i përshtatshëm për t'i kthyer azilkërkuesit shqiptarë në Kosovë. Shqiptarët janë duke u persekutuar sistematikisht nga serbët. Në realitet serbët kanë ndërmarrë të zbatojnë një gjendje aparteidi në Kosovë, ku shqiptarët zëvendësohen nga serbët në pozicionet më të rëndësishme shoqërore. Edhe OKB-ja konfirmon se situata është jashtëzakonisht e vështirë, thotë Kjerum. Sipas Kjerum, është e rëndësishme që organizatat ndërkombëtare të kyçen më shumë në Kosovë për ta monitoruar situatën dhe të forcohet presioni ndërkombëtar. Kombet e Bashkuara dhe Konferenca për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (KSBE) kanë përfaqësues në Kosovë. Debati për kthimin e azilkërkuesve shqiptarë në Kosovë është i vështirë. Serbët dëshirojnë pikërisht që shqiptarët e Kosovës të largohen nga Kosova. Por në situatën e tanishme unë do të isha njëkohësisht shumë i kujdesshëm për t'i kthyer azilkërkuesit shqiptarë në Kosovë. Situata në Kosovë është duke e marrë një pamje të errët, thotë Kjerum.

– Kosovo brenner – sover Norge?

HAMAR: Det brenner en ild for kosovoalbanerne i Hamar. Engasjementet er både stort og bredt – det viste en høring Støttegruppa for kosovoalbanere og Hamar Venstre arrangerte mandag kveld om situasjonen i Kosovo. Drøyt 200 personer tok del i høringen – og det kom klart fram at bekymringen er stor for kosovoalbanere som sendes hjem – og for de 21 som har søkt kirkeasyl i Hamar.

HA: SVERRE FRILSETH

– Er det forsvarlig å sende kosovoalbanere tilbake, spurte Støttegruppa og inviterte et panel bestående av stortingsrepresentanter, justisdepartementet, Amnesty, Det norske Flyktningerråd og Helsingforskomitéen til en høring i Hamar mandag kveld.

– Nei, sa Amnesty.

– Nei, sa Det norske Flyktningeråd.

– Nei, sa Helsingforskomitéen.

– Nei, sa Magnar Sortåsløkken (SV) og Ragnhild Q. Haarstad (Sp).

– Jeg har tillit til at justisdepartementet til en hver tid gjør det som er riktig og rett, sa Arbeiderpartiets Einar Olav Skogholt og fikk følge av Høyres Bjørn Hernæs.

– Det er IKKE krig i Kosovo og det ligger en grundig vurdering bak hver hjemsendelse av asylsøkere som får avslag på søknad om oppholdstillatelse i Norge, sa ekspedisjonssjef Berit Fossheim i Justisdepartementet.

PRESS

Kosovo-høringen i Hamar mandag kveld avdekket ikke noe revolusjonerende nytt i tenkningen i Justisdepartementet når det gjelder synet på asylsøkende kosovoalbanere, men det er likevel klart at departementet nå settes under et stadig større press for å omgjøre beslutningen om å sende asylsøkere tilbake til den tidligere jugoslaviske provinsen. Til nå er 424 kosovoalbanere sendt hjem via Makedonia etter å ha fått avslag på asylsøknaden i Norge. Ekspedisjonssjef Berit Fossheim innrømmet at norske myndigheter ikke har førstehånds kjennskap til hvilken skjebne de hjemsendte møter ved ankomsten til hjemlandet, men poengterte sterkt at Norge har et godt kildenett av informatører i Kosovo-området og Justisdepartementet mottar ukentlig rapporter om situasjonen derfra.

UENIG: Bekymringen for utviklingen i Kosovo deler de, m,en uenigheten er likevel til stede når det kommer til norsk asylpolitikk. Panelet under Kosovo-høringen i Hamar mandag kveld besto av ekspedisjonssjef Berit Fossheim, Justisdepartementet, Laila Belle fra Amnesty, Jan Borgen fra Det norske Flyktningerråd, Nufri Lekaj fra Helsingforskomitéen, Einar Olav Skogholt (Ap), Magnar Sortåsløkken (SV), Ragnhild Q. Haarstad (Sp) og Bjørn Hernæs (H).
FOTO: OLAV HANSEN

– Foreløpig har ikke de rapportene vært av en slik karakter at de har fått norske myndigheter til å se med nye øyne på asylsøkere fra Kosovo, sa Fossheim.

FORVERRING

Stadig flere organisasjoner hevder imidlertid med tyngde at forholdene for albanerne i Kosovo stadig forverrer seg. Amnesty er utestengt fra landet, men har rapporter om drap, trakassering, forfølgelse og diskriminering av albanere i Kosovo. Det samme har Det norske Flyktningerråd og Helsingforskomitéen, kom det fram på høringen. At FNs Høykommissær for flyktninger har uttalt at Norge bør være meget varsomme med å sende kosovo- albanere hjem, blir av mange tolket som en klar oppfordring til norske myndigheter om å gi generelt asyl for albanere på flukt fra Kosovo.

VITNESBYRD

Selv om mye lå til rette for høy temperatur i Teatersalen i Hamar i går kveld, klarte aldri høringen å tenne den store brannen. Behovet for framførte motstandere av Justisdepartementets asylpolitikk sine argumenter til støtte for kosovo-albanerne, men sterkest inntrykk gjorde likevel de mange vitnesbyrd kosovo-albanere selv framførte. Det var beretninger om flukt fra forfølgelse og trakassering i hjemlandet til et nytt land med ukjent kultur og språk, bare for å bli avvist og sendt tilbake – til et hjemland som ikke ville motta dem – eller sendte dem rett i fengsel.

– Serberne har satt i gang en organisert utrensking av albanere i Kosovo. De som ikke jages på flukt står i fare for å bli drept. Mange er allerede blitt drept, sa flere av de tilstedeværende kosovo-albanerne. Justisdepartementets ekspedisjonssjef noterte flittig og lovet å undersøke sakene nærmere.

REISE

Om ikke Kosovo-høringen i Hamar mandag kveld umiddelbart rokker ved Justisdepartementets asylpolitikk – eller legger grunnlaget for fred og forsoning i Kosovo – kan den likevel føre til noe konkret:

Et forslag om en bred, parlamentarisk delegasjons-reise til Kosovo fikk støtte av et nesten samlet panel under høringen. Bare Høyres Bjørn Hernæs reserverte seg mot tanken.

T. O : NUFRI

NORSKE ARGUS
A-S
BYRÅET FOR AVISUTKLIPP
P.B. 1180, SENTRUM - 0107 OSLO 1
TLF. 20 46 75
Utklipp fra:
16 NOV. 1993
HA
Hamar Arbeiderblad
(Se baksiden)
Opplag 1991: 27 416

INGEN KRISE FOR «ASYLKIRKENE»

HAMAR: Kirkene som skjermer kosovoalbanske flyktninger i Hamar har ingen økonomiske problemer med den daglige driften av kirkens aktiviteter. Andre steder i landet har kirkene måttet leie lokaler for å gjennomføre aktivitetene kirkene har.

I Hamar sitter det nå 21 kosovoalbanske flykninger i kirkeasyl. Av disse er seks barn. Oppholdet til flyktningene blir finansiert gjennom Støttegruppe for kosovoalbanske flykninger i Hamar.

– Vi får penger fra enkeltpersoner og forskjellige organisasjoner. Det hersker ingen økonomisk krise, men vi lever fra måned til måned, sier Anne Hals, leder for støttegruppa i Hamar.

I Den Evangelisk Lutherske Frikirken i Hamar bor det i alt åtte kosovoalbanere. Fire barn og fire voksne har oppholdt seg der siden august i år.

– I vår menighet har vi ingen praktiske problemer ved å ha disse åtte menneskene boende hos oss. Vi ser på tiltaket som svært meningsfullt, og har derfor ingen problemer med å innrette vår alminnelige aktivitet etter deres behov. Aktiviteter som før ble holdt i kjelleren, kan uten problemer avvikles andre steder, sier pastor Øyvind Fjellestad.

På landsbasis er det i alt 562 kosovoalbanske flyktninger som oppholder seg i til sammen 120 kirker. 305 av de 562 er barn. Støttegruppene for kosovoalbanske flyktninger må samle inn i alt 345 250 kroner i måneden til mat og klær for flyktningene. Dette uttaler Elin Pedersen fra støttegruppa i Tromsø.

Referenca nr. 19

Gazeta "Hamar Arbeiderblad", 16 nëntor 1993

NUK PAJTOHEN

E ndajnë shqetësimin e përbashkët për zhvillimet në Kosovë, por nuk pajtohen sa i përket politikës norvegjeze të azilit. Gjatë seancës së dëgjimit për Kosovën të hënën në mbrëmje në Hamar (qytet në Norvegji) paneli përbëhej nga përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë, Berit Foossheim, përfaqësuesja e Amnestit, Laila Belle, përfaqësuesi i Organizatës Norvegjeze për Refugjatë, Jan Borgen, përfaqësuesi i Komitetit Norvegjez të Helsinkit, Nufri Lekaj, përfaqësuesi i Partisë Norvegjeze të Punës (Partisë Socialdemokrate Norvegjeze), Einar Olav Skogholt, përfaqësuesi i Partisë së Majtë Socialiste, Magnar Sortåsløkken, përfaqësuesja e Partisë së Qendrës, Ragnhild Q. Haarstad dhe përfaqësuesi i Partisë së Djathtë, Bjørn Hernæs.

HAMAR

Angazhimi është i madh. Këtë e dëshmoi organizimi i seancës dëgjimore për situatën në Kosovë të hënën në mbrëmje që u aranzhua nga grupi solidar që mbështet shqiptarët nga Kosova dhe nga e Majta Socialiste. Më shumë se 200 persona morën pjesë në seancë, ku rezultoi qartë se shqetësimi është i madh për azilkërkuesit shqiptarë nga Kosova që po dëbohen nga Norvegjia në Kosovë dhe për 21 azilkërkuesit që kanë kërkuar azil kishtar në qytetin Hamar.

NGA: SVERRE FRILSETH

Panelit të përbërë nga përfaqësuesit e Parlamentit, Ministrisë së Drejtësisë, Amnestit, Organizatës Norvegjeze për Refugjatët dhe Komitetit Norvegjez të Helsinkit iu drejtua grupi solidar me pyetjen se a është i drejtë vendimi për t'i kthyer azilkërkuesit shqiptarë në Kosovë.

- Jo, tha Amensty.

- Jo, tha Organizata Norvegjeze për Refugjatë.

- Jo, tha Komiteti Norvegjez i Helsinkit.

- Jo, tha Magnar Sortåsløkken (Partia e Majtë Socialiste) dhe

Ragnild Q. Haarstad (Partia e Qendrës).

- Unë kam besim se Ministria e Drejtësisë në çdo kohë e bën atë çfarë është e duhur dhe e drejtë, tha përfaqësuesi i Partisë Norvegjeze të Punës (Partisë Norvegjeze Socialdemokrate) Einar Olav Skogholt, i cili e mori pëlqimin edhe nga përfaqësuesi i Partisë së Djathtë, Bjørn Hernæs.

- Nuk është luftë në Kosovë dhe çdo vendim për kthim ndaj çdo azilkërkuesi që merr refuzim në kërkesën e tij për azil, e bazojmë në vlerësime të thella, tha përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë, Berit Fossheim.

PRESION

Seanca për Kosovën nuk zbuloi asgjë të re revolucionare në të menduarit e Ministrisë së Drejtësisë, kur është fjala për pikëpamjen ndaj azilkërkuesve shqiptarë. Megjithëkëtë, tani është e qartë se Ministria e Drejtësisë është gjithnjë e më shumë nën një presion në rritje, për ta rishqyrtuar vendimin për kthim të azilkërkuesve shqiptarë nga provinca e ish-Jugosllavisë. Deri më tani 424 shqiptarë janë dëbuar në Kosovë nëpërmjet Maqedonisë, pasi kanë marrë refuzime në kërkesat e tyre për azil në Norvegji.

Përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë, Berit Fossheim, pranoi se autoritetet norvegjeze nuk kanë njohuri të dorës së parë për fatin e azilkërkuesve pas arritjes së tyre në Kosovë, por theksoi fuqishëm se Norvegjia e ka një rrjet të informatorëve në zonën e Kosovës dhe se Ministria e Drejtësisë merr raporte javore për situatën në Kosovë. Njëherë përnjëherë këto raporte nuk janë të një karakteri të tillë saqë të ndikojnë që autoritetet norvegjeze t'i shohin me një sy tjetër azilkërkuesit nga Kosova, tha Fossheim.

PËRKEQËSIM

Gjithnjë e më shumë, shumë organizata argumentojnë se situata për shqiptarët në Kosovë është duke u përkeqësuar edhe më shumë. Amnestit i është ndaluar hyrja në Kosovë, megjithëkëtë kjo organizatë posedon raporte për vrasje, persekutime dhe për diskriminim ndaj shqiptarëve në Kosovë. Këtë e konfirmuan në seancë edhe Organizata për Refugjatë dhe Komiteti i Helsinkit.

Deklarimi i komisionarit për refugjatë pranë OKB-së, se Norvegjia duhet të jetë shumë e kujdesshme në lidhje me kthimin e shqiptarëve në vendin e tyre, interpretohet gjerësisht si një thirrje e qartë për autoritetet norvegjeze për t'u dhënë azil kolektiv shqiptarëve që arratisen nga Kosova.

DËSHMITË

Edhe pse parakushtet për seancën dëgjimore ishin që diskutimet të zhvillohen me një temperaturë më të lartë, kundërshtarët e Ministrisë së Drejtësisë në lidhje me politikën e azilit i paraqitën argumentet e tyre në mënyrë të përmbajtur, duke përkrahur shqiptarët nga Kosova. Përshtypje të forta lanë dëshmitë e shqiptarëve të pranishëm. Këto ishin tregime për persekutimet në vendlindje dhe arratisjet nga vendlindja në një vend të ri me kulturë dhe gjuhë të panjohur për ta, duke refuzuar kështu të kthehen përsëri - në një regjim pushtues që nuk i pranon - ose që i dërgon drejt në burg. Serbët kanë nisur një spastrim të organizuar ndaj shqiptarëve në Kosovë. Ata shqiptarë që nuk ikin rrezikohen të vriten. Shumë shqiptarë në Kosovë janë vrarë nga forcat e regjimit serb, thanë disa prej shqiptarëve të pranishëm në këtë seancë. Përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë, duke i dëgjuar, mori shënime dhe premtoi për t'i ekzaminuar çështjet më tej.

UDHËTIMI

Nëse seanca dëgjimore për Kosovën nuk arriti që përnjëherë t'ia ndryshojë qëndrimin Ministrisë së Drejtësisë në lidhje me politikën norvegjeze të azilit, ose t'i hedhë themelet për paqen dhe pajtimin në Kosovë, arriti të bëjë diçka konkrete: Një propozim për udhëtimin e një delegacioni të gjerë të parlamentit norvegjez për në Kosovë u mbështet pothuajse nga i gjithë paneli. Vetëm përfaqësuesi i Partisë së Djathtë, Bjørn Hernæs, u rezervua ndaj këtij propozimi.

NUK KA KRIZË PËR "KISHAT E AZILIT"

Hamar, - Kishat që strehojnë refugjatët shqiptarë në qytetin Hamar nuk kanë probleme ekonomike për t'i kryer aktivitetet e përditshme kishtare, ndërsa kishat në pjesë të tjera të vendit është

dashur të marrin lokale me qira që të mund t'i ushtrojnë aktivitetet kishtare.

Në qytetin Hamar tani janë 21 refugjatë shqiptarë nga Kosova që kanë kërkuar azil kishtar, gjashtë nga këta janë fëmijë. Qëndrimi i refugjatëve në kishë financohet nëpërmes Grupit Solidar që përkrah refugjatët shqiptarë nga Kosova në këtë qytet. Neve na ndihmojnë financiarisht personat e caktuar dhe organizatat e ndryshme. Kështu që, mund të themi se nuk kemi krizë financiare, por jetojmë nga muaji në muaj, thotë Anne Hals, udhëheqëse e Grupit Solidar që mbështet azilkërkuesit shqiptarë në qytetin Hamar.

Në Kishën Ungjillore Luteriane në qytetin Hamar janë të strehuar që nga gushti i këtij viti tetë shqiptarë nga Kosova, nga këta janë katër fëmijë dhe katër të rritur. Në shoqërinë tonë kishtare nuk kemi asnjë problem praktik që këta tetë persona të jetojnë me ne. Ne e konsiderojmë këtë angazhim tonin si shumë kuptimplotë dhe për këtë arsye nuk kemi kurrfarë probleme që ta përafrojmë detyrën tonë të përbashkët për nevojat e tyre. Aktivitetet kishtare të cilat janë mbajtur më parë në katin e parë të kishës mund të mbahen në të tjera vende, thotë prifti Øyvind Fjellstad.

Në nivel vendor ka një total prej 562 refugjatësh kosovarë që janë të strehuar në 120 kisha, 305 nga 562 janë fëmijë. Grupet e solidaritetit që mbështesin refugjatët shqiptarë nga Kosova duhet të mbledhin një total prej 345 250 kronash në muaj, për ushqim dhe veshmbathje për refugjatët. Këtë e thotë Elin Pedersen nga grupi i solidaritetit që mbështet shqiptarët nga Kosova në Tromsø (qytet në Norvegji).

VÅRT LAND torsdag 25.november 1993 NYHETER

KIRKEASYL

«Gi midlertidig opphold - og øk presset mot Serbia»

Norske myndigheter bør snarest komme fram til en ordning med midlertidig opphold for alle kosovoalbanere som er i Norge. Samtidig må Kosovo-spørsmålet inn i forhandlingene om en fredsløsning i Bosnia.

Av Geir Ove Fonn
Vårt Land

DET er kosovoalbaneren Nufri Lekaj som sier dette til Vårt Land. 32-åringen flyktet til Norge i 1987, etter å ha tilbragt fem år i fengsel for politisk opposisjonsvirksomhet i Kosovo.

Til tross for sin åpenbare status som politisk flyktning måtte Lekaj vente et helt år før han fikk innvilget sitt politiske asyl i 1988. Stuet sammen med 150 andre asylsøkere på flyktningeskipet «Fridtjov Nansen» opplevde han en slitsom ventetid - som han skulle ønske de landsmenn som i dagens situasjon har flyktet til Norge, kunne bli spart for.

- Det er meningsløst av norske myndigheter å tviholde på sitt prinsipp om individuell behandling av asylsøknadene fra Kosovo. Bare et svært lite antall er klassiske politiske flyktninger, men de risikerer alle å bli utsatt for kraftige overgrep hvis de sendes tilbake til Kosovo, påpeker Lekaj, som til daglig arbeider med menneskerettsspørsmål i Den norske Helsingfors-komiteen.

Den internasjonale Helsingfors-komiteen la i går fram ytterligere dokumentasjon på den økende undertrykking som serberne står bak i Kosovo. Blant overgrepene er vilkårlige drap og tortur, påpeker Helsingforskomiteen. Rapporten viser også til at den serbiske nasjonalforsamlingen nå prøver å fremskynde den etniske utrenskningen, ved å tilby kontantstøtte til folk av ikke-albansk avstamning som slår seg ned i Kosovo. Det er også lagt ytterligere begrensninger på reisevirksomhet, privat eiendomsrett og bruken av albansk språk.

Nufri Lekaj er aktiv i en politisk organisasjon i Kosovo, og har direkte tilgang på informasjon fra hjemlandet. Han mener at alle fakta tyder på at situasjonen blir gradvis verre i Kosovo. 32-åringen er takknemlig for at ikke minst kirken har fått problemene i Kosovo på dagsorden i Norge, men han savner politiske initiativ for å få den vanskelige situasjonen med i hele fredsprosessen i det tidligere Jugoslavia.

Ikke-vold

- Norge og andre land vurderer det slik at faren for krig i Kosovo ikke er åpenbar, fordi befolkningen ikke er bevæpnet, og fører en ikke-voldelig mostandskamp. Kosovo har dessverre ingen sterke allierte i det internasjonale samfunnet, bare et politisk og økonomisk svakt Albania. Dette regnestykket kan dessverre vise seg å bli helt feil, fordi det også er grenser for tålmodighet i en hardt prøvet befolkning. Det er mennesker det gjelder, og de kan bli så motløse at de til slutt har mer lyst til å dø enn å til å leve, sier Lekaj.

Det Lekaj frykter nå, er at verdenssamfunnet går inn på en fredsavtale i Bosnia, der Kosovo ikke står på dagsorden. Hvis delingen av Bosnia aksepteres og FN opphever sin boikott av Serbia, er situasjonen for det albanske flertallet på 90 prosent i Kosovo alvorlig svekket. Serberne vil da kunne fortsette sin apartheid-politikk i provinsen, og Lekaj regner det som en meget sannsynlig utvikling at dette kan føre til krig der omkringliggende land som Tyrkia, Hellas, Albania og Russland blir trukket med. Dermed er verdens skrekk-scenario raskt en realitet - et Balkan i flammer.

Målet må være at flyktningene en gang skal kunne vende hjem, fastslår Nufri Lekaj. FOTO: HÅVARD SÆBØ

- Med FN-megler Thorvald Stoltenberg sentralt plassert, kan Norge spille en rolle for å få Kosovo-problemet på forhandlingsbordet. Hvorfor blir ikke Kosovos desperate situasjon tatt med når man søker en helhetlig løsning for regionen? spør Lekaj, som viser til den norske innsatsen for å bringe den serbiske Krajina-«republikken»i Kroatia til forhandlingsbordet.

Urealistisk

Menneskerettsforkjemperen Nufri Lekaj ser at det ikke er realistisk å få til en rask overgang til selvstyre for albanerne i Kosovo, men han mener en fredsløsning må innebære en plan for et nøytralt og demilitarisert Kosovo under FN-overvåkning, der man har selvstendighet som et framtidig mål.

Referenca nr. 20

Gazeta "Vårt Land", e enjte, 25 nëntor 1993

"U jep leje të përkohshme qëndrimi dhe ngrit presionin mbi Serbinë"

Qeveria norvegjeze duhet sa më parë të aprovojë një rregullore për leje qëndrimi të përkohshëm për shqiptarët e Kosovës, të cilët gjenden në Norvegji. Njëkohësisht, çështja e Kosovës duhet të kyçet në kuadër të negociatave për zgjedhjen e konfliktit për Bosnje. Qëllimi duhet të jetë që të gjithë refugjatët një ditë të kthehen në shtëpi, konsideron Nufri Lekaj.

Nga Geir Ove Fonn

Është shqiptaro-kosovari Nufri Lekaj që e thotë këtë për gazetën "Vårt Land". 32-vjeçari ka ardhur në Norvegji në vitin 1987, pas qëndrimit pesë vjet në burg për veprimtari politike në Kosovë. Edhe pse haptazi meritor për statusin e azilit politik, Lekaj është dashur të presë një vit të plotë para se t'i lëshohet vendimi i azilit politik në vitin 1988. I vendosur së bashku me 150 refugjatë të tjerë në anijen për refugjatë "Fridtjof Nansen", ka përjetuar një pritje të lodhshme dhe shpreson se bashkëvendësit e tij do të kursehen nga pritjet e tilla. Është e pakuptimtë se Qeveria norvegjeze insiston t'i përmbahet parimit për trajtimin individual të kërkesave të refugjatëve nga Kosova. Vetëm një numër i vogël janë refugjatë në kuptimin e të qenurit refugjatë klasikë politikë, por rrezikohen nga trajtimi çnjerëzor nëse kthehen prapa në Kosovë, saktëson Nufri Lekaj, i cili punon me çështjet e të drejtave të njeriut pranë Komitetit Norvegjez të Helsinkit.

Komiteti Ndërkombëtar i Helsinkit prezantoi dje raportin që dëshmon për reprezaljet në rritje të serbëve ndaj shqiptarëve në Kosovë. Ndër të tjera, dëshmohet për vrasjet arbitrare dhe përdorimin e torturës, saktëson Komiteti i Helsinkit. Sipas këtij raporti, parlamenti serb përpiqet ta përshpejtojë spastrimin etnik, duke u ofruar mjete financiare kolonistëve të cilët do të vendosen në Kosovë. Janë vënë kufizime në të drejtën e lëvizjes së lirë, në të

drejtën e pronës private dhe në përdorimin e gjuhës shqipe.

Nufri Lekaj është aktiv në një organizatë politike në Kosovë dhe ka informacion të drejtpërdrejtë nga vendlindja. Ai mendon se faktet dëshmojnë se situata në Kosovë po përkeqësohet gjithnjë e më shumë. 32-vjeçari është falënderues që edhe kisha norvegjeze ka vënë në rend të ditës problemet e Kosovës, por ai thotë se mungon nisma politike për ta vënë situatën e vështirë të Kosovës në procesin e zgjidhjes së përgjithshme të konfliktit në ish-Jugosllavi.

Jo dhunë

Norvegjia dhe shtetet e tjera konsiderojnë se rreziku i një lufte në Kosovë nuk është i pranishëm, sepse populli është i paarmatosur dhe bën një rezistencë jo të dhunshme dhe se Kosova nuk ka asnjë aleat të fortë ndërkombëtar, vetëm një Shqipëri e cila është politikisht dhe ekonomikisht e dobët. Ky kalkulim mund të dalë krejtësisht i gabueshëm sepse durimi ka kufijtë e vet për një popull të vënë në sprova të mëdha. Këtu flasim për njerëz dhe ata në një situatë do të mund të bëjnë zgjedhje mes robërisë dhe lirisë me çmimin e jetës, thotë Lekaj.

Gjëja që e merakos Lekajn është se, tani kur bashkësia ndërkombëtare është duke e filluar një proces për një marrëveshje ndërkombëtare të paqes për Bosnjën, Kosova nuk është në rend të ditës. Nëse ndarja e Bosnjës pranohet dhe Kombet e Bashkuara heqin sanksionet ndaj Serbisë, situata për 90 % të popullatës shqiptare në Kosovë do të keqësohet edhe më shumë. Serbët do ta vazhdojnë politikën e aparteidit, e Lekaj mendon se kjo ka gjasë të madhe të shpjerë tek një luftë e cila mund t'i përfshijë edhe vendet përreth si Turqinë, Greqinë, Shqipërinë dhe Rusinë. Kështu që, shumë shpejt mund të bëhet realitet skenari botëror i tmerrshëm: Ballkani në flakë.

Me negociatorin norvegjez të Kombeve të Bashkuara, z. Thorvald Stoltenberg, i cili ka rol qendror në këto procese, Norvegjia mund të luajë një rol të rëndësishëm për ta vënë problemin e Kosovës në tryezën e negociatave. Pse nuk përfshihet edhe situata desperate politike në Kosovë kur të gjithë jemi pro arritjes së një paqe të përgjithshme për të gjithë rajonin?, - pyet Lekaj, duke iu referuar angazhimit norvegjez për ta përfshirë "republikën" serbe të Krahinës

në Kroaci në tryezën e negociatave.

Jorealiste

Aktivisti për të drejtat e njeriut, Nufri Lekaj, nuk e sheh realist një pavarësim të shpejtë të Kosovës, mirëpo mendon se zgjedhja paqësore duhet të nënkuptojë një plan për një Kosovë të demilitarizuar dhe neutrale nën mbikëqyrjen e Kombeve të Bashkuara, duke e pasur si qëllim në të ardhmen pavarësimin e Kosovës.

Referenca nr. 21

Kafeneja tek St. Croix ju fton për ligjëratë në lidhje me KONFLIKTIN NË BALLKAN

- *para JUGOSLLAVISË dhe pas saj*
- *Profesori Svein Mønesland, profesor i gjuhëve sllave, njëkohësisht ekspert i njohur për Ballkanin*

Situata për shqiptarët në KOSOVË
- *Nufri Lekaj nga Komiteti Norvegjez i Helsinkit*
- *Lekaj është i kyçur në "Aksionin Norvegji - Shqipëri", projekt në kuadër të KNH*

*** Servojmë kekë shqiptarë dhe, natyrisht, kafe dhe çaj.*
*** Ndajmë libra dhuratë*



NE NË KAFENENË E LIBRIT U DËSHIROJMË MIRËSEARDHJE NË EVENIMENTIN E PARË TË VJESHTËS

*** KOHA, 5 shtator, ora 18:00*
*** VENDI: Kafeneja e librit St. Croix – SHTËPIA*

Aftenposten Torsdag 18. mars 1993

Berit Backer

Det är med djup bestörtning som jag och min fru mottar budet om att Berit Backer mördats av en kosovoalban.

Ingen i Norden har förmodligen gjort mer än Berit Backer för att sätta sig in och förklara albanernas situation. Hon var en mycket kompetent forskare om det albanska folket och en välinformerad och objektiv iakttagare av situationen på Balkan, särskilt i Albanien och Kosovo.

Jag har träffat henne åtskilliga gånger under de senaste åren i framförallt Albanien, och ofta kunnat dra nytta av hennes djupa insikter om det politiska och ekonomiska läget där. Jag har ibland också haft tillfälle att läsa hennes intressanta analyser.

För mig, min fru och andra kolleger som kom i kontakt med henne, var hon en härlig människa — modig, kunnig, öppen och vänlig.

Med Berit Backers bortgång har de nordiska staterna förlorat en forskare och observatör om den albanska situationen som vi inte kan ersätta utan vidare.

Hon gick bort i en tid när hennes kunskaper behövdes mer än någonsin.

Våra tankar går till dem som stod Berit Backer nära och de många albaner i Albanien och Kosovo som nu måste uppröras över illdådet och sörja en nära vän och insiktsfull hjälpare.

JAN AF SILLÉN
Sveriges ambassadör i Jugoslavien och Albanien 1987—92.

Referenca nr. 22

Gazeta "Aftenpoften", mars 1993

Berit Backer

Me pikëllim të thellë unë dhe zonja ime morëm lajmin për vrasjen e Berit Backerit nga një shqiptar i Kosovës. Askush në shtetet nordike nuk ka bërë më shumë se Berit Backer për të njohur dhe sqaruar situatën e shqiptarëve. Ajo ishte një shkencëtare shumë kompetente për popullin shqiptar dhe një vrojtuese e mirinformuar dhe objektive e situatës në Ballkan, posaçërisht në Shqipëri dhe Kosovë. Unë e kam takuar shumë herë këto vitet e fundit në rrugën e saj për në Shqipëri dhe shpesh kam pasur mundësinë të përfitoj nga njohuritë e saj të thella për gjendjen politike dhe ekonomike atje. Gjithashtu, nganjëherë më ka rastisur t'i lexoj edhe analizat interesante të saj.

Për mua, zonjën time dhe kolegët e tjerë të cilët ishim në kontakt me të, ajo ishte një person i mrekullueshëm, e guximshme, e shkathët, e hapur dhe miqësore. Me vdekjen e Berit Backerit shtetet nordike kanë humbur një observatore të situatës së shqiptarëve, të cilën nuk ka kush ta zëvendësojë. Ajo iku kur më shumë se kurrë nevojiteshin njohuritë e saj.

Mendimet tona shkojnë tek të gjithë ata të cilët ishin të afërt me Berit Backerin dhe tek shumë shqiptarë në Shqipëri dhe Kosovë, të cilët i ka prekur vdekja e saj tragjike dhe i ka kapluar zija për humbjen e një mike dhe përkrahëse të pashoqe.

JAN AF SILLÉN
Ambasador i Suedisë në Jugosllavi e Shqipëri 1987 - 1992

Referenca nr. 23

EKSKLUZIVE, NR. 7/2000

Jetëshkrim i shkurtër i dr. Berit Backerit

Milaim Zeka

Dr. Berit Backer u lind në vitin 1947 në qytetin Mandal të Norvegjisë. Ajo kreu studimet në Degën Sociologji Antropologji në Universitetin e Bergenit. Studimet e larta universitare i mbaroi në Universitetin e Oslos. Temën për diplomim, magjistrim, specializim dhe doktoraturë e kishte nga kultura shqiptare dhe titullohej: "Struktura e familjes shqiptare". Për ta realizuar këtë temë shkoi në Kosovë dhe gjatë viteve 1974-1976-ta qëndroi në familjet shqiptare në fshatin Isniq dhe në rrethinën e tij të pasur me lëndë burimore konkrete për interesimin e saj. Antropologia Berit ishte përqendruar me banim dhe studim në familjen e madhe të Kuklecëve. Aty

jtesë EKSKLUZIVE NR. 7/2000

Jetëshkrim i shkurtër i Dr. Berit Backer-it

Backer dhe Demaçi para Komitetit të Helsinkit (1992)

Dr. Berit Backer u lind në vitin 1947 në qytetin Mandal të Norvegjisë. Ajo kreu studimet në degën Sociologji Antropologji në Universitetin e Bergenit. Studimet e larta universitare i mbaroi në Universitetin e Osllos. Temën për diplomim, magjistrim, specializim dhe doktoranturë e kishte nga kultura shqiptare dhe titullohej: «STRUKTURA E FAMILJES SHQIPTARE». Për ta realizuar këtë temë shkoi në Kosovë dhe gjatë viteve 1974-1976 qëndroi në familjet shqiptare në fshatin Isniq dhe në rrethinën e tij të pasur me lëndë burimore konkrete për interesimin e saj. Antropologia Berit ishte përqëndruar me banim dhe studim në familjen e madhe të Kuklecëve. Aty gjeti dhe studjoi me kujdes të madh strukturën e trashëguar nëpër shekuj të jetës së familjes shqiptare. Ajo u mahnit me format e jetës, punës, qëndrimit dhe raporteve të familjeve të mëdha shqiptare, struktura e së cilave ishte një eveniment i jashtëzakonshëm. Prandaj studimi i saj bëri një jehonë të fuqishme në Universitetin e Osllos. Mjerisht ai studim dhe vlerat e tij ende nuk njihen nga opinionin lexues, madje as nga opinion studiues shqiptar, ashtu siç nuk njihet as edhe Raporti mbi gjendjen e të burgosurve politikë që kjo studiuese e bëri në vitin 1987.

Dr. Berit Backer, kështu u bë e vetmja specialiste në shtetet skandinave që aq mirë e kishte sudjuar dhe e njihte mirë Kosovën. Veçanërisht pas vitit 1990, ajo u bë një ambasadore e vërtetë e Kosovës. Në këtë vit, me bashkëpunëtorët shqiptarë, për herë të parë mundi të sjellë një delegacion të nivelit të lartë nga Kosova në krye me dr. Ibrahim Rugovën që shoqërohej nga Nufri Leka dhe Shkëlzen Maliqi. Ata u pranuan nga tre ministra norvegjezë dhe personalitete të tjera të larta parlamentare dhe kulturore të Norvegjisë. Më vonë, delegacionet që vinin nga Kosova i kishin dyert e hapura në të gjitha rangjet e këtij shteti.

Dr. Berit Backer ftohej, konsultohej dhe i kërkoheshin raporte dhe relacione nga organet qeveritare të Norvegjisë si Ministrisë së Jashtme, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë për Emigracion dhe asociacionet e ndryshme humanitare e profesionale si Amnesty International, Federata e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut etj., sepse ishte kompetente profesioniste për çështjen e Kosovës.

Jeta e atropologes së shquar Dr. Berit Backer u shua në mënyrë mizore, më 7 mars 1993. Ajo u vra me armë të ftohtë nga një vrasës shqiptar me emrin Malë Lajçi, i cili studionte në Suedi. Atëherë u fol shumë për mundësinë e motivimit politik të vrasjes, si një atentat politik, nxitur nga UDB-ja mbi miken e madhe të shqiptarëve, dr. Berit Backer-in. Gjyqi norvegjez konstatoi se krimineli shqiptar ka vrarë Berit Backerin për motive të ulëta! Vallë a është kjo e vërteta!?

Vrasësi gjendet ende në burg. Ndërsa shqiptarët, Kosova humbi, një ndër përkrahësit konkrete më të spikatura në Evropë, në luftën për liri dhe pavarësi nga Serbia.

SHKRUAR NGA MILAIM ZEKA

gjeti dhe studioi me kujdes të madh strukturën e trashëguar nëpër shekuj të jetës së familjes shqiptare. Ajo u mahnit me format e jetës, punës, qëndrimit dhe raporteve të familjeve të mëdha shqiptare, struktura e të cilave ishte një eveniment i jashtëzakonshëm. Prandaj, studimi i saj bëri një jehonë të fuqishme në Universitetin e Oslos. Mjerisht ai studim dhe vlerat e tij ende nuk njihen nga opinioni lexues, madje as nga opinioni studiues shqiptar, ashtu siç nuk njihet as edhe raporti mbi gjendjen e të burgosurve politikë që kjo studiuese e bëri në vitin 1987.

Dr. Berit Backer ishte e vetmja specialiste në shtetet skandinave që aq mirë e kishte studiuar dhe e njihte Kosovën. Veçanërisht pas vitit 1990 ajo u bë ambasadore e vërtetë e Kosovës. Në këtë vit, me bashkëpunëtorët shqiptarë, për herë të parë mundi të sjellë një delegacion të nivelit të lartë nga Kosova në krye me dr. Ibrahim Rugovën, që shoqërohej nga Nufri Leka dhe Shkëlzen Maliqi. Ata u pranuan nga tre ministra norvegjezë dhe personalitete të tjera të larta parlamentare dhe kulturore të Norvegjisë. Më vonë, delegacionet që vinin nga Kosova i kishin dyert e hapura në të gjitha rangjet e këtij shteti.

Dr. Berit Backer ftohej, konsultohej dhe i kërkoheshin raporte dhe relacione nga organet qeveritare të Norvegjisë si Ministrisë së Jashtme, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë për Emigracion dhe asociacionet e ndryshme humanitare e profesionale si Amensty International, Federata e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut etj. sepse ishte kompetente profesioniste për çështjen e Kosovës.

Jeta e antropologes së shquar dr. Berit Backer u shua në mënyrë mizore më 7 mars 1993. Ajo u vra me armë të ftohtë nga një vrasës shqiptar me emrin Malë Lajçi, i cili studionte në Suedi. Atëherë u fol shumë për mundësinë e motivimit politik të vrasjes si një atentat politik, nxitur nga UDB-a mbi miken e madhe të shqiptarëve, dr. Berit Backerin. Gjyqi norvegjez konstatoi se krimineli shqiptar ka vrarë Berit Backerin për motive të ulëta. Vallë a është kjo e vërteta? Vrasësi gjendet ende në burg, ndërsa shqiptarët e Kosova humbën një ndër përkrahëset konkrete më të spikatura në Evropë në luftën për liri dhe pavarësi nga Serbia.

Kosovos president beklager drapet

– Jeg kan ikke forstå at en person med albansk blod i årene kan drepe et menneske som Berit Backer, sa den kosovoalbanske presidenten Ibrahim Rugova til Nufri Lekaj i går ettermiddag. Rugova ringte selv og sa, han var sjokkert over drapet, sier Lekaj.

Berit Backer var en av de viktigste ambassadørene i Vesten for både Albania og de to millioner albanerne i Kosovo.

Hun var nær venn både av den albanske presidenten Sali Berigha, og av presidenten for den provisoriske regjeringen i Kosovo, Ibrahim Rugova.

Også den albanske forfatteren Ismail Kadare, som i mange år har vært en av de fremste favorittene til Nobels litteraturpris, var blant hennes venner.

I bøker, radioprogrammer og avisartikler har Berit Backer i snart 20 år vært en av de viktigste informatorer om forholdene i Albania og det tidligere Jugoslavia. Hun var en av meget få som har hatt kontakter i det som før var den politiske opposisjonen. Og hadde derfor meget gode kontakter med dagens ledere.

Berit Backer snakket både albansk og serbokroatisk flytende.

Dagbladet mars 93

Referenca nr. 24

Gazeta "Dagbladet", mars '93

Presidenti i Kosovës shpreh keqardhje për vrasjen

Nuk mund ta kuptoj se një person me gjak shqiptari në deje të vrasë një person si Berit Backer, i tha presidenti i Kosovës, Ibrahim Rugova, Nufri Lekajt dje pasdite. Rugova e mori në telefon dhe i tha se është i shokuar nga lajmi i vrasjes, thotë Lekaj.

Berit Backer ishte ambasadorja më e spikatur në Perëndim si për Shqipërinë ashtu edhe për dy milionë shqiptarë në Kosovë. Ajo ishte mike e afërt si për presidentin e Shqipërisë, Sali Berishën, po ashtu edhe për presidentin e Qeverisë Provizore të Kosovës, Ibrahim Rugovën.

Ismail Kadare, shkrimtar shqiptar i cili është me vite një ndër kandidatët kryesorë për Çmimin Nobel për Letërsi, ishte një ndër miqtë e saj.

Berit Backer për më shumë se 20 vjet ishte informatorja kryesore për gjendjen në Shqipëri dhe ish-Jugosllavi nëpërmes librave, radioprogrameve, artikujve në gazeta etj. Ajo ishte një nga shumë pak persona që ka pasur kontakte me ata të cilët më herët ishin opozitë, prandaj edhe kishte kontakte shumë të mira me liderët aktualë. Berit Backer fliste rrjedhshëm shqipen dhe serbokroatishten.

MEDICAL
REHABILITATION CENTER
FOR TORTURE VICTIMS

NAMES AND ADDRESSES OF DELEGATES

-Mrs Margareta Olsson
CTD, Center for Torture Survivors
Karolinska Hospital, Box 60500
S-10401 STOCKHOLM- SWEDEN

-Mr Luis Ramos-Ruggiero
CTD, Center for Torture Survivors
Karolinska Hospital, Box 60500
S-10401 STOCKHOLM- SWEDEN

-Mr Hans-Deter Sontergaard
CTD, Center for Torture Survivors
Karolinska Hospital, Box 60500
S-10401 STOCKHOLM-SWEDEN

-Mrs Irene Wakinder
CTD, Center for Torture Survivors
Karolinska Hospital, Box 60500
S-10401 STOCKHOLM-SWEDEN

-Mr Jan Lapins
CTD, Center for Torture Survivors
Karolinska Hospital, Box 60500
S-10401 STOCKHOLM-SWEDEN

-Mr Hartmut Apitzsch
CTD, Center for Torture Survivors
Karolinska Hospital, Box 60500
S-10401 STOCKHOLM -SWEDEN

-Mr Lono Bergstrom
CTD, Center for Torture Survivors
Karolinska Hospital, Box 60500
S-10401 STOCKHOLM-SWEDEN

9 LYCABETTOUS STREET, ATHENS - GREECE, TEL.: 36.04.967, FAX: 36.12.273

Referenca nr. 25

MEDICAL
REHABILITATION CENTER
FOR TORTURE VICTIMS

-Mrs Zuhal Amato
Halk Sagligi Uzmani
ITO Baskani
Bagli oldugu Kurulus: Izmir Tabib Odasi
Nusret Fisek CD No: 5 Als
IZMIR- TURKEY

-Mr Evgeni Guentchev
National Neuroscience and Behavior Research Programme
15m Dim. Nestorov Str.
1431 Sofia
BULGARIA

-Mr Metin Basoglu,
Institute of Psychiatry, De Crespigny Park
99 Denmark Hill
London SE5 8AF
ENGLAND

-Mrs Lilla Hardi
Huvosvolgyi u. 116
1021 Budapest
HUNGARY

-Mrs Maria Frank
Huvosvolgyi u. 116
1021 Budapest
HUNGARY

-Mr Mahboob Mehdi
RAHAT-VAT
P.O.Box 2428
Islamabad
PAKISTAN

MEDICAL
REHABILITATION CENTER
FOR TORTURE VICTIMS

-Mrs Camelia Doru
ICAR Foundation
Bq. Unirii No 27
Bl 15, Sc. 1, Ap.1
Bucharest
RUMANIA

-Suzana Kulovic
MRCT Zagreb
41000 Zagreb
Radiceva 15
KROATIA

-Mrs Kozara Kati Albanian Rehab. Center for Torture Victims
Rr. Kont. Urani No. 17
TIRANA
ALBANIA

-Mr Nufri Lekaj
Aksjon Norge Albania
Urlegata 50, N-0187 Oslo
NORWAY

-Mr Peter Vasti
RCT/IRCT
Juliane Maries Vej 34
P.O. Box 2672
DK-2100 Copenhagen
DENMARK

MEDICAL
REHABILITATION CENTER
FOR TORTURE VICTIMS

BALKAN'S DECLARATION

OF THE BALKAN NETWORK OF REHABILITATION CENTERS FOR TORTURE VICTIMS

******

At this moment Europe goes through a period in which the human rights have become an open wound in the Balkan area. While the effort was concentrated to the institutionalization of the so-called "third generation rights", the most basic rights are again in danger, as is the right to life which is followed by denouncements concerning torture, rape, concentration camps, etc.

With respect to the principles and rules generally recognized by the international society as expressed in:

- the United Nations Universal Declaration of Human Rights (1948)

- the United Nations International Covenant of Civil and Political Rights

- the United Nations Convention against Torture and other Cruel Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (1984)

- the European Convention of Human Rights

- the European Convention on the prevention of Torture

- the World Medical Association's Declaration of Tokyo (1975)

- the United Nations Principles of Medical Ethics (1982)

9 LYCABETTOUS STREET, ATHENS - GREECE, TEL.: 36.04.967, FAX: 36.12.273

- the Global Appeal for the Abolition of Torture adopted by the IRCT in Istanbul (1992)

The Centers for the Rehabilitation of Torture Victims in the Balkan area decided:

- The establishment of a network of cooperation and assistance, in order to better coordinate their action aimed at the prevention of torture and medical care of the victims.

The goals of the Network are the following:

- The prevention and evidence of torture, and the rehabilitation of torture and war victims.
  This regional network will also help for the establishment of a number of Rehabilitation Centers for torture victims wherever this is considered to be necessary within the Balkan area.

- The collection of data and dissemination of information concerning human rights.

- The organisation of training seminars and meetings.

- The investigation of allegation of torture in the Balkan countries where human rights abuses take place.

This network being a regional structure places itself within the international frame and aims also to strengthen the links with the IRCT by giving and evaluating information in a more global way, by presenting common plans of action, by conducting coordinated research and by any other appropriate means.

The same applies to the presentation of common problems concerning the area to the United Nations and European Union as well as to any other national or international authority.

Members of the network are the Centers - existing or to be established - in the Balkan area that accept the present text and abide by its principles.

Centers in the process of being established can subscribe to this declaration provided that within 6 months they will deposit their constituting documents.

Affiliated members can be Centers outside the geographically defined area of the Balkans, but having common areas for action and cooperation.

Each member appoints one representative who will participate in the yearly meetings and will be mandared to take decisions.

This Declaration has been adopted in Athens on November 13, 1993 by the following:

Maria Piniou-Kalli
Medical Director
Greece

Veli Lök
Turkey

Lilla Hardi
Hungary

Nufri Lekaj
Kossovo (Serbia)

Suzana Kulovic
Kroatia

Kozara Kati
Albania

Evgeni Guentchev
Bulgaria

The General Meeting of representatives took the decision to elect a Secretariat which is composed of 3 members and will have a mandate of 3 years.

The three members elected by the General Meeting were: Dr. Veli Lök (Human Rights Foundation of Turkey), Mrs

Kozara Kati (Albanian Rehabilitation Center for Torture Victims) and Dr. Maria Piniou-Kalli (Medical Rehabilitation Center for Torture Victims, Greece).

The Secretariat was decided to have its seat in Athens.

General Secretary of the Network was elected Dr. Maria Piniou-Kalli who was designated to be in charge of the coordination and the representation of the Network.

******

DEKLARATA E RRJETIT BALLKANIK TË QENDRAVE PËR REHABILITIMIN E VIKTIMAVE TË TORTURËS

QENDRA MJEKËSORE PËR REHABILITIMIN E VIKTIMAVE TË TORTURËS

EMRAT E DELEGATËVE

Margareta Olsson, Suedi, Metin Basoglu, Angli
Luis Ramos-Ruggiero, Suedi, Lilla Hardi, Hungari
Hans-Deter Sontergaard, Suedi, Maria Frank, Hungari
Irene Wakinder, Suedi, Mahboob Mehdi, Pakistan
Jan Lapins, Suedi, Camelia Doru, Rumani
Hartmut Apitzsch, Suedi, Suzana Kulovic, Kroaci
Lono Bergstrom, Suedi, Kozara Kati, Shqipëri
Zuhal Amato, Turqi, Nufri Lekaj, Norvegji
Evgeni Guentchev, Bullgari, Peter Vesti, Danimarkë

DEKLARATA E BALLKANIT E RRJETIT BALLKANIK TË QENDRAVE PËR REHABILITIMIN E VIKTIMAVE TË TORTURËS

Evropa është duke kaluar nëpër një periudhë në të cilën të drejtat e njeriut janë bërë plagë e hapur në zonën e Ballkanit. Përderisa përpjekjet ishin të përqendruara në institucionalizimin e të ashtuquajturave "të drejtave të gjeneratës së tretë", përsëri janë në rrezik të drejtat themelore, siç është e drejta e jetës që ka pasuar me denoncime lidhur me torturën, përdhunimin, përqendrimin në kampe etj. Duke respektuar parimet dhe rregullat e mirënjohura gjeneralisht nga bashkësia ndërkombëtare, siç janë të shprehura në:

- Deklaratën Universale të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (1948)

- Paktin Ndërkombëtar të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Civile dhe Politike

- Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Torturës dhe Keqtrajtimit Çnjerëzor dhe Poshtërues apo Degradues ose Ndëshkues (1984)

- Konventën Evropiane për Parandalimin e Torturës

- Deklaratën e Asociacionit Botëror Mjekësor, Tokio (1975)

- Parimet e Kombeve të Bashkuara për Etikën Mjekësore (1982)

- Apelin Global për Zhdukjen e Torturës të miratuar nga IRCT (Këshilli Ndërkombëtar për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës) në Stamboll (1992)

Qendrat për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës në Zonën e Ballkanit vendosën për: Krijimin e rrjetit të bashkëpunimit dhe asistencës, në mënyrë që të koordinohen më mirë veprimet e përbashkëta në synimin për parandalimin e torturës dhe për kujdesin mjekësor për viktimat.

Qëllimet e rrjetit janë:

- Parandalimi dhe dëshmimi i torturës, si dhe rehabilitimi i viktimave të torturës dhe i viktimave të luftës.

- Ky rrjet rajonal gjithashtu do të ndihmojë për themelimin e një numri të qendrave të rehabilitimit për viktimat e torturës kudo që kjo të konsiderohet se është e nevojshme brenda zonës së Ballkanit.

- Grumbullimin e të dhënave dhe përhapjen e informacionit në lidhje me të drejtat e njeriut.

- Organizimin e seminareve trajnuese dhe takimeve.

- Hetimin e akuzave ndaj përdorimit të torturës në vendet e Ballkanit ku ndodhin abuzimet me të drejtat e njeriut.

- Ky rrjet, duke qenë një strukturë rajonale, e vendos veten në kuadër ndërkombëtar dhe gjithashtu synon ta forcojë lidhjen me IRCT (Këshillin Ndërkombëtar për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës) duke dhënë dhe vlerësuar informacionin në një mënyrë më globale, duke paraqitur plane të përbashkëta të veprimit, duke përçuar hulumtime të koordinuara dhe gjëra të tjera që shërbejnë për këtë.

- Gjithashtu, do t'i parashtrojë problemet e përbashkëta të zonës tek Kombet e Bashkuara, tek Bashkimi Evropian si dhe tek çdo autoritet tjetër kombëtar ose ndërkombëtar.

- Anëtarë të rrjetit janë qendrat ekzistuese ose që do të themelohen në zonën e Ballkanit që akceptojnë këtë tekst dhe që u përmbahen parimeve të këtij teksti.

- Qendrat që janë në proces të themelimit mund të bëhen pjesë e kësaj deklarate me parakushtin që brenda gjashtë muajve t'i depozitojnë dokumentet konstituese.

- Anëtarë të bashkëlidhur mund të jenë jashtë gjeografisë së qendrave e definuar si zona e Ballkanit, por që kanë zona të përbashkëta për veprim dhe bashkëpunim.

- Çdo anëtar emëron një përfaqësues i cili do të marrë pjesë në mbledhjet vjetore dhe do të mandatohet për të marrë vendime.

Kjo deklaratë është miratuar në Athinë më 13 nëntor 1993 nga:

Maria Piniou-Kalli (Greqi), Nufri Lekaj (Kosovë)
Veli Lök (Turki), Suzana Kulovic (Kroaci)
Lilla Hardi (Hungari), Kozara Kati (Shqipëri)
Evgeni Guentchev (Bullgari)

Në mbledhjen e përgjithshme të përfaqësuesve u mor vendimi për të zgjedhur një sekretariat të përbërë nga tre anëtarë me mandat trevjeçar. Tre anëtarët e zgjedhur nga mbledhja e përgjithshme janë: dr. Veli Lök (Fondacioni i të Drejtave të Njeriut i Turqisë), znj. Kozara Kati (Qendra Shqiptare për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës) dhe dr. Maria Piniou-Kalli (Qendra Mjekësore për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës, Greqi). U vendos që sekretariati ta ketë selinë në Athinë. Sekretare e përgjithshme e Rrjetit u zgjodh dr. Maria Piniou-Kalli, e cila u caktua të jetë koordinatore dhe përfaqësuese e Rrjetit.

MEDICAL
REHABILITATION CENTER
FOR TORTURE VICTIMS

Nufri Lekaj
Aksjon Norge Albania
Urlegata 50, N-0187
Oslo

Athens, 8 February 1994

Dear friend,

Enclosed please find the text of the *BALKAN'S DECLARATION* for your signature, as well as the Minutes of the Balkan Meeting.

Please let us know within two days if you have any observations.

In case we do not receive anything within this period we will consider that we have your full agreement.

In any case please return, within two days, dully signed by you a copy of the text of the Declaration and the organizational principles needed in order to present an operational budget to the appropriate authorities on behalf of the Network. (The Network has to look as one entity).

Best regards,

MKalli

Maria Piniou-Kalli
Medical Director

NB! Qëndra në Gurgi ka ketë tel 301 3612273
fax 301 3604967

9 LYCABETTOUS STREET, ATHENS - GREECE, TEL.: 36.04.967, FAX: 36.12.273

Referenca nr. 26

QENDRA MJEKËSORE PËR REHABILITIMIN E VIKTIMAVE TË TORTURËS

Nufri Lekaj
Aksioni Norvegji - Shqipëri
Urtegata 50, N-0187
Oslo

Athinë, 8 shkurt 1994

I dashtuni mik,

Tekstin e Deklaratës së Ballkanit për nënshkrimin tuaj, si dhe procesverbalin e mbledhjes i ke të bashkangjitura. Ju lutem na lajmëroni brenda dy ditëve nëse keni ndonjë vërejtje. Në rast se nuk marrim përgjigje nga ju brenda kësaj periudhe, konsiderojmë se e kemi pajtueshmërinë tuaj të plotë. Sidoqoftë, ju lutemi ta ktheni, brenda dy ditëve, kopjen e tekstit të deklaratës dhe parimet organizative të nënshkruara nga ju, si gjë e nevojshme për të paraqitur një buxhet operativ tek autoritetet përkatëse në emër të Rrjetit. (Rrjeti duhet të shihet si një njësi).

Shumë të fala,
Maria Piniou-Kalli

Qendra Shqiptare e Rehabilitimit për të Mbijetuarit e Torturës

WORKSHOPI I -RË RAJONAL

"Trauma, Faktorët, Pasojat dhe Përballimi"

Një Perspektivë Rajonale: Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni

Tiranë
8-10 Dhjetor, 2000

Organizuar nga:
Qendra e Rehabilitimit për të Mbijetuarit e Torturës-QSHRMT

Në bashkëpunim me
Rehabilitation and Research Center for Torture Victims-RCT

Tiranë

1

Referenca nr. 27

WORKSHOPI I -RË RAJONAL

"Trauma, Faktorët, Pasojat dhe Përballimi"

Një Perspektivë Rajonale: Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni

Tiranë
8-10 Dhjetor, 2000

Organizuar nga:
Qendra e Rehabilitimit për të Mbijetuarit e Torturës-QSHRMT
Në bashkëpunim me
Rehabilitation and Research Center for Torture Victims-RCT

Tiranë

Workshop-i i Parë Rajonal
"Trauma, faktorët, pasojat dhe përballimi"
Një perspektivë rajonale: Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni

Tiranë
8-10 Dhjetor, 2000
Organizuar nga:
Qendra Shqiptare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës- QSHRMT
Në bashkëpunim me:
Rehabilitation and Research Center for Torture Victims – RCT, Kopenhagen

First Regional Workshop
"Trauma, factors, consequences and the coping process"
A regional perspective: Albania, Kosova and Macedonia

Tirana
8-10 December 2000
Organized by:
Albanian Rehabilitation Center for Torture Victims-ARCT
In cooperation with:
Rehabilitation and Research Center for Torture Victims- RCT, Copenhagen
(summaries in page)

Address:
Qendra Shqiptare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës
Rruga: "Kont Urani", 10 Tiranë, Albania
Tel.++3554256522
E-mail: arct@albmail.com

PËRMBAJTJA

faqe

- **Organizimi, Punimet, Vendime** .....
- **Pjesëmarrësit në Workshop**.....
- **Adrian Kati**
  Fjala e Hapjes .....
- **Tue Magnussen**
  Strategjia e RCT-së në mbështetje të viktimave
  të torturës në botë.....
- **Prof.As.Dr. Fatmira Rama**
  Retrospektivë e përndjekjes nacionale ndaj shqiptarëve
  dhe integrimi ballkanik .....
- **Prof.Milaim Fejziu**
  Trauma te shqiptarët e Maqedonisë shikuar nga aspekti i
  realizimit të lirive dhe të drejtave të tyre në Maqedoni
  (dhe 4 raporte të Forumit Demokratik për Mbrojtjen e të
  Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Maqedoni-Gostivar).....
- **Prof. Dr. Adem Tamo**
  Trauma te shqiptarët në një perspektivë social psikologjike.....
- **Dr. Dragush Totozani**
  Trajtimi psikosocial në QSHRMT.....
- **Bardhyl Belishova**
  Vecanti të rehabilitimit të viktimave të totalitarizmit në
  Shqipëri.....
- **Dr.Feride Rushiti**
  Prezantimi i QKRMT.....
- **Dr. Shaban Memeti**
  Nevoja e ngritjes së Qendrës së Rehabilitimit për të
  Mbijetuarit e Torturës në Maqedoni.....
- **Niazi Jaho**
  Disa cështje lidhur me Liritë dhe të Drejtat e Njeriut
  në frymën e dokumentave ndërkombëtare dhe
  kushtetutës tonë.....

- **Luan Kroi**
  Eksperienca e Institutit të Integrimit të Përndjekurve
  Politikë në Shqipëri ……..

- **Afërdita Onuzi**
  Mirënjohje për miqtë e mirë si Berit Backer……

- **Përmbledhja e temave në anglisht** ……

WORKSHOPI I PARË RAJONAL

"Trauma, Faktorët, Pasojat dhe Përballimi" Një persepektivë Rajonale:
Shqipëri, Kosovë, Maqedoni.

(Organizimi, Punimet, Vendimet)

Nga data 8 deri në 10 Dhjetor 2000 u mbajt në Tiranë Workshopi i Parë Rajonal me temën " Trauma, Faktorët, Pasojat dhe Përballimi. Një perspektivë Rajonale: Shqipëri, Maqedoni, Kosovë".
Mbajtja e këtij Workshop-i u propozua nga QSHRMT dhe u organizua me përkrahjen e RCT- së

Në këtë workshop morën pjesë përfaqësues nga RCT- Copenhagen, Instituti i Integrimit të Ish të Përndjekurve Politike, Shoqatat e Ish të Përndjekurve Politikë nga Shqipëria , Maqedonia dhe Kosova, Qendra Shqiptare e të Drejtave të Njeriut, Instituti Shqiptar për Hulumtimin e Krimeve të luftës në Kosovë, Departamenti i Rehabilitimit të të Mbijetuarve të Torturës pranë Forumit Demokratik për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut në Maqedoni-Gostivar , profesorë nga Universiteti i Tiranës, Prishtinës dhe Tetovës, drejtuesit e QKRMT-së dhe QSHRMT-së.

Konteksti dhe Pikësynimet e Workshop-it

Qendra Shqiptare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës si partnere e RCT-Copenhagen në kuadrin e lëvizjes ndërkombëtar për lehtësimin e vuajtjeve të të mbijetuarve të torturës, prej vitesh është duke punuar në drejtim të rehabilitimit të të mbijetuarve të torturës si rezultat i shtypjes së regjimit komunist të Enver Hoxhës në Shqipëri. Në kushtet e jashtëzakonshme që u krijuan gjatë krizës kosovare, për t'iu përgjigjur nevojave emergjente të shoqërisë kosovare për të përballuar problemin e mprehtë të pasojave të traumës kolektive të shkaktuar nga shtypja e gjithanshme dhe alarmuese policore e popullsisë shqiptare nga regjimi shovinist i Miloshevicit, QSHRMT dha ndihmesën e vet për krijimin e KRCT-së, Qendrës Kosovare të Rehabilitimit të të Mbijetuarve nga Tortura.

Parë në një kontekst historik, në hapësirat mbarëshqiptare është ushtruar sistematikisht dhunë e genocid etnik ndaj shqiptarëve, dhunë që ka shkaktuar një traumë kolektive në popullsinë shqiptare, të cilës i është mbivendosur trauma e shkaktuar nga shtypja gati 50 vjecare e rregjimeve totalitare komuniste në këto hapësira.
Për shmangien e pasojave të shkaktuara nga një traumë e tillë kolektive dhe e shtresëzuar në kohë, del si një nevojë emergjente që të bashkërendohet puna në një nivel mbarëshqiptar, duke krijuar një sistem network-u të qendrave të rehabilitimit të të mbijetuarve nga torturat. Në një perspektivë të tillë lind nevoja që të punohet për krijimin paraprakisht të një qendre të tillë në Tetovë, në mënyrë që të bëhet e mundshme realizimi i një network-u me qendra në Tiranë, Prishtinë dhe Tetovë.

Realizimi i një Network-u mbarëshqiptar të Qendrave për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës është edhe në logjikën e masave komplekse që ndihmojnë proçesin e stabilizimit mbarëballkanik, që përbën pikësynimin kryesor të përpjekjeve të

mbarë komunitetit euroatlantik për realizimin e Paktit të Stabilitetit për Ballkanin. Është tashmë i njëpërmend fakti se nuk mund të ketë qëndrueshmëri sociale, politike dhe ekonomike në vendet e gadishullit ballkanik nëse nuk realizohet edhe rehabilitimi e integrimi social i grupeve të margjinalizuar të mbijetuarve nga tortura në këto vende. Nëse nuk do të kapërcehet margjinalizimi i këtyre grupeve, ato fare lehtë do të mund të kthehen në vatra gjeneruese të konfliktit shoqëror. Luftrat me bazë etnike në ish Jugosllavi dëshmojnë më së miri për këtë gjë.

Pritmëritë nga Workshop-i

Ajo që pritet si rezultat kryesor është:

- Rënia dakort dhe pleqërimi i rrugëve për të mundësuar hapjen e Qendrës se Rehabilitimit të të Mbijetuarve të Torturës në Tetovë.
- Rezultat i dytë i pritshëm është debati lidhur me modalitetet për ngritjen e një Network-u mbarëshqiptar të qendrave të tilla rehabilituese me pikëmbështetje në Tiranë, Prishtinë dhe Tetovë.
- Përpunimi i një strategjie të përbashkët të punës rehabilituese dhe të avokatësisë në të mirë të të mbijetuarve të torturës dhe për shmangien e shfaqjes së rasteve të reja të torturës në kuadrin e Network-ut mbarëshqiptar.

Zhvillimi i punimeve

Nga referimet dhe diskutimet u argumentua prezenca e pasojave të shumta të një traume kolektive në hapësirat mbarëshqiptare të shkaktuar historikisht nga faktorë të ndryshëm (dhunë, shtypje politike me bazë ideologjike etj.)

Në mënyrë të veçantë u trajtuan pasojat e traumave të viteve të fundit, përballimi i tyre dhe parandalimi i traumave të reja.

Nga referimet dhe diskutimet rezultoi se:

1) Në Kosovë janë probleme të mprehta:

- Preokupimi dhe shqetësimi më i madh i të gjithë pjesëmarrësve të Workshop-it ishte lirimi i menjëhershëm i pengjeve dhe të burgosurve shqiptarë që mbahen ende në burgjet serbe.
- Numri shumë i madh i traumave të jashtëzakonshme të ndodhura në një kohë të afërt.
- Vakumi ligjor për reabilitimin e të mbijetuarve të torturës të viteve '90 dhe më parë.
- Prevenimi i dhunës dhe traumave të reja.

2) Në Maqedoni:

- Nuk është dhënë pafajësi për ish të dënuarit e ndërgjegjës.

- Ka mungesë të interesimit nga shteti dhe organizma ndërkombëtare për rehabilitimin e të mbijetuarve të torturës.
- Ka shkelje e të drejtave të njeriut dhe lirive nga legjislativi dhe ekzekutivi.
- Në burgje ka të dënuar të ndërgjegjës.

3) Në Shqipëri:

- Akoma nuk është realizuar një rehabilitim dhe integrim real i ish të përndjekurve politikë.
- Qëndrimi i sotëm i shtetit dhe një pjese të shoqërisë ndaj të kaluarës komuniste dhe pasojave të saj gjeneron ngarkesa psikologjike në komunitetin e ish të përndjekurve politikë.

Nga të gjithë diskutuesit krijimi i Network-ut Tiranë, Prishtinë, Tetovë u vlerësua si rruga më e mirë për përballimin e pasojave të traumës dhe parandalimit të tyre dhe se ky Network do ta bëjë më eficiente punën e këtyre tre qendrave, bashkëpunimin me RCT, BAN-in. Network-u Tiranë, Prishtinë, Tetovë në kuadrin e objektivave të Paktit të Stabilitetit Ballkanik do të jepte një ndihmesë për stabilitetin në këto vende dhe rajon.

Në diskutime u trajtuan hartimi i një strategjie të përbashkët për ndihmesën e drejtëpërdrejtë për lehtësimin e vuajtjeve të mbijetuarve nga tortura, për të zhvilluar avokatsi sociale në të mirë të kësaj shtrese dhe për të sensibilizuar shoqërinë për nevojën e ndërmarrjes së masave efikase për parandalimin e shfaqjes së rasteve të reja të ushtrimit të dhunës nga shteti, grupe jo shtetërore ose individë.

U shfaqën mjaft mendime për mundësitë dhe modalitetet e kthimit të Departamentit të Rehabilitimit të Forumit të Drejtave të Njeriut Maqedoni- Gostivar në qendër reabilitimi dhe të krijimit të Network-ut të qendrave të reabilitimit Tiranë, Prishtinë, Tetovë. Mendimi i përgjithshëm ishte se realizimi i tyre duhet të jetë objektivi kryesor i bashkëpunimit të të tre qendrave.

Pakti i Stabilitetit Ballkanik në Workshop-in u vlerësua si një shans për realizimin e objektivave të qendrave dhe ato duhet të sensibilizojnë organizmat përkatëse për rëndësinë e reabilitim-integrimit të të mbijetuarve të torturës dhe ish të përndjekurve politikë në arritjen e stabilitetit të vendeve dhe të rajonit.

Vendime

1) T'u drejtohet organizmave ndërkombëtare një thirrje për lirimin e pengjeve dhe të burgosurve të mbajtur në burgjet serbe.

2) Të vazhdojë bashkëpunimi i tre qendrave:

-Në realizimin e objektivave të tyre, dhe zgjidhjen e problemeve shqetësuese,në mënyrë të vecantë të lehtësimit të vuajtjeve të të mbijetuarve të torturës dhe të dënuarve të ndërgjegjes.
-Në konstituimin e Qendrës së Rehabilitimit të Tetovës dhe Network-ut Tiranë- Prishtinë- Tetovë.

-Në realizim të projekteve të vecanta dhe të përbashkëta jashtë dhe brenda kuadrit të Paktit të Stabilitetit dhe BAN-it.

3) T'i propozohet Presidentit të Republikës dekorimi i znj. Berit Backer në shenjë mirënjohjeje për kontributin e saj për shoqërinë shqiptare.

LISTA E PJESËMARRËSVE

Shqipëri

1. **Marenglen Spiro**, Rektor i Universitetit të Tiranës.
2. **Adem Tamo**, Prof.Dr. në Universitetin e Tiranës.
3. **Fatmira Rama**, Prof.As.Dr. në Universitetin e Tiranës.
4. **Afërdita Onuzi**, Drejtoreshë e Institutit të Kulturës Popullore.
5. **Niazi Jaho**, Jurist i Komitetit Shqiptar të Helsinkit
6. **Kozara Kati**, Drejtoreshë e Qendrës Shqiptare për të Drejtat e Njeriut dhe Kryetare e tryezës së Demokracisë të Komisionit Parlamentar për Paktin e Stabilitetit.
7. **Kino Buxheli**, Qendra Shqiptare e Rehabilitimit të Mbijetuarve të Torturës.
8. **Luan Kroi**, Drejtor Drejtorie në Institutin e Integrimit të ish të Përndjekurve Politikë.
9. **Tanush Mulleti**, Sekretar i Përgj. Shoqatës Kombëtare të Ish të Dënuarve dhe Persekutuarve Politikë të Shqipërisë.
10. **Tomorr Aliko**, Kryetar i Shoqatës Antikomuniste të Ish të Përndjekurve Politikë Demokratë.
11. **Lili Ndoci,** Sekretare e Përgj. e Shoqatës Antikomuniste të Ish të Përndjekurve Politikë Demokratë.
12. **Uran Kalakula**, Shkrimtar dhe studiues, ish i përndjekur politik.
13. **Adrian Kati**, Qendra Shqiptare e Rehabilitimit të Mbijetuarve të Torturës.
14. **Tue Magnussen**, Rehabilitation and Research Center for Torture Victims-RCT, Kopenhagen.
15. **Dragush Totozani**, Qendra Shqiptare e Rehabilitimit të Mbijetuarve të Torturës.
16. **Ariel Çomo**, Qendra Shqiptare e Rehabilitimit të Mbijetuarve të Torturës.
17. **Bardhyl Belishova**, Qendra Shqiptare e Rehabilitimit të Mbijetuarve të Torturës.
18. **Delisa Uruçi**, Qendra Shqiptare e Rehabilitimit të Mbijetuarve të Torturës.

Kosova

1. **Feride Rushiti**, Drejtore e Qendrës Kosovare të Rehabilitimit të Mbijetuarve të Torturës.
2. **Arif Birinxhiku**, Neuropsikiatër, Prishtinë.
3. **Arsim Bajrami**, Prof.Dr.Universiteti i Prishtinës.
4. **Adem Hasani**, Kryetar i Institutit Shqiptar për Hulumtimin e Krimeve të Luftës në Kosovë.

Tetovë, Maqedoni

1. **Prof. Milaim Fejziu**, Universiteti i Tetovës.Kryetar i Senatit, Universiteti i Tetovës.
2. **Dr. Shaban Memeti**, Tetovë.
3. **Xhevat Ademi**, Shoqata e Ish të Përndjekurve Politikë, Maqedoni.
4. **Dr.Kastriot Haxhirexha**, Deputet në Parlamentin e Maqedonisë

ARDIAN KATI

FJALA E HAPJES NË WORKSHOP-IN E PARË RAJONAL

Të nderuar miq, të ftuar pjesëmarrës në këtë takim pune, mirë se keni ardhur! Në mënyrë të veçantë përshëndesim miqtë tanë të ardhur nga Prishtina dhe Tetova.

Do të doja të hapnim punimet e këtij workshopi duke nderuar viktimat e torturës kudo në botë me një minutë heshtje.

Jemi mbledhur së bashku, këtu në Tiranë, për të shkëmbyer mendime dhe përvoja lidhur me punën tonë fisnike për të lehtësuar dhimbjet e për të rehabilituar të mbijetuarit nga tortura. Në përputhje me nevojat për një punë të përbashkët midis qendrave të Tiranës, Prishtinës, dhe departamentit përkatës në Tetovë, kemi menduar që të koordinojmë punën në mënyrë që të ndihmojmë këtë departament të ngrihet në nivelin e një qendre dhe kësisoj të mund të krijojmë një lidhje koordinuese të bashkëpunimit midis tyre. Ne e kemi emërtuar atë Network-u Rajonal Mbarëshqiptar i Qendrave për Rehabilitimin e të Mbijetuarve nga Tortura. Ndoshta ky emërtim nuk është shumë i goditur dhe nuk i përgjigjet si duhet pikësynimeve tona, por mendoj se nuk është kjo gjëja më kryesore. Ne dëshirojmë të ecim përpara dhe të zhvillohemi nga pikëpamja institucionale, duke rritur kapacitetet në funksion të realizimit sa më të mirë të misionit tonë fisnik.

Jemi të mendimit se e gjithë kjo punë që do të bëjmë së bashku në këtë workshop është‌në logjikën e punës sonë, përfshirë këtu edhe atë në kuadrin e Network-ut Ballkanik si dhe të veprimtarisë ndërkombëtare për të realizuar stabilitetin në gadishullin ballkanik.

Ne shpresojmë që në këtë punë do të kemi mirëkuptimin dhe ndihmën e të gjithë miqve dhe kolegëve tanë, në veçanti të atyre të rjeteve të Qendrave të Rehabilitimit të të Mbijetuarve të Torturës. Gjithashtu, duam të përshëndesim Z. Nufri Lekaj nga Kosova, një nga ideatorët e këtij bashkëpunimi.

Shprehim mirënjohjen tonë të veçantë për veprën e Znj. Berit Backer në shërbim të kulturës shqiptare dhe në ndihmë të ish të përndjekurve politikë.

Në emër të Qendrës Shqiptare të Rehabilitimit të të Mbijetuarve të Torturës, ju falenderoj edhe njëherë për pjesmarrjen tuaj dhe shpallim të hapur këtë workshop dhe i uroj atij punime të mbara!

FJALA E HAPJES NGA z. ARDIAN KATI NË WORKSHOP-IN E PARË RAJONAL

Organizuar nga:
Qendra e Rehabilitimit për të Mbijetuarit e Torturës-QSHRMT
Në bashkëpunim me:
Rehabilitation and Research Center for Torture Victims-RCT
Tiranë, 8-10 dhjetor 2000

NJË PERSPKTIVË RAJONALE: SHQIPËRI, KOSOVË DHE MAQEDONI

Të nderuar miq, të ftuar pjesëmarrës në këtë takim pune, mirë se keni ardhur!

Në mënyrë të veçantë përshëndesim miqtë tanë të ardhur nga Prishtina dhe Tetova.

Do të doja t'i hapnim punimet e këtij workshopi duke nderuar viktimat e torturës kudo në botë me një minutë heshtje.

Jemi mbledhur së bashku, këtu në Tiranë, për të shkëmbyer mendime dhe përvoja lidhur me punën tonë fisnike për t'i lehtësuar dhimbjet e për t'i rehabilituar të mbijetuarit nga tortura. Në përputhje me nevojat për një punë të përbashkët midis qendrave të Tiranës, Prishtinës dhe departamentit përkatës në Tetovë, kemi menduar ta koordinojmë punën në mënyrë që të ndihmojmë këtë departament të ngrihet në nivelin e një qendre dhe kësisoj të mund të krijojmë një lidhje koordinuese të bashkëpunimit midis tyre. Ne e kemi emërtuar atë Network-u Rajonal Mbarëshqiptar i Qendrave për Rehabilitimin e të Mbijetuarve nga Tortura. Ndoshta ky emërtim nuk është shumë i goditur dhe nuk u përgjigjet si duhet pikësynimeve tona, por mendoj se nuk është kjo gjëja më kryesore. Ne dëshirojmë të ecim përpara dhe të zhvillohemi nga pikëpamja institucionale, duke rritur kapacitetet në funksion të realizimit sa më të mirë të misionit tonë fisnik.

Jemi të mendimit se e gjithë kjo punë që do të bëjmë së bashku në këtë workshop është në logjikën e punës sonë, përfshirë këtu edhe atë në kuadrin e Network-ut Ballkanik si dhe të veprimtarisë

ndërkombëtare për ta realizuar stabilitetin në Gadishullin Ballkanik. Shpresojmë që në këtë punë do ta kemi mirëkuptimin dhe ndihmën e të gjithë miqve dhe kolegëve tanë, në veçanti të atyre të rrjeteve të Qendrave të Rehabilitimit të të Mbijetuarve të Torturës. Gjithashtu, duam të përshëndesim z. Nufri Lekaj nga Kosova, një nga ideatorët e këtij bashkëpunimi.

Shprehim mirënjohjen tonë të veçantë për veprën e znj. Berit Backer në shërbim të kulturës shqiptare dhe në ndihmë të ish të përndjekurve politikë.

Në emër të Qendrës Shqiptare të Rehabilitimit të të Mbijetuarve të Torturës, ju falënderoj edhe një herë për pjesëmarrjen tuaj dhe shpallim të hapur këtë workshop dhe i uroj atij punime të mbara!

P. s.: Përpos të tjerash, në këtë workshop u morën këto vendime:

1) T'u drejtohet organizmave ndërkombëtare një thirrje për lirimin e pengjeve dhe të burgosurve të mbajtur në burgjet serbe.

2) Të vazhdojë bashkëpunimi i tri qendrave:

- Në realizimin e objektivave të tyre dhe zgjidhjen e problemeve shqetësuese, në mënyrë të veçantë të lehtësimit të vuajtjeve të të mbijetuarve të torturës dhe të dënuarve të ndërgjegjes.

- Në konstituimin e Qendrës së Rehabilitimit të Tetovës dhe Network-ut Tiranë - Prishtinë - Tetovë.

- Në realizim të projekteve të veçanta dhe të përbashkëta jashtë dhe brenda kuadrit të Paktit të Stabilitetit dhe BAN-it.

3) T'i propozohet presidentit të Republikës dekorimi i znj. Berit Backer në shenjë mirënjohjeje për kontributin e saj për shoqërinë shqiptare.

(Për më shumë në lidhje me workshop-in e parë rajonal: http://www.arct.org/pdf/workshopi1rajonal.pdf)

DEN NORSKE HELSINGFORSKOMITE

appell **Nr. 1/1993**

Makedonia mot anerkjennelse, men hva med albanerne?

Av Nufri Lekaj

Det har i den siste tiden vært fokusert på Makedonia som en følge av at Hellas nekter å anerkjenne staten under navnet Makedonia, men hva skjer egentlig i Makedonia?

Makedonia som område i det gamle Hellas ble kjent under Alexander Den Store av Makedonia hvis far var gresk og mor albansk. Området var i denne perioden under gresk styre og bebodd av grekere, ilyrere (albanere) og trakere. På syvhundre-tallet kom slavere og tyrkere fra Bulgaria og bosatte seg i det østlige Makedonia. Den greske dominansen var på denne tiden for svak til å forhindre innvandring fra Bulgaria. Det medførte at det østlige og sør-østlige Makedonia allerede på 1000-tallet ble bebodd av slaviske stammer. Nord- og vest-Makedonia beholdt sin etniske sammensetning som bestod av albanere, og var en del av det Albanske middelalderike. Deler av Makedonia var bebodd av Bulgarske makedonere som ble styrt av det bulgarske kongerike. Etter at serberne hadde okkupert Kosova, Nord-Albania, Montenegro og Hercegovina i det 7.de århundre klarte de nesten å okkupere det Bulgarske Makedonia. Det mektige serbiske kongerike ble slått av tyrkerne i 14.de århundre og som alle andre land på Balkan ble det makedonske område okkupert av tyrkerne.

Under den tyrkiske okkupasjonen, særlige i det 17.de århundre, begynte det å vokse fram en Makedonsk nasjonalisme som hadde en autonom holdning overfor den Bulgarske nasjonale bevegelse. På den tiden begynte befolkningen i det som i dag kalles Makedonia å kalle seg makedonere og skille seg fra bulgarere. Denne holdningen falt ikke i god jord hos bulgarerne, og den makedonske nasjonalbevegelsen ble i delt i to: autonome nasjonalister og pro-bulgarske nasjonalister. Den første gruppen var sterkest og allierte seg med albanerne som i denne perioden til sammen utgjorde ca.45% av befolkningen i Makedonia og som kjempet mot tyrkerne. Under ledelse av makedonere og albanere begynte frigjøringskampen mot tyrkerne. Den 2. august 1903 ble republikken Krusevo erklært grunnlagt, men etter kort tid ble republikken erobret av tyrkere. Dette intermesso har fått stor betydning for Makedonias historie og for såvel makedonere som albanere.

Ny Serbisk okkupasjon

Allerede i 1912 okkuperte Serbiske styrker Makedonia og erklærte makedonerne for serbere. Det brøt ut krig mellom Serbia og Makedonia. Bulgaria tapte og Makedonia ble i likhet med Kosova en del av det Serbiske kongerike og senere Jugoslavia (etter første verdenskrig). Årene fra 1912 til 1940 kan anses som de vanskeligste for Makedonias befolkning. Hverken makedonerne eller albanerne hadde noen menneskerettighetsbeskyttelse og ble offisielt kalt serbere.

Annen verdenskrig og den makedonske republikk

Det Makedonske kommunistparti hadde kontakt med det Bulgarske kommunistparti. Kominterns holdning før annen verdenskrig var at staten Jugoslavia skulle opphøre og flere selvstendige stater dannes. Makedonia skulle deles mellom Bulgaria og Albania. Kosova skulle tilhøre Albania. Etter at annen verdenskrig brøt ut gikk nasjonalistiske serbiske sosialister under ledelse Alexander Rankovic og Milovan Djilas mot Kominterns linje. Også

Referenca nr. 28

ikke-kommunistiske serbiske ledere støttet dette i motsetning til makedonerne og albanerne. Det førte til en ny situasjon i Makedonia hvor flertallet av kommunistene som støttet den pro-bulgarske bevegelsen ville legge Makedonia under Bulgaria. De serbiske kommunistene sendte sine agenter til Makedonia i 1941/42 for å drive propaganda mot pro-bulgarere og for en makedonsk republikk i den jugoslaviske føderasjon. Dette synet fikk støtte i den Makedonske nasjonalbevegelsen som støttet makedonsk autonomi med det til følge at det i 1943 ble dannet et nytt Makedonsk kommunistparti med pro-jugoslavere i spissen.

Det pro-bulgarske partiet mistet etter hvert støtten som en følge av at Bulgaria var alliert med Tyskland og fordi mange bulgarere hadde sympati med Sovjet-Unionen. I 1943, 1944 og 1945 deltok makedonerne og albanerne aktivt i krigen mot Tyskland. Etter krigens slutt ble Makedonia republikk i Jugoslavia.

DE TIDLIGERE UNDERTRYKTE BEGYNNER Å UNDERTRYKKE

Etter krigen ble Makedonia dannet som et mønster for nasjonal rettferdighet, albanerne ble valgt og representert i statsapparatet på samme vilkår som makedonerne og Makedonia ble både Makedonsk og Albansk republikk. Dette varte bare i tre år som følge av den serbiske politikken. Serbisk politikk skremte makedonerne med at albanerne ville overta styringen av Makedonia og at landet ville bli en del av Albania hvis albanerne fikk fortsette i sine posisjoner. Makedonerne ble oppfordret til å slå til mot albanerne på samme måte som serberne gjorde mot albanerne i Kosova og Montenegro. De makedonske nasjonalistene som var samlet rundt kommunistpartiet begynte allerede i 1948 å undertrykke sine naboer og faktisk hardere enn den serbiske undertrykkelsen i Kosova. For eksempel kan nevnes: Alle albanske politiske ledere og de som hadde vært motstandsfolk mot tyskerne under krigen ble fengslet og internert. Bøker og radiosendinger på albansk ble forbudt, skoler stengt og de albanske navnene ble slavifisert osv.

I 1970-årene ble det litt mer liberalt som en følge av Titos oppgjør med Serbiske nasjonalister og i grunnloven av 1974 ble albanerne i Makedonia anerkjent som et folk og formelt likestilt. I praksis kom det lite ut av dette i en befolkning hvor albanere utgjør ca. 50% og som bare fikk lære og benytte sitt morsmål til og med fjerde klassetrinn, fikk utgi en avis pr.uke, og sende to timer pr. uke med albanske radioprogram. De nasjonalistiske krefter var fortsatt sterke både i lokal- og statsadministrasjon.

Året 1981 ble et vendepunkt for albanerne i Makedonia og Kosova. I Kosova krevde albanerne sin egen republikk. Kravet ble slått ned av en serbisk militær- og politiaksjon. Albanerne i Makedonia viste solidaritet overfor albanerne i Kosova noe som medførte at de makedonske nasjonalistene fratok albanerne de få rettighetene de hadde. De makedonske nasjonalistene ble igjen skremt av serbiske nasjonalisters propaganda om at hvis albanerne fikk en egen republikk i Kosova ville de også kreve områder i Makedonia. Det er ikke riktig. Fram til 1991 var det en systematisk makedonsk undertrykking og vandalisering av alt som er av albansk kultur og nasjonal tilhørighet. Politiske drap og fengslinger, riving av albanske boliger osv.

MAKEDONIA UNDER OPPLØSNINGEN AV JUGOSLAVIA.

Serbernes gamle argument om at Makedonia bare kan eksistere hvis det er en del av Jugoslavia har lenge blitt brukt også av pro-jugoslaviske makedonere. I det første frie valget i Makedonia vant et pro-jugoslavisk parti som nølte med å respektere valgresultatet i de byene hvor albanerne utgjør flertallet. Det ble hevdet at "vi kan ikke akseptere at en albaner blir ordfører i en makedonsk by" (albanerne er ikke verd en slik stilling). Etter krigen i Slovenia og Kroatia har imidlertid denne pro-jugoslaviske holding blitt stadig svakere med det til følge at nasjonalistene i sentrum og de pro-bulgarske har dannet flertall i parlamentet og bestemt seg for løsrivelse fra rest-Jugoslavia.

Samtidig vokser en makedonsk ide om at Makedonia vil klare seg som suveren stat. Serbia spiller på at en løsrivelse vil føre til at Makedonia vil bli delt mellom Bulgaria og Albania. Samtidig blokkerer det tradisjonelt allierte Hellas at EF anerkjenner landet under navnet Makedonia fordi det gamle Makedonia strekker seg inn i den nordlige Hellas.

Albanerne på sin side har flere ganger i det Makedonske parlament (25 representanter) forsøkt å overbevise makedonerne om at et stabilt og nøytralt Makedonia ikke kan eksistere uten albansk representasjon i offentlige organer. De nye makthaverne i Makedonia har til nå ikke etterkommet dette kravet. Det er et tegn på en uavklart fremtid og vil bare styrke posisjonene til den pro-serbiske og pro-bulgarske ide.

I påvente av en avklaring i den ene eller den andre retning har albanerne i Vest-Makedonia avholdt folkeavstemning om det bør opprettes et eget autonomt område i Ilirida innenfor den Makedonske stat. Flertallet gikk inn for dette, men man avventer å gjøre noe inntil begge parter kan finne en løsning. Albanerne støtter et selvstendig Makedonia der folkegruppene er likestilt.

Et stabilt forhold mellom albanerne og makedonerne i Makedonia vil ha stor betydning for landets fremtidige stabilitet og svekke den serbiske apetitt på makt i området.

appell Side 3

Det greske utspillet om at de ikke aksepterer navnet Makedonia fordi det er et gresk navn og frykten for at Makedonia vil kreve en provins i Hellas med samme navn er lite sannsynlig fordi det også i Bulgaria finnes en provins med samme navn. Fra et militært synspunkt vil Makedonia bli en svak faktor i forhold til Hellas og Bulgaria. Den greske motstanden mot dette er pisket opp av Serbia hvor Milosevic har foreslått et statsforbund overfor Hellas. Hvordan kan dette gjennomføres uten at Makedonia deles?

Den greske motstanden mot anerkjennelse under navnet Makedonia er kunstig når dette navnet har vært akseptert i 200 år. Hellas og resten av EF i likhet med verdensamfunnet må være oppmerksom på den politiske og menneskerettslige situasjonen til albanerne i Makedonia. Et Makedonia som ikke tar hensyn til albanerne vil ikke bare bli en skrøpelig stat, men kanskje en konflikt lik den som er i Kroatia og Bosnia.EF og Vesten må presse Makedonske myndigheter til å respektere albanerne og Hellas til å anerkjenne staten under navnet Makedonia.

KOMITETI NORVEGJEZ I HELSINKIT

Appel Nr. 1/1993

Maqedonia drejt njohjes, por çka me shqiptarët?

Nga Nufri Lekaj

Kohët e fundit është fokusuar konsiderueshëm mbi Maqedoninë si rezultat që Greqia nuk do ta njohë me emrin Maqedoni, por çka është duke ndodhur në Maqedoni?

Maqedonia si territor në Greqinë e vjetër u bë e njohur në kohën e Aleksandrit të Madh të Maqedonisë, babai i të cilit ishte grek e nëna shqiptare. Ky territor gjatë kësaj periudhe administrohej nga grekët dhe ishte i banuar nga grekët, ilirët (shqiptarët) dhe trakasit. Në shekullin e shtatë fillon dyndja e sllavëve dhe turqve nga Bullgaria, duke u vendosur në pjesën lindore të Maqedonisë. Dominimi grek ishte i dobët për të ndaluar këtë imigrim nga Bullgaria. Kjo rezultoi që pjesa lindore dhe ajo juglindore e Maqedonisë të banohet nga fiset sllave rreth vitit 1000. Pjesa veriore dhe perëndimore e Maqedonisë mbajti përmbajtjen e vet etnike të përbërë nga shqiptarët dhe ishte pjesë e mbretërisë mesjetare shqiptare. Pjesë të Maqedonisë ishin të banuara edhe nga maqedonasit bullgarë që udhëhiqeshin nga mbretëria bullgare. Pasi serbët okupuan Kosovën, Shqipërinë e veriut, Malin e Zi dhe Hercegovinën, gati arritën ta okupojnë edhe Maqedoninë bullgare. Perandoria e fuqishme serbe u thye nga turqit

në shekullin e 14 dhe ashtu si vendet e tjera të Ballkanit edhe Maqedonia u okupua nga turqit.

Gjatë okupimit turk, posaçërisht gjatë shekullit 17, filloi të shfaqet një nacionalizëm maqedon i cili kishte një qëndrim autonom karshi lëvizjes kombëtare bullgare. Rrjedhimisht në këtë periudhë fillon popullata e caktuar në territorin që tani quhet Maqedoni ta quajnë vetën maqedonas dhe të dallohen nga bullgarët. Ky qëndrim nuk u pëlqye nga bullgarët dhe bëri që lëvizja kombëtare maqedone të ndahet në dysh: në nacionalistët autonomistë dhe në nacionalistët pro-bullgarë. Grupi i parë ishte më i fuqishëm dhe u bashkua me shqiptarët të cilët në atë kohë përbënin rreth 45 % të popullatës së Maqedonisë për të luftuar kundër turqve. Më 2 gusht 1903 u shpall Republika e Krushevës, por pas një kohe të shkurtër republika u pushtua nga turqit. Ky intermeco ka pasur një rol të rëndësishëm për historinë e Maqedonisë, për maqedonët sllavë ashtu dhe për shqiptarët.

RIOKUPIMI SERB

Në vitin 1912 forcat serbe okupuan Maqedoninë dhe deklaruan se maqedonët janë serbë. Kjo shkaktoi luftën në mes të Serbisë dhe Bullgarisë. Bullgaria humbi luftën dhe Maqedonia ashtu si Kosova u aneksua duke u bërë pjesë e mbretërisë serbe e më pas asaj jugosllave (pas Luftës së Parë Botërore). Vitet 1912-1940 mund të konsiderohen vitet më të vështira për popullatën e Maqedonisë. Maqedonasit dhe shqiptarët ishin pa të drejta themelore të njeriut dhe zyrtarisht quheshin serbë.

LUFTA E DYTË BOTËRORE DHE REPUBLIKA MAQEDONE

Partia komuniste maqedone kishte kontakt me partinë komuniste bullgare. Qëndrimi i Kominternit para Luftës së Dytë Botërore ishte se shteti jugosllav duhet të shpërbehej dhe disa shtete të pavarura të krijohen. Maqedonia të ndahet në mes të Bullgarisë dhe Shqipërisë dhe Kosova t'i bashkohet Shqipërisë. Pas Luftës së Dytë Botërore komunistët nacionalistë serbë, të udhëhequr nga Aleksandër Rankoviq dhe Millovan Gjillasi, iu kundërvunë linjës së Kominternit.

Linjën politike kundër Kominternit e mbështetën edhe udhëheqësit

jokomunistë serbë, ndërsa shqiptarët dhe maqedonët ishin pro linjës së Kominternit. Rrjedhimisht u krijua një situatë e re në Maqedoni, ku shumica e komunistëve mbështetën linjën pro-bullgare, e cila donte ta bashkonte Maqedoninë me Bullgarinë. Komunistët serbë dërguan agjentët e tyre në Maqedoni në vitet 1941-'42 për të bërë propagandë kundër lëvizjes pro-bullgare, njëkohësisht bënin propagandë pro një republike maqedone në kuadër të Federatës Jugosllave. Pikëpamja e kësaj propagande u mbështet nga lëvizja kombëtare maqedone autonomiste dhe në vitin 1943 u themelua një parti e re komuniste e Maqedonisë me pro-jugosllavët në udhëheqje.

Partia pro bullgare e humbi ndërkohë mbështetjen si pasojë e aleancës bullgaro-gjermane dhe si pasojë e simpatisë së shumë bullgarëve ndaj Bashkimit Sovjetik. Në vitet 1943, 1944, 1945 maqedonët dhe shqiptarët morën pjesë në mënyrë aktive në luftën kundër gjermanëve. Pas luftës, Maqedonia u bë republikë në kuadër të Federatës Jugosllave.

ISH TË SHTYPURIT FILLOJNË TË SHTYPIN

Pas Luftës së Dytë Botërore Maqedonia u krijua si shembull i barazisë kombëtare. Shqiptarët u zgjodhën me përfaqësim në aparatin shtetëror me të njëjtat kushte si maqedonët dhe Maqedonia u bë republikë e maqedonëve dhe e shqiptarëve. Kjo zgjati vetëm tre vjet për shkak të politikës serbe. Politika serbe frikësoi maqedonët me paragjykimin se nëse shqiptarët vazhdojnë t'i mbajnë pozitat e veta do ta marrin udhëheqjen e Maqedonisë dhe se Maqedonia do të bëhet pjesë e Shqipërisë. Maqedonët u urdhëruan të veprojnë kundër shqiptarëve ashtu siç vepronin serbët kundër shqiptarëve në Kosovë dhe Mal të Zi. Nacionalistët maqedonë, të kyçur në partinë komuniste, filluan që nga viti 1948 t'i shtypin fqinjët e tyre shqiptarë edhe më ashpër sesa shtypësit serbë në Kosovë. Për shembull, të gjithë udhëheqësit politikë shqiptarë, duke përfshirë edhe ata që kishin luftuar kundër gjermanëve gjatë luftës, u arrestuan dhe u internuan. Librat dhe radioprogramet në gjuhën shqipe u ndaluan, shkollat u mbyllën dhe emrat e shqiptarëve u sllavizuan etj.

Në fillimvitet 1970-ta situata u liberalizua pak si pasojë e spastrimit të hesapeve mes Titos dhe nacionalistëve serbë dhe në

Kushtetutën e vitit 1974 shqiptarët në Maqedoni u pranuan formalisht si popull i barabartë. Në praktikë u bë shumë pak, ngase në një vend ku shqiptarët përbënin gati 50 % të popullatës, u lejua vetëm mësimi në gjuhën shqipe deri në klasën e katërt, një gazetë javore dhe programi në radio dy orë në javë. Forcat nacionaliste maqedone vazhduan të qëndrojnë të forta në administratën lokale dhe atë qendrore.

Viti 1981 ishte viti i kthesës së madhe për shqiptarët në Maqedoni dhe Kosovë. Në Kosovë shqiptarët kërkonin statusin e republikës. Kjo kërkesë u shtyp me dhunë nga ana e aparatit ushtarak dhe policor serb. Shqiptarët në Maqedoni treguan solidaritet me shqiptarët në Kosovë dhe kjo u përdor nga nacionalistët maqedonë që t'ua ndalojnë edhe ato pak të drejta që kishin shqiptarët në Maqedoni. Nacionalistët maqedonë i frikësoi propaganda nacionaliste serbe që propagandonte se, nëse shqiptarët në Kosovë fitojnë republikën e tyre, ata do t'ia bashkëngjesin republikës së tyre edhe territoret e Maqedonisë. Kjo propagandë serbe shkaktoi deri në vitin 1991 një shtypje sistematike të gjithçkaje që përfaqëson kulturën dhe përkatësinë kombëtare shqiptare në Maqedoni. Vrasje politike, burgosje, rrënimin e shtëpive shqiptare etj.

MAQEDONIA GJATË SHPËRBËRJES SË JUGOSLLAVISË

Argumentimi i vjetër serb, se Maqedonia nuk mund të ekzistojë nëse nuk është pjesë e Jugosllavisë, është përdorur një kohë të gjatë nga maqedonasit pro-jugosllavë. Në zgjedhjet e para të lira në Maqedoni fitoi një parti pro-jugosllave që hezitonte t'i respektonte rezultatet e zgjedhjeve në qytetet ku shqiptarët përbëjnë shumicën. Duke thënë se "nuk mund të pranojnë që një shqiptar të bëhet kryetar bashkie në një qytet maqedon" (shqiptarët nuk vlejnë aq). Pas luftës në Slloveni dhe Kroaci, qëndrimi pro-jugosllav është reduktuar gjithnjë e më shumë duke rezultuar me forcimin e nacionalistëve të qendrës dhe atyre pro-bullgarë, të cilët krijuan një shumicë në parlament dhe vendosën të ndahen nga pjesa e Jugosllavisë së mbetur.

Njëkohësisht, është në forcim e sipër ideja se Maqedonia do të mbijetojë si shtet i pavarur. Serbia nga ana e saj luan kartën se

shkëputja e Maqedonisë do të rezultojë me ndarjen e Maqedonisë në mes të Bullgarisë dhe Shqipërisë. Të njëjtën kohë aleati tradicional serb, Greqia, bllokon që BE-ja ta njohë Maqedoninë me emrin e saj, duke e arsyetuar këtë se Maqedonia e vjetër shtrihet edhe në Greqinë veriore.

Shqiptarët nga ana e tyre (25 përfaqësuesit në parlamentin maqedon) disa herë janë përpjekur t'i bindin maqedonasit se një Maqedoni stabile dhe neutrale nuk mund të ekzistojë pa përfaqësimin e duhur të shqiptarëve në të gjitha nivelet. Pushtetmbajtësit e ri në Maqedoni deri më tani nuk e kanë pranuar këtë kërkesë. Kjo është shenjë e një të ardhmeje të paqartë dhe vetëm se do t'i përforcojë pozicionet e forcave e ideve pro-serbe dhe pro-bullgare.

Në pritje të qartësimit të njërit apo tjetrit pozicion shqiptarët në Maqedoninë perëndimore kanë mbajtur një referendum për krijimin e një autonomie brenda shtetit maqedon me emrin Ilirida. Shumica shqiptare ishte për një zgjedhje të këtillë, por në pritje për një qëndrim nga ana e maqedonasve. Shqiptarët janë për një Maqedoni të pavarur, ku popujt janë të barabartë. Një marrëdhënie stabile në mes të shqiptarëve dhe maqedonëve në Maqedoni do të kishte një rëndësi të madhe për stabilitet dhe do t'i shuante apetitet serbe për këtë territor.

Loja greke, duke mos pranuar emrin e Maqedonisë, me pretekst se ky është një emër grek dhe se ka frikë se Maqedonia do ta kërkojë krahinën greke në Greqi, nuk është e besueshme, sepse edhe në Bullgari shtrihet po ashtu një provincë me të njëjtin emër. Shikuar nga një pikëpamje ushtarake, Maqedonia do të jetë një faktor i dobët ushtarak si për Greqinë ashtu dhe për Bullgarinë. Kjo lojë e emrit është nxitur nga Serbia, ku Millosheviqi i ka bërë propozim Greqisë për krijimin e një lidhje të shteteve. A mund të realizohet kjo lidhje shtetesh pa e ndarë Maqedoninë?

Kundërshtimi grek i emrit të Maqedonisë është artificial, kur dihet se ky emër është akceptuar të përdoret për këtë territor më shumë se 200 vjet. Greqia dhe të gjitha shtetet e Bashkimit Evropian dhe në përgjithësi bashkësia ndërkombëtare duhet të jenë të preokupuara me situatën e të drejtave politike dhe të drejtave të njeriut për shqiptarët në Maqedoni. Një Maqedoni e cila nuk respekton

shqiptarët dhe të drejtat e tyre nuk do të jetë vetëm një shtet i brishtë, por ndoshta edhe një vend konflikti i ngjashëm me atë në Kroaci dhe Bosnjë. Bashkimi Evropian dhe Perëndimi në përgjithësi duhet t'u bëjnë presion pushtetarëve maqedonas për t'i respektuar shqiptarët dhe t'i bëhet presion Greqisë për ta pranuar shtetin me emrin Maqedoni.

MJETET SKANDINAVE TË INFORMIMIT RRETH EKZISTIMIT DHE AKSIONEVE TË UÇK-së

Edhe durimi e ka fundin

Siç thekson gazeta norvegjeze "Dagens Nytt", në këtë shtet shqiptarët kanë filluar të grumbullojnë mjete dhe të regjistrohen vullnetarisht në radhët e UÇK-së

Stokholm, 9 dhjetor

Ka disa ditë rresht që gati në të gjitha mjetet skandinave të informimit është duke u folur e shkruar për aksionet e ndermarra të UÇK-së në disa mjedise të Kosovës, të cilat ishin të drejtuara kundër stacioneve dhe policeve serbe si dhe të bashkepunetoreve shqiptare të kesaj policie. Edhe sot, duke shikuar lamet e byrove të ndryshme informative, verehet një interesim i shtuar i keivre agjencive lidhur me ekzistimin apo mosekzistimin e UÇK-së. Po ashtu, sot në Kanalin e parë të Radio Suedisë dhjetë minuta u trajtua kjo çështje, e cila si epilog pati faktin se dalja në sipërfaqe e UÇK-se është pasoje e një status kuoje që mbreteroi deri me tash si dhe të një dhune të paparë që po ushtron regjimi i Beogradit mbi popullin e pafajshëm shqiptar. Me një fjalë, u tha në këtë emision, edhe durimi e ka fundin. Ndërkaq, gazeta e perditshme autoritative norvegjeze "Dagens Nytt" shkruan sot se shqiptarët e Kosovës me banim në këtë shtet nordik po tubojnë mjete materiale dhe po regjistrohen vullnetarisht në radhët e UÇK-së.

Në këtë informatë, të cilën e konfirmuan edhe mjetet suedeze të informimit, thuhet se Nufri Leka është njëri ndër ata që bën pjesë në udhëheqjen e kësaj organizate, i cili për këtë gazetë thekson se UÇK-ja synim kryesor dhe të vetmin ka çlirimin e Kosovës nga Serbia. Po kështu bëhet me dije se edhe në një tubim të mbajtur në Malme të Suedisë rreth 200 bashkatdhetarë tubuan rreth 12 mijë korona për UÇK-ne.

Do theksuar se sot në emisionin informativ në gjuhën shqipe "Ditari" të Radio- Suedisë u zhvillua një bisedë me një anëtar të Shtabit Qendror të UÇK-së, i cili u përqendrua në aksionet e fundit që i ndermori kjo ushtri, me theks të veçantë në aksionin e 12 nëntorit në Llaushë të Skënderajt, në të cilin, siç tha ai, armiku pati humbje në njerëz dhe dëme të medha materiale, por, si gjithhere ai këto nuk i qiti në sipërfaqe nga frika që pati prej popullit të vet.

XH. ÇITAKU

"BUJKU"

10. XII. 97

Referenca nr. 29

"BUJKU", 10.12.97

MJETET SKANDINAVE TË INFORMIMIT RRETH EKZISTIMIT DHE AKSIONEVE TË UÇK-së

Edhe durimi ka fund

Siç thekson gazeta norvegjeze "Dagens Nytt", në këtë shtet shqiptarët kanë filluar të grumbullojnë mjete dhe të regjistrohen vullnetarisht në radhët e UÇK-së

Stokholm, 9 dhjetor

Ka disa ditë që gati në të gjitha mjetet skandinave të informimit është duke u folur e shkruar për aksionet e ndërmarra të UÇK-së në disa mjedise të Kosovës, të cilat ishin të drejtuara kundër stacioneve dhe policëve serbë si dhe të bashkëpunëtorëve shqiptarë të kësaj policie. Edhe sot, duke shikuar lajmet e byrove të ndryshme informative, vërehet një interesim i shtuar i këtyre ngjarjeve lidhur me ekzistimin apo mosekzistimin e UÇK-së. Po ashtu, sot në kanalin e parë të "Radio Suedisë" dhjetë minuta u trajtua kjo çështje, e cila si epilog pati faktin se dalja në sipërfaqe e UÇK-së është pasojë e një "status quoje" që mbretëroi deri më tash si dhe të një dhune të paparë që po ushtron regjimi i Beogradit mbi popullin e pafajshëm shqiptar. Me një fjalë, u tha në këtë emision, edhe durimi ka fund.

Ndërkaq, gazeta e përditshme autoritative norvegjeze "Dagens Nytt" shkruan sot se shqiptarët e Kosovës me banim në këtë shtet nordik po tubojnë mjete materiale dhe po regjistrohen vullnetarisht në radhët e UÇK-së. Në këtë informatë, të cilën e konfirmuan edhe mjetet suedeze të informimit, thuhet se Nufri Leka është një ndër ata që bën pjesë në udhëheqjen e kësaj organizate, i cili për këtë gazetë thekson se UÇK-ja synim kryesor dhe të vetmin ka çlirimin e Kosovës nga Serbia. Po kështu, bëhet me dije se edhe në një tubim të mbajtur në Malme të Suedisë rreth 200 bashkatdhetarë tubuan rreth 12 mijë korona për UÇK-në.

Po sot në emisionin informativ në gjuhën shqipe "Ditari" të "Radio Suedisë" u zhvillua një bisedë me një anëtar të Shtabit Qendror të UÇK-së, i cili u përqendrua në aksionet e fundit që i ndërmori kjo ushtri, me theks të veçantë në aksionin e 12 nëntorit në Llaushë të Skenderajt, në të cilin, siç tha ai, armiku pati humbje në njerëz dhe dëme të mëdha materiale por, si gjithherë, ai këto nuk i qiti në sipërfaqe për shkak të frikës që pati për popullin e vet.

XH. ÇITAKU

përreth po mbretëron një shqetësim i madh, nga droja e ndërhyrjes së policisë serbe.
Mbrëmë, policia serbe ka kontrolluar të gjitha veturat në hyrje të Vushtrrisë dhe ka maltretuar disa qytetarë.
Ndërsa, sot në orët e mëngjesit, policia serbe shkoi në organizatën "Betonjerka" në Mitrovicë dhe mori në vendin e tij të punës Xhafer Ramën, vëllain e Sadri Ramës nga Balinci.
Policia kërkoi nga Xhaferi që Sadriu të paraqitet në polici, duke thënë se "ndryshe do të ndërmarrim hapa të tjerë"!

Policët keqtrajtuan pa pretekst disa të rinj shqiptarë

Prishtinë, 10 dhjetor (QIK)
Më 7 dhjetor, në Poçestë të Pejës, policia serbe keqtrajtoi rëndë, pa ndonjë pretekst, disa të rinj shqiptarë.
KI i Degës së LDK-së në Pejë se polici serb Stanko Ristoviq, banues i këtij fshati, hyri në lokalin "Biliardo" dhe pasi kërkoi një pije iu drejtua punëtorit Isa Shala (21), po nga ky fshat, duke i thënë pse po qeshesh! Më pas ata u ngatërruan me fjalë, ndërsa polici shkoi në shtëpinë e tij, prej ku thirri policinë në Pejë, nga ku erdhën me të shpejtë dy policë dhe një civil.Ata rrahën rëndë Isanë, të cilit ia lënduan krahun, Valdet Bytyçin (27), gjithashtu ia lënduan krahun, Sylë Bytyçin (27), të cilit ia shkaktuan lëndime në nofull dhe në këmbë dhe Kapllan Bytyçin (23), të cilit gjithashtu i shkaktuan lëndime trupore.
Më pas policët demoluan çdo gjë në lokal dhe shkyen fotografitë e vëna në mur.
Të lënduarit u detyruan të kërkojnë ndihmë mjekësore, ndërsa Syla ende është në gjendje më të rëndë shëndetësore.

Një polic serb u vendos me dhunë në banesën Shefqet Gërxhaliut në Bresje të Fushë-Kosovës

Prishtinë, 10 dhjetor (QIK)
Të premtën, më 5 dhjetor 1997, një polic serb i quajtur Millan nga fshati Orllan i Podujevës, tash me detyrë në stacionin e policisë në Fushë-Kosovë, u vendos me dhunë në banesën Shefqet Gërxhaliut në Bresje të Fushë-Kosovës, të cilën ia kishte ndarë Fabrika e Amortizatorëve, për të posedon vendimin e këtij kolektivi.
Shefqet Gërxhaliu, punëtor i Fabrikës së Amortizatorëve të Prishtinës dhe i dëbuar nga organet e dhunshme serbe, në një deklaratë dhënë QIK-ut thotë se ky polic serb është munduar në çdo mënyrë që ta bindë atë që banesën t'ia japë me qira, por ai nuk kishte pranuar me asnjë kusht propozimin e policit serb.
Shefqet Gërxhaliu rastin e lajmëroi në stacionin e policisë në Fushë-Kosovë, ku i kishin thënë se këtë rast mund ta zgjidhë vetëm përmes gjyqit.
Pasi provon që me Millanin të merret vesh për lirimin e banesës ai bashkë një polic tjetër i kërcënohen me fjalët: "këtu nuk është Skënderaj, por është Fushë- Kosovë e vend serb".
Kur Shefqeti nuk pranon kërkesën e tyre ata e sulmojnë fizikisht, duke e goditur me shqelma e grushta dhe e nxjerrin me dhunë nga banesa, duke e kërcënuar se do ta pësojë edhe më keq.
Shefqeti prapë është paraqitur në stacionin e policisë, ku me cinizëm i thonë se nuk është dashur të shkojë në banesën e tij!

NRK: Shqiptarët e Kosovës grumbullojnë të holla për luftë në

Referenca nr. 30

Kosovë

Shien, 10 dhjetor (QIK)
Televizioni shtetëror norvegjez NRK-1, në një emision të emetuar dje, njoftoi se shqiptarët e Kosovës që jetojnë në Norvegji janë duke grumbulluar mjete financiare dhe duke regjistruar vullentarë për luftë kundër regjimit serb në Kosovë.Njoftimi u përsërit disa herë në edicionet e lajmeve të Radio Norvegjisë gjatë gjithë ditës së sotme dhe ai bazohej në deklaratën e Nufri Lekës.
Në njoftim thuhej se Lekaj i takon organizatës së Lëvizjes Popullore të Kosovës, që është njëra ndër lëvizjet më të vjetra të Kosovës, që ka për qëllim çlirimin e Kosovës.
Në fund të njoftimit NRK theksonte se në javët e fundit gjendja në Kosovë ka qenë e mjegulluar, si pasojë e përleshjeve në mes policisë serbe dhe shqiptarëve të Kosovës.

Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë bëri kallëzim penal ndaj kryeparlamentarit Skender Gjinushi

Prishtinë, 10 dhjetor (QIK)
Pesë anëtarë të Gjykatës Kushtetuese kanë bërë dje kallëzim penal në prokurorinë e rrethit të Tiranës ndaj kryetarit të Kryesisë së Kuvendit Popullor, Skender Gjinushi, për shpifje kundër anëtarëve të kësaj gjykate, njofton ATSH.
Si bazë për këtë kallëzim penal, sipas njoftimit të Gjykatës Kushtetuese, ka shërbyer intervista e dhënë nga zoti Gjinushi në televizionin shqiptar me 05.12.1997, lidhur me vendimin nr.57, të datës 05.12.1997 të kësaj Gjykate, ku ai është shprehur se "Gjykata Kushtetuese e Gjatës po del jashtë loje dhe po i shërben interesave të huaja, jashtë Shqiperise", thënie që i përsëriti edhe dje në konferencën e shtypit.
"Këto deklarata përbëjnë shpifje të qëllimshme për shkak të veprimtarisë shtetërore kundër kryetarit dhe anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese.Në këtë mënyrë, zoti Skender Gjinushi publikisht synon të diskreditojë Gjykatën Kushtetuese në opinionin kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe ka cenuar rëndë nderin dhe dinjitetin tonë personal", thuhet në njoftimin për shtyp të kësaj Gjykate.
Kallëzimi penal është firmosur nga kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Rustem Gjata dhe katër anëtarë të saj, Hilmi Dakli, Manol Konomi, Halil Kopani dhe Alfred Karamuzo.
Gjykata Kushtetuese përbëhet nga nëntë anëtarë.

Analistët e huaj lidhur me problemin e arsimit shqip dhe zgjidhjen e çështjes së Kosovës

Prishtinë, 10 dhjetor (QIK)
Në një bllok tematik kushtuar problemit të arsimit shqip dhe zgjidhjes së problemit të Kosvës i cili u emetua mbrëmë në "Zërin e Amerikës", veç tjerash, thuhej: Në muajin tetor studentët e Universitetit të Prishtinës u hodhën në demonstratat duke kërkuar zbatimin e marrëveshjes për arsimin të nënshkruar nga udhëheqësi i shqiptarëve të Kosovës dr.Ibrahim Rugova dhe presidenti i Serbisë, Sllobodan Millosheviq.
Ngjarjet janë ndjekur me shqetësime edhe nga administrata amerikane.Ditëve të fundit ndodheshin për vizitë në Uashington dy përfaqësues të studentëve shqiptarë

Kosovë

NRK: Shqiptarët e Kosovës grumbullojnë të holla për luftë në Kosovë

Shien, 10 dhjetor 1997 (QIK)

Televizioni shtetëror norvegjez NRK-1, në një emision të emetuar dje, njoftoi se shqiptarët e Kosovës që jetojnë në Norvegji janë duke grumbulluar mjete financiare dhe duke regjistruar vullnetarë për luftë kundër regjimit serb në Kosovë. Njoftimi u përsërit disa herë në edicionet e lajmeve të "Radio Norvegjisë" gjatë gjithë ditës së sotme dhe ai bazohej në deklaratën e Nufri Lekës. Në njoftim thuhej se Lekaj i takon organizatës së Lëvizjes Popullore të Kosovës, që është një ndër lëvizjet më të vjetra të Kosovës, e që ka qëllim çlirimin e Kosovës. Në fund të njoftimit NRK theksonte se në javët e fundit gjendja në Kosovë ka qenë e mjegulluar si pasojë e përleshjeve në mes të policisë serbe dhe shqiptarëve të Kosovës.

Referenca nr. 31

Gazeta "Klassekampen", 10.07.98

Zemërimi ndaj Fossum

Nufri Lekaj, zëdhënës i Bashkësisë Shqiptare në Norvegji, i zemëruar ndaj Grete Fossum për shkak të propozimit të saj për t'i ndaluar ndihmat për luftën çlirimtare në Kosovë, i kërkon Fossumit ta njohë Kosovën e pavarur.

Nga Steinar Aslos

Bashkësia Shqiptare në Norvegji merret me ndihmat e konsiderueshme për luftën çlirimtare të Kosovës. Zëdhënësi Nufri Lekaj ka reaguar ashpër ndaj propozimit të Grete Fossum (anëtare e parlamentit) për të ndaluar këtë ndihmë. Arsyetimi i saj është se mjetet financiare shkojnë për blerjen e armatimit për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Ky është moral i dyfishtë. Lufta për pavarësi është një proces historik, disa shtete e kanë arritur këtë më herët, ne do ta arrijmë tani.

Nyheter

Klassekampen 10.07.98

Raser mot Fossum

Nufri Lekaj, talsmann for det albanske rådet i Norge, raser mot Grete Fossums forslag om å forby innsamling til Kosovo-albanernes frigjøringskamp. Han utfordrer Fossum til å anerkjenne Kosovos uavhengighet.

Av Steinar Alsos

Det albanske rådet i Norge driver omfattende innsamling til støtte for den kosovoalbanske frigjøringskampen. Talsmann Nufri Lekaj reagerer kraftig mot Grete Fossums (Ap) forslag om å forby innsamlingen. Hennes begrunnelse er at pengene går til våpenkjøp for den kosovoalbanske frigjøringshæren (UCK)

– Dette er dobbeltmoral. Kampen for uavhengighet er en historisk prosess, noen nasjoner har klart å bli uavhengige før, vi skal klare det nå. Hvilken rett har land som har oppnådd uavhengighet, til å hindre andre i å oppnå det samme? På denne måten motarbeider vesten en nasjons rett til å klare seg selv, sier Lekaj.

Han utfordrer Grete Fossum til å foreslå for Stortinget at Norge skal anerkjenne Kosovos uavhengighet, isteden for å legge hindringer i veien for motstandskampen.

– Greit med nødhjelp

Grete Fossum uttaler til NTB at hun selvfølgelig ikke har noe imot at penger blir samlet inn til nødhjelp, det er penger til innkjøp av våpen hun vil ha stoppet. Lekaj sier til Klassekampen at det albanske rådet ikke legger seg opp i hva pengene blir brukt til etter at de er sendt til Kosovo.

– Vi hjelper til med penger. Når UCK foretar innkjøp, det være seg våpen, mat eller medisiner, er det ikke vår avgjørelse. Vi støtter UCK, men vi støtter også andre formål i Kosovo. Blant annet samler vi også inn penger til bedre helsevesen, sier Lekaj.

Lekaj forteller at UCK har stor oppslutning blant albanere i Norge, og at det eneste Fossums forbud vil føre til er at innsamlingen skjer illegalt.

– Ingen land i verden har rett til å hindre oss i å samle inn penger, verken juridisk eller moralsk. Dette er ikke norske myndigheters penger, påpeker han.

Går mot forbud

Leder i Sosialistisk Ungdom, Heikki Holmås, mener det blir helt feil å innføre forbud mot pengeinnsamling, uavhengig av hva man mener om UCK og deres mål.

– Det blir helt galt å sette en stopper for folk som samler inn penger for frigjøringskamp for sitt eget land. De som samler inn penger må få fortsette med det, sier Holmås.

Holmås presiserer overfor Klassekampen at SU ikke har tatt stilling til hva organisasjonen mener om UCK og deres mål og arbeidsmetoder, men at SU støtter kosovoalbanernes kamp mot den serbiske undertrykkingen.

Internasjonal sekretær i AKP, Arnljot Ask, reagerer kraftig på Fossums forslag. Han mener det er helt legitimt at kosovoalbanerne forsvarer seg, og at de samler inn penger som gjør dette mulig.

– Det er uhørt å kriminalisere motstandsgrupper på den måten som Fossum gjør, sier Ask.

Çfarë të drejte kanë shtetet që kanë arritur pavarësinë e vet t'u vënë pengesa të tjerëve për të njëjtën gjë? Në këtë mënyrë Perëndimi e kundërshton të drejtën e një kombi për t'u bërë i zoti i vetvetes, thotë Lekaj. Ai i kërkon Grete Fossumit t'i propozojë Parlamentit norvegjez ta njohë Pavarësinë e Kosovës në vend se t'i vënë pengesa luftës çlirimtare.

Në rregull me ndihma humanitare

Grete Fossum thotë për NTB (Agjencinë Telegrafike Norvegjeze) se ajo nuk ka diçka kundër për grumbullimin e mjeteve financiare për ndihmë humanitare, por dëshiron t'i ndalojë mjetet financiare të cilat shkojnë për armë. Lekaj thotë për gazetën "Kalassekampen" se Bashkësia Shqiptare nuk ndërhyn në atë se si përdoren mjetet financiare pasi dërgohen në Kosovë. Ne ndihmojmë me mjete financiare kur UÇK-ja bën blerjet, mund të jenë armë, ushqime, apo ilaçe, nuk është puna jonë. Ne e mbështesim e UÇK-në, por mbështesim edhe veprimtari të tjera në Kosovë, ndër të tjera grumbullojmë mjete financiare për një shëndetësi më të mirë, thotë Lekaj. Ai tregon se UÇK-ja ka mbështetje të fortë tek shqiptarët në Norvegji. E vetmja që do të shkaktonte propozimi i Fossumit do të ishte: grumbullimi i mjeteve financiare të bëhet ilegalisht. Asnjë vend në botë nuk ka të drejtë të na pengojë të mbledhim mjete financiare, as juridikisht, as moralisht. Këto nuk janë mjete financiare të shtetit norvegjez, saktëson ai.

Kundër ndalimit

Lideri Socialistik Ungdom (SU), Heiki Holmås, mendon se është gabim të vendoset ndalesa për mbledhjen e mjeteve financiare, pa marrë parasysh se çka mendojmë për UÇK-në dhe qëllimin e saj. Është gabim të vëmë ndalesë për njerëzit të cilët dëshirojnë të grumbullojnë mjete financiare për luftën çlirimtare në vendin e tyre. Ata të cilët grumbullojnë mjete financiare duhet të vazhdojnë me këtë, thotë Holmås. Ai saktëson për gazetën "Klassekampen" se SU nuk ka marrë vendim në lidhje me se çka mendon për UÇK-në, por SU mbështet luftën e shqiptarëve të Kosovës kundër shtypjes serbe.

Sekretari ndërkombëtar i AKP-së, Arnljot Ask, reagon ashpër ndaj

propozimit të Fossumit. Ai thotë se është legjitime që shqiptarët e Kosovës të mbrohen dhe grumbullimi i mjeteve financiare e mundëson një gjë të tillë. Është i padëgjuar kriminalizimi i grupeve çlirimtare në këtë mënyrë siç bën Fossum, thotë Ask.

NORVEGJI

Komunikatë e Këshillit të Përgjithshëm të Bashkësisë Shqiptare në Norvegji

Kundër zhvlerësimit të "Fondit të Republikës së Kosovës"

Bazuar në faktin se qeveria deri më tani nuk ka kryer obligimet e veta në drejtim të përkrahjes së rezistencës së armatosur, BSHN-ja do të vazhdojë të përkrahë direkt UÇK-në përmes fondeve: "Fondi i Republikës së Kosovës" dhe "Vendlindja Thërret"

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Bashkësia Shqiptare në Norvegji, "e cila brenda vetës përfshin të gjitha subjektet politike e kulturore të shqiptarëve në Norvegji pa dallime bindjesh politike, fetare, krahinore apo pozite sociale e shoqërore në bazë të përcaktimeve të veta programore që nga formimi i saj e më tej është vënë në përkrahje të plotë të rezistencës së armatosur të popullit tonë nën udhëheqjen e Ushtrisë Clirimtare të Kosovës", thuhet fillimisht në një komunikatë të kësaj bashkësie, nga mbledhja e rregullt e Këshillit të saj të përgjithshëm.

BSHN-ja ka përkrahur dhe do të përkrahë pa rezerva rezistencën e armatosur të popullit tonë nën udhëheqjen e Ushtrisë Clirimtare të Kosovës, respektivisht Shtabit të përgjithshëm të UÇK-së dhe kundërshton tendencat frakcioniste që i imponohen UÇK-së, thuhet në këtë komunikatë. BSHN-ja ka respektuar dhe respekton të gjitha institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës por njëkohësisht me të drejtë të plotë kërkon nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe institucionet përkatëse t'i kryjnë obligimet e veta ndaj forcave të armatosura të Republikës së Kosovës nën drejtimin e Shtabit të përgjithshëm të UÇK-së, vazhdon komunikata. Kjo bashkësi tutje vlerëson se "obligimet e Qeverisë janë bërë publike për gjithë popullin shqiptar, por për fat të keq kanë mbetur boshe".

Bazuar në faktin se qeveria deri me tani nuk ka kryer obligimet e veta në drejtim të përkrahjes së rezistencës së armatosur, BSHN-ja ashtu si edhe më përpara do të vazhdojë të përkrahë direkt Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës përmes fondeve "Fondi i Republikës së Kosovës" dhe "Vendlindja Thërret" deri sa institucionet e shtetit të Kosovës marrin obligimet e veta kushtetutare për përkrahjen e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, shtjegohet në komunikatë. BSHN-ja, thuhet në vazhdim, është kundër zhvlerësimit të "Fondit të Republikës së Kosovës" dhe shkarkimit të personave përgjegjës të Fondit nga ana e Ministrisë për Ekonomi dhe Financa, si dhe hapjes së fondit të "dytë" të Qeverisë së Republikës së Kosovës në Norvegji. Sipas BSHN, "kjo mënyrë është arbitrare dhe shkon në dëm të bashkimit dhe forcimit tonë reth 'motos' së Qeverisë 'Gjithçka për pavarësinë e Kosovës'".

Në vazhdim të komunikatës thuhet se BSHN-ja e konsideron të nevojshme që ministria përkatëse të sqarojë shkeljet e rregullores. BSHN-ja, "në bazë të evidencës së hyrje-daljeve konstaton se mjetet e bashkatdhetarëve janë administruar dhe bartur në bazë të vendimeve të Këshillit të Përgjithshëm dhe shprehjes vullnetare të popullit tonë për përkrahjen e UÇK-së".

Në fund të komunikatës se Këshi të Përgjithshëm të Bashkës Shqiptare në Norvegji apelohet bashkatdhetarët me banim Norvegji që ndihmat e veta të va dojnë t'i derdhin në fondet ekzist

SIGUROHUNI TE DRINI
SE DRINI ËSHTË YN

MINIMARKET & AUDIO-VIDEO SHOP
KAUBOJ XHEMA
pronar REMI
RISI!
Non-Stop 00-24
Prej tash e tutje gjëra ushqimore dhe audio-video kasetat mund t'i porositni nga shtëpia juaj.
Mjafton të lajmëroheni në tel. 038/38 494 ose në "Radio Taxi" 038/200-11

TAFË KUSURI

AGIM QENA

KOHA Ditore • e hënë • 21.9.1998

Referenca nr. 32

"Koha Ditore", 21.09.1998

Norvegji

Komunikatë e Këshillit të Përgjithshëm të Bashkësisë Shqiptare në Norvegji

Kundër zhvlerësimit të "Fondit të Republikës së Kosovës"

Bazuar në faktin se Qeveria deri më tani nuk ka kryer obligimet e veta në drejtim të përkrahjes së rezistencës së armatosur, BSHN do të

vazhdojë ta përkrahë direkt UÇK-në nëpërmjet fondeve: "Fondi i Republikës së Kosovës" dhe "Vendlindja Thërret"

Prishtinë, 20 shtator - Bashkësia Shqiptare në Norvegji, "e cila brenda vetes përfshin të gjitha subjektet politike e kulturore të shqiptarëve në Norvegji pa dallime bindjesh politike, fetare, krahinore apo pozitë sociale e shoqërore, në bazë të përcaktimeve të veta programore që nga formimi i saj e më tej është vënë në përkrahje të plotë të rezistencës së armatosur të popullit tonë nën udhëheqjen e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës", thuhet fillimisht në një komunikatë të kësaj bashkësie nga mbledhja e rregullt e Këshillit të saj të Përgjithshëm.

BSHN-ja ka përkrahur dhe do të përkrahë pa rezerva rezistencën e armatosur të popullit tonë nën udhëheqjen e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, respektivisht Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së dhe kundërshton tendencat fraksioniste që i imponohen UÇK-së, thuhet në këtë komunikatë.

BSHN-ja ka respektuar dhe respekton të gjitha institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës, njëkohësisht me të drejtë të plotë kërkon nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe institucionet përkatëse t'i kryejnë obligimet e veta ndaj forcave të armatosura të Republikës së Kosovës nën drejtimin e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, vazhdon komunikata. Kjo bashkësi më tutje vlerëson se "obligimet e Qeverisë janë bërë publike për të gjithë popullin shqiptar por, për fat të keq, kanë mbetur boshe".

Bazuar në faktin se Qeveria deri më tani nuk i ka kryer obligimet e veta në drejtim të përkrahjes së rezistencës së armatosur, BSHN-ja, ashtu si edhe më përpara, do të vazhdojë ta përkrahë direkt Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës nëpërmjet fondeve: "Fondi i Republikës së Kosovës" dhe "Vendlindja Thërret" derisa institucionet e shtetit të Kosovës marrin obligimet e veta kushtetutare për përkrahjen e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, shpjegohet në komunikatë.

BSHN-ja, thuhet në vazhdim, është kundër zhvlerësimit të "Fondit të Republikës së Kosovës" dhe shkarkimit të personave përgjegjës të Fondit nga ana e Ministrisë për Ekonomi dhe Financa, si dhe hapjes së fondit të "dytë" të Qeverisë së Republikës së Kosovës në Norvegji.

Sipas BSHN-së, "kjo mënyrë është arbitrare dhe shkon në dëm të bashkimit dhe forcimit tonë rreth 'motos' së Qeverisë 'Gjithçka për pavarësinë e Kosovës'".

Në vazhdim të komunikatës thuhet se BSHN-ja e konsideron të nevojshme që ministria përkatëse t'i sqarojë shkeljet e rregullores.

BSHN-ja, "në bazë të evidencës së hyrje-daljeve, konstaton se mjetet e bashkatdhetarëve janë administruar dhe bartur në bazë të vendimeve të Këshillit të Përgjithshëm dhe shprehjes vullnetare të popullit tonë për përkrahjen e UÇK-së".

Në fund të komunikatës së Këshillit të Përgjithshëm të Bashkësisë Shqiptare në Norvegji apelohet tek bashkatdhetarët me banim në Norvegji, që ndihmat e veta të vazhdojnë t'i derdhin në fondet ekzistuese.

Referenca nr. 33

Gazeta "Stavanger Aftenblad", 15 prill 1999

Rregullat e pasaportave ndalojnë regrutët e UÇK-së

Nga Ingeborg Eliassen

Dhjetëra shqiptarë nga Kosova që jetojnë në Norvegji kanë udhëtuar për Ballkan që t'i bashkohen gueriles së Kosovës, UÇK-së. Nga Stavangeri (qytet në Norvegji) dëshirojnë të udhëtojnë edhe të tjerë, por nuk i kanë dokumentet e nevojshme të udhëtimit. Urdhri për mobilizimin e përgjithshëm nga ana e UÇK-së është shpërndarë para dy javësh. Aty thuhet se të gjithë burrat mes 18 - 50

STAVANGER AFTENBLAD 15. april 1999

Passregler stanser UCK-rekrutter

Av Ingeborg Eliassen

«Flere titalls» kosovoalbanere i Norge har til nå reist til Balkan for å slåss med UCK-geriljaen i Kosovo. I Stavanger-området vil flere dra, men har ikke de nødvendige reisedokumentene.

Den generelle mobiliseringsordren fra UCK i Kosovo kom for et par uker siden. I den heter det at alle menn mellom 18 og 50 år skal melde seg til tjeneste for geriljabevegelsen, som slåss for et uavhengig Kosovo.

Bakgrunn
Nato angriper Jugoslavia
Øyvind Ellingsens bilder fra Makedonia

Unntakene er folk i eksil som bidrar økonomisk til frigjøringskampen. Dette gjelder de fleste kosovoalbanere i Norge, ifølge Nufri Lekaj, som representerer UCK i Skandinavia og er talsmann for den all-albanske organisasjonen Albansk samling i Norge.

– Alle som drar herfra, reiser dermed frivillig og på grunnlag av egne vurderinger. Vi har selvfølgelig stor respekt for dem som gjør dette, men ingen er utsatt for sosialt press. Tvertimot har vi frarådet folk å dra hvis de i stedet kan gi penger til frigjøringskampen. Det er annerledes i Italia og Tyskland, der mange er arbeidsløse. Folk som ikke kan bidra materielt, forventes å verve seg, sier Nufri Lekaj til Aftenbladet.

Norske borgere
Siden i fjor har likevel «flere titalls» kosovoalbanere fra Norge – de aller fleste med norsk statsborgerskap – reist til Balkan for å slutte seg til UCK, ifølge Lekaj. Flere av dem har vært såret og tildels hardt skadet av blant annet granatsplinter, men alle er i live, sier han.

Meldingene om at UCK-geriljaen så å si er knust av serbiske styrker og lider av en dramatisk mangel på utstyr, har ifølge UCK-talsmannen ikke virket inn på folks motivasjon.

– UCK er overhode ikke knust. Tvertimot har de gjenvunnet sine posisjoner og har gått til motangrep i enkelte enklaver. Påstandene om at UCK ligger dårlig an, har bare styrket kampmoralen, sier Lekaj.

Mangler papirer
Men det er ikke bare å reise. Man trenger pass eller andre gyldige reisedokumenter for å få passere gjennom landene mellom Norge og UCKs baseområder i Albania. Mange av kosovoalbanerne i Norge har ikke bodd lenge nok i landet til å ha fått norsk pass eller såkalt utlendingspass, og jugoslaviske reisedokumenter er det ikke særlig aktuelt for dem å forsøke å skaffe seg.

Dermed sitter mange og venter på å få ordnet slike papirer. I Stavanger-

området er et titalls personer i denne situasjonen, ifølge Nufri Lekaj.

Norske myndigheter er ikke spesielt imøtekommende, mener UCK-representanten.

– Vi har bedt norske myndigheter utstede enveis reisedokumenter til folk. Men vi støter på paragrafer i utlendingsloven og manglende vilje i byråkratiet, sier Nufri Lekaj, som nå planlegger å ta saken opp med ledelsen i Justisdepartementet.

Ifølge norsk lov er det heller ikke tillatt å verve seg til militær tjeneste i et annet land. – Vi verver da heller ingen. Her er ingen kampanje. De som reiser, er enkeltpersoner som føler seg bundet av det som skjer i hjemlandet, sier Nufri Lekaj, UCK-representant i Skandinavia.

vjeç duhet të lajmërohen për shërbim në armatën e gueriles, e cila lufton për Kosovën e pavarur. Përjashtim bëjnë ata të cilët janë në ekzil dhe që ndihmojnë materialisht luftën çlirimtare. Kjo vlen për shumicën e shqiptarëve në Norvegji, sipas Nufri Lekajt, përfaqësues i UÇK-së në Skandinavi dhe zëdhënës i Bashkësisë Shqiptare në Norvegji. Të gjithë që nisen nga këtu, vendosin vullnetarisht dhe në bazë të vlerësimeve të veta. Natyrisht ne kemi një respekt të madh për ata të cilët e bëjnë një gjë të tillë, por asnjëri nuk u ekspozohet presioneve. Pavarësisht, ne nuk i këshillojmë të udhëtojnë kur në vend të kësaj mund të kontribuojnë materialisht për luftën çlirimtare. Është më ndryshe situata në vendet si Italia apo Gjermania, ku ka shumë të papunë. Njerëzit të cilët nuk mund të kontribuojnë materialisht pritet të lajmërohen për mobilizim, thotë Nufri Lekaj për gazetën "Aftenbladet".

Shtetasit norvegjezë

Nga viti i kaluar deri më tani dhjetëra veta nga Norvegjia kanë udhëtuar dhe i janë bashkuar UÇK-së, thotë Lekaj. Disa prej tyre janë plagosur nga granatat, por të gjithë janë gjallë, thotë ai. Lajmet se UÇK-ja është thyer nga forcat serbe dhe se vuan nga mungesa për pajisje nuk ka ndikuar në motivimin e njerëzve, thotë zëdhënësi i UÇK-së. UÇK-ja nuk është thyer. Përkundrazi ka rifituar pozicionet e veta dhe ka shkuar në kundërsulm në zona të caktuara. Thëniet se UÇK-ja qëndron dobët vetëm se e kanë forcuar moralin e luftës, thotë Lekaj.

Mungojnë dokumentet

Nuk është çështja vetëm të nisësh. Është e nevojshme pasaporta apo dokumente të tjera të vlefshme për udhëtim për të kaluar shtete mes Norvegjisë dhe bazave të UÇK-së në Shqipëri. Shumica e shqiptarëve të Kosovës nuk kanë banuar aq gjatë në Norvegji për ta pasur të drejtën ta marrin pasaportën norvegjeze apo të ashtuquajturën pasaportën për të huajt, dokumentet jugosllave të udhëtimit nuk është aktuale të kërkohen. Kështu që, kemi shumë që janë duke pritur t'i rregullojnë këto dokumente.

Në regjionin e Stavangerit kemi dhjetëra persona të cilët janë në këtë situatë, sipas Nufri Lekajt

Organet e shtetit norvegjez nuk na kanë ofruar zgjidhje për këtë çështje thotë përfaqësuesi i UÇK-së. Ne u kemi kërkuar organeve të shtetit norvegjez për t'i pajisur me një dokument udhëtimi për një drejtim. Por po ndeshemi në paragrafët e ligjit për të huajt dhe në mungesën e vullnetit tek burokracia, thotë Lekaj, i cili planifikon të bisedojë për këtë çështje me udhëheqjen e Ministrisë së Drejtësisë. Sipas ligjit norvegjez, nuk është e lejuar të mobilizohen qytetarët e saj për një vend tjetër, prandaj nuk mobilizojmë asnjë. Këtu nuk bëhet kampanjë mobilizimi. Ata të cilët udhëtojnë janë individë të cilët janë të prekur nga ajo që po kalon atdheu i tyre, thotë Nufri Lekaj, përfaqësues i UÇK-së për Skandinavi.

Kosova's Representative office in Norway

Youngstorget
2a, 0181 Oslo
E-mail

Press release

No. 01/1999
Oslo November 1, 1999

Kosova's Government represented in Norway

Late in October the Provinsional Government in Kosova led by Prime Minister Hashim Thaci, opened its office of representation in Oslo. The first diplomatic delegate in Norway, Nufri Lekaj, was a former representative of the Kosova Liberation Army, KLA, in Norway.

The official opening was however postponed until Albania's national day on November 28, with members of Thaci's government present. - Our Government in Kosova felt a great need of a representational office in Norway, Nufri Lekaj says. As a member of both NATO and OSCE, Norway has engaged itself strongly in Kosova and plays an important part in the rebuilding of Kosova. The great interest for Balkan in general and Kosova in particular - aswell as the large community of Kosova Albanians in Norway, have made an office which can represent the Kosovans' interest in Norway neseccary, says the newly appointed diplomat who was a political prisoner in Yugoslavia before coming to Norway in 1987. Lekaj is a father of two and has previously been working for the Norwegian Directorate of Immigration (UDI) and the the Norwegian Helsinki-committee.

The Provisional Government of Kosova is a coalition government formated by agreement between the widely politicaly composed Kosova Albanian delegation in Rambouillet earlier this year. Later other political parties have joined in, like Turkish and Muslim parties.

LDK (Kosova's democratic league) and the Serbs are not yet represented in the Government, but this does not mean that our office in Norway will not represent their interest, says Lekaj who is looking forward to get started on the new tasks, in the country which during war recieved the highest number of refugees in proportion to the number of inhabitants.

Information manager Sylo Taraku. phone: 97180176, fax: 32812360, e-mail: sylo@online.no

Referenca nr. 34

Zyra e Përfaqësisë së Kosovës në Norvegji

Youngstorget
2a, 0181 Oslo
E-mail
Publikim për shtyp
No. 01/1999
Oslo, nëntor 1, 1999

Në fundmuajin tetor, Qeveria e Përkohshme e Kosovës, e udhëhequr nga kryeministri Hashim Thaçi, e hapi zyrën e saj të përfaqësimit në Oslo. Përfaqësues i parë diplomatik në Norvegji u dekretua Nufri Lekaj, ish-përfaqësuesi i ish-Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, UÇK-së. Hapja zyrtare u bë në ditën e Pavarësisë së Shqipërisë, më 28 nëntor. Qeveria jonë në Kosovë e vlerësoi shumë të nevojshme ta ketë zyrën e saj të përfaqësimit në Norvegji, thotë Nufri Lekaj.

Norvegjia, si anëtare e NATO-s dhe OSBE-së, është e angazhuar fuqishëm në Kosovë dhe luan rol të rëndësishëm në rindërtimin e Kosovës. Gjithashtu, duke e marrë parasysh interesimin e madh të Norvegjisë për Ballkanin në përgjithësi dhe për Kosovën në veçanti dhe praninë e një komuniteti të madh të kosovarëve në Norvegji, thotë diplomati i sapoemëruar i cili ka qenë i burgosur politik në Jugosllavi para se të vijë në Norvegji në vitin 1987. Lekaj është baba i dy fëmijëve. Më parë ka punuar në Drejtorinë Norvegjeze të Emigracionit (UDI) dhe në Komitetin Norvegjez të Helsinkit.

Qeveria e Përkohshme e Kosovës është një qeveri koalicioni e formuar në bazë të marrëveshjes së delegacionit me përbërje të gjerë politike të shqiptarëve të Kosovës në Rambuje në fillim të këtij viti, më pastaj iu kanë bashkangjitur edhe partitë e tjera turke dhe myslimane.

LDK-ja (Lidhja Demokratike e Kosovës) dhe serbët nuk janë të përfaqësuar ende në Qeverinë e Përkohshme të Kosovës, por kjo nuk do të thotë se zyra jonë në Norvegji nuk do t'i përfaqësojë interesat e tyre, thotë Lekaj, i cili është fokusuar në detyrat e reja, në shtetin i cili

gjatë luftës ka pranuar numrin më të madh të refugjatëve nga Kosova në përpjesëtim me numrin e banorëve të vet.

Menaxher i informacionit, Sylo Taraku. Telefon: 971 80 176, Fax: 3281 2360. e-mail: sylo@online.no

Kosova's Representative office in Norway

Youngstorget
2a, 0181 Oslo
E-mail

Press release

No. 02/1999
Oslo November 1, 1999

The cansellation of the sanctions against Kosova

The Kosovan office of representation in Norway welcomes the resolution by the Ministry of Foreign Affairs of October 29. to ease the measures put on Kosova and Montenegro.

- We believe Norway did right in subscribing to EUs former resolution to cancel the sanctions against Kosova and Montenegro. We do however demand that the sanctions against Serbia will be maintained until all Kosova Albanian political prisoners in Serbia are released, and until everyone accused of war crimes - including Slobodan Milosevic - are extradited to the the War Crimes Tribunal in Hague, Nufri Lekaj says, Kosova's diplomatic delegate in Norway.

- The abolition of the prohibition against direct flights between Norway and Kosova is of great importance, especially to all the Kosovans in Norway who wish to return to Kosova, or feel a need to visit their home country after what has happened during the last year. We also hope that the cancellation of the sanctions will make it easier for Norwegian trades and industries to invest in Kosova, Lekaj says.

Information manager Sylo Taraku. phone: 97180176, fax: 32812360, e-mail: sylo@online.no

Zyra e Përfaqësisë së Kosovës në Norvegji

Youngstorget
2a, 0181 Oslo
E-mail
Publikim për shtyp
No. 02/1999
Oslo, nëntor 1, 1999

Anulimi i sanksioneve ndaj Kosovës

Zyra e Përfaqësisë së Kosovës në Norvegji mirëpriti vendimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme për Rezolutën e 29 tetorit: për lehtësimin e masave të vëna ndaj Kosovës dhe Malit të Zi.

Ne mendojmë se Norvegjia bëri një veprim të duhur duke u bërë pjesë e Rezolutës së UE-së për anulimin e sanksioneve ndaj Kosovës dhe Malit të Zi. Megjithëkëtë, kërkojmë që sanksionet kundër Serbisë të vazhdohen derisa të lirohen të burgosurit politikë shqiptarë të Kosovës në Serbi dhe derisa të gjithë të akuzuarit për krime lufte, duke përfshirë Sllobodan Millosheviqin, të ekstradohen në Gjykatën për Krimet e Luftës në Hagë, thotë Nufri Lekaj, përfaqësues diplomatik i Kosovës në Norvegji.

Shfuqizimi i ndalesës së fluturimeve të drejtpërdrejta të aviacionit në mes të Norvegjisë dhe Kosovës është i një rëndësie të madhe, sidomos për kosovarët në Norvegji, të cilët dëshirojnë të kthehen në Kosovë, ose që dëshirojnë ta vizitojnë vendin e tyre pas gjithë asaj që ka ndodhur gjatë vitit të kaluar. Gjithashtu, shpresojmë se anulimi i sanksioneve do ta lehtësojë mundësinë për investimet e tregtisë dhe industrisë norvegjeze në Kosovë, thotë Lekaj.

Menaxher i informacionit, Sylo Taraku. Telefon: 971 80 176, Fax: 3281 2360. e-mail: sylo@online.no

Kosova office in Norway
Youngtorget 2a
0181 Oslo

Press release

No.04/1999
Oslo November 29, 1999

Make demands on the Serbian opposition

The Kosovan office of representation in Norway welcomes the increasing effort by Norway to democratize Kosova, Serbia and the entire Balkan, but doubt that supporting some of the oppositional leaders and so-called democratic cities in Serbia will lead to the democratizing of the region as supposed.

Lately some of the Norwegian politicians have pleaded in favour of giving economical support to so-called oppositional and democratic cities in Serbia. The reason for this is to strengthen the democratic forces in Serbia and to weaken the regime of Milosevic.

- This is a great thought, but still, not all oppositional forces are necessarily democratic forces, says Nufrij Lekaj, Kosova's diplomatic delegate in Norway. Lekaj is sceptical about wether the oppositional leaders, who visited Norway last week, are politicians capable of democratizing Serbia and contributing to a peaceful coexistence between the different groups of people in the Balkans.

- It must be made greater demands on the Serbian oppositional leaders, Zoran Djindjic, Karadzic's mainstay during the war in Bosnia, and Vuk Draskovic, Milosevic's mainstay during the war in Kosova, before one can support them in the political struggle for power in Serbia, says Lekaj.

Lekaj thinks that also on the so-called democratic cities in Serbia it must be made greater demands. Nis for instance, is one of the so-called "democratic" cities in Serbia, which is suggeseted given economical support. - Many political prisoners are held in this city, among others Dr. Flora Brovina, a women activist and a human rights activist from Kosova. The terrorist accusation against her and the unfair treatment of her does not make this city any more democratic than other cities, Lekaj says.

The Kosovan office of representation has recieved reports indicating that the violence in Kosova has gone down lately, but the office still feels concern about the numerous non-Albanians who feel threatened. - It is regretable that some Kosova Albanians take the law into their own hands in order to revenge everything that has happened to them and their families during the Serbian extermination campaign in Kosova, Nufrij Lekaj says.

Zyra e Kosovës në Norvegji

Youngtorget 2a
0181 Oslo
Publikim për shtyp
No. 04/1999
Oslo, nëntor 29, 1999

Të kushtëzohet opozita serbe

Zyra e Përfaqësisë së Kosovës në Norvegji mirëpret përpjekjet në rritje e sipër të Norvegjisë për ta demokratizuar Kosovën, Serbinë dhe tërë Ballkanin, por dyshon se mbështetja ndaj disave nga liderët opozitarë serbë dhe ndaj të ashtuquajturave qytete demokratike në Serbi, do të çojë në demokratizimin e rajonit siç supozohet.

Kohët e fundit disa politikanë norvegjezë kanë apeluar në favor të mbështetjes ekonomike për të ashtuquajturat qytetet opozitare dhe demokratike në Serbi. Arsyeja për këtë është të fuqizohen forcat demokratike në Serbi dhe të dobësohet regjimi i Millosheviqit. Kjo është një pikënisje e mirë, por ende jo të gjitha forcat opozitare janë domosdoshmërisht forca demokratike, thotë Nufri Lekaj, përfaqësues diplomatik i Kosovës në Norvegji. Lekaj është skeptik ndaj udhëheqësve opozitarë, të cilët vizituan Norvegjinë javën e kaluar, se sa janë politikanë të vullnetshëm për ta demokratizuar Serbinë dhe të kontribuojnë për një bashkëjetesë paqësore midis popujve të Ballkanit.

Duhet t'u vihen kushte më të mëdha udhëheqësve opozitarë serbë, Zoran Gjingjiqit, mbështetësit të Karaxhiçit gjatë luftës në Bosnje dhe Vuk Drashkoviqit, mbështetësit të Millosheviqit gjatë luftës në Kosovë, para se të mbështetet përpjekja e tyre politike për pushtet në Serbi, thotë Lekaj. Sipas Lekajt, edhe për të ashtuquajturat qytetet demokratike në Serbi duhet të vihen kushte më të mëdha. Për shembull, qyteti Nish është një nga të ashtuquajturat qytetet "demokratike" në Serbi, i propozuar për t'i dhënë mbështetje ekonomike. Shumë nga të burgosurit politikë mbahen në burgje në këtë qytet, mes të tjerëve dr. Flora Brovina, aktiviste për të drejtat e njeriut nga Kosova. Akuza terroriste kundër saj dhe trajtimi i

padrejtë ndaj saj nuk e bën këtë qytet më demokratik sesa qytetet e tjera, thotë Lekaj.

Në bazë të raporteve informative që i kanë ardhur Zyrës së Përfaqësisë së Kosovës, dhuna në Kosovë është reduktuar kohët e fundit, por Zyra e Përfaqësisë së Kosovës edhe më tutje vazhdon të mbetet e shqetësuar për një numër të joshqiptarëve, të cilët ndihen të kërcënuar. Është për keqardhje kur disa shqiptarë të Kosovës marrin ligjin në duart e veta, që të hakmerren për çdo gjë që u ka ndodhur atyre dhe familjeve të tyre gjatë fushatës shfarosëse serbe ndaj shqiptarëve në Kosovë, thotë Nufri Lekaj.

23.MAI.2000 11:20 KUNSTHØGSKOLEN I OSLO.22995502 NR.605 S.2/2

KUNSTHØGSKOLEN I OSLO

Program for forelesninger
ved
Del 1: Innføringskurs
Kunsthøgskolen i Oslos etterutdanningskurs:
"Kunst som arena for konfliktløsning"
i tidsrommet 29 mai –7 juni 2000.

Sted: Kunsthøgskolen i Oslo, fellesadministrasjonen
Tidspunkt for forelesninger: hver kursdag er fra kl.16.00 – 19.00

29 mai:
Tema: Menneskerettighetenes betydning for fred og det sivile samfunn.
Fritt Ord – stipendiat Inge Eidsvåg, Nansenskolen
Ekspedisjonssjef Kim Traavik Utenriksdepartementet

30 mai :
Tema: Jugoslavia før og nå.
Prof. Svein Mønnesland, Universitetet i Oslo
Rådgiver Aage Borchgrevink, Den norske Helsingforskomite

31 mai:
Tema: Konflikter og konfliktløsning
Jovo Kosanovic, Inst. For forskning og utvikling, NLH
Dr. Evelin Lindner, Institutt for psykologi, UiO

5 juni:
Tema: Bakgrunn for konflikter
Avdelingsdirektør Petter Wille, Utenriksdepartementet
Nufri Lekaj, Det kosovalbanske representasjonskontor i Norge

6 juni:
Tema: Dokumentasjon av brudd på menneskerettigheter
Filmskaper Maria F. Warsinski

7 juni:
Tema: Konfliktbehandling og tilbakevending
Melinda Meyer, Norsk institutt for kunst og uttrykksterapi, UiO

Postadresse
Postboks 6853 St Olavspl.
0130 Oslo

Kontoradresse
St. Olavsgt. 23
0166 Oslo

Tlf. 22995500
Fax. 22995502

Referenca nr. 35

SHKOLLA E LARTË E ARTEVE

Programi i ligjëratave
Pjesa e parë: *Kursi i përgatitjes*
Shkolla e Lartë e Arteve në Oslo, kurs pas mbarimit të shkollimit
"Arti si arenë e zgjidhjes së konflikteve"
Nga 29 maji deri më 7 qershor 2000
Vendi: *Shkolla e Lartë e Arteve në Oslo, administrata e përgjithshme*
Koha e ligjëratave: çdo ditë nga 16.00 - 19.00

29 maj:
Tema: Rëndësia e të drejtave të njeriut për paqen dhe shoqërinë civile
Fritt Ord (Fjala e lirë), doktorante Inge Eidsvåg, Shkolla Nansen
Drejtor gjeneral Kim Traavik, Ministria e Jashtme Norvegjeze
30 maj:
Tema: Jugosllavia më parë dhe tani
Profesor Svein Mønnesland, Universiteti i Oslos
Këshilltar Aage Borchgervik, Komiteti Norvegjez i Helsinkit
31 maj:
Tema: Konfliktet dhe zgjidhja e konflikteve
Jovo Kosanovic, Instituti i Studimeve Zhvillimore, NLH
Dr. Evelin Linder, Instituti i Psikologjisë, Universiteti i Oslos
5 qershor:
Tema: Prapavija e konflikteve
Petter Wille, drejtor në Ministrinë e Jashtme Norvegjeze
Nufri Lekaj, Përfaqësia e Kosovës në Norvegji
6 qershor:
Tema: Dokumentimi për shkeljet e të drejtave të njeriut
Regjisore Maria F. Warshinski
7 qershor:
Tema: Trajtimi i konflikteve dhe rishikimi i tyre
Melinda Meyer, Instituti Norvegjez për Art dhe Terapi të Shprehjes, Universiteti i Oslos

STATSMINISTEREN

Oslo, 29. oktober 2001

Nufri Lekaj
Kosova Office in Norway
Postboks 121 Grorud
0905 Oslo

Min hjerteligste takk for hyggelig hilsen i forbindelse med min overtakelse av embetet som Statsminister.

Med vennlig hilsen

Kjell Magne Bondevik

Referenca nr. 36

KRYEMINISTRI

Oslo, 29 tetor 2001

Nufri Lekaj
Zyra e Kosovës në Norvegji
Postboks 121 Grorud
0905 Oslo

Ju falënderoj përzemërsisht për përgëzimin tuaj me rastin e marrjes së detyrës së kryeministrit!

Të fala të përzemërta,

Kjell Magne Bondevik

NRK

Store Studio *22.03.2010*

Sending 14. mars

NATO støtter serbisk fremrykk

Jugoslaviske styrker rykket i dag inn i sikkerhetssonen mellom Kosovo-provinsen og resten av Serbia, støttet av NATO-helikoptre. Det er første gang siden Kosovo-krigen at jugoslaviske styrker står helt opp mot Kosovo.

De jugoslaviske soldatene skal, etter avtale mellom NATO og regjeringen

Publisert 14.03.2001 15:31.

i Beograd, ha ansvar for en del av sonen. Hensikten er å kutte den kosovoalbanske geriljaens forsyningslinjer fra den eks-jugoslaviske republikken Makedonia.

Albansk gerilja har benyttet muligheten til å okkupere store deler av denne sonen ettersom jugoslaviske soldater ikke har hatt adgang her. Men som et ledd i fredsavtalen som ble undertegnet tidligere i uken, går nå jugoslaviske styrker inn i grenseområdene for å ta igjen disse.

I studio kommer:
Robert Mood, Forsvarets Overkommando, tidligere leder av Telemark-bataljonen

Nufri Lekaj, representerer Kosova Office in Norway

Ulf Andenæs, journalist Aftenposten

Igor Panevski

Av Guri Størvold, Redaksjon 21

14.03.01

Opphavsrett NRK © 2010
Nettsjef: Sindre Østgård
Ansvarlig redaktør: Hans-Tore Bjerkaas
Tips NRK
Kontakt NRK
Om NRK
Hjelp

Referenca nr. 37

NRK (Radiotelevizioni Shtetëror Norvegjez)
Studio Store
Transmetim, 14 mars

NATO mbështet marshimin serb

Forcat jugosllave marshuan sot në zonën e sigurisë në mes të Kosovës dhe Serbisë të mbështetura nga helikopterët e NATO-s. Është hera e parë që nga lufta e Kosovës që forcat jugosllave qëndrojnë krejtësisht afër Kosovës.

Publikuar më 14.03.2001, 15:31

Sipas marrëveshjes në mes të NATO-s dhe Qeverisë në Beograd, forcat ushtarake jugosllave do ta marrin përgjegjësinë e sigurisë. Qëllimi është të ndërpriten linjat e furnizimit të gueriles kosovare nga ana e ish-republikës jugosllave të Maqedonisë. Guerilja shqiptare ka shfrytëzuar rastin të okupojë pjesë të mëdha të kësaj zone për shkak të moslejimit që ushtria jugosllave të jetë e pranishme aty. Por, si rezultat i një marrëveshje të paqes së nënshkruar gjatë kësaj jave, forcat jugosllave tani kanë akses në zonën e kufirit dhe do të qëndrojnë aty.

Në studio:

Robert Mood, komandant i përgjithshëm i Forcave të Armatosura dhe ish-lider i batalionit të Telemarkut

Nufri Lekaj përfaqëson Zyrën e Kosovës në Norvegji (Kosova Office in Norway)

Ulf Andenæs, gazetar Aftenposten

Igor Panevski

Nga Guri Størvold, Redaksia 21

Etter 95 års okkupasjon er Kosova nå klar for en ny start.

Endelig uavhengighet

NUFRI LEKAJ
LEDER, KOSOVA OFFICE IN NORWAY

[uavhengighet] I disse dager er de fleste kosovoalbanere i gledesrus, og teller ned timene til våre forfedres drøm endelig skal gå i oppfyllelse. Våre tanker går tilbake til den lange og vanskelige veien fram dit vi er i dag. Til våre forfedre fra 1912, våre fedre fra 1945, og til oss selv som opplevde 1968, 1981, 1990, 1997 og juni 1999.

Vi er fulle av glede over å få se vår drøm gå i oppfyllelse, selv om prisen og smerten for å nå fram til målet har vært høy. Kosova (albansk skrivemåte for Kosovo, red. anm.) er et lite land, og hver eneste familie der er berørt av 95 års okkupasjon og kamp for selvstendighet. Kosovarenes glede i 1912, etter frigjøringskampen mot tyrkerne, ble kortvarig da det nordlige Albania (Kosova) og andre albanske områder ble okkupert av Stor-Serbia.

Våre bestrebelser for å oppnå frihet ville ikke ført fram om ikke den vestlige verden hadde vært overbevist om at okkupasjonen av Kosova fra 1912 var urett, og at vi som folk, på lik linje med andre folk, har selvbestemmelsesrett og rett til frihet. Det albanske folket opplevde aldri dette i perioden Kosova var under Jugoslavia, og det skulle bli verst under Milosevic.

Slobodan Milosevics regime undertrykte det albanske folket med vold og represalier. Som reaksjon forsøkte kosovarene å løse konflikten med en ikkevoldelig protest ledet av Dr. Ibrahim Rugova. Den demokratiske verden ble vitne til en situasjon som i økende grad viste konturer av et folkemord midt i Europa, og den albanske befolkningen forstod at ikkevoldtaktikken mot Milosevic-regimet ikke nyttet. Dette førte til at noe som startet som en liten bevæpnet motstandsbevegelse under den albanske frigjøringshæren UCK (etablert i hemmelighet på midten av 90-tallet), fikk økt støtte fra folket da dens inspirator Adem Jashari ofret livet sammen med førti familiemedlemmer. Til sammen ble 52 mennesker massakrert av jugoslaviske /serbiske styrker under angrepet på landsbyen Prekaz den 5. mars 1998 i Drenica-dalen.

Denne massakren, og andre som ble begått mellom 1998 og våren 1999, resulterte i at flere tusen mennesker mistet livet. Dette økte oppmerksomheten rundt det som foregikk, man ønsket ikke en repetisjon av Srebrenica-massakren. Men massakrene fortsatte, og den etniske fordrivingen av albanere begynte. Det internasjonale samfunn slo da fast at situasjonen ikke kunne tolereres.

Kosovas befolkning ble til slutt reddet av Nato, etter at den Albanske frigjøringshæren, UCK, hadde ført en ensom «David mot Goliat»-kamp. Nato kom det albanske folket til unnsetning ved bombing, hovedsaklig av militære mål. I denne perioden, fra mars til juli, «hevnet» Milosevic-regimet seg ved å intensivere massakrene og tilintetgjørelsen av albanske bosettinger i Kosova.

Mer enn 10.000 mennesker ble drept, og over 2.000 tatt til fange som levende skjold ved militære installasjoner. Det skulle også ta mer enn to år etter at krigen var over før de fleste av fangene som hadde overlevd ble løslatt. Ennå i dag er mer enn 3.000 mennesker savnet i Kosova. Nato-bombingen kom siden til å markere et viktig historisk vendepunkt i Natos historie: Verdens diktatorer kan ikke lenger regne med å ustraffet utsette «sin» befolkning for folkemord.

Vi håper at Kosovas uavhengighet vil avslutte Balkans kruttønnemareritt.

Når Kosova bygger sin nasjonalstat er det viktig å understreke en felles forståelse kosovarene imellom, om at frihetskampen var rettet mot et regime, ikke mot et folk. Alle kosovarer har like rettigheter og ansvar for sitt land, og sammen skal de bygge en felles framtid. Vi håper at Kosovas uavhengighet vil avslutte Balkans kruttønnemareritt. Kosovas befolkning ser med glede og forventning fram til å endelig ta del i det europeiske fellesskapet som et fritt land. ■

KOSAVA: Barn i landsbyen Brod sør i Kosava. FOTO:MATT ROBINSON, REUTERS/SCANPIX

Referenca nr. 38

Revista "NY TID", 15 shkurt 2008

ORIENTIM

95 vjet pas okupimit, Kosova është e gatshme për një fillim të ri

Përfundimisht Pavarësia

NUFRI LEKAJ
KRYETAR I ZYRËS SË KOSOVËS NË NORVEGJI

Këto ditë shqiptarët janë të mpirë nga gëzimi dhe numërojnë orët deri tek momenti kur ëndrra e gjyshërve tanë do të bëhet realitet. Mendimet tona shkojnë tek rruga e gjatë dhe e mundimshme deri këtu ku kemi arritur të jemi sot. Tek gjyshërit tanë të 1912-s, tek prindërit tanë të 1945-s dhe tek neve të cilët përjetuam 1968, 1981, 1997 dhe qershorin e 1999-s. Jemi të mbushur plot me gëzim që po realizohet ëndrra jonë, edhe pse çmimi dhe dhimbja për të ardhur tek caku kanë qenë shumë të mëdha. Kosova është një vend i vogël, ku çdo familje është prekur gjatë okupimit që filloi para 95 vjetësh dhe lufta për liri. Gëzimi i kosovarëve në vitin 1912, pas një lufte çlirimtare kundër turqve, ishte i shkurtër. Shqipëria e veriut (Kosova) dhe pjesë të tjera shqiptare u okupuan nga Serbia e madhe. Përpjekjet tona për liri nuk do të kishin pasur sukses sikur shtetet perëndimore të mos bindeshin se okupimi i Kosovës në vitin 1912 ishte i padrejtë dhe kundër lirisë. Populli shqiptar në Kosovë asnjëherë nuk e shijoi lirinë gjatë kësaj periudhe dhe më së keqi kaloi nën regjimin e Millosheviqit.

Regjimi i Sllobodan Millosheviqit shtypi popullin shqiptar me dhunë. Si reagim ndaj kësaj, kosovarët u përpoqën ta zgjidhin konfliktin nëpërmes rezistencës jo të dhunshme të udhëhequr nga dr. Ibrahim Rugova. Bota demokratike u bë dëshmitare e një situate e cila tregonte konturat e një gjenocidi në mes të Evropës dhe populli

shqiptar e kuptoi se rezistenca e padhunshme kundër Millosheviqit nuk jepte rezultat. Kjo situatë çoi në shfaqjen e një lëvizje guerile të vogël që u shndërrua në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (e themeluar në fillimvitet e nëntëdhjeta) dhe fitoi një mbështetje të fuqishme pas masakrës ndaj inspiruesit të saj Adem Jasharit dhe 40 anëtarëve të familjes së tij. Në këtë ndodhi u masakruan 52 persona nga ana e forcave jugosllave/serbe gjatë sulmit të tyre në Prekaz më 5 mars 1998 në luginën e Drenicës. Kjo masakër dhe masakrat e tjera që u bënë gjatë periudhës nga mesi i vitit 1998 dhe pranvera e vitit 1999 rezultuan me mijëra jetë të humbura. Kjo shkaktoi ngritjen e vëmendjes se çfarë po ndodh, u rrit frika e përsëritjes së masakrës së Srebrenicës. Masakrat vazhdonin, spastrimi etnik ndaj shqiptarëve filloi. Bashkësia ndërkombëtare vendosi sepse kjo nuk mund të tolerohej.

Populli i Kosovës në fund u shpëtua nga NATO, pasi Ushtria Çlirimtare e Kosovës kishte bërë luftën e vetme të tipit të Davidit me Goliatin. NATO-ja, si shpëtimtare e popullit shqiptar, i bombardoi kryesisht caqet ushtarake serbe. Gjatë kësaj periudhe, nga marsi deri në qershor, regjimi i Millosheviqit në shenjë hakmarrje intensifikoi masakrat dhe shkatërrimin e vendbanimeve shqiptare në Kosovë.

Më shumë se 10 000 njerëz u vranë, më shumë se 2 000 u morën si robër dhe u vendosën si mburoja të gjalla pranë objekteve ushtarake. Kaluan më shumë se dy vjet pas lufte, para se të lirohen robërit që kishin mbetur gjallë. Akoma kanë mbetur më shumë se 3 000 të zhdukur nga Kosova. Bombardimet e NATO-s do të mbesin një moment historik vendimtar për NATO-n: diktatorët nuk mund të llogarisin se nuk do të dënohen po qe se i ekspozojnë ndaj gjenocidit "popujt" e vet.

Tani kur Kosova ndërton shtetin e vet ka rëndësi ta nënvizojmë kontratën e ndërsjellë të kuptueshmërisë në mes të kosovarëve, se lufta çlirimtare ishte e drejtuar ndaj një regjimi e jo ndaj një populli. Të gjithë kosovarët kanë të drejta të barabarta, por edhe përgjegjësi për shtetin e vet dhe së bashku do ta ndërtojnë të ardhmen e tyre të përbashkët. Shpresojmë se pavarësia e Kosovës do të përfundojë ankthin ballkanik - vatrën e barotit. Populli i Kosovës me gëzim pret të marrë pjesë në gjirin e bashkësisë evropiane si shtet i pavarur.

– Til hele den demokratiske verden sier jeg: Takk for at dere tror på oss! Hashim Thaci, statsminister i Kosovo

SAMMEN I JUBELEN: *Kosovo skal være inkluderende og ta vare på alle, lover Hashim Thaci. I gledesrus strømmet jublende mennesker fra fjern og nær ut i gatene i Pristina etter at parlamentet rev Kosovo løs fra Serbia.*

NYTT FLAGG: *Kosovo har fått sin selvstendighet, og sitt eget flagg. Minutter etter at selvstendigheten var et faktum sist søndag, vaiet det i vintervinden.*

HISTORISK ØYEBLIKK: *Statsminister Hashim Thaci har akkurat lest opp uavhengighetserklæringen i parlamentet i Pristina. For bare ni år siden var han geriljaleder i den kosovoalbanske frigjøringshæren UCK, forøvrig sendig erklærte han den tidligere serbiske provinsen uavhengig.*

LIDENSKAPELIG GLEDE: *Titusener av jublende mennesker feiret Kosovos selvstendighet i gatene i Pristina etter at Thaci leste opp den etterlengtede uavhengighetserklæringen.*

PRISTINA (VG)
– Dette er det viktigste øyeblikket i vår historie.

Hashim Thaci lener seg godt tilbake i den dype stolen lengst foran i parlamentet i Pristina. Den høyreiste 39-åringen, slank, rakrygget og nyfrisert, retter diskré på det røde slipset før han med stolthet oppsøker talerstolen.

– I dag har presidenten og jeg invitert dere hit for å erklære uavhengighet for Kosovo og velge våre fremtidige symboler. Vi har ventet på denne dagen lenge, og mange har gitt mye for at vi skal komme dit vi er nå. Jeg takker alle som har kjempet og alle som har dødd for dette øyeblikket, sier Thaci.

På 109 av 120 plasser klapper glade parlamentarikere taktfast. 11 serbiske seter står tomme.

– Jeg er takknemlig overfor det internasjonale samfunn, som har hjulpet oss på veien og respektert vårt folk og våre institusjoner. Fra i dag vil Kosovo være fritt og uavhengig. Vi har aldri mistet troen, vi er stolte over at vi har kommet hit. Det har vært langt å gå, men når vi skal fortelle fremtidige generasjoner om denne dagen, kan vi si at det har vært verdt det, poengterer statsministeren.

Han griper pennen og signerer uavhengighetserklæringen.

På gaten utenfor jubler titusener av euforiske mennesker. I gledesrus setter folk tennene i den gedigne uavhengighetskaken, mens fyrverkeriet fyker til himmels. Ode til gleden fra Beethovens 9. Symfoni runger i bakgrunnen.

Veiene inn til byen er sperret og folk blir brakt inn i busser for å unngå fullstendig kaos.

– En fantastisk dag, sier Petrit Rrukiqi som tripper gjennom byen med et enormt flagg i hånden.

– Jeg har ikke ord for hvor glad jeg er!

Butikkene har i flere dager vært utsolgt for de svarte og røde albanske flaggene, som pryder alle hus, gater og offentlige bygninger. Lidenskapelig glede råder i Pristina.

FIENDE: *Allerede som student startet Hashim Thaci kampen mot Slobodans Milosevics regime.*

- Studerte jus og historie i Sveits
- Førte væpnet kamp mot Milosevic
- Hadde kallenavnet slangen
- Mistenkt for våpen- og narkotikahandel
- Ledet Kosovo-forhandlinger som 30-åring

Det er i dag nøyaktig én uke siden den største drømmen til Hashim Thaci gikk i oppfyllelse: 39-åringen ville gå inn i historien som den første regjeringssjefen i et fritt og uavhengig Kosovo. Og det bare ni år etter at han byttet ut kampuniformen til Kosovos frigjøringshær UCK med skreddersydd dress.

Allerede ved parlamentsvalget i november i fjor viste han hvor populær han er blant kosovoalbanere flest. Hans demokratiske parti PDK fikk 34 prosent av stemmene og ble dermed den førende politiske kraften.

Når han vandrer gjennom Mor Teresa-gaten i Pristina – med et kobbel av livvakter som tar svømmetak i folkemengdene for at statsministeren skal komme seg frem, merker vi raskt at han er avholdt.

28 VG | VG 29

Referenca nr. 39

Gazeta "VG", shkurt 2008

Të gjithë botës demokratike i them: faleminderit që keni besim në ne!

Hashim Thaçi, kryeministër i Kosovës

PRISHTINË (VG)
Ky është momenti më i rëndësishëm në historinë tonë

Hashim Thaçi, i mbështetur mirë, i ulur në karrige në pjesën e përparme të Parlamentit të Kosovës. 39-vjeçari shtatlartë, vital, trupdrejtë dhe me pamje solemne, e drejton në mënyrë të kujdesshme kravatën e kuqe para se të ngrihet për fjalim.

Sot presidenti dhe unë ju kemi ftuar këtu ta shpallim pavarësinë e Kosovës dhe t'i zgjedhim simbolet tona të ardhshme. Kemi pritur gjatë për këtë ditë, është sakrifikuar shumë të arrijmë këtu ku jemi sot. Falënderoj të gjithë ata që kanë luftuar dhe të gjithë ata që kanë vdekur për këtë moment, thotë Thaçi. Në 109 vendet nga 120 vendet e parlamentit, deputetët e gëzuar rrahin shuplaka me një ritëm të njëjtë. 11 vendet e deputetëve serbë janë bosh.

Jam falënderues ndaj bashkësisë ndërkombëtare për ndihmën në rrugën tonë dhe për respektin e treguar ndaj popullit tonë dhe institucioneve tona. Nga sot Kosova do të jetë e lirë dhe e pavarur. Ne kurrë nuk e kemi humbur besimin, ne jemi krenarë që kemi arritur deri këtu. Ka qenë rrugë e gjatë, por kur do t'u rrëfejmë gjeneratave të ardhshme për këtë ditë, mund t'u themi se ia ka vlejtur të rrugëtojmë në rrugën tonë, thekson kryeministri. Ai merr stilolapsin dhe nënshkruan Deklaratën e Pavarësisë.

Jashtë në rrugë në mënyrë euforike ngazëllehen dhjetëra mijëra njerëz, duke shikuar fluturimin e fishekzjarrëve në qiell dhe duke ngrënë ëmbëlsirë nga torta gjigante e pavarësisë. Oda e gëzimit - Symfonia 9 e Betovenit - tingëllon në prapavijë. Rrugët brenda në qytet janë të bllokuara, e për ta shmangur kaosin e tërësishëm të trafikut, njerëzit transportohen me autobusë në qytet. Një ditë fantastike, thotë Petrit Rrukiqi, duke ecur nëpër qytet me një flamur të madh në dorë. Nuk gjej fjalë të përshkruaj se sa i lumtur jam. Ka disa ditë që janë shitur në dyqane të gjithë flamujt shqiptarë kuq e zi, që janë duke i stolisur të gjitha shtëpitë, rrugët dhe ndërtesat publike. Gëzimi i pasionuar mbizotëron në Prishtinë.

Hashim Thaçi që nga koha kur ishte student filloi betejën kundër regjimit të Sllobodan Millosheviqit.

- *Studioi jurisprudencën dhe historinë në Zvicër*
- *Udhëhoqi kryengritjen e armatosur kundër Millosheviqit*
- *Ka pasur pseudonimin "Gjarpri"*
- *I dyshuar për trafikim të armëve dhe narkotikëve*
- *Udhëhoqi negociatat për Kosovën në moshën 30-vjeçare*

Sot bëhet pikërisht një javë prej se ëndrra më e madhe e Hashim Thaçit u bë realitet: 39-vjeçari do të hyjë në histori si kreu i parë i Qeverisë në Kosovën e lirë dhe të pavarur. Kanë kaluar vetëm nëntë vjet qëkur e zëvendësoi uniformën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës me kostumin e qepur nga rrobaqepësi. Zgjedhjet parlamentare të nëntorit të vitit të kaluar treguan se sa është i popullarizuar në mesin e kosovarëve. Partia e tij demokratike, PDK-ja, fitoi 34 për qind të votave, prandaj u bë forca udhëheqëse politike. Kur parakalon nëpër rrugën "Nëna Terezë" në Prishtinë, i rrethuar nga një ekip i truprojave të cilët hapin rrugën në turmën që kryeministri të parakalojë, e vërejmë shpejt se ai është i përmbajtur.

FOTOALBUM

Në klasën e parë të shkollës fillore, Pejë, 1968

Nxënës i shkollës së mesme, Pejë, 1978

Student në Prishtinë, 1981

Me një grup shokësh në shërbimin ushtarak në ish-Jugosllavi, 1982

Pas lirimit nga burgu në fillimvitin 1987, me Ujkan Nikçin dhe Naser Salihajn, Pejë

Fjalim në demonstratën e vitit 1987, në Oslo, me kërkesën: Kosova Republikë



Me Fazli Veliun, kryetar i LPK-së, djv., Zvicër, 1988

Me Fazli Veliun, kryetar i LPK-së, djv., Avni Deharin, redaktor i "Zërit të Kosovës" dhe aktivistin e hershëm të LPK-së, Qani Deharin, Zvicër, 1988

Me shokët, Isa Thaçi, Blerim Rexhepi, Ali Aliu, 1988

Me një grup shokësh të LPK-së në Malmø-Suedi, 1988

Fjalim në demonstratë, Oslo, 1989

Konferencë për shtyp, Osman Osmani, Joe Diogardi, profesor Zekrija Cana, Mehdi Hajdari, Nufri Lekaj, në Komitetin Norvegjez të Helsinkit, 1991

Vizita e delegacionit të Kuvendit të Kosovës pas shpalljes së Deklaratës për Kosovën Republikë (Bujar Gjyrgjeala, Skënder Skënderi, Muharrem Shabani), 1991



Apel për mbështetje të grevistëve për të drejtat e tyre legjitime, Tiranë, 1991

Foto personale e miqve, znj. Berit Backer dhe z. Adem Demaçi, në zyrën time, Komiteti Norvegjez i Helsinkit, 1991

Fotografja e mirënjohur Ann-Christine Ekk, mike e shqiptarëve

Në festën e dasmës, me znj. Berit Backer, 1991

Dorëzimi i peticionit Ministrisë së Jashtme norvegjeze në emër të komunitetit shqiptar dhe kroat në Norvegji, 1993. Pranë meje z. Ivan Poljac, ambasador i parë i Kroacisë në Norvegji.

Vjenë, shëtitje pas një konference, 1993

Përcjellja mortore e znj. Berit Backer. Adem Demaçi, Gazmend Pula, Nufri Lekaj, Shkëlzen Kukleci, Musa Ramadani, Qani Dehari, 1993

Fjalim në takimin e miqësisë norvegjezo-shqiptare, 1994

Fjalim në demonstratë, Oslo, 1995

Demonstrata e 7 marsit 1998 në përkrahje të UÇK-së, në Oslo



Me ushtarin e UÇK-së, Esat Kadriaj, në Tropojë, korrik-gusht 1998

Me Isa Thaçin dhe Esat Kadriajn në Tropojë, korrik 1998

Stafi i Zyrës së Kosovës në Norvegji nga e majta: Fatmir Zymberi, Gëzim Haklaj, Nufri Lekaj, Shkëlzen Kukleci, Bajram Mjeku dhe Sylo Taraku, 1999

Fjalim gjatë hapjes solemne të Përfaqësisë Diplomatike të Kosovës në Norvegji, 1999



Një dolli për të ftuarit me rastin e hapjes solemne të Përfaqësisë Diplomatike të Kosovës në Norvegji, 1999. Pranë meje z. Fatmir Zymberi dhe znj. Maria Warsinska.



Bisedë me z. Blankenborg (kryetar i Komisionit për Politikë të Jashtme në parlamentin norvegjez) me rastin e hapjes solemne të Zyrës së Kosovës në Norvegji, 1999



Fjala përshëndetëse me rastin e njohjes zyrtare të pavarësisë së Kosovës nga shteti norvegjez, 2008

Fjala përshëndetëse e znj. Maria F. Warsinska

Fjala përshëndetëse e kirurgut të mirënjohur z. Erik Fosse

Fjala përshëndetëse e profesorit Svein Mønnesland

Fjala përshëndetëse e z. Sabri Hamitit

Fjala përshëndetëse e z. Xhavit Haliti (duke evokuar kujtime për znj. Berit Backer)

Mirënjohje për gazetarin z. Pål Refsdal

Pasthënie

Bedri Islami, ish-kryetar i LPK-së

Një dëshmi konkrete e angazhimit të personaliteteve të LPK-së në emigracion

Nufri Leka është një ndër emrat më të njohur të shqiptarëve në Skandinavi, sidomos në Norvegji, ku ishte në ekzil dhe ku vazhdon të jetojë edhe pas çlirimit të Kosovës. Ai nuk është bërë rastësisht i tillë dhe, po ashtu, jo rastësisht ka marrë mbi supet e tij një barrë që për shumëkënd është dukur si "e pakohë", "e panevojshme" dhe "e vështirë", por që ka qenë një barrë e domosdoshme. Është bëri i tillë sepse gjithë jetën e tij të ndërgjegjshme, Ai, ashtu si edhe më parë Fisi i tij, e lidhi me realizimin e përcaktimit për një Kosovë të pavarur.

Është dukur "e pakohë" sepse në mendimin e shumë njerëzve, jashtë e brenda në Kosovë, çështja e saj do të zgjidhej apriori nëpërmjet respektimit të të drejtave të njeriut dhe se çështja e Kosovës nuk është shtruar e nuk ka përse të shtrohet për zgjidhje. Kjo gjetje, "e pakohë", dëshmoi se ishte dega e parë nga do të varej pushtimi i përhershëm i Kosovës.

Është quajtur "e panevojshme", veçanërisht pas vitit 1990, sepse tashmë kjo do të ishte një çështje që mund të zgjidhej vetëm nëpërmjet pacifizimit të Kosovës, bisedave pa fund dhe konferencave të shtypit, ndaj nuk është e nevojshme që gjërat të radikalizohen, të ashpërsohen. Kjo gjetje, "e panevojshme", do të ishte një degë tjetër, ku, mjerisht, do të vareshin ëndrrat e thara të njerëzve që kishin aspiruar për shtetin e Kosovës dhe do të paraqiste një shqiptar krejt tjetër, nga sa ishte në përfytyrimin kodik të botës, pra një shqiptar të nënshtruar.

Është quajtur "e vështirë" sepse tashmë Kosova ndodhej para zgjidhjes finale të së ardhmes së saj; pas kësaj etape historike nuk do të mund të kishte një pritje tjetër por, pikërisht sepse do të ishte një ndeshje e fundit, ajo do të ishte edhe më e vështira. Nga njëra anë

ishte një makineri e stërmadhe serbe, e pajisur me mjetet moderne të luftës dhe me një psikologji vandale ndaj shqiptarëve, nga ana tjetër, një popull i shtypur, i çarmatosur, edhe ushtarakisht edhe politikisht, i cili, ashtu si nuk kishte armë, nuk kishte as udhëheqje të denjë drejt zgjidhjes së problemit jetik.

Pikërisht në këtë kohë, kur ishin bërë bashkë "e pamundura" dhe "e vështira", siç propagandonte me zell "alternativa kosovare", për mendimin tim dhe të disa bashkëveprimtarëve, në kuadër të luftës speciale serbe, të inskenuar në Beograd dhe e komanduar nga Beogradi, një strukturë e organizuar që më herët, e cila kishte pasur një "Lindje të përgjakur", Lëvizja Popullore e Kosovës, themeluar më 17 janar 1982, me bashkimin e tri grupimeve politike klandestine të kohës, do ta merrte përsipër trasimin e një rruge të re, qëndrestare, si rruga e fundit, por e domosdoshme. Nufri Lekaj do të ishte një prej përbërësve të këtij grupimi dhe drejtues i saj në viset skandinave, ku ende prania e shqiptarëve nuk ishte aq e madhe sa në disa shtete të tjera, po ku po rritej vrullshëm.

Pasi ka bërë një rrugë të gjatë, që nga viti 1987, kur ai do ta fillojë jetën dhe angazhimet në ekzil, por edhe më herët se kaq, që kur ai nis të bëhet pjesë e lëvizjeve protestuese dhe e të burgosurve politikë, tani, kur, si të them, gjërat kanë filluar ta zënë vendin e tyre dhe lëvizja e "koreve të tokës është qetësuar pas vullkanizimit të Kosovës", ai vjen me një libër, që lexuesit do ta kenë në duart e tyre, si një dëshmi më shumë konkrete e gjërave që duheshin kuptuar shumë më herët, por edhe që u pritën si një përmbysje e fuqishme.

Unë vetë, që pas janarit të vitit 1993, i kam takuar po kësaj strukture, Lëvizjes Popullore të Kosovës, pra duke qenë i brendshëm, shpeshherë kam menduar se di shumë gjëra, për të mos thënë se shumicën e tyre, por libri i Nufriut është një shkollim i mëtejshëm edhe për mua, sepse nëpërmjet këtij libri jo vetëm kureshtja, por edhe vetëdija rizgjohen për të parë një përmasë të re të Lëvizjes, që nga vitet kur ajo ishte e vetmja forcë politike në emigracion, që bënte bashkimin e njerëzve, jashtë çdo përcaktimi ideologjik, fetar apo regjional, deri në përmbylljen e misionit të saj çlirimtar. Por tashmë e parë nëpërmjet jetës së një njeriu, i cili, ashtu si ka qenë pjesë e saj, ka qenë njëkohësisht edhe drejtues.

Përse është i veçantë ky libër, i cili, aq sa është autobiografik, është edhe gjithëpërfshirës?

Libri i dedikohet mikës së madhe të shqiptarëve, zonjës Berit Backer. Ajo, ndoshta si askush tjetër në shtetet skandinave, u bë zëdhënësja e një populli të vuajtur, e cila, pasi i besoi kësaj çështjeje, me gjithë fuqinë e shpirtit të saj, prandaj si pararendje e masakrës serbe, u vra nga një dorë e zgjatur serbe, kur i duhej më së shumti Kosovës dhe çështjes së saj. Dedikimi i librit zonjës Backer është shenjë fisnikërie, sepse dëshmon se populli ynë nuk i harron ata që u sakrifikuan për të, qofshin edhe të largët pasi, duke u bërë pjesë e kauzës sonë, ata u bënë një pjesë e jona. Është edhe më tej se kaq: është dëshmi se njerëzit e një strukture politike, si Lëvizja Popullore e Kosovës, e cila aq shumë është diskredituar e shantazhuar si përçmuese e Perëndimit, e ka gjetur më shpejt dhe më fort se gjithë forcat e tjera politike rrugën e koordinimit me botën perëndimore. Kjo vetvetiu ngjan, siç do të informohem më vonë, në shembullin e bashkëveprimtarit të tij, Ibrahim Kelmendi, i cili qysh në vitin 1978 do ta kishte këshillën e përkrahjen e profesorit të tij gjerman, Jürgen Link, dhe të albanologut kroat Lazër Dodiq, në Universitetin ku ai studionte, për formulimin e Programit dhe të Statutit të Organizatës që e formuan atë vit, të cilit i bëri korrekturë gjuhësore e drejtshkrimore edhe Jusuf Gërvalla, posa u arratis në Gjermani (dhjetor 1980).

Libri i Nufi R. Lekaj dëshmon për këtë të vërtetë, ku edhe në vende me një politikë të mbyllur të brendshme dhe të ftohtë, njëkohësisht ngjarjet e Kosovës do të fillojnë ta zgjojnë vëmendjen e më pas përkushtimin e tyre, duke kaluar nga mosnjohja e çështjes së saj tek ndihma e pakursyer. Në faqet e librit do të gjejmë se si fillon shkrirja e akujve diplomatikë edhe në një "tokë të ngrirë politike", se si nga moskuptimi do të fillojë sqarimi i gjërave. Do të jenë të pranishëm në libër emrat e politikanëve të njohur norvegjezë, danezë e suedezë, me luhatjen dhe praninë e tyre, do të jenë organizata dhe struktura politike e shtetërore, të cilat, njëra pas tjetrës, do të bëhen pjesë e zgjidhjes, por jo zgjidhja vetë; do të jenë diplomatë dhe gazetarë, të cilët, nëpërmjet lidhjeve me strukturat dhe njerëzit e LPK-së, do t'i vendosin lidhjet dhe kontaktet me UÇK-në, pasi mund të kalojë

nëpërmjet së njëjtës derë. Tashmë duhet pohuar, pa asnjë lloj droje, se Lëvizja Popullore e Kosovës në Perëndim ishte UÇK-ja në Perëndim dhe një ndër përfaqësuesit e saj më të vyer e më të devotshëm do të jetë edhe Nufri Leka.

Në parathënien shumë interesante të librit, nëpërmjet së cilës është panorama politike, e deri-diku historike e vendeve skandinave, me theks të veçantë e shtetit norvegjez, politika e sotme në Kosovë, por edhe në Shqipëri, mund ta gjejë mësimin e vyer, se në të mirën e kombit është e domosdoshme ajo që bashkon politikën dhe partitë e këtyre vendeve, krijimi i imazhit dhe linjës së përbashkët, duke u nisur nga pikat pajtuese, e jo nga kundërshtitë... Ky mësim është tepër domethënës për një vend dhe shtet si Kosova, ku çdo gjë po bëhet për herë të parë dhe ku mundësia e gabimeve është shumë më e madhe se kudo tjetër. Dua të besoj se nëpërmjet kësaj parathënie, e cila duhet të ketë qenë qëllimi i fillesës për botimin e këtij libri, janë ngritur edhe disa ngrehina të tjera, të domosdoshme.

Lëvizja Popullore e Kosovës në vendet skandinave e ka zanafillën konkrete qysh në vitet 1979-1982, me bërthamat e saj të para në Suedi e Danimarkë; në Suedi bashkëshortët Shefkate e Nexhmi Sherolli (mitrovicali e porgradecar), bashkëshortët Shehide e Xhemail Duraku (prishtinali), Sherif Gjonbalaj (vuthjan), Fitore Malo (çame), Sherif Osmani (tetovar), bashkëshortët Shpetime e Musli Fida (struganë), Xhelal Ademi e Sadullah Zendeli (gostivarli), Tomë Camaj (malësor i Malësisë së Madhe) e të tjerë, e përforcuar më vonë edhe me veprimtarë të rryer, si Hajdin Abazi dhe të tjerë; në Danimarkë tetovarët Abdyhalim Kasami, Xhemil Zeqiri, Remzi Loku, Xhevahir Fetahu, Besnik Lajçi (rugovas), duke u konsoliduar më vonë me bashkëshortët Emine e Ibrahim Xhemajli (ferizajli), të cilët Lëvizja i caktoi atje për strehim që ta koordinonin organizimin e tyre, e shumë të tjerë; në Norvegji Lëvizja është ngritur më fuqishëm në vitin 1987, si një lëvizje e organizuar, gjysmëklandestine në organizim dhe krejtësisht legale në qëllimin e saj. Ndërkohë, në vendet e tjera, sidomos në Gjermani dhe në Zvicër, lëvizja klandestine kishte thuajse në dekadë që vepronte dhe që nga janari i vitit 1982 edhe si strukturë e mirëfilltë dhe e bashkuar. Shkaku i ngritjes pesë vjet më vonë në Norvegji është tepër i thjeshtë: asokohe atje ende nuk ishte një

emigrim i ndjeshëm numerik shqiptar e, për më tepër, edhe ata që kishin provuar të bënin diçka, pas ndarjes nga trungu i Lëvizjes, si Novosella apo Durmishi, nuk kishin qenë shëmbëlltyrë që duheshin ndjekur. Lëvizja në shtetet skandinave do të krijohej me miratimin e udhëheqjes së saj, si dhe me praninë e përhershme dhe të nevojshme, fillimisht të Ibrahim Kelmendit, më vonë edhe të Jashar Salihajt, Xhavit Halitit, Ali Ahmetit, Gafurr Elshani, Gjyle Krasniqit, e të tjerë, si veprimtarë me njohje të gjerë dhe me ndikim politik e shoqëror; por tashmë ajo edhe në Norvegji do ta gjejë terrenin e saj të vyer dhe të dobishëm. Prania e Nufri Lekajt si pjesë dhe si drejtues është një shkak më tepër për të pasur besueshmëri dhe mbështetje. Kjo ka ndodhur kudo në shtrirjen e kësaj Organizate: krahas vizionit të saj dhe ideve që bartte, të cilat fillimisht nuk ishin aq të kapshme nga njerëzit e thjeshtë e hallexhinj, ajo është mbështetur edhe në imazhin e figurave thellësisht atdhetare dhe me përkushtim.

Ndonëse do të quhej një lëvizje sektare, ajo do të dilte, thuajse gjithnjë, mbi interesat e një strukture politike moniste e autokratike dhe do të bëhej apotheoza e një shtrirje politike të shqiptarëve kudo, nëpërmjet së cilës formë që kanë dashur, edhe kur ka qenë e bindur se mund të ishte paskëtaj në një minorancë politike. Për shumëkënd mund të jetë e çuditshme sot se si nëpërmjet Lëvizjes janë organizuar vizitat e para të Ibrahim Rugovës në vendet skandinave, se si liderët e Lidhjes Demokratike, megjithëse politikisht kundër Lëvizjes, nëpërmjet saj kanë marrë kontaktet dhe janë pritur në qarqet diplomatike, se si ministrat e së ashtuquajturës "Qeveri Bukoshi", po përsëri nëpërmjet Lëvizjes, janë bërë pjesë e pritjeve dhe e takimeve. E më pas, po të njëjtët, ku përsëri del në pah figura kontroverse e Jusuf Buxhovit, do të jenë zëdhënësit më të zëshme kundër prishjes së bashkësive shqiptare, kundër fondeve në ndihmë të Kosovës dhe të burgosurve politikë, në Kosovë dhe në Shqipëri, për të ngritur struktura ndarëse.

Norvegjia, ndryshe nga shtetet e tjera në Perëndim, do të ketë një tablo tjetër përbashkimi, ndarja nuk do të jetë aq gërryese, përdallimet nuk do të jenë aq të thella, dhe kjo ka lidhje me atë që autori nuk e përmend, por që është fakt i njohur, me rolin e tij, si drejtues dhe si personalitet, në mjedisin e kësaj mërgate dhe që do të ketë një fryt të

jashtëzakonshëm gjatë luftës çlirimtare: së fundmi, është i vetmi shtet ku pothuajse e gjithë ndihma e shqiptarëve do të ketë një destinacion: Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

Nëse do të mësosh se si ka rrjedhur ecuria dhe fuqizimi i mbështetjes për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe rrugëtimi i njerëzve drejt saj, ky libër është një vlerë dhe njëkohësisht një dritare e pazakontë. Nëpërmjet fakteve dhe dokumenteve historike, shumica të cituar dhe të botuar në libër, mund të mësosh se është kaluar nëpërmjet shpalljes së fakteve, edhe kur nuk je i besuar; nëpërmjet deklaratave, edhe kur ato janë quajtur heretike; nëpërmjet njohjeve me publicistë dhe aktivistë të të drejtave të njeriut, edhe pse fillimisht kanë qenë të paktë; nëpërmjet botimeve të ndryshëm në shtypin e kohës; edhe pse gazetat bënin kujdes; nëpërmjet takimeve me shtetarë dhe diplomatë; edhe pse ata ishin të vëmendshëm që të mos trazonin Jugosllavinë e mbetur, deri tek kalimi në demonstrata dhe protesta masive... Ky përshkallëzim ka çuar pastaj deri tek njohja, përkrahja dhe mbështetja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Nufri Lekaj i jep të gjitha këto nëpërmjet rrëfimit të tij, në vetën e parë njëjës, por shumëkush mund ta zhvendosë emrin e tij dhe të vendosë një emër apo një shtet tjetër; pasi kjo ka qenë një rrugë e përbashkët, e cila, diku është ndjekur mrekullisht e diku tjetër ka pasur pengesa. Në Norvegji kjo rrugë ka edhe emrin e Nufri Lekajt dhe të Lëvizjes Popullore të Kosovës.

Pas demonstratës dhe metingut masiv të Lëvizjes në mbështetje të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që do të zhvillohej në Gjermani, në vitin 1996, nën kujdesin e Lëvizjes Popullore të Kosovës dhe në drejtimin e Fehmi Lladrovcit, tashmë hero i Kosovës, dhe të Ibrahim Kelmendit, vendi tjetër më i parë ku do të zhvillohej një demonstrim i tillë, do të jetë Norvegjia. Kjo do të jetë edhe pika më kulmore e parapërgatitjes së mbështetjes fuqishëm të luftës dhe kjo u bë realitet, në një masë kohore shumë të shkurtër, që nga dërgimi i ndihmave, vullnetarëve, spitalit fushor e deri tek gazetarët e diplomatët norvegjezë, e më tej, skandinavë apo anglezë. Ka qenë një mbështetje totale, e cila zë vendin e saj të veçantë në historinë e re të Kosovës.

Do të ishte i mangët ky shkrim për librin e Nufri Lekajt nëse nuk do të shtonim diçka edhe për njeriun, për të cilin autori ka “harruar” të

flasë, ose thjesht nuk ka dashur të flasë.

Në librin e tij gjysmëbiografik e gjysmëdokumentar, Nufri Lekaj ka treguar se jeta e tij ka qenë e lidhur me Kosovën pazgjidhshmërisht, edhe pse kjo ka qenë një rrugë e vështirë, e lodhshme dhe mund të kishte edhe rreziqe të tjera përballë vetes, ashtu si ndodhi me zonjën Berit Backer.

Është e nevojshme të themi diçka më shumë: ndoshta mund të përmblidhet edhe thjesht në atë, që ky njeri, gjatë gjithë kohës, ka pasur besimin më të ndjeshëm të strukturave drejtuese të Organizatës dhe mbështetjen e saj. Kjo ka ndodhur sepse, po aq sa ka spikatur roli i tij si drejtues, po aq e ndjeshme ka qenë edhe figura e tij si njeri; aq sa ka qenë ai i besueshëm në radhët e Organizatës, po aq i besueshëm ka qenë ai edhe për diplomacinë ndërkombëtare, se shpeshherë tek figura e tij kanë qenë në një: përmasat e militantit të vyer, e njeriut besnik, e studiuesit të ditur, e gazetarit të pasionuar, e të gjitha bashkë në figurën e një personaliteti që, pasi bëri detyrën e tij ndaj Kosovës, nuk kërkoi shpërblim prej saj, por vazhdon edhe tani, qoftë edhe nëpërmjet këtij libri, ta bëjë punën e tij.

Dhe kjo ka qenë e mbetet një punë e vyer, e dobishme dhe kurdoherë në të mirë të Kosovës dhe të njerëzve të saj.

Ndaj, ashtu si ishte jeta e tij, ashtu është edhe ky libër: i vyer për të gjithë sepse, edhe kësaj here, i shërben përbashkimit të njerëzve. Dhe është i mirëseardhur.

POLITIKA NORDIKE

dhe një rrëfim i Nufri R. Lekës për veprimtarinë e tij në kuadër të organizatës Lëvizja Popullore e Kosovës (LPK)

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

94(496.51)(046)
323.1(496.51: 4/17)(046)

Lekaj, Nufri
Politika nordike : dhe një rrëfim i Nufri R. Lekës për veprimtarinë e tij në kuadër të organizatës Lëvizja Popullore e Kosovës (LPK) / Nufri Lekaj. – Prishtinë : Epoka e Re, 2014. – 267 f. ; 24 cm.

Parathënie : f. 4. – Fotoalbum : f. 235-260

ISBN 978-9951-8503-3-9

Copyrights: Nufri Lekaj